



Republika e Kosovës · Republika Kosovo · Republic of Kosovo  
Institucioni i Avokatit të Popullit · Institucija Ombudsmana · Ombudsperson Institution



# RAPORTI VJETOR 2021

Nr. 21

Prishtinë, 2022

# Përmbajtja

<b>Fjala e Avokatit të Popullit .....</b>	<b>8</b>
<b>I. Institucioni i Avokatit të Popullit.....</b>	<b>10</b>
Roli dhe mandati i Avokatit të Popullit .....	10
Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut .....	11
Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut.....	12
Mandati promovues i të drejtave të njeriut .....	12
Mandati si MKPT .....	12
Mandati si mekanizëm i barazisë .....	12
Instrumentet dhe standardet ndërkombëtare në të cilat mbështetet ushtrimi i funksioneve të Avokatit të Popullit .....	13
Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit .....	13
Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025 dhe Plani i Zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2023.....	13
<b>II. Gjendja e respektimit të të drejtave të njeriut gjatë vitit 2021.....</b>	<b>18</b>
Ecuria e procesit legjislativ .....	18
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave .....	20
Zvarritja e procedurave në rastet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore .....	22
Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve .....	22
Monitorimi i reformës së sistemit të drejtësisë.....	23
Zbatimi i të drejtave të njeriut nga organet ekzekutive .....	24
Mbikëqyrja e të drejtave të njeriut në Forcën e Sigurisë së Kosovës .....	29
Faturimi i energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të vendit .....	31
Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale .....	32
E drejta për qasje në dokumente publike.....	34
Përgjegjësia institucionale për mjedisin jetësor.....	35
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor .....	40
Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut .....	41
<b>III. Të drejtat e fëmijëve .....</b>	<b>50</b>
Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit në fushën e të drejtave të fëmijëve..	52
Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve.....	55
E drejta e fëmijëve për arsim .....	55
Fëmijët me aftësi të kufizuara .....	56
Të drejtat e fëmijëve në procedurat e organeve gjyqësore .....	58
Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve.....	59
Shëndeti mendor i fëmijëve gjatë pandemisë.....	61
<b>IV. Barazia para ligjit .....</b>	<b>62</b>
Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm i mbrojtjes nga diskriminimi.....	62
Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi .....	63
Personat me aftësi të kufizuara .....	64
Mbrojtja e së drejtës për mosdiskriminim në punë.....	69

Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve gjatë pandemisë COVID-19 .....	69
Të drejtat sociale, pensionet, përfitimet sociale dhe të veçanta .....	71
Barazia gjinore .....	72
Barazia gjinore në të drejtën për pronë dhe trashëgimi .....	72
Të drejtat e personave LGBTI.....	73
Përgjegjësia e autoriteteve publike për mbrojtje nga dhuna në familje.....	73
E drejta në mbrojtjen shëndetësore .....	76
Të drejtat e komuniteteve joshumicë.....	77
E drejta për kthim dhe siguri .....	78
Masat e autoriteteve publike për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të komuniteteve joshumicë.....	80
E drejta në arsim.....	82
E drejta në përdorim të gjuhës.....	83
Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian .....	83
Strategjia dhe Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali (2017-2021) .....	84
Grupi teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian .....	84
<b>V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKP) .....</b>	<b>88</b>
Metodologjia e vizitave e MKP-së .....	89
Vizitat e realizuara gjatë vitit 2021 .....	90
Policia e Kosovës .....	91
Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit .....	94
Qendrat për Azilkërkues .....	103
Qendra e Mbajtjes për të Huajt .....	103
Institucionet e shëndetit mendor dhe ato të kujdesit social .....	105
Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës .....	105
Repartit i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik .....	107
Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi .....	110
<b>VI. Qëndrimet e Avokatit të Popullit për të drejtat dhe liritë themelore të shprehura në raportet për rastet e hetuara gjatë vitit 2021.....</b>	<b>112</b>
<b>DINJITETI I NJERIUT, E DREJTA PËR JETËN, MBROJTJA SHËNDETËSORE DHE SOCIALE dhe BARAZIA PARA LIGJIT.....</b>	<b>112</b>
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në shëndetin publik .....	112
Shëndeti mendor dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 .....	113
Dhuna në familje gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë .....	113
Të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 .....	114
Informimi i komuniteteve joshumicë lidhur me pandeminë COVID-19 .....	114
Ndihma ekonomike - procedurat për qasje në Paketën Fiskale Emergjente .....	115
Qasja në arsim dhe në shërbimet shëndetësore e komuniteteve .....	116
Raport ex-officio nr. 621/2018 në lidhje me masat operative parandaluese për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës.....	118

Raport ex-officio nr. 434/2020 përkitazi me kufizimet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë.....	118
Raporti A.nr.645/2020 dhe A.nr.650/2020, në lidhje me diskriminimin për pranimin e kandidatëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021 në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” .....	120
Raport ex officio nr. 150/2021 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje .....	120
Raport ex-officio nr. 698/2020 në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB), gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë.....	121
Raport për rastin A. nr. 822/2017, A. nr. 864/2018, A. nr. 571/2019 dhe A. nr. 518/2020 lidhur me diskriminimin në zbatimin e së drejtës së lirit nga detyrimet e importit për automjete të pasagjerëve për personat me paraplegji dhe tetraplegji si dhe për persona të verbër .....	123
Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen nga dhuna në familje si dhe kundër diskriminimit në bazë gjinore .....	124
Mendim juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkitazi me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, respektivisht mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike për personat me aftësi të kufizuar në hapësirat publike dhe private në Komunën e Prishtinës.....	124
<b>NDALIMI I TORTURËS, TRAJTIMIT MIZOR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES.....</b>	<b>125</b>
Raportet e Avokatit të Popullit në cilësinë e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës .....	125
Të drejtat e personave të privuar nga liria dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 nga këndvështrimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës .....	125
Raport për vizitën në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, në Mitrovicë dhe në Vranidoll .....	126
Raport për vizitën në Qendrën e Mbrojtjes për të Huaj në Vranidoll .....	127
Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë.....	127
Raport për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë .....	128
Raport për vizitën në stacionet policore në Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan .....	129
Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë .....	130
Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë .....	130
Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë .....	130
Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë .....	131
Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren .....	132
Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan .....	132
Raport për vizitën në stacionet policore në Gjilan, Lipjan, Prizren, Ferizaj, Shtime, Shtërpcë, Rahovec, Kamenicë, Viti, Suharekë dhe Malishevë .....	133
Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan....	133
<b>E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË DHE TË PAANSHËM dhe MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE... 134</b>	<b>134</b>
E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (funksionimi i sistemit: gjyqësor, prokurorial, veprimet e policisë në shqiptimin e gjobave, procedura kundërvajtëse gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë).....	134
Raport për rastin A. nr. 482/2019 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë.....	135
Raport për rastin A. nr. 58/2020 në lidhje me zvarritjen e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën C-III-14-0315 .....	136
Raport për rastin A. nr. 543/2020 dhe A. nr. 544/2020 që kanë të bëjnë me vendimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit DM 220/2020 dhe DM 219/2020, të datës 1 shtator 2020.....	136
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 734/2020 .....	137
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 404/2020.....	137

Letër rekomandimi për rastin A. nr. 168/2018 .....	137
<b>E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE .....</b>	<b>138</b>
Raport për rastin A. nr. 512/2021 në lidhje me mungesën e arsytimit dhe të këshillës juridike në vendimin mbi trajtimin e ankesës për mospërzgjedhje për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm .....	138
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 213/2020 .....	138
<b>E DREJTA E PRIVATËSISË.....</b>	<b>139</b>
E drejta e privatësisë gjatë pandemisë COVID-19 .....	139
Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex-officio nr. 711/2020, në lidhje me vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës .....	139
<b>E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE .....</b>	<b>140</b>
Raport për rastin A. nr. 454/2020 kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike .....	140
Raport për rastin A. nr. 658/2020 kundër Komunës së Gjilanit në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike .....	140
Raport për rastin A. nr. 2/2021 kundër Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike.....	141
Raport për rastin A. nr. 756/2020 kundër Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike .....	142
Raport për rastin A. nr. 580/2020 kundër Ministrisë së Pushtetit Lokal në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike.....	142
Raport për rastin A. nr. 739/2020 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike .....	143
Raport për rastin A. nr. 486/2020 kundër Komunës së Mitrovicës Veriore në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike .....	143
Raport për rastin A. nr. 574/2020 kundër Komunës së Mitrovicës Veriore në lidhje me të drejtën e qasjes në dokumente publike .....	144
Raport për rastin A. nr. 737/2020 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike.....	144
Raport për rastin A. nr. 175/2020 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me të drejtën për qasjes në dokumente publike .....	145
Raport për rastin A. nr. 506/2020 kundër Komunës së Ferizajt në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike .....	145
Raport për rastin A. nr. 575/2020 kundër Prokurorisë Themelore në Prishtinë një lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike.....	146
Raport për rastin A. nr. 505/2020 kundër Komunës së Ferizajt në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike .....	146
Raport për rastin A. nr. 187/2021 kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike.....	147
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 205/2021 .....	147
<b>LIRIA E TUBIMIT, LIRIA E BESIMIT, E NDËRGJEGJES DHE E FESË .....</b>	<b>148</b>
Liria e tubimit, liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, si dhe kufizimet e këtyre të drejtave gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë.....	148
<b>LIRIA E SHPREHJES dhe LIRIA E MEDIEVE .....</b>	<b>149</b>
Liria e shprehjes dhe liria e medieeve gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë .....	149
<b>TË DREJTAT ZGJEDHORE DHE TË PJESËMARRJES .....</b>	<b>151</b>
Të drejtat zgjedhore në periudhën e pandemisë COVID-19 .....	151
Raport për rastin A. nr. 757/2020 në lidhje me moszbatimin e nenit 61 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale.....	151
Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën e subjekteve politike: Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK) .....	152
<b>E DREJTA PËR PUNË DHE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT .....</b>	<b>152</b>

Ndikimi i pandemisë në të drejtat sociale dhe ekonomike dhe në të drejtën e punës në sektorin publik dhe privat .....	152
Raport ex-officio nr. 49/2021 në lidhje me të drejtat e nënave (prindërve) vetushqyese në Kosovë lidhur me njohjen e pushimit vjetor edhe për dy ditë pune për prindin vetushqyese, i cili i takon sipas Ligjit nr.03/L-212 të Punës .....	154
Raport për rastin A. nr. 928/2019 lidhur me harmonizimin e Rregullores (MKRS) nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksonimin e Ansambilit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve me Rregulloren (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore .....	154
Raport për rastin A. nr. 933/2019 lidhur me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për Procedurat për Licencimin e Institucioneve Publike Shëndetësore, si dhe zhvillimin e procedurave për licencimin e institucioneve shëndetësore publike.....	155
Opinion i Avokatit të Popullit për kërkesën e Gjykatës Supreme dërguar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e nenit 94 të Ligjit të Punës, që ndërlidhet me kompetencat e Inspektoratit të Punës.....	155
Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar në Gjykatën Supreme (ARJ.nr. 115/2021) nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore .....	156
<b>E DREJTA PËR ARSIMIN dhe TË DREJTAT E FËMIJËS .....</b>	<b>157</b>
Të drejtat e fëmijëve, ndikimi i emergjencës shëndetësore në jetën e fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar, dhe vështirësitë e hasura gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë.....	157
E drejta për arsim dhe për aktivitete kulturore gjatë pandemisë .....	158
Raport ex officio nr. 381/2020 në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës.....	160
Raport ex officio nr. 597/2020 në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë.....	160
Raport për rastin A. nr. 24/2018, A. nr. 790/2018, A. nr. 605/2019, A. nr. 635/2020, A. nr. 534/2020, A. nr. 254/2021 dhe A. nr. 276/2021 në lidhje me mosushtimin e mbikëqyrjes efektive nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ndaj funksionimit të Bartësve të Arsimit të Lartë .....	161
Raport ex officio nr. 69/2021 në lidhje me mungesën e harmonizimit të Ligjit nr. 04/l-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje .....	161
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 152/2020.....	162
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 272/2021 .....	162
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 408/2021.....	162
<b>PËRGJEGJËSIA PËR MJEDISIN JETËSOR .....</b>	<b>163</b>
Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor .....	163
Raport ex officio nr. 365/2018 kundër Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit në lidhje çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjes në dokumente përkritazi me hidrocentralet .....	163
Letër rekomandimi për rastin A. nr. 59/2020.....	164
<b>KUFIZIMI I TË DREJTAVE DHE I LIRIVE THEMELORE .....</b>	<b>165</b>
Raport i veçantë për emergjencën shëndetësore dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës .....	165
Standardet ndërkombëtare dhe praktikata e vendeve me demokraci të zhvilluar .....	165
Kufizimet e të drejtave të njeriut dhe legjislacioni në përgjithësi .....	166
<b>Kërkesat për Masë të Përkohshme .....</b>	<b>168</b>
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar ministrit të Punëve të Brendshme, për pezullimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 07/2017 për ndërrimin e patentë shoferëve të huaj në patentë shoferë të Republikës së Kosovës .....	168
Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronës për pezullimin e zbatimit të vërejtjes së fundit për dëbim dhe kthim të pronës në ripsedim, nr. DS003164 .....	169
<b>Vizita e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në Dhomat e Specializuara të Kosovës ..</b>	<b>169</b>

Qasja në drejtësi dhe e drejta në kompensim e viktimave të krimeve të luftës .....	173
<b>VII. Bashkëpunimi ndërkombëtar .....</b>	<b>176</b>
Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare .....	182
Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare .....	186
Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë .....	187
<b>VIII. Komunikimi me publikun dhe me mediat.....</b>	<b>190</b>
<b>IX. Aktivitetet e Avokatit të Popullit .....</b>	<b>194</b>
Aktivitetet e Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut.....	194
Aktivitetet në promovimin e mbrojtjes nga diskriminimi .....	199
Aktivitetet në promovimin e të drejtave të fëmijëve .....	200
Aktivitetet dhe takimet e MKP-së me institucionet kompetente .....	202
<b>X. Financimi .....</b>	<b>206</b>
Buxheti i IAP-së .....	206
Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës .....	206
Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021 .....	208
<b>XI. Statistikat.....</b>	<b>210</b>
Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve .....	210
Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit - 1 janar 2021 - 31 dhjetor 2021 .....	217
Statistikat mbi treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike .....	222

## Fjala e Avokatit të Popullit

Në përmbushje të obligimit kushtetues dhe ligjor, nëpërmjet Raportit të 21-të vjetor, ia paraqes Kuvendit të Republikës së Kosovës gjendjen e të drejtave të njeriut në Republikën e Kosovës, për vitin 2021.

Raporti paraqet shkallën e respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut në Republikën e Kosovës, në bazë të hetimit dhe analizimit të rasteve të trajtuara në raport me të gjitha nivelet e pushteteve, kryesisht te roli i legjislativit, vendimmarrja dhe miradministrimi i ekzekutivit dhe mbrojtja gjyqësore e të drejtave.

Situata me pandeminë COVID-19, edhe në këtë vit ka vazhduar të mbetet sfidë për të gjithë sektorët, në veçanti për shëndetësinë, arsimin, ekonominë dhe për sektorët e tjerë. Avokati i Popullit më 10 dhjetor 2021 ka publikuar Raportin e veçantë mbi ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë. Në qendër të këtij raporti është vendosur respektimi dhe mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut me rastin e nxjerrjes së vendimeve për masat mbrojtëse nga pandemia.

Theksoj faktin se edhe në këtë vit janë adresuar një numër i madh i ankesave për zvarritje të procedurave gjyqësore. Ndërsa mungesa e një mekanizmi ligjor, i cili do të mundësonte kompensimin e palëve për mbrojtjen e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm kohor, vazhdon të mbetet shqetësim i Avokatit të Popullit.





Për vëmendjen tuaj ritheksoj se konstatimet dhe rekomandimet që kam adresuar përgjatë këtij viti janë përpjekje e vazhdueshme dhe përkushtim i Avokatit të Popullit që në thelb kanë respektimin, avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Prandaj, në këtë kontekst, shpresoj se këto konstatime dhe rekomandime, të paraqitura në këtë Raport, do të marrin vëmendjen e merituar të autoriteteve, në mënyrë që ky dokument të jetë një udhëzues për orientimin e politikave të funksionimit të shtetit, në pajtim me parimin e respektimit të të drejtave të njeriut, të barazisë, të epërsisë së sundimit të ligjit, të transparencës, të llogaridhënies, si vlera të demokracisë.

Përgjegjësi për të gjitha institucionet mbetet shkalla e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Kuvendi i Republikës së Kosovës ka rol vendimtar dhe besoj se do të ketë përkushtim dhe angazhim që, duke kërkuar përgjegjësi dhe llogaridhënie nga autoritetet publike, të kërkojë zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Zbatimi i rekomandimeve drejtpërdrejt do ta avancojnë respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore për qytetarët e këtij vendi, të cilët presin, kërkojnë dhe e meritojnë.

# I. Institucioni i Avokatit të Popullit

## Roli dhe mandati i Avokatit të Popullit

Avokati i Popullit është institucion i themeluar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me mandat kryesor: mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut. Kushtetuta i përcakton parimet themelore të organizimit dhe të funksionimit të tij. Në ushtrimin e mandatit të tij, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimi i pavarësisë institucionale, funksionale dhe buxhetore. Në kuptim të kësaj të fundit, paragrafi 2 i nenit 132 të Kushtetutës e përcakton parimin e mosndërhyrjes dhe të ndalimit të marrjes së udhëzimeve nga cilido autoritet në Republikën e Kosovës. Kushtetuta gjithashtu e përcakton parimin e detyrimit të çdo institucioni publik për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit. Sipas paragrafit 4 të nenit 134 të Kushtetutës, Avokati i Popullit gëzon imunitet nga ndjekja penale, nga paditë civile ose nga shkarkimi për veprimet ose vendimet e tij. Avokati i Popullit paraqet Raport vjetor në Kuvendin e Republikës së Kosovës për gjendjen e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore në vend. Funksionin e tij, Avokati i Popullit e ushtron në bazë të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit. Sipas këtij ligji, Avokati i Popullit udhëhiqet nga parimet e paanësisë, pavarësisë, epërsisë së të drejtave të njeriut, konfidencialitetit dhe profesionalizmit,<sup>1</sup> si dhe ka pavarësi organizative, administrative e financiare.

1 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 3, paragrafi 1.



Ligji e përcakton Avokatin e Popullit si mekanizëm ligjor për mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe promovimin e të drejtave dhe të lirive themelore nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme dhe të parregullta të autoriteteve publike, të institucioneve dhe të personave apo të autoriteteve të tjera të cilat ushtrojnë autorizime publike në Republikën e Kosovës, dhe si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.<sup>2</sup> Gjithashtu, Avokati i Popullit përfaqëson mekanizmin e barazisë, i cili promovon, monitoron dhe mbështet trajtimin e barabartë, pa diskriminim në bazat e përcaktuara me Ligjin për Barazi Gjinore dhe me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi.<sup>3</sup>

Sipas Ligjit për Barazi Gjinore, Avokati i Popullit është institucion i barazisë gjinore që trajton rastet që lidhen me diskriminimin gjinor, në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin për Avokatin e Popullit.<sup>4</sup> Ndërsa sipas Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit bën promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe trajton rastet që kanë të bëjnë me diskriminimin, sipas ligjit përkatës për Avokatin e Popullit.<sup>5</sup> Me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, Avokati i Popullit është përcaktuar si mekanizëm nacional për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Gjithashtu ka një numër ligjesh që përcaktojnë kompetenca shtesë për Avokatin e Popullit.<sup>6</sup>

## Mandati i mbrojtjes së të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të hetimit të rasteve të ngritura nga ankuesit, hetimit sipas detyrës zyrtare të një shkeljeje të mundshme, mekanizmit të kontestimit të një akti të administratës në cilësinë e mbrojtësit të interesit publik, dhënies së rekomandimeve të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, dhënies së opinionëve në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curie*), dhënies së rekomandimeve individuale për rastet e zvarritjes së rasteve gjyqësore, udhëheqjes së procedurës së ndërmjetësimit dhe të pajtimit, dhënies së asistencës së viktimave të

2 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 1, paragrafi 1

3 Po aty, neni 1, paragrafi 2.

4 Ligji nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore, neni 13.

5 Ligji nr. 05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, neni 9.

6 Ligji për Qasje në Dokumente Publike (Nr. 06/L-081), Ligji për Procedurën Kontestimore (Nr. 03/L-006), Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë (Nr. 03/L-063), Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat (Nr. 03/L-222), Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Ligji për Konfliktet Administrative (Nr. 03/L-202), Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës (Nr. 03/L-047), Ligji Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes (Nr. 02/L-65), Ligji mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (Nr. 04/L-149), Kodi i Procedurës Penale i Kosovës (Nr. 04/L-123), Ligji për Përdorimin e Gjuhëve (Nr. 02/L-37), Ligji për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve (Nr. 06/L-057)

diskriminimit, dhënien e rekomandimeve për institucionet publike për zbatimin e duhur të detyrimeve në fushën e ndalimit të diskriminimit dhe të barazisë, referon çështje në Gjykatën Kushtetuese dhe në mekanizma të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## **Mandati i mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut**

Avokati i Popullit ushtron mandatin e mbikëqyrjes së respektimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të monitorimit të rasteve gjyqësore, ku palët kanë një status të viktimit të pretenduar të të drejtave të njeriut, ose ku sipas detyrës zyrtare konsiderohet se mund të ketë shkelje sistematike të të drejtave të njeriut; nëpërmjet mekanizmit të detyrimit të autoriteteve publike për t'u përgjigjur në kërkesat e Avokatit të Popullit; monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga Avokati i Popullit; mbikëqyrjen e standardit të hartimit të legjislativimit sa u përket përcaktimeve të të drejtave të njeriut dhe përputhshmërisë me Kushtetutën; monitorimit të zbatimit të ligjeve që kanë për fokus të drejtat e njeriut; dhe mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## **Mandati promovues i të drejtave të njeriut**

Avokati i Popullit ushtron mandatin e promovimit të të drejtave të njeriut nëpërmjet mekanizmit të ngritjes së vetëdijesimit të opinionit të publikut dhe të institucioneve publike për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore, nëpërmjet edukimit, trajnimeve dhe ligjëratave, publikimit të opinioneve dhe të broshurave që paraqesin qëndrimin e Avokatit të Popullit për një çështje të caktuar, deklaratave për zbatim të masave të caktuara, organizimin e ditëve të hapura për të drejtat e njeriut, organizimin e konferencave, tryezave tematike, bashkëpunimit dhe bashkërendimit të punës me partnerë social, shkëmbimin e vizitave me institucione homologe, paraqitjes në media të opinioneve të Avokatit të Popullit dhe të mekanizmave të tjerë që përcaktohen me ligje të veçanta.

## **Mandati si MKPT**

Avokati i Popullit ushtron mandatin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese, përmes vizitave të rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor, paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin e emigrantëve dhe çdo vend tjetër ku dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut. Në pajtim me Ligjin për Avokatin e Popullit jep rekomandime për përputhshmërinë e ligjeve dhe të akteve të tjera me Kushtetutën dhe me standardet ndërkombëtare në parandalimin e torturës. MKPT-ja bashkëpunon me mekanizmat ndërkombëtarë, vendorë dhe me mekanizmat e tjerë që përcaktohen me ligj të veçantë në fushën e parandalimit të torturës.

## **Mandati si mekanizëm i barazisë**

Avokati i Popullit ushtron mandatin e tij si mekanizëm i barazisë për promovim, monitorim dhe mbështetje të trajtimit të barabartë pa diskriminim në bazat e mbrojtura nga Ligji për Barazi Gjinore dhe nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe në përputhje me Ligjin për Avokatin e Popullit. Një mandat të tillë, Avokati i Popullit e ushtron përmes hetimit të rasteve të diskriminimit, të mbikëqyrjes së zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të promovimit të praktikave të mira në promovimin e barazisë, të informimit të publikut për rastet e diskriminimit, trajtimin e rasteve që lidhen me diskriminimin gjinor, dhe bashkëpunon me partnerë socialë, me organizata joqeveritare vendore dhe ndërkombëtare.

## **Instrumentet dhe standardet ndërkombëtare në të cilat mbështetet ushtrimi i funksioneve të Avokatit të Popullit**

Avokati i Popullit ushtron mandatin, para së gjithash, duke u mbështetur në instrumentet ndërkombëtare të përfshira në nenin 22 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike dhe Protokollet e saj, Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Racor, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Gruas, Konventa për të Drejtat e Fëmijës, Konventa kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese dhe Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës kundër Grave dhe Dhunës në Familje. Avokati i Popullit gjithashtu merr në konsideratë edhe instrumentet e tjera me karakter universal, të cilat, edhe pse nuk janë të përfshira në të drejtën e brendshme, ato kanë një status të çmuar në demokracitë e konsoliduara. Disa nga to janë: Konventa mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga Zhdukja me Forcë, Konventa e OKB-së për Refugjat etj. Avokati i Popullit gjithashtu zbaton një numër standardesh ndërkombëtare, siç janë: Parimet e Parisit, Parimet e Venedikut etj.

## **Qasja në Institucionin e Avokatit të Popullit**

Qytetarët të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre nga autoritetet publike të Republikës së Kosovës, mund t'i drejtohen Avokatit të Popullit çdo ditë pune nëpërmjet zyrave të Avokatit të Popullit, nëpërmjet Zyrës Qendrore në Prishtinë dhe nëpërmjet zyrave rajonale: në Gjiilan, në Ferizaj, në Prizren, në Gjakovë, në Pejë, në Mitrovicën Jugore, në Mitrovicën Veriore dhe në Graçanicë. Përveç qasjes fizike, qytetarët mund t'i drejtohen Avokatit të Popullit edhe nëpërmjet postës, telefonit, rrjetit social Facebook, nëpërmjet postës elektronike dhe nëpërmjet linjës telefonike falas në numrin: 080015555.

Avokati i Popullit kryen vizita të rregullta në të gjitha burgjet, në qendrat e ndalimit policor dhe në qendrat e paraburgimit. Për të mundësuar komunikim të drejtpërdrejtë me të burgosurit, me të paraburgosurit dhe me të ndaluarit, në të gjitha burgjet dhe në qendrat e paraburgimit në Republikën e Kosovës, në vende të dukshme, ka vendosur kutitë postare për pranimin e ankesave, të cilat menaxhohen dhe mbikëqyren nga Avokati i Popullit.

## **Strategjia e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025 dhe Plani i Zbatimit të Strategjisë së Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2023**

Me qëllim të avancimit të zbatimit të mandatit të tij, Avokati i Popullit, më 18 mars 2021, ka miratuar Strategjinë e Institucionit të Avokatit të Popullit 2021-2025. Strategjia zbatohet nëpërmjet planit trevjeçar të Zbatimit e Strategjisë 2021-2023, i cili është pjesë përbërëse e Strategjisë. Strategjia ka përcaktuar vizionin, misionin, objektivat strategjike dhe ato specifike dhe veprimet që synojnë ta udhëheqin punën e IAP-së në periudhë afatmesme në zbatimin e përgjegjësive dhe të kompetencave kushtetuese, të Ligjit për Avokatin e Popullit, të Ligjit për Barazi Gjinore dhe të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, të legjisllacionit tjetër në fuqi në Kosovë dhe të standardeve ndërkombëtare.

Strategjia e IAP-së ka për qëllim rritjen e ndikimit të punës së Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe në promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale, edukimin për të drejtat e njeriut, si dhe në parandalimin e shkeljeve nga ana e institucioneve publike. Identifikimi dhe hetimi i rasteve ex-officio dhe i shkeljeve sistematike, ngritja e numrit

të rasteve individuale, hetimi dhe shqyrtimi efektiv i tyre janë synime në të cilat do të përqendrohen kapacitetet institucionale.

Strategjia synon ngritjen e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit dhe thellimin e bashkëpunimit me komisionet relevante të Kuvendit të Republikës së Kosovës, me institucionet e nivelit qendror dhe lokal, me mediat, me shoqërinë civile, si dhe me organizatat ndërkombëtare në vend, me mekanizmat ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe të barazisë. Të gjitha këto synime do të realizohen nëpërmjet katër qëllimeve strategjike:

1. Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij.
2. Promovimi i të drejtave dhe i lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së.
3. Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm.
4. Zhvillimi i mëtejshëm i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP-së.

Risi dhe hap i rëndësishëm është qëllimi strategjik për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe lidhjen e tyre me të drejtat e njeriut, si dhe ndërtimi i një sistemi për gjenerimin e të dhënave në raport me indikatorët OZhQ-së.

Strategjia e IAP-së 2021-2025, përveç si një dokument planifikues, shërben edhe si dokument me anë të të cilit duhet të vlerësohet performanca e institucionit. Strategjia, plani i saj i zbatimit 2021-2023 dhe procesi i saj i vazhdueshëm i monitorimit dhe i raportimit duhet të shërbejnë si bazë për përmirësimin e procesit të vendimmarrjes strategjike të IAP-së për pesë vjetët e ardhshme.

## PJESA E QENDRORE E STRATEGJISË



QËLLIMET E PËRGJITHSHME



OBJEKTIVAT SPECIFIKE



TREGUESIT



CAQET

## QËLLIMET STRATEGJIKE

### 01

Mbrojtja dhe mbikëqyrja e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përmes ndikimit të shtuar të Institucionit të Avokatit të Popullit në përmbushjen e mandatit të tij.

- Mbrojtja dhe mbikëqyrja e respektimit të të drejtave të njeriut, me fokus edhe në rastet sistematike me interes të përgjithshëm
- Përmirësimi i efikasitetit dhe efektivitetit në shqyrtimin e ankesave dhe rasteve ex-officio
- Rritja e shkallës së zbatimit të rekomandimeve të IAP-së
- Mbikëqyrja e legjislacionit në raport me të drejtat dhe liritë e njeriut në Kosovë

### 02

Promovimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe roli i IAP-së.

- Vetëdijesimi i publikut për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut
- Promovimi dhe edukimi për të drejtat e njeriut tek institucionet përgjegjëse për zbatimin e standardeve kushtetuese dhe ligjore në vend
- Rritja e bashkëpunimit të IAP-së me institucionet e tjera dhe organizata joqeveritare
- Avancimi i komunikimit të vazhdueshëm dhe ndërgjegjësimit për rolin dhe rëndësinë e IAP-së



## 03

Promovimi i Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ).

- Zhvillimi i programeve vetëdijesuese për promovimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm
- Zhvillimi i një sistemi për gjenerimin e të dhënave në raport me indikatorët e OZhQ-së mbi mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut nga IAP-ja.
- Avancimi i kapaciteteve të stafit të IAP-së për promovimin e OZhQ-së, adresimin e tyre dhe ndërlidhjen e tyre me të drejtat e njeriut
- Bashkëpunimi ndërkombëtar në ndërtimin e kapaciteteve reciproke, shkëmbimi i përvojave dhe praktikave të mira me vendet rajonale drejt arritjes së progresit në promovimin dhe adresimin e OZhQ-së

## 04

Zhvillimi i mëtjejmë i kapaciteteve institucionale dhe i burimeve njerëzore të IAP-së.

- Ofrimi i vazhdueshëm i mundësive për mësim dhe zhvillim profesional për stafin e IAP-së
- Rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar për stafin përmes programeve të shkëmbimit
- Forcimi i kapaciteteve institucionale, të administratës dhe të menaxhimit të brendshëm të IAP-së, përfshirë përmes rishikimit funksional dhe të akteve të brendshme normative

## II. Gjendja e respektimit të të drejtave të njeriut gjatë vitit 2021

### Ecuria e procesit legjislativ

Avokati i Popullit, ngjashëm sikurse në vitet e kaluara, ka ndjekur procesin legjislativ në nivelin e Qeverisë dhe në Kuvendin e Republikës së Kosovës sa i përket përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga e drejta e të drejtave të njeriut. Fokus i mbikëqyrjes së Avokatit të Popullit ka qenë vlerësimi i përputhshmërisë së projektligjeve/ligjeve me standardet e të drejtave të njeriut dhe atë në kuptim të përmbushjes së detyrimeve pozitive të shtetit për t'i rregulluar të drejtat dhe liritë e caktuara përmes nxjerrjes së ligjeve.

Avokati i Popullit ka vërejtur që në Programin Legjislativ për vitin 2021<sup>7</sup>, Qeveria e Republikës së Kosovës ka paraparë shqyrtimin dhe miratimin e 186 projektligjeve (106 projektligje të reja dhe 80 projektligje për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve ekzistuese). Nga to, Kuvendi ka miratuar vetëm 36 ligje. Shkalla e ulët e përmbushjes së Programit Legjislativ për ligjet që afektojnë

7 Programi Legjislativ për vitin 2021 është miratuar në mbledhjen e 11-të të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/11, i datës 7.5.2021, i ndryshuar dhe plotësuar me Vendimin nr. 12/16, i datës 22.6.2021, me Vendimin nr. 23/16, i datës 22.6.2021, me Vendimin nr. 06/17, i datës 26.6.2021, me Vendimin nr. 02/31, i datës 25.8.2021, me Vendimin nr. 01/34, i datës 8.9.2021, dhe me Vendimin nr. 02/42, i datës 27.10.2021.



të drejtat e njeriut ka rezultuar me mungesë të zbatimit të detyrimeve pozitive të autoritetit publik përballë qytetarëve.

Ndër projektligjet që i kanë arritur Kuvendit për shqyrtim dhe miratim është edhe Projektkodi Civil i Kosovës. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit në vitet e kaluara kishte dërguar komente me qëllim që Projektkodi, në përputhje me kërkesat e së drejtës kushtetuese për respektimin e jetës familjare, t'i përfshinte shprehimisht dispozitat ligjore për njohjen dhe mbrojtjen e marrëdhënieve homoseksuale, qoftë edhe në formë jomartësore.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka vërejtur se në Projektkodin Civil është zbatuar rekomandimi i Avokatit të Popullit i publikuar në Raportin ex-officio 206/2019 lidhur me parandalimin e martesave të fëmijëve.

Projektligji për Zyrtarët Publikë dhe Projektligji për Paga në Sektorin Publik janë në proces të hartimit në nivelin ministror. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit vazhdon të mbajë qëndrimin që gjatë hartimit të këtyre dy projektligjeve, të merren parasysh në mënyrë të detajuar aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese dhe të përfshihen në tërësi kërkesat e gjykatës lidhur me këto projektligje.

Avokati i Popullit vazhdon të konstatojë që mungesa e versioneve të konsoliduara të legjislacionit të plotësuar/ndryshuar e të publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës përbën një barrierë në të drejtën për qasje në informacion të qytetarëve. Avokati i Popullit konstaton se mungesa e miratimit të një ligji për pagat në sektorin publik rezulton me mungesë të zbatimit të parimit të barazisë në kompensim të të punësuarve në këtë sektor. Avokati i Popullit do të vazhdojë ta ndjekë gjithashtu draftimin e projektligjeve të fushës të së drejtës së punës, të fushës së shërbimeve sociale dhe familjare, të fushës së skemave pensionale të financuara nga shteti, të fushës së vlerësimit dhe njohjes së statusit dhe përfitimet e shërbimet e personave me aftësi të kufizuara, të fushës së shëndetit në punë, të fushës së mbrojtjes nga dhuna në familje, të fushës së restituimit të pronës etj.

Avokati i Popullit rikujton që mosfillimi i zbatimit të një numri ligjesh përbën një shkelje të të drejtave të subjekteve që rrjedhin nga ligjet e tilla. Një shembull konkret është mungesa

## Mbrojtja gjyqësore e të drejtave

Sundimi i ligjit është një ndër parimet kryesore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës.

Neni 54 i Kushtetutës së vendit përcakton qartë se çdokush ka të drejtë për mbrojtje gjyqësore në rast të shkeljes apo të mohimit të ndonjë të drejte që është e garantuar me Kushtetutë. Po ashtu, Kushtetuta i garanton secilit të drejtën për mjete juridike efektive, nëse konstatohet se e drejta e tij/saj është shkelur.

Mbrojtjen e të drejtave të njeriut në gjykatë e plotëson edhe kontrolli gjyqësor i administratës (kontrolli i kushtetutshmërisë dhe i ligjshmërisë së akteve të caktuara të organeve të administratës), me të cilat vendoset për të drejtën e ndokujt, obligimin apo interesin e bazuar në ligj.

Njëra ndër sfidat e vazhdueshme të sistemit gjyqësor mbetet moszbatimi i plotë i standardeve për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, siç parashihet me nenin 53 të Kushtetutës, sipas të cilit interpretimi i të drejtave në fjalë duhet të bëhet në pajtim me vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNj). Referimet në praktikën e GjEDNj-së nga ana e gjykatave të rregullta gjatë arsyesimit të vendimeve të tyre vazhdojnë të jenë të pakta.

## Zvarritja e procedurave gjyqësore

Avokati i Popullit konstaton se një ndër problemet më serioze në kuptim të mbrojtjes gjyqësore të të drejtave në Republikën e Kosovës është zvarritja e procedurave gjyqësore. Edhe përkundër progresit të arritur nga gjyqësori për shqyrtimin e rasteve, ende ka zvarritje të procedurave gjyqësore, para së gjithash si pasojë e numrit të madh të lëndëve të pazgjidhura nga vitet paraprake, pastaj nga paraqitja e rasteve të reja si dhe nga prishja e vendimeve duke vendosur nga gjykatat më të larta sipas mjeteve juridike të zakonshme dhe të jashtëzakonshme në procedura ankimore, si dhe kthimi i tyre në rishqyrtim dhe rivendosje.

Duke pasur parasysh maksimumin “*Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar*” si dhe “*Ta vonosh drejtësinë dhe ta mohosh drejtësinë është e njëjta gjë*” (sipas Magna Carta), zvarritja e procedurave gjyqësore paraqet shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të qytetarëve të garantuara me Kushtetutë.

Avokati i Popullit konstaton se në rritjen e numrit të rasteve në gjykata ka ndikuar fakti se ekzekutivi nuk ka arritur t’i përmbushte në mënyrë sistematike detyrimet që dalin nga kontrata kolektive lidhur me pagat jubilarë, shpenzimet e udhëtimit, shujtat, diferencat në pagë etj. Kjo situatë, përveçqë ka rënduar gjendjen me numrin e lëndëve në gjykata, ka shkakuar pasoja dhe dëme të tjera, ashtu që ka vështirësuar realizimin e të drejtave të punëtorëve dhe në anën tjetër ka krijuar shpenzime të panev-ojshme për buxhetin e shtetit. Nuk është vërejtur asnjë përpjekje e autoriteteve publike për ta zgjidhur këtë problem.

Zvarritja e procedurave gjyqësore është edhe si rezultat i mungesës së kapaciteteve, që po ashtu ka ndikuar në kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, prandaj Avokati i Popullit vëren se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta mbështesë sistemin gjyqësor me buxhet dhe t'i aprovojë kërkesat për rritjen e kapaciteteve për të dhënë kontributin e saj për rritjen e efikasitetit dhe shkurtime të afatit për përfundimin e procedurave gjyqësore në një afat të arsyeshëm kohor dhe në harmoni me nenin 31, paragrafi 2, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Në të gjitha rastet e ankesave të cilat janë në kompetencë të tij, lidhur me zvarritjet e procedurave gjyqësore nga gjykatat, Avokati i Popullit ka zhvilluar hetime dhe ka reaguar te rastet kur ka konstatuar se ka zvarritje të procedurave gjyqësore dhe në disa raste gjykata ka marrë parasysh këto reagime duke i proceduar këto raste.<sup>8</sup> Ankesat e pranura gjatë vitit raportues për zvarritjen e procedurave kryesisht kanë të bëjnë me zvarritje të procedurave lidhur me kontestet e natyrave juridiko-civile, me konfliktet administrative, me zvarritjen e procedurave penale<sup>9</sup> (hetime joefikase dhe joefektive).

Gjithashtu Avokati i Popullit edhe gjatë vitit raportues ka pranuar kërkesa për monitorim të seancave gjyqësore në procedura penale<sup>10</sup> dhe civile<sup>11</sup>, me pretendime për mungesë të objektivitetit të gjyqtarëve gjatë vendosjes së rasteve të tyre.

Vështirësitë në realizimin e të drejtave gjyqësore të qytetarëve para organeve të drejtësisë, tek qytetarët kanë krijuar perceptime dhe opinione publike të mosbesimit në punën e gjyqësorit,<sup>12</sup> përkundër kryerjes së lëndëve të shumta gjyqësore, disa prej të cilave janë kryer në afate optimale.

Një problem shqetësues për qytetarët e vendit vazhdon të mbetet mungesa e një mekanizmi ligjor për mbrojtjen e së drejtës së gjykimit në afat të arsyeshëm kohor, i cili do të mundësonte kompensimin e palëve për shkak të dëmit të shkaktuar material. Për këtë çështje Avokati i Popullit në vitin 2018 i ka rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës<sup>13</sup> për nxjerrjen e ligjit për përcaktimin e mjeteve efektive juridike për kompensimin në rastet e shkeljes të së drejtës për mbrojtje gjyqësore në kohë të arsyeshme.

Avokati i Popullit konstaton se pandemia COVID-19 ishte një sfidë shtesë për sistemin gjyqësor dhe ndikoi në mbajtjen e seancave dhe qasjen e publikut në to. Si rrjedhojë e gjendjes së krijuar vazhduan zvarritjet edhe gjatë vitit raportues. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin e veçantë për emergjencën shëndetësore dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës<sup>14</sup>.

8 Ankesa nr. 580/2021, Ankesa nr.316/2021, Ankesa nr.231/2021, e cila është monitoruar nga përfaqësuesit e IAP-së, Ankesa nr.135/2021, Ankesa nr. 717/2020 etj.

9 Ankesa nr.537/2021, Ankesa nr.597/2021 etj.

10 IAP-ja ka monitoruar seancat gjyqësore të rastit A.nr. 131/2021, të cilat vazhdojnë edhe në vitin 2022.

11 IAP-ja ka monitoruar seancat gjyqësore në rastet A.nr.306/2021, 231/2021 etj.

12 Pretendim i bazuar në shumë nga ankesat e qytetarëve të parashtruara te Avokati i Popullit; gjithashtu, <https://www.gjyqesori-rks.org/>, sipas rezulateve të vlerësimit online të gjykatave në lidhje me shkallën e kënaqshmërisë me shërbimet e gjykatave, vërehet se qytetarët deri diku janë të kënaqur me shërbimet e Gjykatës Themelore në Prishtinë 89.42% dhe të Gjykatës Themelore në Gjakovë me 85.77%, ndërsa qytetarët më së paku janë të kënaqur me shërbimet e Gjykatës së Apelit, por edhe gjykatat e tjera janë nën nivelin e 65.45%.

13 Raport me rekomandime ex-officio 129/2018, <https://oik-rks.org/2018/03/29/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1292018/>

14 <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/>

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, Avokati i Popullit ka publikuar katër raporte me rekomandime dhe tri letër rekomandime ndaj gjykatave. Te rasti A. nr. 482/2019, ankuesi kishte parashtruar ankesë në IAP në lidhje me zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë, pas publikimit të raportit, gjykata ka nxjerrë vendim meritore lidhur me rastin. Rasti A.nr.58/2020, ankesa kundër Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) në lëndën C-III-14-0315, pas hetimeve ishte konstatuar shkelje e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor, prandaj Avokati i Popullit i kishte rekomanduar DhPGjSK-së që t'i ndërmerrte të gjitha veprimet e nevojshme për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës dhe ky rekomandim është në pritje për t'u zbatuar.

Rasti Ex officio nr.150/2021, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, pas hetimit të rastit, Avokati i Popullit kishte nxjerrë tri rekomandime për Policinë e Kosovës, të cilat janë zbatuar, një rekomandim për KGJK-në dhe KPK-në, i cili po ashtu është zbatuar, ndërsa rekomandimi për KGJK-në<sup>15</sup> është në pritje për implementim.

Te rastet A.nr. 168/2018, A.nr.404/2020 dhe A.nr.734/2020, ankesat në IAP ishin paraqitur lidhur me zvarritjen e procedurës gjyqësore në Gjykatën Themelore në Prishtinë. Avokati i Popullit, pasi kishte analizuar shkresat e rasteve dhe kishte kryer hetimet e nevojshme, kishte gjetur shkelje, prandaj kishte publikuar tri letra me rekomandime në kuptim të rekomandimit të shqyrtimit dhe vendosjes sa më të shpejtë lëndëve të caktuara.

## Zvarritja e procedurave në rastet e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka pranuar ankesa ndaj AKP-së lidhur me mosnjohjen e të drejtave të punëtorëve që rrjedhin nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka vërejtur se vazhdon praktika e zvarritjeve procedurale në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës lidhur me ankesat e parashtruara nga ish-punëtorët e ndërmarrjeve shoqërore. Përkitazi me këtë çështje, Avokati i Popullit ka publikuar raporte dhe ka rekomanduar që pa vonesa të mëtejme të vendoset për çështjet që janë në shqyrtim nga kjo gjykatë. Lidhur me rastet e tilla, Avokati i Popullit edhe në vitet e kaluara ka ngritur shqetësime për zvarritjen e procedurave lidhur me vendosjen e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat e punëtorëve që rrjedhin nga procesi i privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore, vonesa këto që e cenojnë të drejtën kushtetuese për gjykim të drejtë dhe të paanshëm.

## Përgjegjësia disiplinore e gjyqtarëve dhe e prokurorëve

Ligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve i jep kompetenca Avokatit të Popullit, ndër të cilat edhe: kompetencën për t'ia dërguar autoritetit kompetent ankesën e pranuar ndaj një gjyqtari ose prokurori; kompetencën për t'i kërkuar Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Këshillit Gjyqësor të Kosovës fillimin e procedurës disiplinore; dhe kompetencën për të ushtruar ankesë te Gjykata Supreme, në rastet e përcaktuara me ligj.

Avokati i Popullit, edhe në raportet vjetore të kaluara, ka theksuar se kompetencat e lartpërmendura janë kompetenca shtesë të Avokatit të Popullit, duke marrë parasysh Ligjin për Avokatin e Popullit dhe ligjet e tjera në fuqi. Avokati i Popullit, bazuar në nenin 16,

15 Rekomandimi për KGJK-në ishte: "Këshilli Gjyqësor të kërkojë nga të gjithë gjykatësit që në të gjitha rastet kur marrin vendim për urdhër mbrojtje, të veprojnë në pajtim me nenin 17, paragrafi 2, të Ligjit nr. 03/L-182 për Mbrojtje nga Dhuna në Familje."

paragrafi 8, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor dhe nuk mund të ndërhyjë në rastet dhe as në procedurat e tjera ligjore që janë duke u zhvilluar nëpër gjykata, përveç rasteve kur ka zvarritje të procedurave. Për sa i përket kompetencës për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore, Ligji 05/L-019 për Avokatin e Popullit, në nenin 25, paragrafi 2, e njeh këtë kompetencë vetëm në një situatë specifike - në rastet e dështimit për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit: *“Refuzimi për të bashkëpunuar me Avokatin e Popullit nga nëpunësi civil, funksionari ose nga autoriteti publik përbën shkak që Avokati i Popullit të kërkojë nga organi kompetent fillimin e procedurës administrative duke përfshirë marrjen e masave disiplinore, deri në largimin nga puna ose nga shërbimi civil.”* Megjithatë, siç u pa më sipër, Ligji nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe të Prokurorëve i jep Avokatit të Popullit kompetencën për të kërkuar fillimin e procedurës disiplinore edhe në raste të tjera të parapara në nenet 9.5 dhe 9.7 të ligjit, si dhe kompetencën për të ushtruar ankesë tek Gjykata Supreme, në raste të caktuara.

Gjatë vitit raportues, duke u bazuar në Ligjin nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit ka pranuar gjithsej 12 ankesa, prej të cilave 9 ankesa janë shpallur të pranueshme dhe 3 ankesa të papranueshme. Vlen të theksohet se Avokati i Popullit në të gjitha këto raste, brenda afatit ligjor, ka pranuar përgjigje nga autoritetet përgjegjëse dhe ka pasur bashkëpunim të mirë me autoritetet kompetente sa i përket shqyrtimit të këtyre ankesave të qytetarëve brenda afateve të parapara me ligj. Nga 9 ankesat të cilat janë shpallur të pranueshme nga Avokati i Popullit dhe janë hapur për hetim, 2 prej tyre janë paraqitur bazuar në nenin 12.3 të Ligjit nr.06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve: *“Avokati i Popullit mund të kërkojë nga Këshilli që të filloj hetimet disiplinore ndaj një Kryetari të Gjykatës ose Kryeprokurorit nëse kanë arsye të besojnë se ai/ajo ka kryer shkelje disiplinore sipas nenit 9, paragrafi 7 i këtij Ligji.”* Pas hetimit të këtyre rasteve është konstatuar se ankesat e palëve nuk kanë përmbushur kërkesat e nenit 9, pika 7, të Ligjit nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, prandaj rastet nuk janë proceduar për fillim të hetimeve disiplinore nga Këshilli përkatës. Sa i përket shtatë ankesave të tjera të shpallura si të pranueshme nga Avokati i Popullit, ato janë proceduar sipas kërkesave të ankuesve për trajtim të mëtejshëm nga autoritetet kompetente dhe në përputhje me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, Avokati i Popullit i ka pranuar vendimet e autoriteteve kompetente brenda afatit të paraparë me ligj dhe i ka njoftuar ankuesit me vendimet që ka pranuar.

## Monitorimi i reformës së sistemit të drejtësisë

Në muajin korrik 2021 është miratuar Strategjia për Sundimin e Ligjit 2021-2026,<sup>16</sup> pjesë përbërëse e Strategjisë është edhe Plani i Veprimit, ku në mënyrë specifike janë paraqitur të gjitha aktivitetet, në kuadër të masave të politikave që parashihet të ndërmerren nga Qeveria, Ministria e Drejtësisë, KGJK-ja, KPK-ja, Akademia e Drejtësisë, Policia e Kosovës dhe nga institucionet e tjera relevante, për t'i adresuar problemet e identifikuar dhe për t'i arritur objektivat e synuara.

Sipas strategjisë në fjalë, parashihet që për funksionimin e duhur dhe të pavarur të gjyqësorit janë të rëndësishme: efikasiteti, profesionalizmi, llogaridhënia dhe integriteti. Më tutje sipas strategjisë, si probleme kryesore janë identifikuar: vonesat në sistemin gjyqësor dhe prokurorial, nevoja për rritje të profesionalizmit dhe të kompetencës, llogaridhënia e pamjaftueshme dhe sistemi i cenueshëm ndaj aktorëve të jashtëm. Duke u bazuar në këto,

16 <https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>

Avokati i Popullit konsideron se është e një rëndësie të veçantë reforma në drejtësi përmes zbatimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit nga institucionet e drejtësisë.

Megjithatë, Avokati i Popullit rikujton nevojën e respektimit të opinionëve të Komisionit të Venedikut sa u përket instrumenteve të reformës në drejtësi, me theks të veçantë në respektimin e standardeve të pavarësisë gjyqësore, paanshmërisë së gjyqtarit dhe mbrojtjes së pushtetit gjyqësor dhe prokurorial nga ndërhyrjet politike. Avokati i Popullit do të vazhdojë të monitorojë dhe të ofrojë rekomandime që reforma në sistemin e drejtësisë të bëhet në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare.

Sa u përket mbrojtjes së të drejtave dhe të lirive të njeriut në lëmin e gjyqësorit, dihet se Avokati i Popullit ka mandat të kufizuar, të përcaktuar me Ligjin për Avokatin e Popullit, sipas të cilit Avokati i Popullit mund të japë rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor, duke mos ndërhyrë në raste dhe në procedura ligjore që janë duke u zhvilluar në gjykata, përveç çështjeve që kanë të bëjnë me rastet e zvarritjeve të procedurave gjyqësore.

## Zbatimi i të drejtave të njeriut nga organet ekzekutive

Avokati i Popullit ka vazhduar të mbikëqyrë përshtatjen e punës së administratës dhe të organeve ekzekutive në përgjithësi me obligimet që lindin nga e drejta për të drejtat e njeriut. Në këtë aspekt kujdes i është kushtuar mbikëqyrjes së vendimeve të Qeverisë në respektimin e të drejtave të njeriut dhe miradministrimit, me theks të veçantë në mbikëqyrjen e vendimeve të Qeverisë në fushën e masave kufizuese për menaxhimin e Pandemisë COVID-19.

Sikur edhe në vitin e kaluar, edhe gjatë vitit raportues puna e pushtetit ekzekutiv është karakterizuar në masë të madhe me pandeminë COVID-19.

Avokati i Popullit ka ndjekur me vëmendje çështjet që ndërlidhen me ndikimin e vendimeve të Qeverisë. Në këtë drejtim, më 10 dhjetor 2021, Avokati i Popullit ka publikuar një raport gjithëpërfshirës *“Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës”*. Gjetjet kryesore të këtij raporti, në mes të tjerash, janë: mungesa e buxhetit për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor, mungesa e trajtimit adekuat të personave të sëmurë kronikë gjatë pandemisë, mungesa e planifikimit të ndarjes së mjeteve financiare për mbështetjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje në periudhë pandemie etj.

Lidhur me çështjet që ndërlidhen me pandeminë, Avokati i Popullit ka pranuar një numër ankesash që kanë të bëjnë me kriteret e vendosura nga Qeveria për posedimin e certifikatës së vaksinimit me dy doza kundër COVID-19. Megjithëse në vendimet e Qeverisë lidhur me masat për parandalimin e COVID-19 vaksinimi shprehimisht nuk bëhet i obligueshëm, por vetë masat e vendosura e parashohin si kusht në mënyrë që qytetarët të mundë t'i qasen objekteve publike si dhe hyrjes në Republikën e Kosovës. Avokati i Popullit vlerëson se Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në Territorin e Republikës së Kosovës e autorizon Ministrinë e Shëndetësisë që në kohën sa zgjat pandemia COVID-19, përveç autorizimeve nga Ligji nr. 02/L-109 për Luftimin dhe Parandalimin e Sëmundjeve Ngjithëse dhe Ligji nr. 04/L-125 për Shëndetësi, që të ketë autoritet të kufizimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut, përjashtimisht ato të specifikuara në nenin 56 (2) të Kushtetutës, për aq sa një gjë e tillë është e domosdoshme për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19.



Në anën tjetër, praktika e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sipas së cilës interpretohen të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, në rastin *Varvicka dhe të tjerët kundër Republikës Çeke*, ka vlerësuar se vaksinimi paraqet një kufizim të së drejtës në jetën private. Megjithatë gjykata vlerëson se një kufizim i tillë arsyetohet për shkak se kjo është e domosdoshëm për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe të shëndetit publik në përgjithësi.

Avokati i Popullit gjatë vitit raportues ka nxjerrë edhe një numër raportesh të veçanta për organet ekzekutive të nivelit qendror dhe lokal. Gjetjet kryesore të Avokatit të Popullit lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut do të paraqiten në bazë të konstatimeve dhe raporteve me rekomandime, të cilat Avokati i Popullit i ka adresuar për pushtetin ekzekutiv.

- Shërbimet e kujdesit shëndetësor të personave të prekur me virusin HIV dhe me Tuberkuloz, në rrethanat e krijuara si pasojë e pandemisë COVID-19 dhe me fokus për personat me HIV dhe TB në Kosovë si dhe domosdoshmërinë e qasjes së tyre në shërbime shëndetësore në kohë pandemie. Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave të paraqitura dhe të fakteve të mbledhura, si dhe analizimit të ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën e personave të infektuar me HIV/AIDS dhe me TB në Kosovë, konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, meqë autoritetet përkatëse nuk kanë arritur t'i përmbushnin detyrimet kushtetuese dhe ligjore kundrejt personave të infektuar me HIV/AIDS dhe me TB, si pasojë e gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19.
- Çështja e realizimit efektiv të të drejtave shëndetësore gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, në raport me qasjen në kujdes dhe trajtim shëndetësor, kryesisht në institucionet e nivelit sekondar dhe terciar, duke u ndalur në veçanti tek kufizimet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore (vizitat specialistike dhe operacioneve elektive) për personat që nuk ishin të infektuar me COVID-19. Avokati i Popullit, në mes të tjerash, ka gjetur se veprimi i autoriteteve shëndetësore përkritazi me ndërprerjen e operacioneve elektive dhe ambulancave specialistike, përveçse nuk kishte bazë juridike, nuk kishte lënë asnjë lloj alternative se ku mund të trajtoheshin këta persona dhe se shteti nuk kishte marrë përgjegjësitë që i takonin, përfshirë kostot financiare nëse këto shërbime eventualisht mund të merreshin në institucionet private shëndetësore.
- Çështja e ligjshmërisë së operimit të hidrocentraleve në Deçan, si dhe hidrocentraleve në Shtërpce. Pas analizës së rastit, Avokati i Popullit ka konstatuar se organet kompetente përkundër ndikimit në mjedis të hidrocentraleve, reagimeve, pakënaqësive dhe protestave të qytetarëve dhe shoqërisë civile, nuk janë përpjekur të jepnin informata të sakta lidhur me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve, dhe respektimit të parimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje.
- Avokati i Popullit ka konstatuar se Republika e Kosovës nuk e ka përmbushur në tërësi obligimin e saj pozitiv për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje për shkak të moszbatimit të dispozitave të Ligjit për Monitorimin Elektronik, në bazë të informatave të grumbulluara nga Policia e Kosovës, Prokuroritë Themelore dhe nga Gjykatat Themelore.
- Avokati i Popullit ka trajtuar detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje. Lidhur me këtë është publikuar raport që trajton vrasjen dhe vetëvrasjen, e cila ndodhi më 14 mars 2021, në lagjen Emshir në Prishtinë, me ç' rast mediat raportuan se një burrë ka vrarë me armë zjarri gruan e vet, e pastaj bëri vetëvrasje. Avokati i Popullit ka konstatuar se përkundër faktit se nga viti 2013 është hartuar Procedura Standarde e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, në të cilën janë përcaktuar edhe lista të kontrollit për veprimet që duhet t'i ndërmarrin autoritetet përgjegjëse, në rastin konkret këto procedura nuk janë respektuar, se autoritetet përgjegjëse nuk e kishin vlerësuar mjaftueshëm rrezikun potencial të rastit dhe se kishte munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet

autoriteteve, gjë që shtron nevojën e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të secilit institucion, prej momentit të paraqitjes së rastit të dhunës në familje e deri në përfundimin e tij.

- Gjatë vitit raportues Avokati ka nxjerrë një raport lidhur me të drejtat e nënave (prindërve) vetushqyese për pushime të përcaktuara me Ligjin e Punës, përkatësisht përcaktimit ligjor sipas të cilit nënat me fëmijë deri në tre vjeç, prindi vetushqyese dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për dy ditë pune shtesë. Në rastin konkret, Avokati i Popullit ka konstatuar se ka shkelje të Ligjit të Punës dhe ka rikujtuar se diskriminimi në fushën e punës është i ndaluar.
- Me qëllim të përmirësimit të situatës së zbatimit në praktikë të Ligjit të Punës, Avokati i Popullit ka dërguar Opinion në Gjykatën Kushtetuese për një çështje e cila është ngritur nga Gjykata Supreme e që ka të bëjë me vlerësimin e nenit 94 të Ligjit të Punës, që ndërlidhet me kompetencat e Inspektoratit të Punës. Përmes këtij Opinioni, Avokati i Popullit ka theksuar se shqyrtimi i rasteve që kanë të bëjnë me ndërprerjen e kontratës së punës, kompensimet që u takojnë punonjësve sipas këtij ligji, si dhe kthimin e punëtorit në punë dhe kompensimet e pagave gjatë kohës së largimit të kundërligjshëm nga puna nga Inspektorati i Punës, përbën tejkalim të kompetencave nga Inspektorati i Punës e që rrjedhimisht rezulton me cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, sepse një organ i cili vepron në kuadër të pushtetit ekzekutiv nuk mund të shqyrtojë dhe të vendosë çështje të cilat ligji shprehimisht i ka lënë në kompetencë të gjykatave, pra në kuadër të pushtetit gjyqësor. Avokati i Popullit thekson se kjo çështje nuk është vendosur nga Gjykata Kushtetuese deri në kohën e përpilimit të këtij raporti.
- Janë trajtuar ankesat e studentëve dhe të ish-studentëve të kolegjeve private, bartës të arsimit të lartë në Kosovë, që lidhen me mosnjohjen/mosverifikimin e diplomave. Avokati i Popullit ka nxjerrë një raport me të cilin ka trajtuar çështjen e ankuesëve, të cilët kishin përfunduar programet studimore në Bartës të Arsimit të Lartë (BAL), në drejtime të cilat nuk kishin pasur akreditim dhe as licencë dhe çështjen e regjistrimit në kolegji, i cili kishte akreditim, mirëpo me rastin e përfundimit të studimeve, kolegjit i ishte refuzuar kërkesa për riakreditim dhe si pasojë në këto raste diplomat e ankuesëve ishin të pavlefshme. Në rastet e tjera, ankuesëve nuk mund t'u njihen/verifikohen diplomat për shkak të mosdorëzimit të librave amë nga BAL-i dhe të njëjtët po ashtu nuk mund t'i vijojnë studimet më tej dhe as studimet jashtë vendit. Raporti vlerëson se mosveprimi i institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore ka krijuar hapësirë që BAL-i të funksionojë në kundërshtim me dispozitat ligjore, në mungesë të akreditimit dhe mosadministrimit në mënyrë të duhur të dokumentacionit përkatës, siç parashihet me dispozita ligjore. Duke qenë se akreditimi është proces që garanton se një institucion i arsimit të lartë dhe programet e tij i plotësojnë standardet ndërkombëtare të pranuar të cilësisë dhe se kualifikimet e lëshuara nga BAL-i u japin bartësve të tyre një numër të drejtash, Avokati i Popullit konstaton se disa BAL kanë lëshuar diploma në kundërshtim të plotë me procedurat e akreditimit dhe të licencimit. Avokati i Popullit ka nxjerrë edhe një numër raportesh me rekomandime lidhur me ndryshimin apo nxjerrjen akteve normative.
- Avokati i Popullit ka vërejtur se Ligji për Kundërvajtje përcakton se askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje për veprën e cila para se të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte (rregullore komunale) të kuvendit të komunës dhe për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës. Për më tepër, Ligji për Kundërvajtje obligon që dispozitat për kundërvajtje që nuk janë në pajtim me të, përfshirë këtu edhe dispozitat e Ligjit për Arsimin Parauniversitar, të harmonizohen brenda afatit prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për Kundërvajtje. Avokati i Popullit më tej ka vërejtur se nga hyrja në fuqi e Ligjit për Kundërvajtje kanë kaluar më shumë se katër vjet, prandaj ka rekomanduar ndryshimin

dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenet 15 dhe 47 të harmonizohen me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje.

- Avokati i Popullit ka trajtuar çështjen lidhur me faktin se në disa komuna të Kosovës, përpos kritereve ligjore të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ MASHT nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, ato kanë vendosur edhe kritere shtesë për pranimin e fëmijëve në çerdhe publike. Me kriterin shtesë kërkohej që të dy prindërit duhet të jenë në marrëdhënie pune dhe se ky kriter është vendosur nga institucionet parashkollore për shkak të kapaciteteve të kufizuara. Avokati i Popullit vlerëson se Udhëzimi Administrativ Nr. 19/ 2016 nuk është i qartë, konciz dhe se normat përkatëse të tij janë kundërthënës, nuk kanë konsistencë si dhe nuk janë në pajtim me parimet bazë dhe autorizimet që dalin nga Ligji për Edukimin Parashkollor dhe si i tillë mund të konsiderohet si bazë për diskriminim. Prandaj ka rekomanduar ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë duke rregulluar, pos të tjerash, procedurën dhe kriteret në pajtim me parimet bazë të Ligjit nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor.
- Avokati i Popullit ka nxjerrë raport me rekomandime me të cilin ka vënë në pah mungesën e akteve nënligjore për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës si dhe mosrespektimit të afateve ligjore për nxjerrjen e të gjitha akteve të parapara me ligjin në fjalë. Avokati i Popullit ka vërejtur se nga 18 akte nënligjore sa ishin paraparë me ligj, ishin nxjerrë vetëm 2, prandaj u ka rekomanduar institucioneve përkatëse nxjerrjen sa më shpejt të tyre.
- Avokati i Popullit ka nxjerrë rekomandime për kryetarin e komunës së Graçanicës dhe për Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, përkitazi me moszbatimin e nenit 61 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 5, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkryetarëve në Komuna. Rasti ka të bëjë me mosemërimin e nënkryetarit të komuniteteve në komunën e Graçanicës. Gjatë hetimit të rastit është vërejtur se ka mospërputhje në emërtim të nenit 60 mes gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe, si dhe të nenit 61, që në praktikë mund të sjellë paqartësi rreth zbatimit të ligjit. Prandaj Avokati i Popullit, përveç që ka kërkuar nga MAPL-ja mbikëqyrjen e zbatimit të nenit 61, që ka të bëjë me emërimin e nënkryetarit të komunës, gjë që nuk ishte iniciuar nga kryetari i komunës së Graçanicës pothuajse përgjatë gjithë mandatit të tij si kryetar komune, po ashtu ka kërkuar edhe harmonizimit gjuhësor të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht nenet 60 dhe 61.
- Avokati i Popullit ka kërkuar nga Ministria e Shëndetësisë nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për Procedurat për Licencimin e Institucioneve Publike Shëndetësore si dhe zbatimin e nenit 42 të Ligjit nr. 04/L-125 për Shëndetësi, që ka të bëjë me licencimin dhe akreditimin e institucioneve publike dhe private shëndetësore. Sipas nenit 42 të Ligjit për Shëndetësinë, MSh-ja obligohet që të ketë akt nënligjor për procedurat për licencimin e institucioneve shëndetësore. Avokati i Popullit ka vërejtur se MSh-ja ka nxjerrë udhëzim administrativ për procedurat për licencimin e institucioneve shëndetësore private, por nuk ka nxjerrë një udhëzim të tillë për institucionet shëndetësore publike. MSh-ja nuk e ka zbatuar tërësisht obligimin që rrjedh nga neni 42 i Ligjit për Shëndetësinë, sipas të cilit duhet të ketë bazë ligjore për licencimin dhe akreditimin e institucioneve shëndetësore, pa dallim. Prandaj e konsideron të domosdoshme që MSh-ja t'i ndërmarrë veprimet urgjente për nxjerrjen e udhëzimit administrativ për procedurat për licencimin e institucioneve shëndetësore publike.
- Avokati i Popullit ka rekomanduar ndryshimin e Rregullores së MKRS nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funkcionimin e Ansambllit Rezydent të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve me Rregulloren e Qeverisë (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Performuesve të Kulturës Profesionale të Trashëgimisë Kulturore, për

shkak se kishte nocione të paqarta dhe të pa harmonizuara. Avokati i Popullit ka vërejtur se në nenin 8 të Rregullores nr. 04/2019, si përvojë pune njihet vetëm përvoja e aktorëve, të cilët janë punësuar si anëtarë të rregullt të ansamblit rezident apo të teatrove simotra, mirëpo nuk përcaktohen kriteret e tjera sipas të cilave mund të kategorizohen aktorët. Në këtë rast, sipas përmbajtjes së dispozitës në fjalë, është e paqartë se a merret parasysh përvoja e realizuar në teatrot e qytetit, si kriter për kategorizimin e aktorëve. Avokati i Popullit konsideron se mangësitë në aktet normative ndikojnë në sundimin e ligjit, përkatësisht në sigurinë juridike. Me sigurinë juridike kërkohet që rregullat ligjore të jenë të qarta dhe precize, me të cilat synohet parashikimi i situatave dhe veprimet ose premtimet e dhëna individëve nga shteti (pritjet legjitime) duhet të respektohen.

- Avokati i Popullit ka pranuar ankesa individuale lidhur me zbatimin e Ligjit për Zyrtarët Publikë, me ç' rast ka hasur në rrethana kur autoritetet kanë bërë interpretimin e gabuar të këtij ligji. Në njërin nga ankesat e pranuar, Avokati i Popullit është vënë në dijeni se Ministria e Punëve të Brendshme ka interpretuar gabimisht dispozitën që rregullon pushimin vjetor. MPB-ja në vend se këto dispozita të fillonte së zbatuari nga hyrja në fuqi e Ligjit për Zyrtarët Publikë, MPB-ja ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë në mënyrë retroaktive duke i zbritur numrin e ditëve të pushimit vjetor të fituara në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikë së Kosovës.
- Interpretim të gabuar të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët Publikë, Avokati i Popullit ka hasur edhe gjatë hetimit të të dy ankesave individuale kundër Agjencisë Kosovare të Privatizimit me rastin e nxjerrjes së vendimeve për shqiptimin e masës së pezullimit parandalues, për shkak të inicimit të procedurës penale. Vërehet se AKP-ja ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Zyrtarët Publikë (neni 58, paragrafi 4) për procedurat që kanë filluar në kohën kur ky ligj nuk ishte në fuqi. Çështja e pezullimit nuk ka filluar me hyrjen në fuqi të Ligjit për Zyrtarët Publikë, por ankuesit kanë vazhduar të jenë të pezulluar deri në një vendim të gjykatës kompetente. Zbatimi retroaktiv i ligjit drejtpërdrejt ndikon në sigurinë juridike dhe rrjedhimisht edhe në sundimin e ligjit. Zbatimi retroaktiv i ligjit, përveçse ndërlihet drejtpërdrejt me sigurinë juridike të palëve, ai mund të shkaktojë dëme të pariparueshme për palët ndaj të cilave janë duke u zhvilluar procedurat. Zbatimi retroaktiv i ligjit parimisht është i ndaluar, përveç në rastet kur kjo lejohet me ligj dhe kur një gjë e tillë është më e favorshme për palët. Së këndejmi, Avokati i Popullit vlerëson si të domosdoshme ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve që merren me zbatimin e ligjit, sepse në rastin konkret kemi të bëjmë jo vetëm me keqinterpretim të ligjit, por edhe me shkeljen e parimeve themelore në zbatimin e ligjit.
- Avokati i Popullit ka trajtuar një numër ankesash individuale kundër Doganës së Kosovës lidhur me privilegjin doganor për lehtësimet doganore për importin e automjeteve të pasagjerëve, të përshtatura për nevojat e personave me aftësi të kufizuar, të cilin, sipas ankesave të pranuar, Dogana e Kosovës ua mundëson vetëm një kategori personash me aftësi të kufizuara nga mosha 18 vjeç, duke mos marrë parasysh dhe duke mos bërë dallim në bazë të shkallës dhe natyrës së mungesës së aftësisë së tyre fizike. Avokati i Popullit ka konstatuar se Dogana e Kosovës, duke vendosur një kusht të përgjithshëm - posedimin e patentë shoferit për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, i përjashton personat me paraplegji, tetraplegji, personat e verbër, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara, që ta gëzojnë të drejtën e dhënë ligjërisht për privilegjet doganore në fjalë. Kushti i vënë për përfituesit e së drejtës në fjalë, për shkak të natyrës së invaliditetit të tyre, është një kusht objektivisht i pamundur, të cilin ata nuk mund ta plotësojnë në asnjë mënyrë dhe i vendos ata në një pozitë të pabarabartë në raport me kategorinë tjetër të personave me aftësi të kufizuara, për të cilët, për nga natyra dhe shkalla e aftësisë së tyre të kufizuar, ky kusht është i realizueshëm. Prandaj Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime për Doganën e Kosovës që të krijojë kushte për zbatimin e plotë të së

drejtës së dhënë me ligj për lehtësimet doganore me mundësi të ushtrimit indirekt të të drejtave të përfituesit përmes kujdestarit ligjor ose personave të autorizuar, të pajisur me patentë shoferi dhe që praktikantët e veta të jenë në pajtim me legjislacionin për mbrojtje nga diskriminimi.

Avokati i Popullit vlerëson bashkëpunimin dhe gatishmërinë e pushtetit ekzekutiv për t'u përgjigjur kërkesave lidhur me rastet që Avokati i Popullit i ka hapur për hetim. Megjithatë, niveli i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit mbetet relativisht i ulët.

Avokati i Popullit vlerëson kërkesën e kryeministrit drejtuar ministrave të Qeverisë së vendit me të cilën ua rikujton indikatorin e shtatë në kuadër të Kontratës së Reformave Sektoriale në Administratën Publike, i cili ka të bëjë me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson kërkesën e kryeministrit për prioritizimin e shqyrtimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit ka analizuar Raportin e Sigma-s, lidhur me monitorimin e parimeve të administratës publike për vitin 2021. Sipas këtij raporti, shkalla e ulët e zbatimit të rekomandimeve të IAP-së vlerësohet shqetësuese. Në këtë drejtim, sipas këtij raporti, rekomandohet që Kuvendi i Republikës së Kosovës duhet ta rrisë bashkëpunimin me IAP-në, me qëllimin për të rritur përgjegjshmërinë e administratës publike në drejtim të zbatimit të rekomandimeve të IAP-së.

Më tej Avokati i Popullit ka vërejtur se sipas këtij raporti, vlerësohet se, edhe përkundër bazës së mjaftueshme ligjore, IAP-ja nuk ka mundur të ishte efektive, për shkak se zbatimi i rekomandimeve nga organet e administratës shtetërore është duke u përkeqësuar (zbatimi i rekomandimeve në vitin 2020 është 19%).

Sipas këtij raporti vlerësohet se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur IAP-së dhe për këto arsye IAP-ja nuk ka arritur që ta ushtronte mandatin e saj në drejtim të mbikëqyrjes dhe sanksionimit të ekzekutivit. Ky raport vazhdimisht e përsërit qëndrimin se duhet të forcohet bashkëpunimi ndërmjet Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe IAP-së në mënyrë që të ngrihet shkalla e zbatimit të rekomandimeve të IAP-së, sepse sipas vlerësimit aktual të këtij raporti, shkalla e zbatimit të rekomandimeve të IAP-së është alarmante. Avokati i Popullit thekson se përgjegjësia e zbatimit të rekomandimeve bie mbi autoritetet publike të cilave u janë adresuar këto rekomandime. Ndërsa në lidhje me nivelin e zbatimit të rekomandimeve, Avokati i Popullit sqaron se nivelet e raportuara të zbatimit të rekomandimeve rriten në mënyrë progresive çdo vit pas raportimit, ashtu që niveli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2020 nga 19% sa është raportuar në raportin vjetor, ka arritur tashmë në 43%.

Avokati i Popullit konstaton që janë identifikuar një numër çështjesh që e ndërlidhin aktivitetin e pushtetit ekzekutiv me standardet e të drejtave të njeriut, për të cilat do të vazhdohet të ushtrohet mbikëqyrje dhe raportim. Avokati i Popullit thekson rëndësinë e rritjes së transparencës dhe të llogaridhënies, të miradministrimit dhe respektimit e rekomandimeve të Avokatit të Popullit. Institucionet ekzekutive do të duhej të kishin një kujdes të veçantë në hartimin e akteve nënligjore në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, si dhe respektimin e standardeve ndërkombëtare sa u përket kufizimeve të të drejtave të njeriut përmes vendimeve të Qeverisë.

## **Mbikëqyrja e të drejtave të njeriut në Forcën e Sigurisë së Kosovës**

Mandati kushtetues dhe ligjor i Avokatit të Popullit në Kosovë e bën atë autoritet mbikëqyrës edhe për sektorin e sigurisë, përfshirë këtu Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Kushtetuta e vendit qartësisht saktëson: *“Kontrolli civil dhe demokratik mbi institucionet e sigurisë garantohet.”* (Kapitulli XI Sektori i Sigurisë, neni 125, paragrafi 4). Mbikëqyrja dhe kontrolli civil demokratik përcaktohet po ashtu në nenin 14 të Ligjit nr. 06/L-123 për Forcën e Sigurisë së Kosovës, i cili është në fuqi që nga janari 2019. Megjithëse ky ligj nuk e specifikon Avokatin e Popullit si një nga institucionet në zinxhirin e kontrollit demokratik dhe civil, Kushtetuta e vendit e ka bërë këtë gjë kur e ka vendosur Avokatin e Popullit si kategori të veçantë kushtetuese, me mandat jashtëzakonisht të gjerë (shih Kapitullin XII, veçmas nenin 132).

Avokati i Popullit në Kosovë është i pavarur nga organet e tjera të shtetit, përfshirë ato të cilat i mbikëqyr dhe është i paanshëm në kryerjen e hetimeve. Këto dy karakteristika janë thelbësore që një Institucion Nacional i të Drejtave të Njeriut (IKDNj) të konsiderohet në pajtueshmëri me Parimet e Parisit, si: standardet minimale ndërkombëtare që këto institucione të jenë efektive dhe të besueshme dhe të mundë ta ushtrorjnë rolin mbikqyrës edhe për sektorë të ndjeshëm e kompleks, siç janë strukturat e sektorit të sigurisë<sup>17</sup>.

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe i liritë themelore për të gjithë, duke përfshirë personelin e forcave të armatosura, paraqet koncept gjithëpërfshirës të sigurisë, i cili e lidh ruajtjen e paqes me respektimin e të drejtave të njeriut dhe me liritë themelore.<sup>18</sup> Personeli i forcave të armatosura ka të drejta të njëjta dhe mbrojtje po të njëjlojtë si të gjithë personat e tjerë, me përjashtim të disa kufizimeve të vendosura nga shërbimi ushtarak.<sup>19</sup>

Për vitin raportues<sup>20</sup> Avokati i Popullit ka pranuar tri ankesa me pohime ankimore për shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut nga ana e autoriteteve të FSK-së. Ankesat ndërlidhen me procesin e rekrutimit të pjesëtarëve të rinj në FSK-së dhe me çështje që kanë të bëjnë me ngritjen e kapaciteteve profesionale për të uniformuarit. Gjatë procesit të hetimit të ankesave është treguar bashkëpunim dhe korrektësi nga ana e zyrtarëve përgjegjës, me të cilët është zhvilluar komunikimi përkthimor me rastet.

Përgjatë viteve, Avokati i Popullit ka pranuar pak ankesa që janë drejtuar kundrejt komponentit të Forcës së Sigurisë së Kosovës. Ankesat e pranuar nuk kanë sinjalizuar që shkeljet mund të jenë sistematike. Në anën tjetër, IAP-ja ka pasur parasysh se ndërtimi dhe fuqizimi i FSK-së ka pasur afër vazhdimisht aleatë ndërkombëtarë me përvoja të ndërtuara brenda standardeve ndërkombëtare të punës, trajtimit dhe sjelljes së të uniformuarve.

Sidoqoftë, transformimi legjislativ i FSK-së, përfshirë atë operues, përgjegjësitë, obligimet dhe të drejtat që gëzojnë pjesëtarët e uniformuar, rritja e numrit të pjesëtarëve të saj, rekrutimi, avancimi, ngritja e kapaciteteve (si procese më vete), rritja e dukshme e buxhetit, proceset që kërkojnë investime dhe tërheqin shpenzime buxhetore etj., kërkojnë tashmë vëmendje të shtuar e të veçantë dhe kontroll nëpërmjet zinxhirit demokratik dhe civil. Gjithsesi, Avokati i Popullit konsideron se roli i tij si institucion mbikëqyrës sa i përket cenimit të të drejtave të njeriut dhe keqadministrimit duhet të jetë tashmë më aktiv dhe më i dukshëm në të gjithë komponentët që përfshijnë mandatet dyanshëm, sipas përgjegjësisë kushtetuese dhe ligjore.

17 Për më tepër, shih studimin hartëzues Ombuds Institutions for the Armed Forces in the Osce Region të OSCE/ODIHR & DCAF, 2015 <https://www.osce.org/files/f/documents/9/8/277616.pdf>

18 Për më tepër, shih Kodi i Sjelljes mbi Aspektet Politiko-Ushtarake të Sigurisë, dokument i Organizatës për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Europë (OSCE) <https://www.osce.org/files/f/documents/6/a/119812.pdf>

19 Për më tepër, shih Përmbledhjen e standardeve, praktikave të mira dhe rekomandimeve mbi të Drejtat e Njeriut dhe Personelin në Forcat e Armatosura [https://www.osce.org/files/f/documents/6/5/480143\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/6/5/480143_1.pdf)

20 2021 janë pranuar 3 ankesa; 2020 është pranuar 1 ankesë; 2019 janë pranuar 3 ankesa.

Përkitazi me iniciativën për projektligjin për komisionarin e FSK-së, Avokati i Popullit ka realizuar një takim me Grupin Punues të deputetëve të angazhuar rreth këtij projektligji, më 9 dhjetor 2021. Në takim, Avokati i Popullit ka paraqitur qëndrimin e tij lidhur me këtë iniciativë dhe ka theksuar se me statusin dhe kompetencat që ka Avokati i Popullit, themelimi i një komisionari krijon dyzim dhe dyfishon përgjegjësitë. Mandati i gjerë kushtetues që ka IAP-ja dhe ligji organik dhe ligjet e tjera që i japin mandat shtesë, krijojnë bazën ideale në kuptimin e kornizës legjislative për mbikëqyrje nga perspektiva e të drejtave të njeriut në gjithë kompleksitetin e vet. Instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e vendit dhe standardet mbi të cilat është themeluar dhe kornizuar juridikisht IAP-ja në Republikën e Kosovës, janë garanci që IAP-ja i ka kompetencat për mbikëqyrjen e FSK-së. Rolin e këtij Komisionari, i cili parashihet në Ligjin nr. 06/L-124 për Shërbimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës, e përbrendëson mandati aktual kushtetues dhe ligjor që ka Avokati i Popullit. Ndërkaq shihet si imperativ roli aktiv i IAP-së për sa u tha më lart, në përmbushjen e përgjegjësisë që ka.

Në funksion të mandatit mbikëqyrës edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës, IAP-ja gjatë vitit 2021 është ftuar dhe ka ndjekur (nëpërmjet një platforme të veçantë elektronike) punimet e Konferencës së 13-të Ndërkombëtare të Institucioneve të Ombuds-ve për Forcat e Armatosura (13<sup>th</sup> ICOAF). Konferenca është organizuar nga DCAF<sup>21</sup> dhe Inspektori i Përgjithshëm i Forcës Mbrojtëse Australiane (me mbështetjen e Ombudsman-it të Commonwealth-it), nga data 18-22 tetor 2021, në Canberra, kryeqytetin australian. Tema e trajtuar në këtë vit kishte të bënte me koontributin e Ombuds-ve në efektivitetin operacional të Forcave të Armatosura. Gjatë pesë ditëve pune, konferenca ka shqyrtuar se si Institucionet e Ombuds-ve mund të ndikojnë pozitivisht në punën e forcave të armatosura dhe janë prezantuar praktika të mira gjithandej globit.

IAP-ja për vite me radhë ka ndjekur Konferencat e tilla vjetore me Ombuds-të e Forcave të Armatosura, të cilat organizohen nga DCAF dhe vendet respektive ku vendoset të mbahen ato.<sup>22</sup> Vitin e ardhshëm, Konferenca e 14-të do të mbahet në Oslo, Norvegji. Nëpërmjet tyre, Ombuds-të nga vendet pjesëmarrëse jo vetëm që kanë mundësi t'i këmbëjnë përvojat e tyre dhe t'i diskutojnë mësimet e nxjerra, mandatin, fuqinë dhe funksionimin e tyre, por gjithashtu kanë mundësi të veçantë të ofrojnë perspektivën e sundimit të ligjit, të mirëqeverisjes, të transparencës e të llogaridhënies në strukturat e uniformuara të sigurisë në Republikën e Kosovës.

## Faturimi i energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të vendit

Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, me Aktgjykimin A.nr.1373/2017, i datës 15 shtator 2019, ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e Avokatit të Popullit për anulimin si të kundërligjshëm të Vendimit V\_399\_2012, i datës 6 shkurt 2021, dhe për detyrimin e ZRrE-së për të ndërmarrë veprime që e obligojnë KEDS-in që të bëjë

21 DCAF - Geneva Centre for Security Sector Governance është Fondacion zviceran që përfshin 57 anëtarë dhe Kantonin e Gjenevës. Me Programet e veta që prekin më shumë se 80 vende, DCAF është e njohur ndërkombëtarisht si një lidere për Qeverisjen në Sektorin e Sigurisë (SSG) dhe Reformën në Sektorin e Sigurisë (SSR). DCAF pohon se një sektor sigurie i drejtuar në mënyrë demokratike, i përgjegjshëm dhe efikas është thelbësor për jetesën e njerëzve, për reduktimin e varfërisë dhe rrezikut të konfliktit dhe për krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillim të qëndrueshëm. DCAF identifikon tre shtigje kryesore të koontributit në përmirësimin e sigurisë njerëzore dhe kombëtare brenda kornizës së qeverisjes demokratike, shtetit të së drejtës dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

22 12<sup>th</sup> ICOAF në Vienë, Austri (2020/virtualisht); 11<sup>th</sup> ICOAF në Sarajevë, B&H (2019) IAP ka qenë pjesë e panelit mbi modelet dhe specifikat që kanë të bëjnë mbrojtjen e të drejtave të njeriut në forcat e armatosura në regjion; Për më tepër <https://www.icoaf.org/events>

kthimin e shumës së faturuar, respektivisht kompensimin e dëmit konsumatorëve, të cilët janë faturuar për shpenzimin e energjisë elektrike në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës për periudhën prej datës 6 shkurt 2012 deri më 20 tetor 2017, në vlerën prej dyzet milionë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë mijë e katërqind e tetëdhjetë eurosh (40.855.480.00 EUR). Ndaj këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor, ZRrE-ja ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit. Gjykata e Apelit pritet të vendosë lidhur me ankesën.

Aktgjykimi, në mes të tjerash, ka gjetur se vendimi i sipërpërmendur i ZRrE-së nuk është në përputhje me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë Elektrike, ngase është bërë trajtim jo i barabartë i banorëve të katër komunave veriore në raport me banorët në pjesën tjetër të Republikës së Kosovës dhe se i njëjti faturim nuk është i autorizuar me ligj.

Në anën tjetër, Avokati i Popullit vë në pah gjetjet e ekspertizës, e cila është zhvilluar gjatë procedurës gjyqësore, sipas së cilës, përveç shpenzimeve në veri, qytetarët e Kosovës mbulojnë edhe shpenzimet komerciale dhe teknike e që brenda vitit mesatarisht kanë vlerën rreth 40 milionë EUR. Çështja e shpenzimeve komerciale dhe e atyre teknike nuk kanë qenë objekt i padisë, megjithatë kjo për Avokatin e Popullit paraqet një shqetësim të cilin me këtë rast ia paraqet Kuvendit për trajtim.

## Zgjedhjet e përgjithshme dhe lokale

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2021 ka ndjekur proceset zgjedhore, përkatësisht zgjedhjet e përgjithshme, zgjedhjet lokale dhe raundin e dytë të zgjedhjeve lokale (balotazhit), të cilat janë mbajtur në vitin 2021.

Nga ajo që është identifikuar gjatë realizimit të ndjekjes së këtyre proceseve zgjedhore, Avokati i Popullit konsideron se këto procese zgjedhore janë zhvilluar në një atmosferë të sigurt, të qetë, të lirë e demokratike. Pjekuria e qytetarëve në njërin anë, angazhimi maksimal të cilin KQZ-ja e ka treguar në tërësinë e vet në përgatitjet dhe në organizimin e këtyre zgjedhjeve, kanë shënuar moment jashtëzakonisht të rëndësishëm për respektimin e vullnetit të lirë të qytetarëve dhe nivelin e demokracisë në vend.

Prandaj, nga perspektiva e respektimit dhe e ushtrimit të kësaj të drejte politike, Avokati i Popullit shpreh konsideratën dhe vlerësimin e tij maksimal. Po ashtu, Avokati i Popullit vlerëson Policinë e Kosovës për mbështetjen profesionale që ka ofruar përgjatë mbajtjes së këtyre proceseve zgjedhore nëpër tërë territorin e Republikës së Kosovës, duke garantuar siguri dhe mbarëvajtjen e procesit elektoral.

Gjithsesi, duke e pasur parasysh vështirësinë që ka një proces zgjedhor, ka pasur segmente specifike nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut që kanë tërhequr vëmendjen e vëzhguesve të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit vlerëson se realizimi i zgjedhjeve në situatë pandemie ka imponuar kërkesa specifike përkitazi me masat anti-COVID. Mundësitë e zbatimit të distancës ndërmjet votuesve nuk kanë ekzistuar në secilën qendër votimi, në radhë të parë, por as ndërmjet administruesve të procesit. Ky problem është shfaqur veçmas në qendra të mëdha votimi (kryesisht në qytete), ku fluksi i votuesve ka qenë më i madh. Megjithatë ka pasur respektim sa i përket bartjes së maskave dhe përdorimit të dezinfektuesve.

Në anën tjetër, shumica e shkollave që shërbenin si qendra votimi nuk ofronin kushte të përshtatshme infrastrukturore (mungesa e pjerrinave, ashensorëve etj.) për personat me aftësi të kufizuara në të ecur. Në të shumtën e herëve, vendvotimet ishin në katet e epërme



dhe kjo ka paraqitur vështirësi në realizimin e së drejtës së tyre për të votuar. Ndërkaq, pothuajse të gjitha qendrat e votimit kanë qenë të pajisura me fletëvotime me alfabet të Brajlit.

Po ashtu, bazuar në mandatin specifik që ka, Avokati i Popullit ka monitoruar për së afërmi institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, si: qendrat e paraburgimit, qendrat korrektuese dhe Burgun e Sigurisë së Lartë. Vëzhguesit gjatë monitorimit kanë vërejtur se për shkak të bartjeve që kanë ndodhur me të paraburgosurit, pasi janë dërguar të dhënat përkitazi me ata që kanë të drejtë vote, ka pasur raste kur persona të privuar nga liria nuk kanë pasur mundësi të votonin, sepse emri i tyre nuk ka qenë në listat e ekipit mobil, ndërkaq nuk janë verifikuar aty për aty edhe me listën e përgjithshme të votuesve.

Përfundimisht, Avokati i Popullit vlerëson shumë lart organizimin dhe mbarëvajtjen e këtyre proceseve zgjedhore dhe konsideron se të drejtat zgjedhore janë respektuar në përgjithësi, përveç rasteve të theksuara më sipër, të cilat nuk kanë ndikuar drejtpërdrejt në cenimin e të drejtave zgjedhore të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit, me qëllimin që t'i shprehë pikëpamjet e tij shikuar nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut në lidhje me çështjen e ngritur në Gjykatën Kushtetuese nga subjektet politike: *Partia Liberale Egjiptiane (PLE)*, *Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)*, dhe individët: Veton Berisha nga komuniteti egjiptian dhe Albert Kinolli nga komuniteti rom, në cilësinë e parashtruesit të kërkesës, të cilët kanë kërkuar nga gjykata që të bënte: *“Kontrollin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit AA.nr.29/2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe vendimit A.nr736/2021 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP).”*, më 3 gusht 2021 në Gjykatën Kushtetuese ka dërguar opinion lidhur me këtë kërkesë.

Përmes këtij opinioni, Avokati i Popullit ka vlerësuar se për raste të njëjta organet vendimmarrëse duhet të nxjerrin vendime të njëjta. Në këtë mënyrë garantohej realizimi pa dallim i të drejtave zgjedhore dhe i pjesëmarrjes, të garantuara me Kushtetutë, dhe instrumente ndërkombëtare, në të kundërtën, nëse për raste të njëjta nxjerrën vendime të ndryshme, atëherë krijohet situatë e pabarazisë dhe e standardeve të dyfishta të vendosura nga organet vendimmarrëse, duke theksuar se është me rëndësi që Gjykata Kushtetuese ta vlerësojë këtë çështje dhe të vendosë se a janë cenuar të drejtat kushtetuese zgjedhore në këtë rast.

Po ashtu Avokati i Popullit konsideron se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të jenë përgjegjëse dhe garantuese për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në tërësi, duke respektuar plotësisht dhe pa dallim përcaktimet kushtetuese lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

Më 27 tetor 2021, Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e znj. Valdete Daka, të paraqitur kundër Vendimit nr. 42/2021, i datës 14 qershor 2021, të Presidentes së Republikës së Kosovës, për ndërprerjen e mandatit të saj si kryesuese e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Znj. Daka ka pohuar se vendimi i Presidentes është jokushtetues dhe i paligjshëm dhe se ka shkelur të drejtat dhe liritë personale, prandaj ka kërkuar nga Avokati i Popullit që çështjen ta dërgojë në Gjykatën Kushtetuese.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se çështja e ndërprerjes së mandatit të znj. Daka, si kryesuese e KQZ-së, paraqet një çështje ligjore dhe se në këto rrethana do të duhej të vlerësohej ligjshmëria e vendimit të presidentes, e që kjo nuk mund të jetë objekt i vlerësimit nga Gjykata Kushtetuese.

Për më tepër, Avokati i Popullit i është referuar Aktvendimit për Papranueshmëri në Rastin Nr. K1142/13, i datës 18 nëntor 2013, parashtrues z. Fadil Maloku, lidhur me *Kërkesën për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit të Presidentes së Republikës së Kosovës,*

*Nr.686-2013*, të 6 shtatorit 2013, që është rast i ngjashëm me çështjen e ngritur në ankesën e znj. Daka. Gjykata Kushtetuese në këtë rast kishte vlerësuar se ekzistonin mjetet efektive juridike, të cilat duhej të shteroheshin para se çështja të ngrihej në Gjykatën Kushtetuese. Duke u bazuar në këtë praktikë, znj. Daka do të duhej t'i përdorte mjetet juridike kundër vendimit të presidentes, të cilave u referohej Gjykata Kushtetuese në Aktvendimin Nr. KI142/13 lidhur me rastin z. Malokut.

Në anën tjetër, Ligji për Avokatin e Popullit, neni 22, paragrafi 1, nënparagrafi 4, përcakton se Avokati i Popullit refuzon kërkesat në rastet kur nuk janë shteruar të gjitha mjetet juridike të rregullta dhe të jashtëzakonshme, përpos nëse ai vlerëson se do të jetë e padobishme për paraqitësin e ankesës për të filluar apo vazhduar procedurën, apo nëse vlerëson se individët kanë pësuar dëm të madh apo mund të pësojnë dëm të madh dhe të pariparueshëm në ndërkohë.

Prandaj, Avokati i Popullit, më 17 nëntor 2021, ka nxjerrë Vendimin A. nr. 625/2021, me të cilin ka refuzuar ankesën e paraqitur nga znj. Daka.

## E drejta për qasje në dokumente publike

Gjatë vitit 2021, Avokati i Popullit ka pranuar 45 ankesa që kanë të bëjnë me qasjen në dokumente publike, 7 nga këto janë shpallur të papranueshme, ndërsa 38 të tjerat janë hapur për hetim. Nga ankesat e hapura për hetim, 12 janë pranuar nga shoqëria civile, 6 nga mediat, dhe 20 janë ankesa individuale. Palët përgjegjëse në këto ankesa janë kryesisht të nivelit qendror dhe të atij lokal (13 ministri, 10 komuna dhe 15 janë të tjera).<sup>23</sup>

Gjatë hetimit të këtyre ankesave vërehet se në të shumtën e rasteve, përgjigjet e institucioneve për pranimin e kërkesës janë me kohë dhe brenda afateve ligjore, megjithatë, koha e vendosjes së lejitimit apo të refuzimit të qasjes, përkundër rëndësisë së dhënies me kohë të informacioneve, i tejkalon afatet e parapara me ligj.

Avokati i Popullit ka publikuar 14 raporte me rekomandime dhe një letër rekomandimi lidhur me kufizim e së drejtës për qasje në dokumente publike. Nga këto rekomandime, tri<sup>24</sup> nuk janë zbatuar, një pjesërisht<sup>25</sup> është zbatuar dhe një është në pritje<sup>26</sup> për zbatim, ndërsa 10 rekomandime janë zbatuar.

Nga ankesat e hetuara është vërejtur se ka raste kur dokumentet publike, të kërkuara nga kërkuesit e dokumenteve, që bëjnë pjesë në kategorinë e dokumenteve sipas nënparagrafit 2.6 të nenit 5 të Ligjit nr.06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, nuk janë të qasshme, parashihen të jenë të qasshme me iniciativë të institucioneve publike, të cilat përmes qasjes proaktive do të duhej të vendoseshin në ueb-faqen zyrtare të institucionit publik.

Po ashtu është vërejtur se vonesat në përgjigje për lejitim, kufizim apo refuzim të qasjes shpesh ndodhin për shkak të mungesës së kapaciteteve njerëzore. Në rastet kur institucionet publike refuzojnë qasjen apo lejojnë qasje të kufizuara në të shumtën e rasteve dështojnë të nxjerrin vendim dhe të japin arsyetim të bazuar në ligj.

23 Të tjerat: ShSKUK(2), ZRRë (1), AUV (1), AKPPMt (1), prokuroritë (1), gjykata (1), KKTK (1), AKA(1), ShKK (1) etj.

24 A.nr.486/2020, 574/2020 të dyja kundër komunës së Mitrovicës Veriore dhe A.nr. 454/2020 kundër KPK-së.

25 A.nr.658/2020 kundër Komunës së Gjilanit.

26 A.nr.205/2021 kundër MMPHI-së.

Megjithatë, në raport me vitet e kaluara, ka një ndryshim për të mirë kur bëhet fjalë për nxjerrjen e vendimeve për lejim apo refuzim të qasjes në dokumentet e kërkuara. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit konsideron se institucionet publike kanë arritur progres në zbatimin e procedurave ligjore sa u përket kërkesave për qasje në dokumentet publike. Në këtë drejtim, vlen të theksohet se ndikim pozitiv në realizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike ka edhe zgjedhja e Komisionares së Agjencisë për Informim dhe Privatësi<sup>27</sup>, me ç’ rast u mundësua edhe funksionalizimi i Agjencisë për Informim dhe Privatësi.

Zbatimi i Ligjit për Qasje në Dokumente Publike është i rëndësishëm, përveç për transparencë dhe për llogaridhënie të qeverisjes, është edhe për ndërgjegjësimin e punonjësve të administratës dhe për detyrimin që kanë ata për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, por edhe për ndërgjegjësimin e qytetarëve për shërbimet që i pret nga administrata. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e thekson nevojën e ngritjes së kapaciteteve njerëzore të zyrtarëve lidhur me zbatimin e LQDP-së, si në nivel lokal, ashtu edhe në nivel qendror.

## Përgjegjësia institucionale për mjedisin jetësor

Avokati i Popullit vëren se edhe në vitin 2021 nuk janë shënuar ndryshime pozitive nëpërmjet të cilave do të promovohet mbrojtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm. Përkundër mësimave të marra dhe mungesës së integritit të faktorit mjedisor në vendimet e qeverisë për mbrojtje nga pandemia në vitin e parë të pandemisë COVID-19, gjendjes fragjile si rezultat i mospërfshirjes së gjatë të mjedisit në prioritetet shtetërore, kapaciteteve të pamjaftueshme, autoriteti publik edhe këtë vit nuk arriti të krijonte strategji nëpërmjet të cilave do t’i balanconte interesat në mes mbrojtjes së shëndetit dhe mbrojtjes së mjedisit.

Përkundër gjendjes së krijuar të mjedisit, domosdoshmërisë për parandalimin e problemeve dhe mënjanimin e tyre, buxheti i ndarë për Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe të Infrastrukturës (MMPHI)<sup>28</sup> vazhdon të mbete i ulët. Taksa ekologjike, e paraparë me Ligjin për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve<sup>29</sup>, e cila ka për qëllim ngritjen e cilësisë së mbrojtjes së ambientit, vazhdon të mos shfrytëzohet sipas dedikimit të mbledhur.

Mungesa e politikave të qëndrueshme, të cilat do të shënonin hap para në ndryshimin e gjendjes së mjedisit në vend, si dhe situata me pandeminë kanë bërë që gjendja e mjedisit të vazhdojë të ndikojë në kufizimin e së drejtës kushtetuese të qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm. Pothuajse i njëjtë vazhdon të mbetet ndikimi në ajër, në ujë dhe në tokë. Po ashtu nuk është vërejtur ndonjë përmirësim në drejtim të parandalimit të degradimit të mjedisit. Shkatërrimi dhe prerja e pyjeve dhe ndërhyrja në tokën bujqësore<sup>30</sup> kanë vazhduar me hapa të njëjtë. Përkundër lëvizjeve të vazhdueshme të temperaturave dhe tendencës për rritje në vend, vendi ende nuk ka ndërmarrë veprime konkrete si përgjigje për t’iu bashkëngjitur nismave globale në drejtim të sfidave ndaj ndryshimeve

27 Kuvendi i Republikës së Kosovës në seancën parlamentare të mbajtur më 17 qershor 2021, ka zgjedhur komisionaren e AIP-së.

28 MMPHI, organ kompetent për krijimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm të fushës së Mjedisit, Ujërave, Planifikimit Hapësinor dhe Ndërtimit e Banimit.

29 Ligji nr. 04/L-117 për Taksën Rrugore dhe Ekologjike të Automjeteve, neni 1, par. 2.

30 Ligji për Tokën Bujqësore; neni 2, Qëllimi: “Toka bujqësore si pasuri natyrore me interes të përgjithshëm, ka mbrojtje të veçantë dhe duhet të shfrytëzohet për prodhimtari bujqësore dhe nuk mund të përdoret për qëllime tjera përveç në rastet e përcaktuara më këtë ligj dhe me dispozitat e tjera të nxjerrura në bazë të tij.”

klimatike<sup>31</sup>. Kërkesat e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, si dhe Agjenda e Gjellbër për Ballkanin Perëndimor, mbeten ende sfidë.

Edhe pse janë vërejtur përmirësime në respektimin e tri parimeve procedurale të së drejtës mjedisore, parimit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, qasjes në informata mjedisore, si dhe parimit të qasjes në drejtësi, në këtë drejtim institucioneve u mbetet ende për të punuar. Shumica e projekteve lidhur me mjedisin vazhdon të realizohet me mungesë të vlerësimeve cilësore të ndikimit në mjedis, apo edhe pa to. Ka vazhduar moszbatimi i parimit “ndotësi dhe shfrytëzuesi paguan”, si dhe rehabilitimi i hapësirave të degraduara dhe moszbatimi i dispozitave të tjera të dala nga ligjet.

Në krahasim me vitet paraprake është vërejtur një debat i shtuar në publik lidhur me mjedisin dhe me problemet mjedisore. Në këtë drejtim, zhvillimeve mjedisore u është dhënë hapësirë më e madhe në media dhe në rrjete sociale. Progres në drejtim të demokracisë mjedisore paraqet aktivizimi i shoqërisë civile. Promovimi, edukimi dhe integrimi i së drejtës mjedisore në kurrikulat mësimore mbetet për t’u adresuar me seriozitet.

Avokati i Popullit vëren se sa i përket cilësisë së ajrit, edhe përkundër faktit se ka qenë i paraparë në programin legjislativ, nuk u arrit të miratohej Ligji i ri për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja. Gjithashtu, edhe gjatë vitit 2021, qytetarët e vendit janë ballafaquar me kufizim të herëpashershëm të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, nga cilësia jo e mirë e ajrit. Ndotja tanimë përbën kërcënim serioz për shëndetin e qytetarëve.<sup>32</sup> Sezoni vjeshtë-dimër si çdo vit ka shënuar ngritje të vlerave ndotëse në ajër<sup>33</sup> dhe tejkalim të vlerave për cilësinë e ajrit.

Sipas raporteve të mësipërme, ndotja më e madhe, pothuajse 50%, vjen nga djegiet e vogla, industria është e dyta më 37% tejkalime, transporti - kryesisht trafiku rrugor, është burimi i tretë më 11% dhe 7% të emetimeve. Sektorët e mbetur përbëjnë më pak se 5% të shkarkimeve. Nga 38 komuna, vetëm komuna e Glllogocit ka hartuar planin lokal të veprimit për cilësinë e ajrit.

Nuk është shënuar përmirësim në parandalimin e ndotjes nga ndërtimi i rrugëve, djegia e pyjeve, hamulloreve dhe mbeturinave, si dhe kundërmimit nga parregullsitë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Po ashtu ka vazhduar mosarritja e organeve kompetente për të zbatuar legjisllacionin e planifikimit, të ndërtimit dhe të inspektimit për vënien nën kontroll të infrastrukturës së ajrosjes dhe tymtarëve të objekteve.

Edhe pse tashmë i pakontestueshëm ndikimi i ndotjes së ajrit në shëndetin publik, mungesa e funksionalizimit të SISH-it pamundëson nxjerrjen e statistikave të qarta lidhur me ndikim e ndotjes në shëndetin e qytetarëve. Po ashtu, ende vazhdon të mos ketë një hulumtim nga ISHPK-ja lidhur me ndikimin e ajrit të ndotur në shëndetin publik. Mbetet ende për t’u përmirësuar informimi lidhur me cilësinë e ajrit. Avokati i Popullit, duke pasur parasysh këtë gjendje, kërkon nga qeveria dhe nga institucionet e tjera kompetente që ta kenë prioritet çështjen e së drejtës për ajër të pastër.

31 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, 2020, “Mjedisi i Kosovës 2020, Raport i treguesve mjedisore”, “në Kosovë, që nga viti 1900 e deri sot ka pasur lëvizje të temperaturave mesatare vjetore me një tendencë rritjeje. Kështu temperatura mesatare vjetore për periudhën 1930-1990 ishte 8.6 gradë celsius, për periudhën 1990-2002 ishte 9 gradë celsius, ndërsa për periudhën 2003-2019, mbi 10 gradë celsius”.

32 Raporti për Kosovën\* 2021, Komisioni Evropian, “Mjedisi dhe ndryshimi klimatik”, fq. 100.

33 Raporti mujor për cilësinë e ajrit, nëntor 2021, <http://ammk-rks.net/?page=1,163>

Avokati i Popullit gjithashtu vëren se mbrojtja e ujërave sipas parimeve të menaxhimit të qëndrueshëm mbetet sfidë. Degradimi dhe shfrytëzimi arbitrar i resurseve ujore ka vazhduar me rritëm pothuaj të njëjtë. Përkundër gjendjes alarmante, nuk janë vërejtur veprime konkrete parandaluese dhe politika të cilat do të ndikonin në shfrytëzim të qëndrueshëm të resurseve ujore. Edhe pse i paraparë në programin legjislativ, nuk u miratua Ligji i ri për Ujërat.

Nuk janë vërejtur masa që do të parandalonin shkarkimin e ujërave të pa trajtuara<sup>34</sup>, në veçanti atyre minerare<sup>35</sup>, industriale<sup>36</sup> dhe mbeturinave. Praktika e mbishfrytëzimit pa kriter të inerteve (rërës dhe zhavorrit) ka vazhduar në mënyrë të pakontrolluar, duke determinuar në shfrytëzimin e rezervave natyrore të lumenjve mbi kapacitetet regjenerues të tyre. Tanimë aftësia natyrore e lumenjve për t'i mbuluar gropat e hapura me sipërfaqe të tëra, shumë pjesë mund të llogariten të pakthyeshme. Nga viti 2012 nuk është bërë vlerësim i dëmeve të shkaktuara lumenjve të vendit nga eksploatuesit. Mosmënjanimi i gropave të mëdha si dhe devijimi i shtretërve të lumenjve është duke shkaktuar rrezik permanent për jetën dhe shëndetin e qytetarëve dhe vërshime.

Lumenjtë që cilësohen më të ndoturit dhe më të degraduarit, janë: Drini i Bardhë<sup>37</sup>, Lumëbardhi i Pejës<sup>38</sup>, Ereniku<sup>39</sup>, Toplluha<sup>40</sup>, Desivojcë, Krivarekë, Sitnica<sup>41</sup>, dhe Ibri.

Avokati i Popullit vëren se qeveria duhet ta rrisë shtrirjen e furnizimit me ujë të pijshëm në zonat kryesisht rurale, të cilat sot mbesin pa qasje, si dhe t'i ndërmarrë masat efektive në drejtim të miradministrimit të resurseve ujore.

Avokati i Popullit vëren se çështja e operimit të hidrocentraleve në vend vazhdon të paraqesë problem serioz në shfrytëzimin e qëndrueshëm të resurseve ujore, mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin social - ekonomik të Republikës së Kosovës. Përkundër domosdoshmërisë për adresim serioz, problemet përkitazi me mungesën e transparencës lidhur me ligjshmërinë e dhënies në shfrytëzim dhe operimit të hidrocentraleve kanë vazhduar edhe në vitin 2021. Edhe pse është konstatuar shfrytëzim i pakontrolluar i ujërave nga hidrocentralet të cilat kanë ndikuar në shterjen e kohëpaskohshme të disa lumenjve, MMPHI-ja dhe nivelet lokale kanë vazhduar lëshimin e akteve mjedisore, ujore, certifikatave ndërtimore për këto aktivitete.<sup>42</sup> Vlerësohet se procesi është zhvilluar me shkelje të ligjeve dhe të dokumenteve planifikuese<sup>43</sup>. Avokati i Popullit vlerëson lart angazhimin e shoqërisë civile si në monitorimin

34 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për gjendjen e ujërave 2020: "Impiantet për trajtim të Ujërave të Zeza, të ndërtuara janë në: Llaushë - K.Skenderaj, Fshatin Harilaq, burgi i Dubravës dhe ai i Lipjanit, Parku i bizneseve në Drenas".

35 Raporti për Kosovën\* 2019: "Mbeturinave e rrezikshme minerare, si dhe shkarkimet industriale drejtpërdrejtë në lumenj dhe deponitë industriale vazhdojnë të përbëjnë rrezik serioz ndaj dheut dhe ujit".

36 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë, 2018-2019.

37 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Raport për gjendjen e Ujërave në Kosovë 2020: "Uji i pellgut Drini i Bardhë ndotet nga shkarkimet e nënpellgjeve të cilat paraprakisht u janë nënshtruar ndikimeve njerëzore."

38 Po aty: "Në këtë lumë shkaktohet turbullirë e madhe për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i tij prej kompanive private."

39 Po aty: "Cilësia e ujit të këtij lumi në këtë stacion është e dobët, meqenëse gjatë analizave është vërejtur prezenca e sasisë së detergjenteve."

40 Po aty: "Uji ka cilësi më të dobët, njihet si lumi permanent me turbullirë të lartë për shkak të nxjerrjes së zhavorrit nga shtrati i lumit pothuajse në kontinuitet gjatë gjithë vitit."

41 Po aty: "Përmbajnë në vete ujërat e shkarkimeve të amvisëri si dhe ujërat e shkarkimeve industriale."

42 MMPHI, Raport i grupit punues për shqyrtimin e procedurave administrative të zbatuara për hidrocentrale dhe ndikimin e tyre në ujëra dhe në mjedis, 30 qershor 2021, [https://mmpfi.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Final%20i%20Grupit%20Punues%20per%20Hidrocentralet-converted-2\(2\).pdf](https://mmpfi.rksgov.net/assets/cms/uploads/files/Raporti%20Final%20i%20Grupit%20Punues%20per%20Hidrocentralet-converted-2(2).pdf)

43 Po aty.

e proceseve administrative, ngritjes së çështjeve, nxitjes së debatit, si dhe angazhimit në procese gjyqësore.

Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit, më 3 shkurt 2021, publikoi Raportin me Rekomandime Ex officio 365/2018, lidhur me çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe qasjes në dokumente përkitazi me hidrocentralet që kanë të bëjnë me çështjen e operimit të hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpcë. Raporti me rekomandime, i cili njëherësh është dokumenti i parë institucional, ka konstatuar paqartësi në procedurat lidhur me operimin e hidrocentraleve në vend. Raporti ka pasur për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, të Komunës së Deçanit, të Komunës së Shtërpcës dhe të autoriteteve të tjera kompetente për respektimin e së drejtës për informim të qytetarëve duke ofruar qasje në dokumentacionin për hidrocentralet, respektimin e së drejtës së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi. Avokati i Popullit, duke vërejtur paqartësitë lidhur me procesin e operimit të hidrocentraleve, pakënaqësitë e qytetarëve, dhe mbi të gjitha ndikimin në mjedis të hidrocentraleve, nëpërmjet raportit kërkon vëmendjen e shtetit që të balancojë interesat publike me ato ekonomike, duke vlerësuar me kujdes interesin mes rëndësisë së prodhimit të energjisë nëpërmjet hidrocentraleve në vend në raport me ndikimin në mjedis që mund të jetë i rëndë dhe i pariparueshëm. Nga analiza e tërësishme, Avokati i Popullit ka konstatuar se procesi i licencimit dhe i operimit të hidrocentraleve në vend është përcjellë me mangësi të vazhdueshme sa i përket aspektit procedural tredimensional: qasjes në informata, pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi. Prosesi është përcjellë me mungesë të transparencës së institucioneve përgjegjëse për ligjshmërinë e operimit, e po ashtu edhe me paqartësi lidhur me procedurat e organizimit të dëgjimeve publike, si forma të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Avokati i Popullit po ashtu vlerëson se sistemi gjyqësor në vend jo vetëm në rastin konkret, por edhe në të gjitha rastet që kanë të bëjnë me mjedisin, nuk është duke arritur ta përmbushë parimin e sigurisë juridike, si element i rëndësishëm i shtetit të së drejtës, për të siguruar gjykim të drejtë dhe brenda afatit të arsyeshëm kohor. Rastet e iniciuara në gjykata si nga personat fizikë, po ashtu edhe juridikë, nuk tregohen mjete juridike efektive.

Avokati i Popullit i ka rekomanduar MMHPI-së, Komunës së Deçanit dhe të Shtërpcës që ta bëjnë publik tërë dokumentacionin lidhur me operimin e hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpcë, ndërsa Këshillit Gjyqësor dhe atij Prokurorial të ndërmarrin masa që rastet që lidhen me hidrocentralet t'i trajtojnë me prioritet. MMPHI-ja, si përgjigje në rekomandimin e Avokatit të Popullit, më 29 shtator 2021, ka informuar IAP-në: *“Cilado organizatë apo individ që kërkon qasje në dokumente zyrate do t'i mundësohet nga Ministria.”* Ndërsa më 16 shkurt 2021, Avokati i Popullit, përmes një shkrese është njoftuar nga kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës se me qëllim të zbatimit të këtij rekomandimi që u dedikohet gjykatave, Këshilli Gjyqësor i Kosovës ka dërguar këtë raport me rekomandime tek Gjykata Themelore në Prishtinë.

Avokati i Popullit vëren se përkundër kërkesave të dala nga Ligji për Planifikimin Hapësinor, për zhvillim të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të mbrojtjes së tokës, vazhdon mosangazhimi serioz i organeve kompetente të nivelit qendror dhe të atij lokal për vënien nën kontroll dhe pengimin e ndotjes së tokës nga mbeturina të të gjitha llojeve dhe shkarkimeve dhe ujërave të pa trajtuara etj., konvertimit të shpejtë të tokës bujqësore në tokë ndërtimore, si dhe humbjes së hapësirave të gjelbra. Nuk janë ndërmarrë veprime për mbylljen dhe rehabilitimin e Liqenit të ashtuquajtur të kaltër ku bëhen shkarkimet e hidraulikut (bartja e hirit)<sup>44</sup>. Sfidë ka vazhduar të mbetet përmirësimi dhe rikultivimi i hapësirave të degraduara.

44 Raporti për Kosovën\* 2020, Komisioni Evropian, 6.20 Mjedi dhe ndryshimi klimatik, fq. 106

Nuk është vërejtur përmirësimi lidhur me obligimet globale për menaxhimin e qëndrueshëm të pyjeve, të konsideruara si platformë për të kontribuar në ndryshimet klimatike, përmirësimin e cilësisë së ajrit, të ujit, ruajtjes së biodiversitetit dhe cilësisë së jetës. Edhe në këtë vit janë regjistruar prerje ilegale dhe zjarre. Fenomeni i filluar më herët i ndërtimit të shtëpive në parqe kombëtare ka vazhduar duke ndikuar në ekosistemin, në vlerat ujore dhe në peizazh e në vlera të tjera të natyrës. Kanë vazhduar ndërtimet e vrashda të shtëpive dhe të objekteve të larta në Parkun Kombëtar “Sharri” dhe në “Bjeshkët e Nemuna”, pa vlerësim të ndikimit në mjedis, në kundërshtim me Ligjin për Planifikim Hapësinor, me Ligjin për Mbrojtjen e Mjedisit, me Ligjin për Ujërat e Kosovës dhe me ligjet për parqet kombëtare. Veprimet e ndërmarra nga organet e ndjekjes lidhur me ndërtimet në zonën e dytë të Parkut Kombëtar “Sharri” në Brezovicë janë veprime të vonshme dhe joproporcionale në krahasim me dëmin e shkaktuar.<sup>45</sup> Po ashtu, ndërtimi i pakontrolluar dhe ndërhyrje pa kriter në pyje ka vazhduar në zonën e Novobërdës. Ripyllëzimi dhe rivitalizimi nuk u arrit të bëhet në proporcion të përafërt me degradimin e sipërfaqeve të degraduara.

Avokati i Popullit gjithashtu vëren se operimi i guroreve në vend, sidomos operimi i operatorëve ilegalë,<sup>46</sup> vazhdon të mbetet njëri ndër problemet më të mëdha me ndikim serioz në mjedis. Shfrytëzimi i mineraleve nuk bëhet në harmoni me strategjinë minerare. Gjatë periudhës raportuese ka vazhduar edhe ndikimi arbitrar në mjedis nga operatorët ekonomikë, duke mos e kursyer trashëgiminë kulturore,<sup>47</sup> si dhe mosrespektimi i kriteve të sigurisë që kanë të bëjnë me distancën ndaj infrastrukturës dhe objekteve. Përderisa shteti veprimtarive për nxjerrjen e qymyrit, linjiteve, nxjerrjes së xehes së metalit, xeheroreve dhe guroreve, si pak veprimtarive të tjera, nuk ua ndërpreu aktivitetin gjatë periudhës së emergjencës së shëndetit publik, ai paralelisht nuk parashikoi mekanizma për mbikëqyrjen e veprimtarisë. Kërcënim serioz për të drejtën e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe për sigurinë publike paraqesin vendpunimet të cilat rrallë janë të rrethuara<sup>48</sup>, duke mundësuar qasje të papenguar dhe njëherësh bartje të rërës, baltës etj. në rrugë publike.

Kriteret për programet për rehabilitimin e zonave të shfrytëzuara të parashtruara nga operatorët me rastin e aplikimit për leje, mbeten për t’u përforcuar dhe të shqyrtohen me seriozitet nga autoritetet kompetente. Përkundër gjendjes në terren, organet kompetente MEA dhe KPMM nuk arrijnë të monitorojnë dhe inspektojnë mjaftueshëm zbatimin e kriteve që do ta mbanin nën kontroll mbrojtjen e mjedisit nga operimi i operatorëve. Mosrehabilitimi i hapësirave të degraduara nga aktivitetet minerare nga operatorët kërkon shqyrtim serioz nga organet kompetente, madje adresim edhe nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit vëren se menaxhimi i mbeturinave në vend vazhdon të mbetet sfidë. Nuk janë arritur të ndërmerreshin masa për parandalimin e ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut.

45 <https://www.evropaelire.org/a/arrestime-te-reja-ne-rastin-brezovica/31642030.html>

46 <https://www.kosovo-mining.org/aktivitet/komunikate-per-media-prishtine-31-dhjetor-2019/>: “Gjatë vitit 2019, Inspektorati i KPMM-se në aksionin për zbatimin e Planit Operativ për parandalimin dhe ndalimin e operimeve ilegale, së bashku me Policinë e Kosovës, Inspektoratin e Mjedisit, Inspektoratin e Pylltarisë si dhe Inspektoratet Komunale. Pas përfundimit të këtij aksioni në 194 vende të operimeve ilegale janë vendosur shiritat për ndalimin e punës prej të cilave janë 99 seperacione, 16 shfrytëzim, 78 baza betoni dhe asfalti si dhe një fabrikë përpunimi.”

47 Preportr, “Gerryerja e trashëgimise kulturore”, 13 shtator 2021, (linku: [http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Gerryerja-e-trashegimise-kulturore-346?fbclid=IwAR1eqwohKqea-2PsMEZgudFaFRoSRZ88\\_6\\_QeOVGow4\\_caMxqeGhdDUmhBY](http://preportr.cohu.org/sq/hulumtime/Gerryerja-e-trashegimise-kulturore-346?fbclid=IwAR1eqwohKqea-2PsMEZgudFaFRoSRZ88_6_QeOVGow4_caMxqeGhdDUmhBY) “Gërryerja e trashëgimise kulturore).

48 Zyra Kombëtare e Auditimit, Raporti i auditimit të performancës: “Procesi i licencimit të shfrytëzuesve të mineraleve ndërtimore e industriale dhe mbrojtja e ambientit nga kjo veprimtari”.

Përveç iniciativave individuale për riciklimin e mbeturinave nga metalet, plastika dhe letra, vendi ende nuk ka sistem të organizuar të përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave, i cili do t'u përgjigjej mjaftueshëm kërkesave të kohës dhe zhvillimit të metodave të qëndrueshme të deponimit përfundimtar të mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Avokati i Popullit e konsideron çështje me ndikim serioz në trajtim të pabarabartë, kufizim të së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, mospërfshirjen e interesave të të gjithë qytetarëve, në veçanti të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, ntë të moshuarve, të fëmijëve, të të rinjve, brenda planeve rregulluese të hollësishme<sup>49</sup>.

Avokati i Popullit vëren se autoritetet publike vazhdojnë të mos i përmbushin detyrimet pozitive që rrjedhin nga e drejta për mjedis të pastër të individit edhe përkundër faktit se Avokati i Popullit vazhdimisht ka rekomanduar ndryshimin e politikave në këtë fushë. Një shembull i tillë është letër rekomandimi<sup>50</sup> drejtuar Komunës së Prishtinës, lidhur me dislokimin e kontejnerëve për mbeturina, të pozicionuar në lagjen Kodra e Diellit, për shkak të shkakimit të ndotjes së mjedisit.

## **Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor**

Avokati i Popullit në raportin: “Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë në të drejtat e njeriut”, ka vlerësuar se sa ka arritur shteti që të përfshijë integrimin e masave për respektimin dhe mbrojtjen e mjedisit në masat reaguese ndaj pandemisë COVID-19<sup>51</sup>, si dhe të përshtatë politikat për funksionimin e organeve për mbrojtje të mjedisit me përpjekje për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e zyrtarëve, në përputhje me rregullat për mbrojtje nga COVID-19.

Me këtë raport, Avokati i Popullit ka konstatuar mungesë të planeve konkrete, të cilat do të kishin udhëzime të qarta për operim nën kushtet e pandemisë, në përputhje me udhëzimet e IKShPK-së për të organizuar punën e organeve mbikëqyrëse dhe inspektive.

Edhe pse qeveria nëpërmjet vendimeve për mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike gjatë emergjencës së shëndetit publik lejoi operimin dhe funksionimin e operatorëve më të mëdhenj me ndikim në mjedis, si: ndërtimi, prerja e drurëve, nxjerrja e qymyrit, e xeheroreve dhe e gurorëve, veprimtaritë lidhur me mbeturinat etj.<sup>52</sup> nuk gjeten zgjidhje për mbrojtje të mjedisit.

Lidhur me të drejtën e qasjes në informata mjedisore, Avokati i Popullit ka gjetur se ministria kompetente për mbrojtjen e mjedisit nuk ka bërë përpjekje të mjaftueshme për të përmirësuar publikimin e informacioneve mjedisore në ueb-faqen zyrtare.

Në vazhdim Avokati i Popullit konstatoi se situata e krijuar me pandeminë thelloi sfidën e zvarritjes së procedurave gjyqësore në realizimin e të drejtave lidhur me problemet

49 Udhëzim Administrativ nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

50 A. nr. 59/2020

51 [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2021/12/Raport-i-Avokatit-te-Popullit\\_-Emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemisë-në-të-drejtat-e-njeriut\\_FINAL.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2021/12/Raport-i-Avokatit-te-Popullit_-Emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemisë-në-të-drejtat-e-njeriut_FINAL.pdf)

52 Urdhëresa e MEPTINS, nr. 01/05, datë 23 mars 2020.



mjedisore. Situata po ashtu ndikoi në parashkrimin, hedhjen poshtë dhe zvarritjen e lëndëve lidhur me mjedisin.<sup>53</sup>

## Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm - Roli i Avokatit të Popullit si Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut

Çrrënjësia e varfërisë, pabarazisë, realizimi i dinjitetit njerëzor dhe premtimi për të mos lënë askënd pas e për të arritur së pari ata që janë të lënë më anash, kanë në fundament parimet e të drejtave të njeriut, të barazisë dhe mosdiskriminimit dhe përbëjnë përkushtimin dhe premtimin e shteteve nëpërmjet Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Kjo Agjendë bazohet në Rezolutën A/RES/70/1 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, e miratuar më 25 shtator 2015. Në kontekstin vendor, Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, ka shprehur vullnetin politik dhe gatishmërinë për t'u angazhuar në zbatimin e kësaj kornize globale, nëpërmjet Rezolutës Nr. 06-R-001 për miratimin e Objektiveve për Zhvillim të Qëndrueshëm (OZhQ). Ndërkaq, në tetor 2018, Kuvendi themeloi Këshillin për Zhvillim të Qëndrueshëm, si një mekanizëm ndërinstytucional në kuadër të Kuvendit, në shërbim të koordinimit të proceseve drejt përmbushjes së kësaj Agjende.

Agjenda 2030 paraqet një plan veprimi të nivelit global, në linjë me të cilin shtetet kanë shprehur përkushtimin dhe përpiqen të jenë partnerë për t'i përmbushur 17 objektiva, me 169 caqe specifike të synuara, të cilave u korrespondojnë 231 tregues<sup>54</sup>. Ky dokument në thelbin e vet, si shtylla kyçe të vizionit universal që mbart, vë: *popullatën, prosperitetin, planetin, paqen dhe partneritetin* (të njohura si pesë P-të), e tek të cilat mbështetet zhvillimi i vërtetë, rrjedhimisht edhe i qëndrueshëm.

Që kjo të realizohet, është jashtëzakonisht e rëndësishme që Agjenda të shihet e ndërlydhur dhe e ndërvarur në objektivat e saj dhe të ndiqet për t'u realizuar si një vizion kompleks e shumëdimensional. Agjenda bën thirrje për gjithpërfshirje dhe partneritet përkitazi me njohuritë, ekspertizën, përvojat, resurset etj., në mënyrë që progresi drejt arritjes së objektiveve të ndodhë gjithandej globalisht.

Objektivat dhe synimet e Agjendës 2030 shpërfaqin standardet e pranuar ndërkombëtarisht të të drejtave të njeriut dhe integrojnë parimet ndërsektoriale lidhur me to, në mënyrë që të realizohet përkushtimi për të mos lënë askënd pas dhe për të ndikuar në gëzimin e këtyre të drejtave nga çdokush dhe në çdo vend. Nga perspektiva e të drejtave të njeriut, përafërsisht gjysma e indikatorëve të OZhQ-së ka potencial të prodhojë të dhëna që drejtpërdrejt kanë relevancë për monitorimin e instrumenteve specifike të të drejtave të njeriut, përderisa pjesa tjetër ka relevancë të tërthortë apo ofrojnë informacion kontekstual dhe analitik.<sup>55</sup> Kjo

53 A. 198/2015, Kallëzimit penal PPN 154/2015, i hedhur poshtë nga Prokuroria Themelore në Prishtinë më 17 qershor 2020. Rasti është iniciuar më 10 mars 2015, ka ushtruar kallëzim penal kundër Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, për shkeljen e procedurave në dhënien e lejes mjedisore të integruar. Kërkesa K.nr. 48/1 e Inspektoratit të Mjedisit i MMPHI-së për fillimin e procedurës kundërvajtëse, e iniciuar kundër SharCem.

54 Për më tepër shih <https://unstats.un.org/sdgs/indicators/indicators-list/#:~:text=The%20global%20indicator%20framework%20includes%20231%20unique%20indicators>.

55 Për më tepër, shih [https://www.humanrights.dk/what-we-do/sustainable-development-goals/sdgs-indicators-data#:~:text=Approximately%20half%20\(49%25\)%20of,enable%20or%20limit%20the%20realisation](https://www.humanrights.dk/what-we-do/sustainable-development-goals/sdgs-indicators-data#:~:text=Approximately%20half%20(49%25)%20of,enable%20or%20limit%20the%20realisation)

ndërlidhje e Agjendës me të drejtat e njeriut theksohet tek Deklarata e Meridas<sup>56</sup> për rolin e Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut (IKDNj) në zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.

Aty po ashtu pohohet se Agjenda ka të mishëruar fuqishëm Kartën e Kombeve të Bashkuara<sup>57</sup>, Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut<sup>58</sup>, traktate dhe instrumente ndërkombëtare. Një pjesë të këtyre marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare, Republika e Kosovës i ka të integruara në Kushtetutë (neni 22)<sup>59</sup>. Megjithatë, fakti se vendi ynë nuk është shtet anëtar i Kombeve të Bashkuara, ka për rrjedhojë mosraportimin tek organet e traktateve, përfshirë Këshillin e të Drejtave të Njeriut dhe procesin e Rishikimit. Periodik Universal (UPR)<sup>60</sup>. Kjo gjë pashmangshmërisht afekton mënyrën e të raportuarit në nivel të mekanizmave dhe proceseve për monitorimin dhe zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare dhe progresin në këtë drejtim. Gjithashtu, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se vendi ynë ende nuk e ka të përfshirë në Kushtetutë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, një instrument kyç për sa i përket gëzimit të të drejtave të njeriut dhe shtyllë bazike për arritjen e objektivave dhe synimeve të Agjendës. Për më tepër, të dyja dokumentet e plotësojnë dhe fuqizojnë njëra-tjetrën, duke e konfirmuar dimensionin e ndërvarësisë dhe të universalitetit të të drejtave.

Sidoqoftë, bazuar në parimet e themelimit dhe funksionimit, IAP është IKDNj, kompatibil me Parimet e Parisit<sup>61</sup>. Për shkak të rëndësisë që kanë këto institucione në nivel ndërkombëtar, Agjenda e ka vendosur tregues të veçantë ekzistimin e këtyre institucioneve në pajtueshmëri me Parimet e Parisit (Objektivi 16, treguesi 16.a.1)<sup>62</sup>. Institucionet e kësaj natyre, gjithandej ku funksionojnë, aplikojnë **qasje të bazuar në të drejta të njeriut**<sup>63</sup> përgjatë punës së tyre, në ushtrimin e funksioneve dhe kompetencave e përgjegjësive që kanë. Kjo qasje është kornizë konceptuale e bazuar në standarde të pranuar ndërkombëtarisht, që kërkon të vendosë të drejtat e njeriut dhe obligimet përkatëse të shtetit në qendër të politikave dhe të dokumenteve të tjera strategjike.

Në përputhshmëri me këtë qasje, gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit i është përgjigjur ftesës së Zyrës për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, për të marrë pjesë në Dialogun e hisedarëve për Strategjinë Kombëtare për

56 Deklarata e Meridas është miratuar nga Aleanca Globale e IKDNj-ve (GANHRI) në Konferencën e 12-të të Komitetit Ndërkombëtar Koordinues të Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ICC), e mbajtur në Merida, Jukatan, Meksikë, më 8-10 tetor 2015. Fokusi i Konferencës ishte në "Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe rolin e IKDNj në këtë kontekst. Për më tepër për rolin e IKDNj-ve sipas kesaj Deklarate, ju lutem shihni në: <https://ennhri.org/our-work/topics/sustainable-development-goals/#:~:text=The%20M%C3%A9rida%20Declaration%2C%20adopted%20by,human%20rights%20and%20sustainable%20development>.

57 Për më tepër, shih <https://www.un.org/en/about-us/un-charter>

58 Për më tepër, shih <https://www.un.org/en/about-us/universal-declaration-of-human-rights>

59 Për më tepër, shih <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=3702>

60 Rishikimi Periodik Universal është një proces unik që përfshin rishikimin e të dhënave të të drejtave të njeriut të të gjitha shteteve anëtare të OKB-së. Si proces, drejtohet nga shteti, nën kujdesin e Këshillit të të Drejtave të Njeriut, i cili ofron mundësinë për çdo shtet të deklarojë se çfarë veprimesh kanë ndërmarrë për të përmirësuar situatën e të drejtave të njeriut në vendet e tyre dhe për të përmbushur detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut. Si një nga tiparet kryesore të Këshillit, UPR është krijuar për të siguruar trajtim të barabartë për çdo vend kur vlerësohen situatat e tyre të të drejtave të njeriut. Qëllimi përfundimtar i këtij mekanizmi është përmirësimi i situatës së të drejtave të njeriut në të gjitha vendet dhe adresimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut kudo që ato ndodhin. Aktualisht nuk ekziston asnjë mekanizëm tjetër universal i këtij lloji. (informacioni i qasshëm në: <https://www.ohchr.org/en/hrbodies/upr/pages/uprmain.aspx>)

61 Parimet e Parisit kanë të bëjnë me statusin e institucioneve kombëtare për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së 48/134, datë 20 dhjetor 1993.

62 Për më tepër, shih [https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG\\_Indicator\\_16a1\\_Metadata.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG_Indicator_16a1_Metadata.pdf)

63 Për më tepër shih <https://ennhri.org/about-nhris/human-rights-based-approach/>

Zhvillim (SKZh) 2030, në fund të tetorit, 2021, ngjarje kjo e organizuar me mbështetje nga GIZ-<sup>64</sup>. Ky dokument pritet të finalizohet dhe të miratohet në pjesën e parë të vitit 2022, meqë tashmë Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2016 - 2021 ka përmbyllur ciklin kohor për të cilin është hartuar. Kjo Strategji ka tendencë të shihet si një ombrellë për strategjitë e shumta sektoriale, disa prej të cilave edhe me plane veprimi. Referuar një Vlerësimi të shpejtë për përafrimin e politikave dhe të dhënat e disponueshme, të përgatitur nga Agjencitë e Kombeve të Bashkuara në Kosovë, nën udhëheqjen e Ekipit të Kosovës të Kombeve të Bashkuara (UNKT), Kosova: “[...] vazhdon përpjekjet për t’i integruar OZHQ-të në dokumentet e politikave, përdërisa matja e progresit drejt OZHQ-ve po sistematizohet.”<sup>65</sup> Po aty analizohet se përafrimi i përgjithshëm i politikave me OZhQ-në shpërndahet në tri nivele: plotësisht 28% (36 objektiva të 10 dokumenteve); pjesërisht 66% (84 objektiva të 28 dokumenteve); përdërisa 6% (8 objektiva të 5 dokumenteve) konsiderohen se nuk janë përafruar<sup>66</sup>.

Në anën tjetër, zotimi i qeverisë për qeverisje të mirë, sundim të ligjit, për rritje ekonomike, mjedis të pastër, resurse të qëndrueshme, shërbime efektive shëndetësore, arsim cilësor e konkurrues, është domethënës nga perspektiva e të drejtave të njeriut në kuadër të vizionit të vendit për të qenë krahas përpjekjeve globale për arritjen e OZhQ-së. Ky zotim krijon besim se edhe politikat dhe dokumentet strategjike në hartim e sipër (sikur SKZh në fjalë), do të shkojnë drejt përafrimit të mëtejshëm me OZhQ-në dhe me caqet e Agjendës 2030.

Në vazhden e gatishmërisë për bashkëpunim dhe për të ofruar perspektivën e të drejtave të njeriut, Avokati i Popullit po ashtu ka marrë pjesë në Forumin e lartë politik për integrimin e Agjendës 2030 në kuadrin e planifikimit strategjik në Kosovë, mbajtur në fund të nëntorit 2021, i ftuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës dhe Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP).

Në funksion të partneritetit për Zhvillim të Qëndrueshëm me partnerë shumëpalësh që mobilizojnë dhe ndajnë njohuri dhe inkurajohen të promovojnë partneritete efektive, veç të tjerësh edhe me shoqërinë civile, më 1 dhe 2 dhjetor u mbajt Takimi IV Rajonal ndërmjet institucioneve homologe të Avokatit të Popullit në Shqipëri, Avokatit të Popullit në Maqedoni të Veriut dhe Avokatit të Popullit në Kosovë, si dhe Komisionarit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Shqipëri, rol të cilin aktualisht në Kosovë e përmbush institucioni i Avokatit të Popullit, si dhe përfshirjes në diskutime në ditën e dytë të punimeve edhe të përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile (OShC).

**Qasja e bazuar në të drejta të njeriut** shërben për të fuqizuar mbajtësit e të drejtave të njeriut (individët, komunitetet) të kërkojnë dhe të ushtrojnë të drejtat e tyre, si dhe të rrisë kapacitetet e bartësve të përgjegjësive, për të respektuar, mbrojtur e promovuar të drejtat dhe liritë e garantuara dhe për të përmbushur detyrimet e obligimet që kanë.

Bazuar në Rezolutën për Agjendën 2030, është përgjegjësi e qeverive respektive ndjekja dhe vlerësimi i progresit për sa i përket arritjes së objektivave dhe caqeve të synuara. Për të ndihmuar në këtë aspekt dhe në shërbim të llogaridhënies nga ana e qeverive, është zhvilluar korniza globale e treguesve (indikatorëve). Të dhënat e disagreguara, kualitative, të qasshme, të besueshme dhe në kohë, janë thelbësore për vlerësimin e progresit në të drejta të njeriut, për të nxjerrë në pah pabarazitë, për të siguruar llogaridhënie dhe transparence, si dhe për të ofruar informacionin e nevojshëm për vendimmarrësit<sup>67</sup>.

64 Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit në emër të Ministrisë Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ).

65 Vlerësim i shpejtë i integruar: Përafrimi i politikave dhe disponueshmëria e të dhënave në Kosovë, i vitit 2021. Për më tepër, shih fq. 4 <https://kosovoteam.un.org/sites/default/files/2021-09/Kosovo%20SDG%20Report%20AL.pdf>

66 Po aty, fq. 5.

67 Për më tepër, shih [https://www.un.org/ga/search/view\\_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E](https://www.un.org/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/RES/70/1&Lang=E)

Në këtë kontekst, Deklarata e Meridas definojnë rolin e IKDNJ-së për sa i përket kompetencës së tyre këshilluese përkritazi me formësimin e treguesve kontekstualë dhe sistemeve të shëndosha të mbledhjes së të dhënave, si dhe rolin monitorues për sa i përket progresit në zbatimin e Agjendës.<sup>68</sup> Në këtë frymë dhe në përmbushje të obligimeve sipas Rezolutës së Parlamentit të vendit të vitit 2018, IAP-ja dhe Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) kanë nënshkruar në janar 2020, një Memorandum dypalësh të Mirëkuptimit.<sup>69</sup> Ky Memorandum është mbështetur nga Zyra e Komisionarit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejta të Njeriut (OHCHR) në Gjenevë, me ndërmjetësimin e Zyrës për të Drejta të Njeriut të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, me të cilën kanë vazhduar kontaktet dhe takimet edhe gjatë vitit 2021, përkritazi me çështjet e të drejtave dhe lirive të njeriut që janë në fokus të interesimit të përbashkët, përfshirë Agjendën 2030.

Me qëllim të vënies në funksion të Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe ASK-së është themeluar Grupi i përbashkët punues, i cili, përkundër vështirësive të krijuara nga pandemia dhe funksionimi i përgjithshëm në rrethana jo të zakonshme, si dhe zhvillimeve në kontekst institucionesh dhe procesesh në vend, ka realizuar disa takime, me qëllim qartësimin e roleve institucionale dhe obligimeve sipas mandateve që bartin. Vlen të veçohet punëtorja në gusht 2021, në të cilën kanë marrë pjesë edhe krerët e dy institucioneve palë të Memorandumit, të cilët kanë ritheksuar përkushtimin për të luajtur rol aktiv institucional në përmbushje të Agjendës 2030.

Ndërkaq, në funksion të rritjes së kapaciteteve të institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut në Shqipëri dhe në Kosovë dhe të institucioneve respektive të statistikave zyrtare në të dyja vendet, në dhjetor 2021 është mbajtur një trajnim<sup>70</sup> i realizuar nga ekspertë të Zyrës së Kombeve të Bashkuara në New York dhe të Zyrës së OHCHR-së në Gjenevë. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë anëtarët e Grupit punues për operacionalizimin e Memorandumit nga IAP-ja dhe ASK-ja. Një punëtor për ngritjen e kapaciteteve dhe rolin e IAP-së dhe të ASK-së për anëtarët e Grupit punues në funksion të operacionalizimit të Memorandumit është mbajtur në tetor të vitit 2020, nga një ekspert i jashtëm i angazhuar në baza vullnetare.

Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet IAP-së dhe ASK-së shërben për të ndihmuar identifikimin e treguesve për të cilët aktualisht ka të dhëna Kosova; treguesve për të cilët, nga perspektiva e të drejtave të njeriut, të dhënat janë të domosdoshme; treguesve kontekstualë; grupet e cenueshme dhe të lëna anash; si dhe grupet e synuara. Po ashtu, të dhënat statistikore, përfshirë treguesit specifikë, shërbejnë në matjen e zbatimit të rekomandimeve të mekanizmave ndërkombëtarë dhe vendorë për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu rekomandimet e IAP-së.

Gjatë komunikimeve dhe bashkëpunimit që ka pasur Grupi punues IAP –ASK është vënë theksi mbi faktin se ka të dhëna për një numër treguesish, e që një pjesë e tyre korrespondojnë me treguesit e OZhQ-së, por ka edhe zbrazëti dhe mungesë të të dhënave gjithashtu. Kjo mungesë të dhënash thellohet kur vjen puna te disagregimi i tyre, që nga perspektiva e të drejtave të njeriut paraqet çështje që kërkon vëmendje të veçantë dhe të shtuar.

68 Për më tepër, shih <https://www.theioi.org/ioi-news/current-news/merida-declaration-on-nhris-role-in-implementing-the-2030-agenda-for-sustainable-development>

69 Për më tepër, shih <https://oik-rks.org/2020/01/17/>

70 Trajnimi është organizuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit i Shqipërisë, në lidhje me Agjendën 2030 dhe të drejtat e njeriut, nëpërmjet platformës elektronike Zoom.

Identifikimi i treguesve përkatës, të cilët bazohen në udhëzimet mbi treguesit e të drejtave të njeriut dhe në **qasjen ndaj të dhënave të bazuar në të drejtat e njeriut**<sup>71</sup>, të përpiluar nga Zyra e OHCHR-së, është i pashmangshëm për zbatimin e Agjendës 2030. Në këtë kontekst, Avokati i Popullit rikujton se autoritetet përgjegjës dhe kompetentë për ta drejtuar procesin për zhvillimin e treguesve në nivel vendi janë zyrat për statistika kombëtare, sikur është ASK-ja, meqë kanë njohuri për burimet e qasshme të të dhënave dhe kanë njohuri për pengesat kryesore të cilat duhet të adresohen. Megjithatë, përfshirja aktorëve të tjerë kryesorë dhe relevantë në këtë proces është e domosdoshme.

Së këndejmi, është identifikuar si qenësore që të zgjerohet ndërveprimi institucional, sa i përket mbledhjes së të dhënave, identifikimit dhe matjes së treguesve dhe shfrytëzimit të këtyre të dhënave për të monitoruar dhe matur progresin apo ngecjet drejt realizimit të OZhQ-së. Kjo është jashtëzakonisht e rëndësishme për ta pasqyruar situatën aktuale në raport me progresin përgjatë viteve, si dhe në krahasim me standardet e synuara dhe në pajtim me objektivat e përcaktuara. Në këtë kontekst, mbetet sfidues fakti se burimet administrative të të dhënave shpesh i kanë jo të standardizuara metodologjitë dhe përkufizimet me kriteret sipas të cilave funksionon ASK-ja, në mënyrë që ato të jenë të besueshme dhe të zbërthyer, për të matur progresin në vend, duke marrë për bazë edhe kërkesat kontekstuale. Agjencia e Regjistrimit Civil dhe institucionet e sundimit të ligjit kërkojnë vëmendje të veçantë nga kjo perspektivë. Gjithsesi, zhvillimi në këto segmente do të ketë kosto shtesë ose zvogëlim të burimeve në fushat të tjera.

Një aspekt që reflekton vështirësi edhe në punën e Grupit punues, veçmas në këtë periudhë kur janë duke u finalizuar përgatitjet për Projektin e regjistrimit të përgjithshëm të popullsisë, bartës i të cilit është ASK-ja, është edhe objekti i papërshtatshëm<sup>72</sup> ku ASK-ja funksionon, si dhe nevoja për më shumë punonjës. Në anën tjetër, pozicionimi i ASK-së brenda strukturës institucionale (Agjenci në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Trasfereve) kërkon vlerësim të kujdesshëm dhe të përgjegjshëm. Avokati i Popullit inkurajon Qeverinë dhe Kuvendin e Republikës së Kosovës që ASK-ja të jetë në linjë të drejtpërdrejtë llogaridhënëse ndaj Parlamentit ose Qeverisë (ZKM-së).

Përveç rolit këshillues dhe monitorues, IKDNj-ja po ashtu shihet si ura lidhëse ndërmjet mbajtësve të të drejtave dhe shtetit, lidhur me dizajnimin dhe monitorimin e politikave, strategjive dhe veprimeve. Si i tillë, Avokati i Popullit, në pajtim me mandatin dhe funksionet që kryen, adreson vazhdimisht çështje që prekin të drejtat e njeriut, duke vënë në fokus grupet e cënueshme dhe të lëna anash.

Angazhim i një natyre të tillë mund të shihet edhe themelimi i Task-Forcës avokuese joformale për standardet e ndjeshme gjinore të sigurisë dhe të shëndetit në punë dhe të punës së denjë. Kjo Task-Forcë përbëhet nga Avokati i Popullit, si kryesues, ndërsa bashkëkryesuese do të jetë përfaqësuesja e Grupit të Grave Deputete, një numër i organizatave nga shoqëria civile, si dhe Inspektorati i Punës, Oda Ekonomike e Kosovës dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Sekretariati i Task-Forcës do të sigurohet nga UN Women. Ky angazhim ka ndërlidhje të ngushtë me Objektivin 5 dhe me Objektivin 8 të Agjendës 2030.

Po ashtu, në tetor 2021 u bë themelimi i Forumit të Dialogut ndërmjet IAP-së dhe Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHc). Qëllimi i forumit është një bashkëpunim i strukturuar dhe krijimi i një platforme të përbashkët për përfshirjen aktive nga aktorët palë të Forumit, si dhe zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta për të adresuar çështje që kanë

71 Udhëzuesi i plotë: <https://www.ohchr.org/documents/issues/hrindicators/guidancenoteonapproachtoadata.pdf>

72 Shih po të njëjtin konstatim edhe në Raportin për Kosovën 2020 të Bashkimit Evropian [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/kosovo\\_report\\_2020.pdf](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/system/files/2020-10/kosovo_report_2020.pdf)

në prioritet progresin në respektimin, mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë. Ky angazhim ka ndërlidhje me Objektivin 17 të Agjendës 2030.

Po ashtu, përfaqëues të IAP-së kanë ndjekur takimet nëpërmjet platformave elektronike të Grupit të Rezultateve për prioritetin 4 dhe të Grupit të Rezultateve për prioritetin 5, në kuadër të Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UNSDCF) 2021–2025.<sup>73</sup>

Sa u përket çështjeve që trajton, përshtatshmërisht mandatin, kompetencave e përgjegjësi dhe ndërlidhjes me OZhQ-në, gjatë vitit 2021 Avokati i Popullit ka filluar një hetim të përgjithshëm për shëndetin riprodhues, me fokus shëndetin maternal, planifikimin familjar dhe abortin në Kosovë. Ky hetim do të ketë për bazë dëshmi të drejtpërdrejta nga gra/vajza, që potencialisht u janë cenuar të drejtat; dëshmitarë dhe ekspertë, përfshirë shoqëri civile, lidhur me shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut në fushën e shëndetit dhe të të drejtave seksuale dhe riprodhuese.

Me shtrirje në gjithë vendin, ky hetim paraqet vazhdimësi të punës së Avokatit të Popullit dhe ndërlidhet ngushtë me Agjendën 2030, veçanërisht me disa nga synimet e Objektivit 3: *“Sigurimi i jetës së shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë në të gjitha moshat.”*; dhe Objektivit 5: *“Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.”* Hetimi në fjalë pason Vlerësimin e Përgjithshëm të të Drejtave dhe të Shëndetit Seksual dhe Riprodhues<sup>74</sup>, i realizuar në vitin 2016 nga IAP-ja, i cili ka qenë vlerësim i progresit dhe barrierave politike, socio-ekonomike dhe kulturore në shëndetin riprodhues dhe seksual në Kosovë, përmes lenteve të të drejtave të njeriut, të lidhura drejtpërdrejt me Objektivin 3 (caqet e synuara: 3.7, 3.1, 3.3) dhe me Objektivin 5 (caqet e synuara 5.6, 5.2, 5.3) të OZhQ-së.

Hetimi që ka filluar në vitin 2021 ka po ashtu ndërlidhje të ngushtë veçmas me objektivat 3 dhe 5. Ky hetim do të jetë gjithëpërfshirës, por me vëmendje të shtuar për grupet e cenueshme dhe të mbetura anash dhe do të trajtojë problematika që shfaqen në mënyrë sistematike në fushat e lartpërmendura. Metodologjia e punës për realizimin e këtij hetimi është në linjë me parimet e punës së Avokatit të Popullit, që nënkupton: mirëqeverisje, transparencë, gjithëpërfshirje, mosdiskriminim, ndjeshmëri gjinore, konfidencialitet, si dhe do ta ndjekë parimin për të mos bërë dëm. Hetimi ka dimension publik dhe tashmë janë mbajtur fokus-grupet e para në shtatë regjionet e vendit. Ky hetim, ashtu si edhe Vlerësimi në vitin 2016, janë mbështetur nga UNFPA, Zyra në Kosovë.

73 Takimi fillestar i Komitetit të Përbashkët Drejtues (KPD) të Kornizës së Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (UNSDCF) 2021–2025 është mbajtur më 25 qershor 2021, bashkëkryesuar nga Kryeministri dhe Koordinatorja e OKB-së për Zhvillim me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të qeverisë dhe të Agjencive, Fondeve dhe Programeve të Ekipit të OKB-së për Kosovën (UNKT). UNSDCF-ja e miratuar ofron një qasje strategjike dhe të harmonizuar të bashkëpunimit të UNKT-së në Kosovë për të adresuar së bashku nevojat kryesore të zhvillimit në bashkëpunim me qeverinë dhe me partnerët e tjerë të zhvillimit dhe të harmonizuara me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe aspiratat e integritit në BE. Prioritetet kryesore të UNSDCF-ja janë: 1) Qeverisja e përgjegjshme; 2) Politikat dhe shërbimet përfshirëse dhe jodiskriminuese sociale; 3) Zhvillimi ekonomik i gjerë, i qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës; 4) Kohezioni Social dhe 5) Temat ndërsektoriale për rritjen e barazisë gjinore, pjesëmarrjen e mbajtësve të të drejtave, fuqizimin dhe angazhimin qytetar. Grupet e përmendura të rezultateve janë mekanizmat kryesorë të zbatimit që drejtojnë secilën nga këto pesë fusha prioritare. Planet e Përbashkëta të Punës për secilin Grup Rezultatesh janë zhvilluar dhe miratuar në takimin e parë të BDP-së në qershor.

74 Nga ky Vlerësim i Përgjithshëm u adresuan tek autoritetet përgjegjëse 62 rekomandime, prej të cilave 27 janë konsideruar se janë zbatuar, ndërmjet tyre edhe rekomandimi drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës që ta adoptojë formalisht OZhQ-në. Mbetet në pritje për zbatim rekomandimi për amendamentimin e Kushtetutës për të përfshirë Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Kartën Sociale të Evropës, në mënyrë që të jenë direkt të aplikueshme në vendin tonë.

Një hetim tjetër sipas detyrës zyrtare në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me HIV dhe me TB, gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, është adresuar tek autoritetet përgjegjëse, po ashtu gjatë vitit 2021. Qëllimi i këtij Raporti është i ndërlidhur me Objektivin 3 (caqet e synuara: 3.3; 3.8). Ky hetim është përkrahur nga Fondi për Zhvillim Komunitar (CDF), përmes grantit të Fondit Global që lufton AIDS-in, Tuberkulozin dhe Malarien.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka adresuar edhe një Raport të veçantë përkitazi me ndikimin e pandemisë në të drejtat e njeriut në vend, që shkon në frymën e Premtimit për Rimëkëmbje të Qëndrueshme<sup>75</sup>. Ky Raport i Avokatit të Popullit prek një numër të madh të temave, brenda trajtimit të të cilave, mund të krijohet ndërlidhja me caqet e synuara të OZhQ-së: shëndeti publik dhe shëndeti mendor (Objektivi 3); e drejta për arsim (Objektivi 4), ndikimi i pandemisë në të drejtat sociale dhe ekonomike dhe në të drejtën e punës në sektorin publik dhe privat (objektivat 1 dhe 8 ), mjedisi jetësor (objektivat 13 dhe 15); dhuna në familje (Objektivi 5) etj.

Paraprakisht, në pjesën e parë të vitit 2021, AP kishte adresuar Raportin tjetër sipas detyrës zyrtare, i cili kishte në fokus kufizimet në ofrimin e shërbimeve për personat që nuk ishin të infektuar me COVID 19. Çështjet e hetuara dhe trajtuara në këtë raport lidhen ngushtësisht me objektivin 3, e në veçanti caqet e synuara 3.8 dhe 3.c.

Në anën tjetër, përkitazi me masat ligjore dhe politikat për të eliminuar diskriminimin dhe pabarazitë e mëtutjeshme substanciale, IAP-ja mund të këshillojë dhe të ngre çështje që kërkojnë vëmendjen imediate apo masa të veçanta. Avokati i Popullit ka rol këshillues dhe avokues në lidhje me obligimet përkitazi me të drejtat e njeriut, së këndejmi edhe me OZhQ dhe zbrazëtitë që cenojnë grupet e veçanta e më të cenueshme të mbajtësve të të drejtave.

Një aktivitet në kuadër të këtij roli të Avokatit të Popullit ishin vizitat në gjashtë qendra të cilat punojnë me fëmijë me nevoja të veçanta, në katër komuna të vendit. Gjithashtu, në lidhshmëri me të drejtat e fëmijës dhe rolit rekomandues që Avokati i Popullit ka kundrejt autoriteteve, i ka adresuar Qeverisë, Këshillit Gjyqësor dhe Komisionit të Pavarur të Medias, Raport me të cilin rekomandon miratimin e 16 akteve nënligjore të parapara me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës. Për më tepër, në mënyrë që fëmijët të gëzojnë plotësisht të drejtën në arsim, IAP-ja ka publikuar dy raporte me rekomandime për ndryshimin dhe plotësimin e legjisllacionit primar dhe sekondar<sup>76</sup>. Këto aktivitete mund të konsiderohen në funksion të përplotësimit të indikatorëve strukturorë, kryesisht sa i përket Objektivit 4.

Një tjetër aktivitet e që kishte fokus personat me aftësi të kufizuara, ishte bashkëpunimi me Iniciativën e Pavarur të të Verbërve të Kosovës, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, më 3 dhjetor 2021. Ngjarja mbledhi bashkë me personat e verbër që ishin të pranishëm edhe zyrtarët institucionalë vendorë dhe ndërkombëtarë, shoqërinë civile dhe përfaqësues të organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë. Gjithsesi, në këtë pikë, Avokati i Popullit e konsideron të rëndësishme të tërheqë vëmendjen e Kuvendit të Republikës së Kosovës se përfshirja në Kushtetutën e vendit e Konventës mbi të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara do të krijonte mundësinë e ballafaqimit sfidues por të domosdoshëm me pengesat që personat me nevoja të veçanta kanë në realizimin e të drejtave të tyre.

75 Kjo Deklaratë e bazuar në Agjendën 2030, por e iniciuar si veprim përballë situatës së krijuar me pandeminë globale COVID-19, është lansuar në korrik 2021, e përkrahur dhe nënshkruar nga aktorë shtetërorë dhe joshetërorë të shumë shteteve të Kombeve të Bashkuara. Dokumentin e plotë e gjeni në <https://fngeve.um.dk/en/copy-of-human-rights/sustainable-recovery-pledge>

76 Për më tepër shih në këtë Raport pjesën ku flitet për të drejtat e fëmijës.

Gjithsesi, Avokati i Popullit, në Strategjinë e IAP-së 2021 – 2025, ka vendosur si qëllim strategjik të veçantë Promovimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, përderisa që nga viti 2019, IAP-ja, mbështetur nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe me mbështetje financiare të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Norvegjisë, ka lansuar nëpërmjet ueb-faqes së institucionit një platformë elektronike<sup>77</sup> që shërben si udhëzues për OZhQ-në dhe ndërlidhjen me të drejtat e njeriut, respektivisht ndërlidhjen e 169 synimeve në kuadër të 17 OZhQ-ve me instrumentet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Republikën e Kosovës dhe në legjislacionin e zbatuar parësor. Udhëzuesi lehtëson të kuptuarit e lidhjes së OZhQ-së me të drejtat e njeriut dhe të instrumenteve për respektimin dhe mbrojtjen e tyre dhe synon të ndihmojë në zhvillimin e projekteve të ndryshme, hulumtimeve dhe raportimeve drejt arritjes së Agjendës 2030.





### III. Të drejtat e fëmijëve

Të drejtat e fëmijëve përbëjnë një pjesë integrale të të drejtave të njeriut. Fëmijët kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme njerëzore si të rriturit, por edhe të drejta specifike që u përshtaten nevojave të tyre të veçanta si fëmijë. Fëmijët janë bartës të të drejtave dhe pjesëmarrës aktivë në realizimin e tyre. Realizimi i të drejtave ua mundëson atyre të zhvillohen në potencialin e tyre të plotë, duke ua njohur dinjitetin njerëzor dhe urgjencën për të siguruar mirëqenien e tyre. Pa dyshim, zhvillimi i shëndetshëm i fëmijëve është thelbësor për mirëqenien e ardhshme të çdo shoqërie.

Mirëpo, duke qenë se fëmijët janë të varur nga të rriturit, ata janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të mëdha shoqërore, siç është rasti i pandemisë COVID-19. Andaj veprimet ose mosveprimet e institucioneve, të shoqërisë dhe të prindërve mund të ndikojnë tek fëmijët më shumë se tek çdo grup tjetër shoqëror. Rrjedhimisht është e rëndësishme që këto veprime ta kenë parasysh interesin më të mirë të fëmijës gjatë hartimit të politikave dhe të legjislacionit. Analiza e situatës së fëmijëve në Kosovë edhe në këtë vit tregon se fëmijët ende hasin në vështirësi për gëzimin e plotë të të drejtave të tyre. Këto vështirësi janë të shfaqura gati në të gjitha fushat e jetës së tyre, veçanërisht në realizimin e së drejtës për arsim dhe mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Gjendja e krijuar nga pandemia globale COVID-19 ka nxjerrë në pah edhe më shumë mangësitë për realizimin e këtyre të drejtave si dhe ka thelluar



pabarazitë ekzistuese. Në dhjetor të vitit 2021, IAP-ja ka publikuar Raportin “*Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës*”, ku në një kapitull të veçantë ka shtjelluar edhe ndikimin e pandemisë dhe masave të ndërmarra për parandalimin dhe luftimin e saj në të drejtat e fëmijëve<sup>78</sup>. Avokati i Popullit ka konstatuar se vendimet e Qeverisë dhe të institucioneve përkatëse nuk kanë marrë për bazë nivelin e kërkuar të zbatimit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës. Pandemia dhe vendimet gjegjëse të nxjerra nga Qeveria dhe nga institucionet e tjera, kanë ndikuar në realizimin e të drejtave të fëmijës në Republikën e Kosovës. Edhe pse raporti e kishte të vështirë të konkludonte saktë shkallën e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, veçanërisht të atyre me aftësi të kufizuar, shkeljet nga veprimi apo mosveprimi i Qeverisë dhe i institucioneve të tjera janë evidentuar përgjatë hetimit në shumë fusha dhe aspekte.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës mbron shprehimisht të drejtat e fëmijëve dhe imponon detyrime ligjore për shtetin për t’i respektuar, mbrojtur dhe përmbushur këto të drejta, përmes zbatimit të drejtpërdrejtë të Konventës për të Drejtat e Fëmijës (KDF). Plotësimi i kornizës ligjore me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF) dhe hyrjen e tij në fuqi në korrik të vitit 2020, shënon një hap të rëndësishëm drejt realizimit të të drejtave të tyre. Sidoqoftë, miratimi i ligjeve mbetet vetëm një hap simbolik nëse nuk ndiqet me hapa konkretë dhe zbatim të suksesshëm. Ndonëse LMF-ja ka autorizuar institucionet kompetente që në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e tij t’i nxirrnin 18 akte nënligjore, deri më sot janë nxjerrë vetëm dy. Në këtë drejtim IAP-ja, në bazë të autorizimit të LMF-së dhe të Ligjit për Avokatin e Popullit, ka nxjerrë Rregulloren (IAP) nr. 01/2019 për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve<sup>79</sup>. Në mënyrë që kjo Rregullore të jetë sa më e kuptueshme dhe e qasshme për fëmijët, IAP-ja ka mbajtur edhe një punëtori për shqyrtimin e Fletushkës për Rregulloren, ku morën pjesë edhe fëmijë të cilët dhanë komentet e tyre.

78 Raport i Avokatit të Popullit, Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, 2021, në: <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republikene-kosoves/> [e qasur së fundmi më datën 3.1.2021].

79 IAP, Rregullorja nr. 01/2019 për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve, 2019.

Përgjatë këtij raporti, IAP-ja ka përfshirë rekomandime konkrete për secilën nga fushat e adresuara. Natyrisht është qenësore që këto procese të përfshijnë zërin dhe pikëpamjen e fëmijës në pajtim me zhvillimin gradual të aftësive të tij/saj.

## Propozimet për ndryshimin dhe plotësimin e legjislacionit në fushën e të drejtave të fëmijëve

Pandemia ka pasur ndikim edhe në vonesat për zbatimin e agjendës legjislative të Qeverisë dhe të Kuvendit. Disa prej ligjeve që prekin interesin e drejtpërdrejtë të fëmijëve, siç janë: Ligji për Shërbime Sociale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal, nuk është arritur të procedoheshin në Kuvend për aprovim, ndonëse ishin draftuar si dhe gjashtëmbëdhjetë nga aktet nënligjore të parapara me LMF nuk janë miratuar ende.

Lidhur me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, IAP-ja ka publikuar Raport me Rekomandime për Qeverinë e Kosovës, për Këshillin Gjyqësor të Kosovës dhe për Komisionin e Pavarur për Media për të miratuar aktet nënligjore përkatëse<sup>80</sup>. Në vitin 2020 IAP-ja kishte nisur hetimet ex-officio 381/2020 lidhur me vlerësimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës (LMF). LMF-ja ka autorizuar institucionet kompetente që në afat prej një viti nga hyrja në fuqi e tij në korrik të vitit 2020 të nxirreshin 18 akte nënligjore. Këto akte janë të një rëndësie të veçantë për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve dhe pos të tjerash e mundësojnë: bashkërendimin e autoriteteve përkatëse në nivel qendror dhe lokal; funksionimin e Këshillit për të Drejtat e Fëmijës; themelimin dhe funksionimin e Ekipeve për të drejtat e fëmijës; funksionimin e themelimit të tryezave multidisiplinore për ndihmë në menaxhimin e rastit; organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës; marrjen e masave të duhura në mbrojtjen e fëmijës nga substancat narkotike dhe psikotrope; marrjen e masave të duhura parandaluese dhe mbrojtëse në ndalimin e pjesëmarrjes në klubet e natës dhe në lojërat e fatit; mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve në masmedia - me theks të veçantë për fëmijët të cilët janë nën përkujdesje institucionale; marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e fëmijëve nga internet-kafetë dhe video-lojërat, duke përfshirë masat specifike ndaj përmbajtjeve pornografike, ndëshkimin e abuzuesve me fëmijë në internet, reduktimin e qasjes së fëmijës në materiale të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, ofrimi i ndihmës për fëmijën që është në rrezik nga të gjitha format e dhunës përmes internetit. Deri në fund të vitit 2021 janë miratuar vetëm Udhëzimi administrativ (QRK)-nr 02/2021 për zbatimin e drejtësisë mike ndaj fëmijës në procedurën penale, civile dhe administrative si dhe Rregullorja (IAP) nr. 01/2019 për procedurat e veçanta për pranimin, trajtimin dhe adresimin e ankesave të paraqitura nga fëmijët apo ankesave që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve.

Gjatë këtij viti, **lidhur me të drejtën në arsim**, IAP-ja ka publikuar dy raporte me rekomandime për ndryshimin e legjislacionit: Raport me Rekomandim në lidhje me mungesën e harmonizimit të Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje<sup>81</sup> dhe Raport me Rekomandim në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë<sup>82</sup>.

80 Raport me Rekomandim *Ex-officio* nr. 381/2020 në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, 2021, në: <https://oik-rks.org/raportet/ex-officio-raportet/> [e qasur së fundmi më datën 3.1.2021].

81 Raport me Rekomandim *Ex-officio* nr. 69/2021 në lidhje me mungesën e harmonizimit të Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, 2021, në: <https://oik-rks.org/raportet/ex-officio-raportet/> [e qasur së fundmi më datën 3.1.2021].

82 Raport me Rekomandim *Ex-officio* nr. 597-2020 në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, 2021, në: <https://oik-rks.org/raportet/ex-officio-raportet/> [e qasur së fundmi më datën 3.1.2021].

Raporti i parë i rekomandon Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) ndryshimin dhe plotësimin e dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 04/1-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës (LAPRK) si dhe harmonizimin e tij me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje (LK).

LK-ja përcakton se askush nuk mund të dënohet për kundërvajtje për veprën e cila pasi të jetë kryer nuk ka qenë e përcaktuar si kundërvajtje me ligj ose me akte të kuvendit të komunës si dhe për të cilën nuk ka qenë i përcaktuar sanksioni kundërvajtës. Ky ligj po ashtu obligon që të gjitha dispozitat për kundërvajtje, që nuk janë në pajtim me të, duhet të harmonizohen brenda afatit prej një viti nga hyrja në fuqi e ligjit. Në anën tjetër, LAPRK-ja në nenin 15 - *Vijushmëria në shkollë*, ka përcaktuar se vijimi i shkollimit të detyruar për nxënësin është përgjegjësi kryesore e prindit. Në rastet kur prindi nuk e regjistron fëmijën në shkollë ose nuk bën aranzhime alternative për të, pa ndonjë shkak të arsyeshëm dhe/ apo të pashmangshëm, atëherë ai prind shkel ligjin. Më tutje ky nen obligon MASHTI-n për të përgatitur udhëzime për t'i ndihmuar komunat dhe institucionet arsimore dhe aftësuese për të adresuar në mënyrë efektive braktisjen. *Neni 47 - Shkollimi në shtëpi* ka përcaktuar përgjegjësinë mbi komunën për të vlerësuar nëse fëmija nuk është duke u arsimuar në mënyrë të duhur, qoftë përmes vijushmërisë së rregullt në shkollë ose ndryshe, apo nëse nuk i nënshtrohet përjashtimit të përhershëm sipas ligjit. Ky nen përcakton edhe procedurën të cilën duhet ndjekur komuna, ku fillimisht ajo u dërgon një vërejtje me shkrim prindërve dhe kërkon nga ata ta bindin komunën se fëmija është duke u arsimuar në shtëpi ose diku tjetër, brenda afatit kohor të përcaktuar. Nëse prindërit nuk i përgjigjen komunës brenda afatit kohor të specifikuar në vërejtje, komuna e vazhdon rastin në procedurë për kundërvajtje. Mirëpo, nëse prindërit përgjigjen se fëmija është duke u arsimuar jashtë sistemit formal të arsimit, aranzhimet e bëra nga prindërit si dhe ato të inspeksionit, pas konsultimeve me komunën përkatëse, i nënshtrohen autorizimit të MASHTI-t. IAP-ja ka vlerësuar se dispozitat e lartëcekura të LAPRK-së nuk janë rregulluar me sanksione të qarta kundërvajtëse si dhe ka vërejtur se këto nene nuk kanë gjetur zbatim në asnjë rast. Që nga hyrja në fuqi e LK-së kanë kaluar më shumë se katër vjet dhe LAPRK-ja ende nuk është në pajtim me LK-në, andaj IAP-ja ka rekomanduar harmonizimin e këtyre ligjeve. IAP-ja është njoftuar nga MASHTI se këto ndryshime legjislative janë pranuar nga Ministria dhe se do të përfshihen në planin legjislativ për vitin e ardhshëm.

Raporti i dytë i rekomandon MASHTI-t ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr.19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, për të harmonizuar procedurën dhe kriteret e pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore me parimet bazë dhe autorizimet që dalin nga Ligji nr. 02/L-52 mbi Edukimin Parashkollor (LEP) dhe nga LMF-ja.

Në tetor të vitit 2020, IAP-ja kishte hapur hetimet ex-officio duke u bazuar në informatat e siguruar nga *Kallxo.com* se në komunën e Malishevës, të Ferizajt, të Fushë Kosovës, të Istogut, të Rahovecit, të Skenderajt, të Vitisë dhe të Vushtrrisë, përpos kriterëve ligjorë të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ, komunat kishin vendosur edhe kriterë shtesë për pranimin e fëmijëve në çerdhe publike. Kriteri shtesë i raportuar ishte se të dy prindërit duhet të jenë në marrëdhënie pune dhe i referohej kapaciteteve të kufizuara. IAP-ja kontaktoi këto komuna lidhur me verifikimin e këtij raportimi. Deri më datën e publikimit të këtij raporti, IAP-ja nuk mori përgjigje nga Komuna e Malishevës, e Fushë Kosovës dhe e Rahovecit. Po ashtu, në prill 2020 IAP-ja hapi hetimet ex-officio duke u bazuar në informatat e siguruar nga televizioni "*Kanal 10*" se si kopshti "*Botanika*" në Prishtinë ka refuzuar të pranonte fëmijën gjashtë vjeç me nevoja të veçanta. Sipas "*Kanal 10*", pos të tjerash, thuhej se "*Botanika*" gjendej vetëm 10 minuta larg nga shtëpia ku jetonte fëmija në fjalë. Ndonëse prioritet për atë çerdhe kanë fëmijët e lagjes, fëmijës në fjalë i ishte mohuar kjo e drejtë me arsyetimin se nuk ka hapësirë për fëmijët e tjerë me nevoja të veçanta. Kopshti "*Botanika*" ka njoftuar IAP-në se në këtë institucion vijnë mësimin njëzet fëmijë, ku tre prej tyre janë me aftësi të kufizuara, duke zbatuar paragrafin 7 të nenit 5 të Udhëzimit

Administrativ. Me këtë gjithashtu është zbatuar paragrafi 9 i po këtij neni, ku përcaktohet se numri maksimal i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore mund të jetë 3 fëmijë. Sipas “Botanikës”, në interpretim të kësaj dispozite, kopshti nuk ka mundur të shtonte numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta për grup-moshat e fëmijëve 5-6 vjeç që vijnë në aktivitetin e tyre, pasi kjo do të tejkalonte numrin e përcaktuar dhe do të ishte në kundërshtim me rregullativën ligjore.

Pas shqyrtimit të përgjigjeve të komunave dhe analizës ligjore, IAP-ja ka konstatuar se Udhëzimi Administrativ Nr. 19/ 2016 nuk përcakton punësimin e të dy prindërve si kriter për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore. Andaj kërkesa për kontratën e punësimit të prindërve e vendosur nga disa komuna gjatë publikimit të konkurseve si dhe vërejtja e tyre se aplikimet pa këto dokumente nuk do të shqyrtohen, është në kundërshtim me Udhëzimin Administrativ Nr. 19/ 2016. Ky kriter nuk është në pajtim me parimin e ligjshmërisë dhe sigurisë juridike. IAP-ja ka vërejtur se ky prioritet i vendosur nga komunat ka ardhur nga mungesa e kapaciteteve dhe burimeve për të akomoduar numrin e madh të aplikimeve me gjithë vullnetin e tyre për të përfshirë të gjithë fëmijët pa dallim.

Avokati i Popullit gjithashtu ka konstatuar se për shkak të paqartësive ligjore, kërkesa për punësim të prindërve mund të konsiderohet si bazë për diskriminim në bazë të LMD-së dhe LMF-së përmes kategorisë “*apo çdo gjendje tjetër të fëmijës ose prindërve të tij*” dhe se nuk është në pajtim me parimin e interesit më të mirë të fëmijës. Për fund, pas shqyrtimit të përgjigjeve të kopshtit “Botanika” dhe analizës ligjore, Udhëzimi i tanishëm nuk ofron siguri juridike, alternativa të qarta dhe të përbalueshme për fëmijët me dëmtime të rënda në mënyrë që ata të gëzojnë të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët e tjerë, më specifiku të drejtën e fëmijëve për arsim, për mosdiskriminim dhe për interesin më të mirë të tyre. Andaj IAP-ja ka rekomanduar që Udhëzimi të qartësohet dhe të ndryshohet për të qenë në përputhje me parimet bazë dhe autorizimet që dalin nga LEP-i, përkatësisht me parimet e përcaktuara në nenin 4: “*a) Barazia; b) Gjithë përfshirja; c) Demokracia; d) Autonomia e personelit; e) Profesionalizmi dhe përgjegjësia; f) Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve; g) E drejta për të qenë ndryshe; h) Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve*” dhe LMF-ja. IAP-ja është njoftuar nga MASHTI se këto ndryshime legjislative janë pranuar nga Ministria dhe se do të përfshihen në planin legjislativ për vitin e ardhshëm.

**Me qëllim të parandalimit të martesave të hershme** në 2020, IAP-ja publikoi Raportin me rekomandime ex officio me qëllim të ndryshimit dhe plotësimit të nenit 16, paragrafët 2 dhe 3, të Ligjit për Familjen<sup>83</sup>. Neni 16 i Ligjit për Familjen përcakton se martesat e një të mituri mbi 16 vjeç mund të lejohet nga gjykata kompetente nëse konstatohet se i mituri ka arritur pjekurinë e nevojshme fizike dhe psikike për t’i realizuar të drejtat dhe detyrimet martesore. Në raport IAP-ja ka vërejtur se studime të shumta dëshmojnë se martesat e hershme kanë ndikim negativ në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve. Martesa e hershme ndikon në fuqinë vendimmarrëse të vajzave brenda në familje dhe i bënë ato më të ndjeshme ndaj dhunës dhe keqpërdorimeve seksuale. Në Kosovë ky fenomen ndikon në mënyrë joproporcionale tek vajzat dhe te komunitetet rom, egjiptian dhe ashkali, meqë më shumë fëmijë nga këto komunitete martohen më herët dhe më shumë vajza martohen sesa djem. Pas publikimit të raportit, IAP-ja kishte marrë pjesë në takimet konsultative të draftimit të Kodit Civil, ku kishte avokuar për ndryshimet përkatëse. Drafti i Kodit Civil është miratuar në mbledhjen e qeverisë më 30 dhjetor 2021. Ky draft ka përfshirë rekomandimin e IAP-së dhe mosha për lidhjen e martesës është 18 vjeç<sup>84</sup>.

83 Institucioni i Avokatit të Popullit, Raport me rekomandime ex officio, Rasti nr.206/2019 në lidhje me parandalimin e martesave të hershme, 2020, në: <https://www.oik-rks.org/2020/08/13/raport-me-rekomandime-ex-officio-rasti-nr-2062019-ne-lidhje-me-parandalimin-e-martesave-te-femijeve/> [ e qasur së fundmi me datën 03.01.2021].

84 Republika e Kosovës, Qeveria, Projektkodi Civil i Republikës së Kosovës, neni 1140, në: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2021/12/Projekt-Kodi-Civil-i-Republikes-se-Kosoves.pdf?fbclid=IwAR14nnFk9wUj9i6360PCq-jPbrMag9Y5yGz9nn9w6tObydiL9-54PtrVHv0> [ e qasur së fundmi në datën 03.01.2021].

## Ankesat e parashtruara lidhur me të drejtat e fëmijëve

Avokati i Popullit gjatë vitit për të cilin po raportohet ka pranuar 58 ankesa, një numër i të cilave është parashtruar kryesisht nga prindër të fëmijëve. Nga ky numër, 18 janë shpallur të papranueshme, ngase çështjet me të cilat kanë pasur të bënin ato kanë qenë jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit, nuk ka shkelje të drejtave të njeriut, apo ankuesit kanë pasur mundësi t'i shfrytëzonin ose kanë qenë në shfrytëzim të mjeteve juridike. Nga 40 ankesat e vendosura për hetim, dhjetë prej tyre janë hapur sipas detyrës zyrtare, ndërsa shtatë raste janë hapur ex-officio lidhur me shkeljet sistematike të të drejtave të fëmijëve.

Gjatë këtij viti, IAP-ja i ka adresuar 27 rekomandime autoriteteve përkatëse publike dhe ka dërguar 43 letra rikujtuese këtyre autoriteteve lidhur me moszbatimin e rekomandimeve.

## E drejta e fëmijëve për arsim

Vendimet e marra nga institucionet për parandalimin dhe luftimin e pandemisë kanë ndikuar edhe në realizimin e së drejtës për arsim. Gjatë vitit 2021 ka vazhduar mësimi në distancë në kombinim me praninë fizike në shkollë. Mësimi në distancë është realizuar përmes katër platformave: platforma E-Mësimi (platforma kryesore online e transmetuar nga kanali publik RTK); platforma e edukimit në fëmijërinë e hershme (kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 – 6 vjeç); platforma e mësimin në distancë për fëmijët me aftësi të kufizuara (arsimi gjithëpërfshirës) dhe platforma e mësimin E-shkollori (platformë e mësimin për fëmijë për klasat 1-9). Duhet theksuar se një anë pozitive e këtyre platformave ka qenë se mësimi në tri platformat e para është ofruar në katër gjuhë: shqip, serbisht, turqisht dhe boshnjakisht. Gjithsesi, ky proces është përcjellë edhe me sfida ku si sfida është identifikuar qasja jo e barabartë në internet dhe në pajisje teknologjike, mungesa e hapësirave të përshtatshme për mësim në shtëpitë e nxënësve si dhe mungesa e njohurive të mësimdhënësve lidhur me përdorimin e aplikacioneve teknologjike. Kjo situatë ka qenë më e rëndë veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara si dhe fëmijët nga komunitetet egjiptian, ashkali dhe rom<sup>85</sup>.

IAP-ja ka theksuar se çfarëdo kufizime ndaj së drejtës për arsimim nuk do të duhej ta cenonin të drejtën për arsimim në thelbin e saj apo ta zhveshnin atë nga efektiviteti. Në pajtim me vendimet e KEDNj-së, këto kufizime duhet të jenë të parashikuara me ligj dhe të ndjekin një qëllim të drejtë. Pra, e drejta për arsim nuk është e drejtë absolute dhe se mund të kufizohet, mirëpo, të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm deri në atë masë sa është e domosdoshme në një shoqëri të hapur dhe demokratike dhe derisa të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi. Pas analizës së legjislacionit, vendimeve të ndërmarra dhe situatës në përgjithësi, IAP-ja ka konstatuar se mbrojtja e shëndetit të nxënësve, studentëve dhe stafit punonjës të institucioneve arsimore, si dhe qytetarëve në përgjithësi, nga përhapja e sëmundjeve ngjithëse, është qëllim legjitim në synimin e të cilit e drejta për arsim mund të kufizohet për mbrojtjen e shëndetit<sup>86</sup>.

Rastet lidhur me të drejtën për arsim, të cilat janë hetuar nga Avokati i Popullit, duke përfshirë edhe rastet e iniciuara sipas detyrës zyrtare, kanë trajtuar: pamundësinë për regjistrim në shkollë për shkak të kërkesës së dokumenteve të ndryshme tatimore<sup>87</sup>, gjuhën e urrejtjes në libra shkollorë<sup>88</sup>, kërkesa për vaksinim për qasje në hapësira<sup>89</sup>, mungesën e transportit<sup>90</sup>, dhunën në shkollë<sup>91</sup>, mosvijimi i shkollës si pasojë e frikës nga gjakmarrja<sup>92</sup> dhe trajtim jo të barabartë<sup>93</sup>. Nga 11 raste të paraqitura që kanë të bëjnë me të drejtat e fëmijëve në arsim, pesë janë hapur sipas detyrës zyrtare, një është hedhur poshtë si e papranueshme, katër prej tyre janë mbyllur pozitivisht, ndërsa gjashtë janë nën hetime.

91 Rasti 600/2021.

92 Rasti 641/2021.

93 Rasti 640/2021.

Në një nga rastet e nisura ex-officio, IAP-ja ka hetuar shkrimin e portalit *“Koha.net”* me titullin: *“Komuna e Prishtinës i lë pa mësim nxënësit e fshatit Prapashticë”*. Pas skadimit të kontratës së komunës me organizuesin e transportit, 12 nxënës të shkollës “Dëshmorët 1921” nuk kishin mundur të vijonin mësimin. Sipas Ligjit për Arsimin Parauniversitar, komunat duhet të organizojnë transportin pa pagesë për fëmijët që jetojnë mbi katër kilometra larg shkollës. Në këtë rast, nxënësit kishin larg shkollën gjashtë kilometra. Sipas drejtorit të shkollës, ka disa vjet që ka vonesa për këtë tender dhe më së shumti pasojat po i bartin nxënësit. Pas presionit të tyre në MASHT, transporti ishte rregulluar.

Më 26 janar 2021, IAP-ja i ka dërguar letër rekomandimi Gjimnazit “Kuvendi i Lezhës” në komunën e Vitisë lidhur me kthimin e përgjigjes së ankuesit për vlerësimin e fëmijës së tij nga Gjimnazi. Në korrik dhe në gusht të vitit 2019, ankuesi kishte parashtruar ankesë në Sektorin e Inspektoratit të Arsimit në Gjilan dhe në Inspektoratin e Arsimit në Prishtinë, mirëpo nuk kishte marrë përgjigje. IAP-ja i ka rekomanduar gjimnazit që t’i dërgonte ankuesit me shkrim përgjigjen e duhur lidhur me rishqyrtimin e rekomandimit të Sektorit të Inspektoratit të Arsimit.

Më 23 gusht 2021, IAP-ja i ka dërguar letër rekomandimi Komunës së Fushë Kosovës për të siguruar transportin për fëmijët me aftësi të kufizuara në mënyrë që ta ndiqnin mësimin në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim “Xheladin Deda” në Pejë. Prindërit e fëmijëve ishin ankuar në IAP se komuna nuk kishte siguruar transportin në pajtim me obligimet ligjore. IAP-ja i ka kërkuar komunës që t’i ndërmerre masat e menjëhershme që fëmijët të ndiqnin mësimin si dhe është duke monitoruar zbatimin e këtij rekomandimi.

Më 13 korrik 2021, IAP-ja i kishte dërguar letër rekomandimi Komunës së Vushtrrisë lidhur me mosvijimin e mësimin të të dy fëmijëve. IAP-ja kishte hetuar rastin dhe ndonëse kishte kërkuar nga Qendra për Punë Sociale (QPS) ta informonte me shkrim për veprimet që janë ndërmarrë apo që do t’i ndërmarrnin sipas kompetencave ligjore që kanë për trajtim e rastit, kjo nuk kishte ndodhur. IAP-ja i ka rekomanduar Komunës së Vushtrrisë që t’i ndërmerre veprimet e nevojshme përkatëse ndaj QPS-së në Vushtri që kjo e fundit, në kuadër të kompetencave ligjore, ta trajtonte rastin si dhe në koordinim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) të bënte më të mirën e mundshme që fëmijët ta vijonin mësimin në shkollat përkatëse.

### **Fëmijët me aftësi të kufizuara**

Fëmijët me aftësi të kufizuara janë ende duke përjetuar vështirësi serioze dhe përballen me pengesa për gëzimin e plotë të të drejtave të përcaktuara me ligj. Fëmijët me aftësi të kufizuara i përkasin një prej grupeve më të rrezikuara të fëmijëve. Situata e tyre është përkeqësuar edhe më tepër nga pandemia. Në Raportin e veçantë lidhur me emergjencën shëndetësore, IAP-ja ka konstatuar se lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuar në nivel vendi nuk ka pasur një strategji gjithëpërfshirëse mbështetëse për ta dhe në shumë raste mbështetja dhe ndihma ka qenë e përkohshme, e keqorganizuar dhe nuk ka mbuluar të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë.<sup>94</sup>

Ndërprerja dhe pezullimi i disa shërbimeve shëndetësore ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të fëmijëve duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar. Pra, ndërprerja dhe pezullimi i terapive fizio-rehabilituese, terapive këshilluese psiko-sociale, qasja e kufizuar në barnat esenciale dhe programet e mbështetjes ditore i kanë privuar fëmijët me aftësi të kufizuar nga shërbimet bazike terapeutike rehabilituese. Në raste të caktuara kjo ka mundur ta rrezikonte edhe vetë jetën dhe zhvillimin e fëmijëve. Për më tepër, barra e sigurimit të këtyre shërbimeve ka rënë mbi prindërit ose mbi kujdestarët e tyre. Kjo barrë përveç aspektit financiar, është vështirësuar në masë të madhe edhe në gjetjen e alternativave në mënyrë që fëmijëve të mos u ndërpriteshin shërbimet e planifikuara.

94 Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, fq. 146.



Përfaqësuesit e organizatave të personave me aftësi të kufizuara gjithashtu kanë theksuar se pandemia ka ndikuar drejtpërsëdrejti tek personat me aftësi të kufizuara e në veçanti te familjet e tyre. Një pjesë e konsiderueshme e prindërve, si pasojë e pandemisë kanë mbetur pa punë dhe kjo ka ndikuar në mundësitë e këtyre fëmijëve për t'u qasur në shërbime.<sup>95</sup>

IAP-ja i ka rekomanduar Qeverisë që të hartojë dhe të zbatojë një plan gjithëpërfshirës të përkrahjes së fëmijëve në përgjithësi, e të atyre me aftësi të kufizuara në veçanti, për shërbimet shëndetësore të garantuara me ligj, duke u fokusuar edhe në programet e rehabilitimit, të terapive psiko-sociale, të imunizimit, të ushqyeshmërisë cilësore, të ndihmës ndaj prindërve si dhe MASH-it që të rrisë numrin e asistentëve për fëmijët me aftësi të kufizuara, gjithnjë duke u bazuar në kërkesat e komunave.<sup>96</sup>

Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit ka pranuar pesë raste lidhur me fëmijët me aftësi të kufizuara, një të hapur ex-officio. IAP-ja ka nisur hetimet ex-officio lidhur me detyrimet ligjore të komunave për themelimin dhe funksionalizimin e ekipit profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e posaçme arsimore për fëmijët me aftësi të kufizuara.<sup>97</sup> Ligji për Arsimin Parauniversitar obligon komunat që vetë apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojnë ekip profesional vlerësues dhe përkrahës. Ky ekip duhet të jetë i veçantë për nevojat e posaçme arsimore të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të përbëhet nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit.<sup>98</sup> Sipas informatave të IAP-së, disa komuna nuk i kanë themeluar ende këto ekipe.

Ndërsa një rast tjetër kishte të bënte me trajtim joadekuat të fëmijës nga stafi i Qendrës Burimore përkatëse. Pas ndërmarrjes së veprimeve ligjore, IAP-ja është njoftuar nga MASHTI se rasti është trajtuar ku edhe është punësuar staf shtesë për të rritur cilësinë e shërbimeve.<sup>99</sup> Rastet e tjera kishin të bënin me këshillim ligjor lidhur me përshtatjen e orarit të punës për përkujdesje ndaj fëmijës me aftësi të kufizuara, lirimi nga pagesa për fëmijën me aftësi të kufizuara dhe sigurimi i transportit si dhe regjistrimi i fëmijës në klasë pa pëlqimin e prindërve.<sup>100</sup>

Më 18 mars 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar Qendrën e Kujdesit Ditor "Pema" në Prishtinë, ku u njoftuan për së afërmi me punën e kësaj qendre, veçmas gjatë kohës së pandemisë. Kjo qendër ofron shërbime psiko-sociale dhe rehabilituese për fëmijë me aftësi të kufizuara; këshillime psikologjike për prindërit/kujdestarët e fëmijëve në nevojë; ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të punëtorëve të Qendrave të Kujdesit Ditor, përmes trajnimeve dhe mbikëqyrjes klinike; vetëdijësimin dhe fuqizimin e prindërve për të avokuar për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara; monitorimin e zbatimit të ligjeve dhe të politikave që trajtojnë të drejtat e fëmijëve; organizimin e seminareve dhe të konferencave që adresojnë nevojat dhe të drejtat e fëmijëve nga kategoritë më të cënueshme. Në këtë qendër marrin shërbime afro 254 fëmijë me aftësi të kufizuara, të organizuara nëpërmjet zyrës qendrore në Prishtinë dhe katër qendrave të tjera (Pejë, Prizren, Ferizaj dhe Gjiilan). Përfaqësuesit e Qendrës njoftuan IAP-në se pandemia kishte ndikuar jashtëzakonisht shumë në punën e kësaj qendre për ofrimin e shërbimeve të planifikuara. Përveç vështirësive gjatë mbylljes, një ndër sfidat kryesore të saj mbetet qëndrueshmëria financiare. Meqë shumica e mbështetjeve për organizata me bazë në komunitet është 6-mujore, 8-mujore

95 Po aty, fq. 136.

96 Po aty, fq. 162-163.

97 Rasti 411/2021.

98 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, 2011, neni 41, në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2770> [ e qasur së fundmi në datën 03.01.2021].

99 Rasti 545/2021.

100 Rasti 574/2021, Rasti 272/2021 dhe Rasti 438/2021.

deri në 1 vit, apo kontrata 1-vjeçare, kjo situatë nuk garanton qëndrueshmëri tek ofruesit e shërbimeve sociale dhe familjare për grupet e cenueshme të popullatës.

IAP-ja gjithashtu ka kontaktuar Shoqatën “Down Syndrom Kosova”, e cila ofron shërbime terapeutike për fëmijët me sindromë Down, përfshirë shërbimin e psikologut, logopedit, ergoterapisë dhe fizioterapisë. Shoqata ka njoftuar IAP-në se sfidat kryesore me të cilat ata përballen janë të natyrës financiare dhe mungesës së mbështetjes së qëndrueshme institucionale për shërbimet të cilat ata i ofrojnë. Vështirësitë e identifikuar nga terreni për fëmijët kanë qenë shpenzimet financiare për terapinë që është dashur ta blinin fëmijët dhe të rriturit me sindromën Down (rastet të cilat kanë qenë të prekura nga COVID-19). Përfaqësuesit kanë ngritur shqetësimin lidhur me vaksinimin e personave mbi moshën 16-vjeç me sindromën Down, të cilët nga ekspertë ndërkombëtarë janë përcaktuar si grup me rrezik të lartë të komplikimeve, në rast infektimi me COVID-19. Kjo pasi ata kanë imunitet shumë më të dobët sesa pjesa tjetër e popullatës dhe se në shumicën e rasteve sindroma shoqërohet me sëmundje kardiovaskulare, respiratore, sëmundje endokrine, obezitet etj. Sipas shoqatës, shumica e shteteve evropiane kanë përcaktuar në grupin e parë për vaksinim personat me sindromë Down.<sup>101</sup> Ngjashëm, IAP-ja ka kontaktuar edhe Handikosin, dhe Shoqatën “Autizmi”.

Më 1 qershor 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar Qendrën Burimore për mësim dhe këshillim “Xheladin Deda” në Pejë. Kjo qendër ofron arsim të veçantë për nxënësit e verbër; rehabilitim dhe akomodim në konvikt të QBMK-së; integrim dhe mbështetje në shkollat e rregullta; mbështetje dhe këshillim në familje dhe në institucione parashkollore; trajnime për mësimdhënës, prindër dhe personelin që punon me fëmijë të verbër. Ndërsa ndër sfidat me të cilat ballafaqohet kjo qendër janë përmendur: identifikimi i plotë i fëmijëve të kategorizuar nga Komisioni mediko-social i grup-moshës 0-18 vjeç, trajtimi i fëmijëve të verbër dhe me dëmtime të shumëfishta (përfshirja e tyre në sistem arsimor, ngritja e kapaciteteve profesionale e stafit në QBMK-së, përmirësimi i infrastrukturës së akomodimit të tyre në konviktin e Qendrës Burimore), sinteza vokale që siguron qasje në arsimim për të gjithë personat e verbër përmes teknologjisë informative, organizimi i shërbimeve në terren për mbështetje në integrim për nxënësit të arsimit parauniversitar (materiale në brail, orientim dhe mobilitet, trajnime për stafin në shkolla të rregullta, pajisje tiflo-didaktike, ngritje e vetëdijes për prindër etj.) Moskoordinimi ndërsektorial mes ministrive përkatëse për sigurimin e mjeteve tiflo-teknike dhe tiflo- pedagogjike gjithashtu u përmend si sfidë.

Më 1 qershor 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar edhe Qendrën Burimore “Nëna Terezë” dhe Qendrën Burimore “Lef Nosi” në Prizren, Qendrën Burimore “Nëna Terezë” në Mitrovicë, ku janë njohur për së afërmi me punën e tyre, veçmas gjatë kohës së pandemisë.

## **Të drejtat e fëmijëve në procedurat e organeve gjyqësore**

Gjatë këtij viti, IAP-ja ka pranuar njëmbëdhjetë ankesa kundër gjykatave dhe prokurorive. Ankesat kryesisht kishin të bënin me besimin e kujdestarisë së fëmijës së mitur<sup>102</sup>, zvarritjen e procedurave gjyqësore për kompensim dëmi<sup>103</sup>, shtyrja e ekzekutimit të dënimit<sup>104</sup>, mos(realizimi) i kontaktit me fëmijët<sup>105</sup> dhe të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm<sup>106</sup>. Gjithashtu, me kërkesë të palëve, IAP-ja ka monitoruar seancat gjyqësore lidhur me besimin e fëmijëve.

<sup>101</sup> Shoqata “Down Syndrome Kosova”, Përgjigjet në pyetjet e IAP-së, 21 prill 2021.

<sup>102</sup> Rasti 274/2021.

<sup>103</sup> Rasti 585/2021 dhe rasti 230/2021.

<sup>104</sup> Rasti 540/2021.

<sup>105</sup> Rasti 339/2021, rasti 624/2021 dhe rasti 213/2021.

<sup>106</sup> Rasti 314/2021, rasti 725/2021, rasti 405/2021 dhe rasti 227/2021.

## Mbrojtja sociale dhe shëndetësore e fëmijëve

Pandemia padyshim ka ndikuar edhe në mbrojtjen sociale dhe shëndetësore të fëmijëve, e ndonëse nuk dihet saktë niveli i ndikimit të tërthortë, e që sipas shumë ekspertëve të fushës, do të jetë me shumë pasoja dhe i pranishëm për një kohë të gjatë në jetën e fëmijëve.<sup>107</sup> Në veçanti, gjendja ekonomike e familjeve raportohet të jetë rënduar edhe më tej me rrezikun e rritjes së shkallës së varfërisë.

Një aspekt mjaft shqetësues që ka pasur ndikim në jetën dhe në shëndetin e fëmijëve, e sidomos të atyre me aftësi të kufizuara, ka qenë edhe mungesa për periudha të caktuara e barnave esenciale. Për shumë prind ka qenë sfidë me rrezikshmëri të lartë edhe sigurimi i këtyre barnave nëpërmjet mënyrave joligjore. Po ashtu, vendimet e Ministrisë së Shëndetësisë për pezullimin për një periudhë të caktuar të programit të vaksinimit, ka ndikuar në shtyrjen dhe në vonesat për imunizimin e fëmijëve të porsalindur. Ky proces më pastaj është shoqëruar dhe ka ndikuar edhe në çrregullimin e programit të vaksinimit të rregullt.<sup>108</sup>

Shërbimet sociale, edhe pse shumë të nevojshme në kohë pandemie, kanë qenë të kufizuara dhe janë shoqëruar me vështirësi të shumta. Situatën e ka përkeqësuar edhe shpallja me vonesë e granteve të rregullta me të cilat përkrahen ofruesit e shërbimeve sociale. Vonesa janë identifikuar edhe në aspektin e ndarjes së mjeteve tek ofruesit e shërbimeve, e të gjitha këto kanë ndikuar që një pjesë e përfituesve (një numër mjaft i madh janë fëmijë, duke përfshirë edhe ata me aftësi të kufizuara) të këtyre shërbimeve të mbesnin pa shërbime.

Gjithashtu, IAP-ja ka vërejtur se mungesa e informimit adekuat rreth virusit, si dhe informatat e udhëhequra nga teori konspirative kanë ndikuar në masë të madhe edhe në hezitimin e prindërve për të kërkuar ndihmë dhe shërbime shëndetësore për fëmijët e tyre.

Pandemia ka ndikuar që Ligji për Shërbime Sociale dhe Ligji për Financat e Pushtetit Lokal të mos arrihej të miratohej në Kuvend edhe pse ishte draftuar. Miratimi i këtyre ligjeve e veçanërisht i Ligjit për Shërbime Sociale dhe Familjare, përmes të cilit do të rregullohej në tërësi mandati, roli, kompetencat, përgjegjësitë dhe struktura e qendrave për punë sociale, ka qenë një ndër rekomandimet e IAP-së në dy vitet e fundit në Raportin me rekomandime Ex officio nr. 59/2019 – Lidhur me vlerësimin e sistemit të ofrimit të shërbimeve sociale në Kosovë.<sup>109</sup>

Sa i përket mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, në IAP janë paraqitur 6 raste ku tri janë hedhur poshtë si të papranueshme ndërsa tri të tjera janë duke u hetuar. Këto raste kanë të bëjnë me: ndikimin e emergjencës shëndetësore të pandemisë në mbrojtjen sociale dhe shëndetësore<sup>110</sup>, shkelje e të drejtave sociale dhe ekonomike nga prindi<sup>111</sup>, dhe mospërgjigje në ankesë për ndihmë sociale.<sup>112</sup>

Me qëllim të monitorimit dhe vlerësimit të të drejtave të fëmijëve dhe vështirësive me të cilat përballen ata në qasjen në shërbime gjatë pandemisë, IAP-ja ka vizituar disa qendra dhe ka kontaktuar organizatat të cilat veprojnë në këtë fushë. Më 12 mars 2021, përfaqësuesit e IAP-së kanë vizituar Qendrën Ditore të Fëmijëve në Prishtinë, ku u njoftuan më për së afërmi me shërbimet e ofruara për fëmijët në rrezik, veçmas për fëmijët në situatë rruge. Përfaqësuesit e IAP-së u njoftuan lidhur me procesin arsimor të këtyre fëmijëve, ofrimin e shërbimeve psikologjike, shëndetësore etj. Po ashtu u njoftuan se në aspektin shëndetësor

107 Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, fq. 146.

108 Po aty.

109 IAP, Raporti vjetor 2020, fq. 59, në: <https://oik-rks.org/2021/04/14/raporti-vjetor-2020/> [e qasur së fundmi në datën 03.01.2021].

110 Rasti 183/2021.

111 Rasti 586/2021.

112 Rasti 364/2021.

kanë një bashkëpunim shumë të mirë me Qendrën e Mjekësisë Familjare (QMF), ku i referojnë rastet sa i përket pjesës shëndetësore. Duke qenë se fëmijët në situatë rruge përbëjnë një grup të rrezikuar të fëmijëve, IAP-ja në vitin e kaluar u ka kërkuar institucioneve që me rastin e miratimit të pakove mbështetëse, të përfshinin masa specifike për t'i mbështetur fëmijët në situatë rruge, fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët në gjendje të rëndë ekonomike.<sup>113</sup> Mirëpo ky rekomandim është adresuar vetëm në mënyrë të përgjithshme.

Ndërsa organizata SOS ka njoftuar IAP-në se pandemia ka ndikuar në sjelljet dhe mendimet e fëmijëve, ku vazhdimisht është nevojitur përkrahja e stafit psiko-pedagogjik që të ruhet balansi psikologjik. Qysh nga viti i kaluar, SOS-i ka hartuar protokoll të brendshëm reagimi ku çdo muaj familjet e SOS-it janë furnizuar me vitamina adekuate, maska, dezinfektues dhe preparate të tjera preventive për t'u mbrojtur nga virusi. Më tutje, organizata Terre des Hommes (TDH) ka informuar IAP-në se sfidat e shpeshta me të cilët janë përballuar fëmijët kanë qenë për shkak të qasjes diskriminuese dhe përjashtuese që kanë personat ndaj fëmijëve të qendrës ditore (pra edhe në marrjen e shërbimeve shëndetësore). Organizata ka theksuar se këta persona kanë ndryshuar qasje ndaj këtyre fëmijëve kur janë shoqëruar nga stafi i qendrës.

Një lajm i mirë për të ndihmuar gjendjen socio-ekonomike të fëmijëve gjatë vitit 2021 ka qenë nxjerrja e vendimeve: Vendim mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të masës 3.5- PAGESA për lehonat dhe shtesat për fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike dhe Vendim mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të masës 3.5- Shtesat për Fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.<sup>114</sup>

Me vendimin e parë janë subvencionuar lehonat e papunësuar për dymbëdhjetë muajt e fundit para ditës së lindjes së foshnjës me njëqind e shtatëdhjetë euro në muaj për gjashtë muaj. Ndërsa për të gjitha lehonat e tjera mbështetja është për njëqind e shtatëdhjetë euro në muaj për tre muaj. Sidoqoftë, pika 9 e këtij vendimi përcakton se nga subvencionimi i kësaj mase mund të përfitojnë vetëm lehonat të cilat janë mbi moshën tetëmbëdhjetë vjeç dhe shtetase të Republikës së Kosovës.

Me vendimin e dytë qeveria ka caktuar mbështetje prej 10 euro në muaj për fëmijët nën moshën 16 vjeç si dhe 20 euro në muaj për fëmijët e moshës 0-24 muajsh. Sidoqoftë, ky vendim i përjashton fëmijët e moshës 16-18 vjeç dhe i priorizon fëmijët më të vegjël në moshë, ndërsa fëmijët e lindur pas vitit 2012 mund të përfitojnë nga shtesa vetëm nga viti 2023. Kjo mund të shihet si një ndihmë e vogël, mirëpo IAP-ja ngre shqetësimin se sa do të mundë në realitet të përfitojnë nga kjo masë edhe fëmijët e tjerë nga grupet e cënueshme, siç janë fëmijët në situatë rruge. Së pari, duke marrë parasysh kufizimet në moshë, është vështirë për t'u vlerësuar se sa mund të përfitojë ky grup i fëmijëve nga shtesa. Së dyti, forma e aplikimit përmes dorëzimit të dokumenteve të ndryshme, si: çertifikatë e lindjes, dëshmia e kujdestarit ligjor, xhirollogari bankare dhe kopja e letërnjoftimit, mund të jenë një sfidë për këtë grup duke marrë parasysh nivelin e marginalizimit dhe problemeve me të cilat përballen këta fëmijë dhe këto familje.

<sup>113</sup> Raporti vjetor 2020, fq.55.

<sup>114</sup> Qeveria e Kosovës, Vendim mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të masës 3.5- Shtesat për Fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/173A6369-973C-4189-B158-5E4F9BC13650.pdf> dhe Vendim mbi caktimin e kushteve dhe kriterëve për zbatimin e pjesëshëm të masës 3.5- PAGESA për lehonat dhe shtesat për fëmijë të Pakos së Ringjalljes Ekonomike në: <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/4F250604-F09F-481F-B678-EB53F7BE9BEF.pdf> [ e qasur së fundmi në datën 03.01.2021].

## Shëndeti mendor i fëmijëve gjatë pandemisë

Që nga fillimi i pandemisë, IAP-ja kishte tërhequr vërejtjen e institucioneve për ndikimin e pandemisë në shëndetin mendor dhe kishte theksuar rëndësinë e programeve të shëndetit mendor dhe qasjen e të gjithë fëmijëve në shërbime psiko-sociale.<sup>115</sup>

Vendimet për parandalimin dhe kontrollin e pandemisë për mbyllje, izolim në shtëpi, kalimi në sistemin e shkollimit online, mungesa e ndërveprimit me shoqërinë, qëndrimi për kohë të gjatë pranë ekraneve televizive, marrja e informatave të ndryshme rreth rrezikut të COVID-19, informatave të pa censuruara rreth vdekjes dhe shumë lajmeve të pavërteta rreth pandemisë, të gjitha këto raportohet të kenë ndikuar drejtpërdrejt ose tërthorazi në shëndetin mendor të fëmijëve. Në veçanti, është raportuar se gjendja emocionale apo shëndeti mendor i fëmijëve me aftësi të kufizuar gjatë pandemisë ka qenë shumë i rënduar dhe ka afektuar drejtpërsëdrejti në shëndetin e tyre.<sup>116</sup> Në nivel global ngjashëm është raportuar edhe nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) se shëndeti mendor i të rinjve 15-24 vjeç është përkeqësuar seriozisht gjatë dy vjetëve të pandemisë.<sup>117</sup>

Përderisa ndikimi i pandemisë në shëndetin mendor pritet të jetë afatgjatë dhe i gjerë, IAP-ja rithekson nevojën për hartimin e politikave adekuate për shëndetin mendor të fëmijëve dhe mbështetjen e programeve të cilat synojnë ta adresojnë këtë problem.

115 IAP, Deklarata e Avokatit të Popullit me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, 01.06.2020, në: <https://oik-rks.org/2020/06/01/deklarata-e-avokatit-te-popullit-me-rastin-e-dites-nderkombetare-te-femijeve/> dhe Raporti vjetor 2020, fq. 55.

116 Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, fq.139.

117 Po aty.

## IV. Barazia para ligjit

### Institucioni i Avokatit të Popullit si mekanizëm i mbrojtjes nga diskriminimi

Direktivat e Bashkimit Evropian<sup>118</sup> për mosdiskriminim kërkojnë themelimin e një organi barazie që do të kishte një minimum kompetencash të detyrueshme në fushën e luftës kundër diskriminimit. Këto direktiva parashikojnë detyrimin për të themeluar organe, përgjegjësitë e të cilave do të përfshijnë, ndër të tjera, ofrimin e ndihmës së pavarur për viktimat e diskriminimit, kryerjen e kërkimeve të pavarura dhe publikimin e raporteve dhe rekomandimeve të pavarura për diskriminimin.

Kosova e ka ndërtuar një kornizë ligjore për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit, duke respektuar standardet ndërkombëtare dhe duke u mbështetur në përvojën e së drejtës krahasuese.

Me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (LMD) është përcaktuar korniza e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në Republikën e Kosovës. Me të në të drejtën pozitive të Kosovës është futur një pjesë e acquis-it e Bashkësisë Evropiane.<sup>119</sup>

<sup>119</sup> Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 1, paragrafi 2.



Duke qenë se Kosova nuk ka një institucion të posaçëm të specializuar për mbrojtjen e barazisë, Ligji për Barazi Gjinore, si pjesë e pakos së ligjeve për të drejtat e njeriut, ia beson këtë rol IAP-së, si organ i barazisë dhe i mbrojtjes nga diskriminimi..

Në përgjithësi, kompetencat ligjore të Avokati i Popullit në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi janë të harmonizuara me direktivat e BE-së, me standardet ndërkombëtare dhe me praktikën krahasuese përkatëse dhe si të tilla, pjesërisht i tejkalojnë kompetencat tradicionale të këtij institucioni, sepse LMD-ja parashikon risi të rëndësishme dhe Avokatit të Popullit i cakton kompetenca më të gjëra në çështjet që lidhen me diskriminimin dhe kështu Avokati i Popullit e fiton rolin qendror në mbrojtjen nga diskriminimi.<sup>120</sup>

Që nga dita e hyrjes në fuqi e “pakos ligjore për të drejtat e njeriut”<sup>121</sup>, Avokati i Popullit bën përpjekje për të zbatuar mandatin ligjor në mënyrë të barabartë dhe punon në trajnimin e personelit të tij në ngritjen e kapaciteteve në fushën e mbrojtjes nga diskriminimi.

Gjithashtu, meqenëse direktivat për mbrojtje nga diskriminimi të Bashkimit Evropian kërkojnë ngritjen e një organi për mbrojtjen e barazisë, përkatësisht një mekanizëm të veçantë, Avokati i Popullit ka krijuar një departament të veçantë që merret me çështjet e mbrojtjes nga diskriminimi. Detyra kryesore e këtij departamenti është të sigurojë qasje të barabartë në ushtrimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve në tërë Republikën e Kosovës dhe të marrë masa për parandalimin e formave të ndryshme të diskriminimit ndaj qytetarëve në ushtrimin e të drejtave të garantuara me Kushtetutë.

## Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Nga zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka kaluar një periudhë gati shtatëvjeçare, por është e qartë se praktika institucionale e Kosovës kundër diskriminimit nuk është as përafërsisht e pasur siç është realiteti ynë shoqëror “i pasur” me shembuj të diskriminimit.

<sup>120</sup> Ligji për Avokatin e Popullit, neni 16, me të cilin janë të precizuara kompetencat e Avokatit të Popullit, shih Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, neni 9, me të cilin precizohen kompetencat e Avokatit të Popullit në mbrojtjen nga diskriminimi.

<sup>121</sup> “Pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut”, e cila është në fuqi nga korriku i vitit 2015, përfshin: Ligjin nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Ligjin nr. 05/L-020 për Barazi Gjinore dhe Ligjin nr. L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Zbatimi i Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është vështirësuar edhe në këtë vit, si në vitin e kaluar, për shkak të pandemisë globale të shkaktuar nga virusi COVID-19, që i thëllon më tutje vështirësitë lidhur me garantimin e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe krijon sfida të reja për institucionet në aspektin e përmbushjes së obligimeve ligjore. Disa masa të marra nga qeveria për ta frenuar pandeminë kanë goditur në një masë më të madhe anëtarët e grupeve veçanërisht të ndjeshme dhe kanë thëlluar më tej pabarazitë ekzistuese dhe kanë shkaktuar vështirësi të reja në jetën e tyre (personat me aftësi të kufizuara, të moshuarit, pjesëtarët e LGBTI-së, gratë, fëmijët, pjesëtarët e komunitetit rom).

Është e evidente se në mbrojtjen nga diskriminimi, Avokati i Popullit dhe gjykatat kompetente kanë rol të rëndësishëm jo vetëm duke ofruar mbrojtje efektive ligjore nga diskriminimi në procedurat përkatëse, por edhe duke u propozuar me kohë autoriteteve legjislative ndryshimin dhe plotësimin e zgjidhjeve të mundshme joadekuate ligjore.

Mirëpo rastet e diskriminimit në proceset gjyqësore nga viti në vit vazhdojnë të jenë të pakta. Dhe siç është theksuar në raportet e mëparshme vjetore, gjykatave të Kosovës ende u mungon një sistem për monitorimin e duhur të rasteve të diskriminimit. Mirëpo në këtë drejtim mungojnë edhe rastet e iniciuara mbi bazë të diskriminimit në gjykata.

Gjatë periudhës raportuese, Avokati i Popullit ka vazhduar ta monitorojë zbatimin e rekomandimeve të tij drejtuar institucioneve të sistemit për t'u mbrojtur nga diskriminimi. Në këtë kontekst, është e evidente gatishmëria dhe përkushtimi i Qeverisë për ta përmirësuar zbatimin e rekomandimeve të nxjerra.

Po ashtu, Avokati i Popullit me kapacitetet e tij të plota është i përkushtuar për zhvillimin e marrëdhënieve dhe forcimin e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, si ato rajonale dhe ndërkombëtare, të cilat punojnë në fushën e mbrojtjes dhe promovimit të mosdiskriminimit dhe që kontribuojnë në promovimin e barazisë.

Një nga qëllimet më të rëndësishme të Avokatit të Popullit është të kontribuojë në përparimin dhe përmirësimin e politikave, rregulloreve, procedurave dhe praktikave institucionale në respektimin e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe vendore të sistemit si dhe me shoqërinë civile.

## **Personat me aftësi të kufizuara**

Avokati i Popullit e vlerëson çështje me ndikim serioz në trajtim të pabarabartë, kufizim të lëvizjes së papenguar, privatësisë, së drejtës për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm, mospërfshirjen e interesave të të gjithë qytetarëve, në veçanti të nevojave të personave me aftësi të kufizuara, mos respektimin e rregullave të dala nga Udhëzim Administrativ nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.<sup>122</sup>

Për më tepër, lëvizja e papenguar dhe e drejta për mjedis të sigurt e të shëndetshëm të personave me aftësi të kufizuar është duke u kufizuar vazhdimisht nga mospërmirësimi i infrastrukturës për qasje në objekte të banimit kolektiv, sidomos në objekte të institucioneve publike, ashtu sikurse është paraparë me Udhëzimin Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.<sup>123</sup>

<sup>122</sup> Udhëzim Administrativ MMPH nr. 01/2018 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme.

<sup>123</sup> Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.



Avokati i Popullit ka konstatuar se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuara, të përcaktuar sipas nenit 1 të Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe është në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare, përfshirë vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane. Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Komuna e Prishtinës, me një angazhim dhe me një buxhet të përballueshëm, mund t'i rregullojë pjerrinat dhe të krijojë kushte të përshtatshme në Prishtinë për qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuara, të cilat obligime dalin nga LMD-ja, nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe nga Udhëzimi Administrativ nr.33/2017 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Në Kosovë ende nuk dihet numri i saktë i personave me aftësi të kufizuara, por si tregues përgjithësisht merret numri i personave që përfitojnë nga skemat pensionale, i cili nuk pasqyron numrin e saktë. Sipas këtyre vlerësimeve, në Kosovë jetojnë afërsisht 144.000-270.000 persona me aftësi të kufizuara. Sipas regjistrimit të vitit 2011, në Kosovë janë identifikuar rreth 77.730 persona me aftësi të kufizuara. Megjithatë, vetëm 26.247 persona kanë status të njohur të personave me aftësi të kufizuara dhe janë të mbuluar nga skema të ndryshme sociale.<sup>124</sup>

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, përafërsisht 15% e popullsisë së botës janë njerëz me aftësi të kufizuara. Vlerësohet se 10-12% e popullsisë së përgjithshme të Kosovës janë persona me aftësi të kufizuara.<sup>125</sup>

Pavarësisht kornizës ligjore ekzistuese, e cila në mënyrë të qartë ndalon diskriminimin<sup>126</sup>, si dhe ligjeve të veçanta që rregullojnë statusin e personave me aftësi të kufizuara<sup>127</sup>, këta persona mbeten një nga kategoritë më të cenueshme të popullatës në Kosovë.

Procesi legjislativ, që ministria përkatëse e ka nisur në drejtim të hartimit të një dokumenti ligjor gjithëpërfshirës që do t'i mbulonte të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara dhe do t'i harmonizonte me instrumentet ndërkombëtare në këtë fushë, nuk ka përfunduar ende.

Në përgjithësi, pandemia COVID-19 vazhdon të ndikojë në çdo aspekt të jetës sociale dhe ekonomike të të gjithë qytetarëve të Kosovës, përfshirë personat me aftësi të kufizuara. Që nga fillimi i pandemisë, Avokati i Popullit ka monitoruar ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës, me fokus në plotësimin e nevojave të tyre thelbësore gjatë kësaj periudhe.

124 Mbledhja e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit me drejtorin e OJQ-së "Hendikos", e mbajtur më 8 korrik 2021, me qëllim të mbledhjes së informatave për situatën e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, me theks të veçantë në situatën e personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19 dhe nevojat dhe sfidat me të cilat këta persona ballafaqohen, në përgjithësi dhe gjatë kohës së pandemisë.

125 Po aty.

126 Shih nenin 24 të Kushtetutës dhe nenin 1 të Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, në mënyrë të qartë ndalon diskriminimin e kryer nga punëdhënësit dhe thekson nevojat dhe trajtimin e barabartë të personave me aftësi të kufizuara në punësim, trajnim dhe rikualifikim dhe garanton mbrojtjen e tyre ligjore.

127 Ligji nr.2003/23 për Personat me Aftësi të Kufizuara; Ligji nr. 03/L-022 për Përkrahje Material Familjeve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme; Ligji nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 05/L-078 për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara; Ligji nr. 04/L-092 për Personat e Verbër; Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë.

Në kuadër të kujdesit shëndetësor janë marrë të gjitha masat për mbrojtjen e banorëve. Këto masa përfshijnë kufizime dhe respektim të rekomandimeve të Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Organizatës Botërore të Shëndetësisë.<sup>128</sup>

Megjithatë, qeveria ka bërë pak për t'u ofruar personave me aftësi të kufizuara udhëzimet dhe mbështetjen e posaçme që u nevojitet për ta mbrojtur veten gjatë COVID-19, sepse shumë prej tyre i përkasin grupeve veçanërisht të rrezikuara.

Masat parandaluese të Qeverisë, të nisura në vitin e kaluar (11 mars 2020), megjithëse të nevojshme për parandalimin e përhapjes së virusit, patën një ndikim të madh dhe ishin të vështira për personat me aftësi të kufizuara, si dhe për të moshuarit, veçanërisht për ata persona të cilët varen nga ndihma dhe mbështetja e të tjerëve, qoftë nëpërmjet mbështetjes formale nga ofruesit e shërbimeve ose mbështetjes joformale nga familja dhe miqtë, duke përfshirë asistentët personalë, të cilët i ndihmojnë ata në nevojat e tyre themelore ditore.

Në këtë rast, personat me aftësi të kufizuara u përballën me vështirësi të dyfishta, pasi sipas orarit të lëvizjes, familjet apo asistentët nuk lejoheshin të lëviznin në të njëjtën kohë dhe sipas të njëjtit orar, mirëpo kjo situatë në ndërkohë u tejkalua.<sup>129</sup>

Mbështetja shtesë mungonte në situatën nëse një asistenti personal që ofron ndihmë dhe mbështetje të përditshme për personat me aftësi të kufizuara i shqiptohet masa e izolimit ose vetizolimit, ose nëse ata që i ndihmojnë për shkak të respektimit të masave ose frikës nga infeksioni i mundshëm me COVID-19 nuk mund/nuk duan t'ua ofrojnë ndihmën e nevojshme.

Është e rëndësishme të theksohet se fakti që një numër i madh personash me aftësi të kufizuara nuk mund të kujdesen për veten e tyre, ka kërkuar që shteti të krijojë një sistem mbështetjeje dhe asistence të specializuar gjatë pandemisë për t'u mbrojtur nga rreziku i mundshëm i sëmundjes, por edhe ofrimin e kujdesit dhe mbështetjen e duhur për të shmangur ndikimin negativ në shëndetin e tyre, gjë që nuk ka ndodhur deri më tani.

Për pacientët me COVID-19 nuk është aplikuar asnjë protokoll i veçantë për personat me aftësi të kufizuara, por nevoja për akomodim specifik është marrë parasysh në varësi të nevojave të veçanta të këtyre pacientëve. Janë marrë masat e nevojshme në përputhje me burimet në dispozicion për plotësimin e nevojave të veçanta të kësaj kategorie pacientësh.<sup>130</sup>

Nga informacionet e mbledhura mund të konstatohet se as institucionet përkatëse shtetërore dhe as organizatat përkatëse të shoqërisë civile nuk kanë të dhëna të sakta për numrin e personave me aftësi të kufizuara të infektuar me COVID-19, apo numrin e vdekjeve të personave me aftësi të kufizuara nga pasojat e këtij infeksioni.

Pasi shteti bleu vaksinat kundër virusit COVID-19, personat me aftësi të kufizuara po përballen edhe me mungesën e prioritetit të vaksinimit.<sup>131</sup> Në E-platformën për aplikimin

128 Nga përgjigjja e qeverisë së Kosovës, e datës 9 korrik 2021, e cila ia ka dërguar përgjigjen Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve, në Pyetësorin e Institutit të Avokatit të Popullit, dërguar përmes postës elektronike, më 21.6.2021.

129 Mbledhja e përfaqësuesit të Avokatit të Popullit me drejtorin e OJQ-së "Hendikos", e mbajtur më 8 korrik 2021, me qëllim të mbledhjes së informatave për situatën e përgjithshme të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë, me theks të veçantë në situatën e personave me aftësi të kufizuara gjatë pandemisë COVID-19 dhe nevojat dhe sfidat me të cilat këta persona ballafaqohen, në përgjithësi dhe gjatë kohës së pandemisë.

130 Përgjigjja e Klinikës për Sëmundje Infektive, e datës 06.07.2021, në Pyetësorin e Avokatit të Popullit lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 tek personat me aftësi të kufizuara, dërguar përmes postës elektronike më 21 qershor 2021.

131 Përgjigjja e Forumit Kosovar të Personave me Aftësi të Kufizuara, e datës 14 korrik 2021, në Pyetësorin e Avokatit të Popullit lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 tek personat me aftësi të kufizuara, dërguar përmes postës elektronike më 21.06.2021.

për vaksinim nuk ka një rubrikë të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, por vetëm thuhet se caktimi i terminit bëhet ndër të tjera për pacientët kronikë. Pra, personat me aftësi të kufizuara nuk kanë prioritet direkt, por indirekt si pacientët kronikë, megjithëse problemet dhe nevojat e tyre janë shumë më komplekse se të pacientëve kronikë.

Sa i përket vaksinimit kundër COVID-19, Ministria e Shëndetësisë njofton se të gjitha qendrat/njësitë e vaksinimit në Kosovë kanë qasje për personat me aftësi të kufizuara (përveç komunës së Deçanit, por personeli shëndetësor në këtë komunë ka bërë vaksinimin në objekte të përshtatshme për personat me aftësi të kufizuara). Ministria e Shëndetësisë ka shënuar hyrje-daljet për personat me aftësi të kufizuar. Për të gjithë personat me aftësi të kufizuara që nuk kanë mundur të shkonin në qendrat e vaksinimit, vaksinimi është mundësuar në shtëpi.<sup>132</sup>

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, pandemia ka çuar në një rritje të nevojës për shërbime të shëndetit mendor.

Avokati i Popullit vëren se pavarësisht rritjes së kërkesës për mbështetje të shëndetit mendor,<sup>133</sup> Ministria e Shëndetësisë nuk ka ndarë fonde shtesë për shërbimet e shëndetit mendor. Dihet se në Kosovë vetëm 2% e buxhetit të shëndetësisë shpenzohet për shërbime të shëndetit mendor, që është sërish më e ulët se mesatarja e BE-së prej 4%.<sup>134</sup>

Gjithashtu, Avokati i Popullit vëren se sa i përket qasjes në informacion, personat me aftësi të kufizuara gjatë COVID-19 nuk kanë pasur asnjë informacion shtesë nga institucionet përkatëse të sistemit, përveç atij të përgjithshëm.

Avokati i Popullit u informua nga Zyra për Qeverisje të Mirë lidhur me qasjen në informacione se në bazë të Rregullores QRK 15/2014 për ofrimin e shërbimeve të gjuhës së shenjave, Qeveria ka siguruar mjete për përkthyes për t'i ndihmuar personat e shurdhër dhe në bashkëpunim me Shoqatën e të Shurdhërve të Kosovës, gjatë vitit 2021, ka ofruar shërbime të gjuhës së shenjave në institucionet publike.

Sa i përket qasjes në informacion për personat e verbër dhe me shikim të dëmtuar, gjatë pandemisë, ka pasur shkelje të rëndë të të drejtave të kësaj kategorie personash. Broshurat e shtypura për t'i informuar qytetarët për mbrojtjen nga COVID-19 nuk u shtypën me alfabetin Louise Braille, duke lënë pas dore qasjen në informacion për këtë kategori të personave me aftësi të kufizuara.<sup>135</sup>

Bazuar në atë që u tha më lart, është evidente se informacioni publik mbi masat e COVID-19 nuk është transmetuar apo shpërndarë në mënyrë sistematike në mënyrë të mjaftueshme në format dhe mjetet në dispozicion për t'i arritur të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara. Është gjithashtu e rëndësishme që ky informacion të jetë i qasshëm në alfabetin Braille, por të shkruhet në një mënyrë që të jetë e kuptueshme për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

132 Përgjigjja e e Ministrisë së Shëndetësisë, e datës 9 korrik 2021, në Pyetësin e Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë, dërguar përmes postës elektronike më 21 qershor 2021.

133 Raport i Avokatit të Popullit "Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës", publikuar më 10 dhjetor 2021, faqe 25-39. [https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2021/12/Raport-i-Avokatit-te-Popullit\\_-Emergjencia-sh%c3%abndet%c3%absore-dhe-ndikimi-i-pandemis%c3%ab-n%c3%ab-t%c3%ab-drejtat-e-njeriut\\_FINAL.pdf](https://oik-rks.org/wp-content/uploads/2021/12/Raport-i-Avokatit-te-Popullit_-Emergjencia-sh%c3%abndet%c3%absore-dhe-ndikimi-i-pandemis%c3%ab-n%c3%ab-t%c3%ab-drejtat-e-njeriut_FINAL.pdf)

134 Raporti i Avokatit të Popullit: "Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës".

135 Përgjigjja e Komitetit të Grave të Verbëra të Kosovës, e datës 29 qershor 2021, në Pyetësin e Avokatit të Popullit në lidhje me ndikimin e pandemisë COVID-19 tek personat me aftësi të kufizuara, dërguar përmes postës elektronike më 21 qershor 2021.

Avokati i Popullit vlerëson se gjatë krizës së shkaktuar nga COVID-19, autoritetet nuk kanë ofruar ndonjë mbështetje të veçantë për personat me aftësi të kufizuara, përveç asaj të përgjithshme, të cilën ata e kanë marrë si të gjithë qytetarët.

Sa i përket mungesës së përputhshmërisë së akteve nënligjore me ligjet në fuqi, Avokati i Popullit më 19 mars 2021 e ka publikuar raportin me rekomandime<sup>136</sup>, të cilin ia ka dërguar Doganës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave, lidhur me diskriminimin në zbatimin e së drejtës për lirim nga taksat e importit për automjetet e pasagjerëve për personat me paraplegji dhe tetraplegji dhe të personave të verbër. Në raport, Avokati i Popullit konstatoi se praktika e deritanishme e Doganës së Kosovës, e cila me vendosjen e kushtit të përgjithshëm “posedim personal të patentë shoferit” për të gjitha kategoritë e personave me nevoja të veçanta, paraqet shkelje të të drejtave të personave me aftësi të kufizuara sipas Ligjit nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, Ligjit nr. 04 / Z - 092 për Personat e Verbër, Kodit nr. 03/L-109 për Doganat dhe Akcizat në Kosovë dhe Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, sepse me këtë kusht që nuk është në përputhje me këto ligje i përjashton drejtpërdrejt paraplegjikët, tetraplegjikët dhe të verbërit nga gëzimi i së drejtës së dhënë me ligj për privilegje doganore në fjalë, një mohim, preferencë ose kufizim i pajustificuar i të drejtave të përdoruesve bazuar në shkallën dhe kategorinë e paaftësisë së tyre, është një akt i diskriminimit të drejtpërdrejtë dhe shkeljes së dispozitave të detyrueshme kundër diskriminimit, të cilat janë të detyrueshme për të gjithë personat juridikë.

Duke iu referuar asaj që u tha më lart, Avokati i Popullit, ka dërguar këto rekomandime:

Që DK-ja, pa vonesë të mëtejshme, të krijojë kushte për zbatimin e plotë të së drejtës së dhënë ligjërisht të lehtësimit doganor në lidhje me importin e automjeteve të udhëtarëve, të përshtatura për nevojat e personave me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe të personave të verbër, me mundësi të ushtrimit indirekt të të drejtave të përdoruesit nëpërmjet kujdestarit ligjor ose personave të autorizuar, të pajisur me patentë shoferi (neni 10 Ligji nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji; dhe neni 6 i Ligjit nr. 04/Z - 092 për Personat e Verbër).

Në të ardhmen, DK-ja duhet të kujdeset që të përmbahet nga diskriminimi i pajustificuar ose trajtimi dhe veprimi i pabarabartë i lëshimit (përjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësisë) në lidhje me personat ose grupet e personave, që bazohet në një karakteristikë personale dhe ta harmonizojë praktikën e saj me rregulloret pozitive ligjore në fushën e legjislacionit kundër diskriminimit.

Gjithashtu, Avokati i Popullit, në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*), i dërgoi një mendim juridik Gjykatës Themelore në Prishtinë, lidhur me një ankesë individuale lidhur me pretendimet për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar, d.m.th. mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike për personat me aftësi të kufizuara në hapësirat publike dhe private në Komunën e Prishtinës. Në mendimin e tij, Avokati i popullit ka theksuar se personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht nga aftësitë e tyre, kanë të drejta dhe nevoja që shoqëria, shteti, e veçanërisht pushteti lokal, duhet t'i përmbushë në përputhje me konventat, standardet ndërkombëtare dhe ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës. Trajtimi i barabartë është thelbësor për demokracinë, e cila bazohet në parimin se çdo individ ka vlerë të barabartë.

<sup>136</sup> <https://oik-rks.org/2021/04/29/raporti-i-avokatit-te-popullit-ankesat-nr-8222017-a-nr-8642018-a-nr-5712019-dhe-a-nr-5182020-kunder-doganes-se-kosoves-lidhur-me-diskriminimin-ne-zbatimin-e-se-drejtës-se-lirimit-nga-detyrimet/>

Në mendimin e tij, Avokati i Popullit ka nxjerrë konkluzionin se mosofrimi i akomodimit të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në nenin 1 të Ligjit nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe është në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare, duke përfshirë vendimet e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

## **Mbrojtja e së drejtës për mosdiskriminim në punë**

Avokati i Popullit konstaton se Kosova ka një kornizë ligjore bazë që rregullon çështjet e marrëdhënieve të punës. Megjithatë, për të avancuar mbrojtjen nga diskriminimi në punë, marrë parasysh aspiratën e qartë të Kosovës për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian, është e rëndësishme vazhdimi i reformës së Ligjit të Punës në Kosovë.

Ligji themelor i punës, i miratuar në vitin 2010, si Ligji nr. 03/L-212 i Punës, rregullon mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve, por nuk është plotësisht në përputhje me të gjitha direktivat përkatëse evropiane. Nga dhjetori i vitit 2020 është duke u përgatitur ligji i ri i punës, i cili do të harmonizohet me 17 direktiva evropiane në fushën e marrëdhënieve të së drejtës për punë, mbrojtjes sociale, pagave, orarit të punës dhe mbrojtjes moderne të punëtorëve. Avokati i Popullit vëren gjithashtu se ka mangësi në zbatimin e Ligjit të Punës kryesisht për shkak të zvarritjes së procedurave nga gjykatat kompetente.

Ligji nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i miratuar në vitin 2013, ka sjellë ndryshime të mëdha në sistemin e sigurisë dhe shëndetit në punë në Kosovë dhe është në përputhje me shumicën e kërkesave të Direktivës kornizë të BE-së. 89/391 / EEC. Ai zbatohet për të gjithë sektorët, përveç forcave të sigurisë, policisë, zjarrfikësve dhe shërbimeve të shpëtimit. Ky ligj mbulon një gamë të gjerë punëtorësh (përfshirë praktikantët dhe studentët në trajnim praktik), por jo të vetëpunësuarit ose punëtorët në familje. Për të siguruar përputhjen e plotë me Direktivën kornizë të BE-së 89/391/EEZ, ministria e linjës e ka rishikuar këtë ligj në vitin 2019 dhe e ka përgatitur një koncept-dokument që identifikon të gjitha ndryshimet e nevojshme legjislative. Në vitin 2020 ka nisur edhe procesi i ndryshimit të Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Në zhvillimin pozitiv të ngjarjeve, Qeveria ka propozuar edhe Projektligjin nr. 07/L-028 për Inspektoratin e Punës, me qëllimet kryesore zgjidhjen e punësimit joformal dhe rritjen e kapaciteteve për aktivitete inspektuese me qëllim të parandalimit të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve. Megjithatë, projektligji, i cili do ta zëvendësonte Ligjin ekzistues nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës, që nga shtatori 2020 është në pritje të shqyrtimit dhe miratimit nga komisioni funksional i Kuvendit të Kosovës.<sup>137</sup>

Avokati i Popullit konstaton mungesën e mbikëqyrjes së zbatimit të duhur të këtij Ligjit, për shkak të mungesës së kapaciteteve të Inspektoratit të Punës.

## **Mbrojtja e të drejtave të punëtorëve gjatë pandemisë COVID-19**

Avokati i Popullit ka monitoruar zbatimin e të drejtave të marrëdhënies së punës, ka marrë informata nga institucionet përkatëse dhe ka mbledhur informata nga terreni sa i përket ndikimit të pandemisë COVID-19 në ushtrimin e të drejtave të punës në Kosovë.

Avokati i Popullit vëren së të drejtat ekonomike dhe sociale janë ndikuar drejtpërdrejt nga vendimet e qeverisë për vendosjen e masave për mbrojtje nga pandemia COVID-19. Për

<sup>137</sup> Projektligji nr.07/L-028 për Inspektoratin e Punës, 14 shtator 2020.

shkak të masave restriktive të Qeverisë së Kosovës në luftimin e pandemisë, sektori privat në Kosovë vazhdon të jetë veçanërisht i prekur. Shumë ndërmarrje janë mbyllur. Kjo ka lënë një numër të madh njerëzish pa punë.

Në lidhje me atë që u tha më lart, më 29.03.2021, MFPT-ja miratoi Vendimin nr.40/2021 për përcaktimin e kushteve dhe kriterëve në lidhje me funksionalizimin e masës 1.2 - Mbështetje për personat e punësuar formalisht nga pakoja e rimëkëmbjes ekonomike. Nëpërmjet masës 1.2, çdo punëtori të ri do t'i paguhen kontributet pensionale në masën 10% (dhjetë për qind) të pagës bruto, duke filluar nga korriku 2021 deri në qershor 2022. Subvencionimi sipas këtij vendimi bëhet vetëm për ata punëtorë të cilët në qershor 2021 kanë qenë të papunë dhe/ose të paregjistruar për qëllime tatimore në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës, por që janë të punësuar dhe të regjistruar për qëllime tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës që nga korriku 2021.<sup>138</sup>

Gjithashtu, më 5 gusht 2021, MFPT-ja ka miratuar Vendimin nr. 43/2021 për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve në lidhje me funksionalizimin e masës 1.3 të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike – Mbështetje për punësimin e femrave. Nëpërmjet masës 1.3, secila nga femrat e punësuar do të përfitojë subvencion pagash deri në 50% (pesëdhjetë për qind) të pagës mujore bruto për një periudhë 3-mujore, duke filluar nga periudha tatimore e korrikut 2021 e tutje. Në fund të periudhës tremujore do të subvencionohen kontributet pensionale për muajt e mbetur, në përputhje me kriteret dhe limitet e përcaktuara në vendimin për zbatimin e masës 1.2 të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike. Subvencionimi sipas këtij vendimi bëhet vetëm: për punëtorët që në qershor 2021 ishin të papunë dhe/ose të paregjistruar për qëllime tatimore në sistemin e Administratës Tatimore të Kosovës; për të punësuarit dhe të regjistruar për qëllime tatimore në Administratën Tatimore të Kosovës nga korriku 2021 e tutje dhe brenda afatit ligjor.<sup>139</sup>

Gjithashtu, më 6 gusht 2021, MFPT-ja ka miratuar Vendimin nr. 44/2021 për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve në lidhje me funksionalizimin e masës 1.1 të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike – Kthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë. Përmes masës 1.1, çdo punëtori që ka qenë i punësuar në periudhën dhjetor 2019 - shkurt 2020 dhe ka humbur vendin e punës, do t'i subvencionohet paga bruto deri në 50% për 3 muaj, duke filluar nga periudha tatimore e korrikut 2021. Subvencionimi sipas këtij vendimi bëhet vetëm për ata punëtorë që i plotësojnë këto kushte: punëtori i cili ka qenë i punësuar dhe i regjistruar për qëllime tatimore në periudhën dhjetor 2019 - shkurt 2020 (pa ndërprerje); dhe punëtorët që nuk kanë qenë të punësuar dhe të regjistruar për qëllime tatimore për periudhën prill 2021 - qershor 2021 (pa ndërprerje). Humbja e vendit të punës dhe/ose papunësia evidentohet përmes sistemit të Administratës Tatimore të Kosovës.<sup>140</sup>

Me qëllim të monitorimit dhe zbatimit të masave 1.1, 1.2 dhe 1.3 të Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike, më 13 gusht 2021, me Vendimin nr. 48/2021 e ka themeluar komisionin treanëtarësh, i cili e ka mandatin që të sigurojë që institucionet përgjegjëse t'i zbatojnë masat në frymën e Pakos së Rimëkëmbjes Ekonomike dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e përcaktuara në vendimet e ministrit: nr. 40/2021, nr.43/2021 dhe nr. 44/2021.<sup>141</sup>

Avokati i Popullit konstaton që me gjithë masat e ndërmarra në mbështetje të të punësuarve të afektuar nga pandemia në sektorin privat, ato ishin të pamjaftueshme. Mbi bazën e kësaj, është e domosdoshme vazhdimi i mbështetjes së sektorit privat për t'u mundësuar qytetarëve realizimin e të drejtave në punësim.

138 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/EB376412-5F55-4576-B5A9-25BDD29664AB.pdf>,

139 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/3AC5B91A-D01D-4D98-9282-656FC2470FEB.pdf>

140 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/E6EBDAA1-8FF6-4D7A-A46C-FFBEA215D595.pdf>

141 <https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/69389938-6893-4406-9EF2-02DC51E50D11.pdf>

Në anën tjetër, punëtorët në institucionet publike të Kosovës kanë qëndruar në detyrë gjatë gjithë pandemisë, edhe pse Qeveria e Kosovës ka marrë disa vendime me të cilat kërkohet nga institucionet që të punojnë me personel të reduktuar.

Punëtorët në funksionet publike kryesore<sup>142</sup> edhe më tutje vazhdojnë ta bartin një barrë joproporcionale, duke u përpjekur ta ndalojnë përhapjen e virusit, ta mbrojnë shëndetin dhe jetën e njerëzve dhe ta sigurojnë plotësimin e nevojave themelore të jetesës.

Punëtorët në objektet shëndetësore, përkatësisht personeli mjekësor dhe jomjekësor në vendet e punës të ekspozuar ndaj pacientëve të infektuar,<sup>143</sup> vazhdojnë t'i ekspozohen rrezikut më të lartë të infektimit si dhe bëjnë përpjekje më të mëdha, shpesh duke punuar jashtë orarit për shkak të mungesës së punëtorëve shëndetësorë dhe pa pushime gjatë orarit të punës.

Avokati i Popullit vëren se gjatë pandemisë, për ta tejkaluar mungesën e personelit shëndetësor dhe për t'i fuqizuar më tutje kapacitetet e institucioneve publike shëndetësore, Qeveria vazhdoi të punësojë më shumë profesionistë shëndetësorë për t'iu përgjigjur sfidave ekzistuese dhe për të ofruar trajtim adekuat për të gjithë pacientët në mënyrë të barabartë. Megjithatë kjo nuk ishte e mjaftueshme.

Qeveria po ashtu me pakon e masave ka vazhduar me sigurimin e shtesave në pagë për punëtorët të cilët janë të ekspozuar drejtpërdrejt ndaj rrezikut të infektimit në punë.

## **Të drejtat sociale, pensionet, përfitimet sociale dhe të veçanta**

Avokati i Popullit thekson se Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbështetur pensionistët dhe përfituesit e të gjitha skemave sociale gjatë kësaj periudhe raportuese, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19. Gjithashtu vëren se nuk ka pasur vonesa apo vështirësi në pagesën e pensioneve dhe të gjitha përfitimet shtesë janë realizuar në bazë të vendimeve të qeverisë për ta luftuar COVID-19.

Sa i përket skemave pensionale, bazuar në Vendimin nr. 06/58 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, datë 14.01.2021, masa 16, pika 1.16.1 - Mbështetja e skemave pensionale për individët me të ardhura më pak se 100 euro në muaj, dhe në bazë të propozimit - vendimit të ish-Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për miratimin e një shtese në shumën prej 30 €, për muajt janar-mars 2021, e cila është realizuar dhe nga prilli 2021 e deri më tani, shumën e përfitimeve në skemat e mëposhtme është barazuar për të gjitha në shumën 100 €, shtesat që barazojnë shumën e specifikuar në skema janë theksuar në vijim:

1. Pensioni bazë - është  $90 \text{ €} + 10 = 100 \text{ €}$ ,
2. Pensioni familjar - është  $90 \text{ €} + 10 = 100 \text{ €}$
3. Pensioni për personat me aftësi të kufizuara - është  $75 \text{ €} + 25 = 100 \text{ €}$

142 Personeli shëndetësor, mjekësor dhe jomjekësor, zyrtarët policorë. Policia e Kosovës; inspektorët e Inspektoratit të Punës, të Administratës Tatimore të Kosovës, si dhe inspektorët e inspektorateve të tjera përkatëse; punëtorët socialë; doganierët e Doganës së Kosovës; punëtorët socialë; shoferët e transportit publik, shoferët e taksive dhe kamionëve; punëtorët në përpunimin dhe prodhimin e ushqimit, punëtorët në dyqane ushqimore dhe hotelieri etj.

143 Përfshin mjekët dhe motrat medicinale, por edhe terapistët respiratorë dhe të gjithë profesionistët e tjerë shëndetësorë, të cilët duhet të hyjnë në dhomën ku qëndrojnë pacientët e infektuar, si dhe personeli bazë jomjekësor, i cili çdo ditë e mirëmban higjienën e ambienteve ku qëndrojnë pacientët e infektuar, punëtorët e mirëmbajtjes hapësirave për përgatitjen e ushqimit, ndihmësit e kujdesit për pacientët, teknikët e kujdesit për pacientët dhe administratën; të gjithë ata që vijnë rregullisht për të punuar në institucionet me pacientë të infektuar për të kryer shërbime jetësore.

#### 4. Pensioni invalidor i punës - është 90+ 10 € = 100 €

Po ashtu më 27 tetor 2021, në seancën e 42-të, Qeveria e Kosovës ka miratuar vendimin në kuadër të Pakos për Rimëkëmbjen Ekonomike, masën 3.2 - Mbështetja e pensionistëve dhe familjeve me asistencë sociale, me të cilën përfituesit e skemave pensionale, në nëntor të këtij viti, kanë marrë një ndihmë të njëhershme nga 100 euro shtesë për pensionin e rregullt dhe shtesën aktuale. Nga ana tjetër, përfituesit e skemave sociale në muajt nëntor dhe dhjetor kanë marrë pagesa të dyfishta të rregullta dhe shtesën vijuese. Ndihma i është paguar me rregull të gjithë përfituesve. Me këtë vendim të Qeverisë janë përfshirë rreth 330.000 familje.

Sa i përket reformës së legjislacionit të pensioneve, Qeveria në periudhën e kaluar ka planifikuar dhe tashmë ka ndërmarrë disa hapa në reformën e sistemit të pensioneve dhe përfitimeve, për ta harmonizuar këtë çështje me praktikën evropiane, por ende nuk dihet se kur do të zbatohet plotësisht kjo reformë.

Përfituesit e skemave pensionale edhe gjatë kësaj periudhe raportuese janë liruar nga detyrimi i paraqitjes së rregullt me qëllim të evidentimit ose paraqitjes në zyrat përkatëse të administratës së pensioneve.

Avokati i Popullit, edhe pse i vlerëson masat e ndërmarra nga Qeveria, konstaton se niveli i mbështetjes dhe lartësia e saj nuk mundëson plotësimin e nevojave elementare për një jetë të dinjitetshme për këto kategori.

### **Barazia gjinore**

Barazia gjinore nënkupton mundësi të barabarta për të gjitha femrat dhe meshkujt, si dhe njerëzit e identiteteve të ndryshme gjinore në shoqëri. Avokati i Popullit konstaton se përkundër përpjekjeve dhe masave për avancimin e pozitës së gruas, në shoqërinë tonë ende ekziston pabarazia gjinore. Kjo pabarazi është e shprehur në pjesëmarrjen e grave në ndarjen e pasurisë në trashëgimi, pjesëmarrjen e tyre në tregun e punës, në jetën politike dhe vendimmarrje, në fushën e arsimit, shëndetësisë dhe në ndarjen e përgjegjësisë në familje. Pengesat dhe sfidat që ekzistojnë në fushën e barazisë gjinore dolën më shumë në pah gjatë vitit të kaluar në kohën e pandemisë të shkaktuar nga virusi Covid-19.

Bazuar në ankesat e parashtruara te Avokati i Popullit, gratë janë në një pozitë më të pafavorshme se burrat në fushën e punësimit dhe zhvillimit të karrierës. Diskriminimi gjinor është i pranishëm si në sektorin publik, ashtu edhe në atë privat. Rastet e diskriminimit gjinor rrallëherë denoncohen, për shkak të mosnjohjes së të drejtave si dhe mungesës së praktikës gjyqësore në rastet e diskriminimit.

Avokati i Popullit konstaton se është me rëndësi që autoritetet publike t'i përmbushin detyrimet pozitive që rrjedhin nga e drejta për barazi gjinore.

### **Barazia gjinore në të drejtën për pronë dhe trashëgimi**

Një prej të drejtave themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës është edhe drejta në pronë. Edhe pse sipas ligjeve në fuqi, gratë dhe burrat kanë të drejta të barabarta në pronë, shumica e pronave në shoqërinë tonë janë të regjistruara në emër të burrave. Gjithashtu, burrat dhe gratë kanë të drejta të barabarta në trashëgimi të pronës, por në praktikë, gratë janë më të diskriminuara sesa burrat, meqenëse vazhdon që në disa raste burri konsiderohet si trashëgimtar i vetëm i pasurisë së familjes së tij.



Avokati i Popullit thekson si një hap pozitiv ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ 03/2016, më 19 prill 2021, si një masë afirmative të regjistrimit të pronës së palujtshme të përbashkët në emër të të dy bashkëshortëve, me të cilin është zgjatur periudha kohore e zbatimit të tij edhe për gjashtë vjet nga dita e hyrjes në fuqi. Qëllimi i kësaj mase afirmative ishte që të rrisë qasjen në pronë nga gratë, regjistrimi i pronës në emër të tyre si dhe ta përshejtojë arritjen e barazisë mes burrave dhe grave në aspektin e të drejtave pronësore.

Avokati i Popullit vëren se ende paraqet shqetësim heqja dorë nga trashëgimtarët në favor të trashëgimtarit. Korniza aktuale legjislative për trashëgimi është e pamjaftueshme që të përballet me këtë praktikë, andaj, nisur nga kjo, ekziston nevoja për legjislacion dhe rregulla procedurale më të qarta në njërin anë, ndërsa në anën tjetër duhet të punohet më shumë në ndërgjegjësimin e shoqërisë për të drejtat e gruas në trashëgimi.

## **Të drejtat e personave LGBTI**

Avokati i Popullit vlerëson se korniza ligjore e Republikës së Kosovës siguron promovimin dhe mbrojtjen e të gjitha gupeve të marginalizuara, duke përfshirë edhe komunitetin LGBTI.

Si rrjedhojë, promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të personave që i përkasin komunitetit LGBTI është një përgjegjësi integrale e të gjitha institucioneve në vend. Legjislacioni ekzistues, i cili rregullon të drejtat e personave LGBTI, duhet të plotësohet dhe ndryshohet sa i përket të mbrojtjes më efikase dhe të drejtave të këtij komuniteti dhe këto ndryshime duhet të reflektohen në hartimin e Kodit Civil, i cili ka paraparë ndryshime ligjore në lidhje me mbrojtjen të drejtave të personave LGBTI. Avokati i Popullit e konsideron të nevojshëm që Projektkodi Civil të jetë në përputhje me kërkesat e së drejtës kushtetuese për respektimin e jetës familjare dhe me standardet e GjEDNj-së për njohjen e marrëdhënieve të çifteve homoseksuale.

## **Përgjegjësia e autoriteteve publike për mbrojtje nga dhuna në familje**

Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) e përkufizon dhunën ndaj grave si shkelje e të drejtave të njeriut dhe një formë e diskriminimit ndaj grave dhe nënkupton të gjitha veprimet e dhunës me bazë gjinore që rezultojnë ose mund të rezultojnë në dëm fizik, seksual, psikologjik ose ekonomik ose vuajtje ndaj grave, duke përfshirë kërcënime për kryerjen e këtyre akteve, shtrëngim ose heqje arbitrare të lirisë, qoftë nëse ndodh në jetën publike ose private.<sup>144</sup>

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 20 shtator 2020, përmes ndryshimit të Kushtetutës, ka përfshirë Konventën e Stambollit si instrument ligjor detyruës për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, veprim me të cilin është plotësuar korniza ligjore me standardet më të avancuara ndërkombëtare për mbrojtjen nga dhuna në familje. Megjithatë, Avokati i Popullit konsideron që janë duke u bërë hapa shumë të ngadalshëm në harmonizimin dhe përafrimin e legjislacionit dhe politikave shtetërore me standardet e përcaktuara në këtë Konventë.

Më 9 nëntor 2020, me nismën e Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur, Viktimat e Dhunës Seksuale të Luftës dhe Peticione, është

<sup>144</sup> Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës nga Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit), neni 3, e qasshme në: <https://rm.coe.int/168046246b>

hartuar dhe publikuar Projektligji nr.07/L-044 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave<sup>145</sup>, i cili nuk ka arritur të miratohej ende nga ana e Kuvendit të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit konsideron që teksti i publikuar i këtij projektligji nuk është në harmoni të plotë me Konventën e Stambollit dhe nuk përfshin një numër të madh të detyrimeve që rrjedhin nga ajo, rrjedhimisht I rekomandon Kuvendit që bazuar në standardet e Konventës, të sigurohet që projektligji të përfshijë të gjitha dispozitat që kanë të bëjnë me përgjegjësitë e mekanizmave institucionalë, politikave me ndjeshmëri gjinore, parandalimin, mbrojtjen dhe kompensimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Avokati i Popullit vëren se Ministria e Drejtësisë është vonuar në hartimin dhe aprovimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Dhunës në Familje (sepse kishte skaduar) dhe i ka rekomanduar kësaj ministrie që me urgjencë ta hartojë dhe miratojë këtë dokument, i cili mundëson funksionimin e mekanizmave institucionalë në hartimin e politikave parandaluese dhe në koordinimin e masave për mbrojtjen e viktimave nga dhuna në familje. Ky rekomandim është në proces plotësimi.

Avokati i Popullit konstaton se edhe në këtë vit raportues, dukuria e dhunës në familje në Kosovë është e shprehur në përmasa shqetësuese përmes rritjes së numrit të rasteve të raportuara dhe prezencës së dhunës në familje në shoqërinë tonë.

Edhe përkundër masave që kanë ndërmarrë autoritetet publike, ato nuk kanë arritur t'i përmbushnin detyrimet pozitive për mbrojtjen nga dhuna në familje, e që në periudhën e shfaqjes së pandemisë COVID-19, numri i rasteve të raportuara të dhunës në familje është rritur edhe më shumë. Avokati i Popullit luan rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimeve të shtetit në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje. Në kuadër të kësaj, me kujdes ka monitoruar masat e ndërmarra në periudhën e pandemisë, prandaj më 10 dhjetor 2021 ka publikuar raportin e veçantë: "Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës"<sup>146</sup>, i cili ka trajtuar edhe dhunën në familje gjatë pandemisë Covid-19 në vitin 2021 në Kosovë. Sipas këtij raporti, del se rastet e dhunës në familje gjatë pandemisë janë rritur. Sipas informatave të siguruar nga Policia e Kosovës, del se gjatë vitit 2019 janë regjistruar 1915 raste, në vitin 2020 janë regjistruar 2069 raste, kurse ky numër është rritur edhe më tutje në vitin 2021, duke shënuar 2456 raste.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka kontaktuar me organizatat që strehojnë viktimat për të parë gjendjen e funksionimit të tyre, ku ka marrë informacione lidhur me gratë e strehuara në këto qendra gjatë vitit 2021, si në vijim:

Në komunën e Prishtinës, sipas të dhënave nga Qendra për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijëve (QMGF) në Prishtinë, del se kjo qendër ishte në rinovim, ndërsa shërbimet për viktimat ofroheshin në një objekt joadekuat për strehimore. Sipas tyre, prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2021, në këtë strehimore janë strehuar 132 persona, prej tyre 63 fëmijë.

Në komunën e Pejës, nga 1 janar deri më 31 dhjetor 2021, në QMG në Pejë janë strehuar 76 persona, prej tyre 27 fëmijë. Gjithashtu, vështirësitë financiare gjatë pandemisë COVID-19 ishin të shumta. Kontratat me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) nuk

<sup>145</sup> Kuvendi i Republikës së Kosovës, Projektligji nr.07/L-044 për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje dhe dhunës ndaj grave, <https://www.kuvendikosoves.org/shq/projektligjet/projektligji/?draftlaw=236#info-div>

<sup>146</sup> IAP, "Emergjenca shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës", i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/>

ishin të nënshkruara për një vit, por për tetë ose nëntë muaj. Gjatë vitit 2021, QMG ka nënshkruar kontratën me MPMS-në për financim të strehimores, e cila e ka kohëzgjatjen deri më 15 janar 2022. Pasiguria financiare ndikon në ofrimin e shërbimeve dhe në gjendjen psikologjike të grave dhe fëmijëve si viktimat e dhunës në familje. Gjithashtu, sfidë tjetër ka qenë edhe moskoordinimi i rregullt i strehimores me institucione të tjera, siç janë: QPS, mbrojtësi i viktimave dhe gjykatat, për shkak të orarit të reduktuar të punës gjatë pandemisë.

Në komunën e Prizrenit, sipas të dhënave nga QMG në Prizren, në vitin 2021 janë strehuar gjithsejtë 53 viktima të dhunës në familje, ndërsa krahasuar me vitin 2020, kur janë strehuar 37 raste, rezulton se në vitin 2021 ka pasur rritje të numrit të viktimave të strehuara në këtë qendër.

Në komunën e Ferizajt, sipas të dhënave të Qendrës për Mbrojtje të Grave dhe Fëmijëve (QMGF) del se në këtë qendër numri i rasteve të dhunës në familje të trajtuara, nga 1 janari deri më 31 dhjetor 2021, janë strehuar 62 raste; 25 femra të rritura dhe 37 fëmijë.

Në Komunën e Mitrovicës së Jugut, sipas të dhënave, në vitin 2021 kanë qenë 61 raste të viktimave të dhunës në familje të strehuara në strehimoren e Mitrovicës, prej tyre 34 fëmijë.

Kurse në komunën e Gjakovës, sipas të dhënave nga Shtëpia e Sigurt, aty janë strehuar 114 persona viktima të dhunës në familje, prej tyre 56 fëmijë.

Gjatë kësaj periudhe raportuese, Avokati i Popullit ka pranuar 21 raste lidhur me dhunën në familje. Disa nga rastet e pranuar kanë qenë kërkesa për monitorimin e rasteve në gjykata në bazë të të cilave përfaqësuesit e Avokatit të Popullit kanë monitoruar proceset gjyqësore për viktimat e dhunës në familje.

Më 27 prill 2021, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin Ex officio nr.150/2021 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.<sup>147</sup> Në këtë raport, Avokati i Popullit konstatoi se kishte munguar koordinimi i veprimeve ndërmjet autoriteteve, gjë që kërkon nevojën e përmirësimit të cilësisë dhe sigurisë së shërbimeve për rastet e dhunës në familje dhe forcimin e mekanizmave të kontrollit të secilit institucion, prej momentit të paraqitjes së rastit të dhunës në familje e deri në përfundimin e tij. Avokati i Popullit ka dalë me rekomandime konkrete për autoritetet gjegjëse lidhur me përmirësimin e gjendjes nga perspektiva e të drejtave të njeriut, me qëllim të ndërtimit të një sistemi në pajtim me parimet e sundimit të së drejtës dhe standardeve ndërkombëtare.

Edhe në këtë vit mbetet i pazbatueshëm Ligji për Mbikëqyrjen e Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës. Për zbatimin e këtij ligji në realizimin e mbikëqyrjes elektronike dhe raportim nga Policia e Kosovës të personave të cilëve u kufizohet lëvizja, Ministria e Punëve të Brendshme ka nxjerrë udhëzim administrativ. Megjithatë, ky ligj vazhdon të mos gjejë zbatim. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex. Officio nr. 621/2018, në lidhje me masat operative parandaluese për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen

147 IAP, Raport me Rekomandime Ex officio nr.150/2021, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2021/04/27/raport-me-rekomandime-ex-officio-nr-1502021-ne-lidhje-me-detyrimet-pozitive-te-shtetit-per-te-drejtjen-ne-ujete-dhe-mbrojtjen-nga-dhuna-ne-familje/>

Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës<sup>148</sup>, i cili ka adresuar disa rekomandime për autoritetet përgjegjëse, të cilat ndërlidhen me detyrimet e tyre për zbatimin e këtij ligji, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë do të ndikonte në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

## E drejta në mbrojtjen shëndetësore

Pandemia COVID-19, edhe në këtë vit ka vazhduar të sfidojë rrjedhën normale të jetës në Kosovë dhe gjithë botën. Investimi jo i mirë në sistemin shëndetësor dhe ridrejtimi i burimeve shëndetësore në luftimin e kësaj pandemie, ka zvogëluar aftësinë për t'iu përgjigjur asaj dhe njëkohësisht ka ndikuar në mosofrimin e shërbimeve të tjera shëndetësore. COVID-19 po tregon se aplikimi i Mbulimit Shëndetësor Universal (MShU)<sup>149</sup> duhet të jetë imperativ i së ardhmes.<sup>150</sup> Kjo do të arrihet vetëm atëherë kur shtetet do të kenë ngritur sisteme të qëndrueshme shëndetësore, që janë në gjendje t'iu përgjigjen kërkesave themelore të qytetarëve të tyre, në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe pa diskriminim, pa lënë askënd prapa. Në këtë drejtim, Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, siç është edhe Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) në Kosovë, luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimeve të shtetit, në arritjen e qasjes universale për këto grupe.

Avokati i Popullit vëren se Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore ende vazhdon të jetë jashtë listës së instrumenteve ligjore të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Republikën e Kosovës. Edhe në raportet paraprake vjetore, Avokati i Popullit e ka ngritur këtë çështje, e cila ka një rëndësi të veçantë, sepse do të ndikonte në avancimin e mbrojtjes së të drejtave ekonomiko sociale në vendin tonë.

Avokati i Popullit ripërsërit faktin se Ligji nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, i miratuar në vitin 2014, akoma nuk po gjen zbatim. Qëllim i këtij ligji është që qytetarëve t'i sigurohet qasje universale me shërbime kualitative të kujdesit themelor shëndetësor, me qëllim të sigurimit të mbrojtjes financiare për kujdesin shëndetësor, nëpërmjet themelimit dhe rregullimit të sistemit publik të sigurimit shëndetësor.

Mbrojtja shëndetësore nuk është në nivelin e duhur dhe kjo situatë është rënduar edhe më shumë si pasojë e pandemisë globale Covid-19, prandaj Avokati i Popullit në raportin e veçantë me temën "Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës"<sup>151</sup> ka trajtuar edhe të drejtën në mbrojtjen shëndetësore dhe ka bërë rekomandimet përkatëse për autoritetet përgjegjëse për përmirësimin e situatës.

148 IAP, Raportin me Rekomandime Ex. Officio nr. 621/2018, në lidhje me masat operative parandaluese për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2021/03/09/raport-me-rekomandime-ex-officion-rasti-nr-6212018-ne-lidhje-me-masat-operative-parandaluese-per-mbrojtjen-e-viktimave-te-dhunes-ne-familje-sipas-ligjit-nr-05l-003-per-mbikëqyrjen-elektronike-t/>

149 Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Mbulimi Shëndetësor Universal (MShU) nënkupton që të gjithë njerëzit dhe komunitetet mund t'i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore promovuese, parandaluese, shëruuese, rehabilituese dhe paliative që iu nevojiten, të cilësisë së mjaftueshme për të qene efektive, duke siguruar poashtu që shfrytëzimi i këtyre shërbimeve nuk e ekspozon përdoruesin ndaj vështirësive financiare.

150 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Përmbledhje politikash lidhur me të drejtat e njeriut dhe Covid-19, i qasshëm në: [https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un\\_policy\\_brief\\_on\\_human\\_rights\\_and\\_covid\\_23\\_april\\_2020.pdf](https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_brief_on_human_rights_and_covid_23_april_2020.pdf)

151 IAP, Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/>

Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 në territorin e Republikës së Kosovës ka përcaktuar përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësive gjatë pandemisë COVID-19. Mirëpo, pavarësisht faktit se MSh-ja kishte hartuar planin për gatishmëri dhe reagim kundër COVID-19 dhe qeveria kishte ndarë mjete financiare shtesë, u vërejtën vështirësi dhe vonesa për furnizim me mjete mbrojtëse, teste, barna, respiratorë dhe me mjete tjera përkatëse.

Mbi bazën e informatave nga institucionet shëndetësore, nga organizatat sindikale si dhe nga qytetarët, Avokati i Popullit vlerëson se ka mangësi në sistemin shëndetësor për shkak të kontributeve të ulëta buxhetore për shëndetësi, moszbatimi i ligjeve dhe i politikave, moskoordinimi mes sektorëve, monitorimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e llogaridhënies.

Avokati i Popullit vlerëson se është i nevojshme hartimi i një strategjie dhe politikave të veçanta nga qeveria për ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe trajtimin e personave me aftësi të kufizuara dhe të të moshuarve në situata emergjente, për faktin se kjo kategori është më e cenueshme dhe ka vështirësi specifike në marrjen e shërbimeve shëndetësore.

Fokusi në parandalimin dhe trajtimin e të sëmurëve me COVID-19, veç të tjerash, ka lënë anash shumë qytetarë, të cilët kishin nevoja shëndetësore të natyrave të tjera, përfshirë edhe ato kronike, e që solli sfida të shumta te institucionet shëndetësore, te personeli shëndetësor si dhe ndikoi në buxhetin e të infektuarve me COVID-19 dhe të familjarëve të tyre. Lidhur me këtë problematikë, Avokati i Popullit ka publikuar Raportin me Rekomandime Ex.Officio Nr. 698/2020, në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB), gjatë periudhës së pandemisë COVID 19 në Kosovë<sup>152</sup> dhe Raportin me Rekomandime Ex. Officio Nr. 434/2020 përkitazi me kufizimet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID 19 në Kosovë.<sup>153</sup>

Bazuar në ankesat e pranuar, Avokati i Popullit konsideron se ndër faktorët kryesorë që janë duke ndikuar në situatën e rënduar shëndetësore në Kosovë, përveç pandemisë, janë papunësia dhe mungesa e zbatimit të legjisllacionit për sigurime shëndetësore, e cila po e vështirëson qasjen në shërbime mjekësore adekuate për qytetarët. Bazuar në rastet e pranuar në IAP, edhe gjatë këtij viti raportues, mbrojtja shëndetësore mbetet sfidë dhe shqetësim për Avokatin e Popullit, prandaj ripërsërit kërkesën që urgjentisht të merren të gjitha masat për fillimin e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor, si e drejtë themelore për qasje në shërbimet e kujdesit shëndetësor.

## Të drejtat e komuniteteve joshumicë

Në Republikën e Kosovës jetojnë komunitete të ndryshme joshumicë: serb, boshnjak, goran, turk, malazez, kroat, rom, ashkali dhe egjiptian. Të drejtat e komuniteteve joshumicë janë të garantuara me Kushtetutë dhe me ligje, si dhe me Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, e cila synon të promovojë të drejtat e pakicave dhe barazinë efikase të komuniteteve pakicë në të gjitha fushat e jetës ekonomike, sociale, politike dhe kulturore.

<sup>152</sup> IAP, Raporti me Rekomandime Ex. Officio Nr. 698/2020, në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB), gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, i qasshëm në: <https://www.oik-rks.org/wp-content/uploads/2021/01/Raport-me-rekomandime-Ex-Officio-698-2020.pdf>

<sup>153</sup> IAP, Raportin me Rekomandime Ex. Officio Nr. 434/2020 përkitazi me kufizimet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë, i qasshëm në: <https://oik-rks.org/2021/03/12/raport-me-rekomandime-ex-officio-rasti-nr-4342020-ne-lidhje-me-kufizimet-e-ofrimit-te-sherbimeve-shendetesore-gjate-pandemise-covid-19-ne-kosove/>

Avokati i Popullit vlerëson se gjatë periudhës raportuese nuk ka pasur ndryshime sa u përket përmirësimeve të dukshme në zbatimin e ligjeve të cilat janë relevante për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve në Republikën e Kosovës.<sup>154</sup> Nga numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar në institucion gjatë këtij viti raportues, 151 ankesa individuale vijnë nga pjesëtarët e komuniteteve joshumicë. Gjatë vitit 2021, si edhe gjatë vitit 2020, vërehet rënje e numrit të ankesave të parashtruara nga pjesëtarët e komuniteteve, e që mund të shpjegohet me vështirësitë që mund të jenë përballë qytetarët dhe institucionet me pasoja të shkaktuara nga pandemia e virusit COVID-19.<sup>155</sup> Problemet që prekin pjesëtarët e komuniteteve pakicë vazhdojnë të lidhen me kthimin, të drejtat pronësore, arsimimin, problemet me zbatimin e plotë të rregulloreve për përdorimin e gjuhëve dhe dokumentet personale.

## E drejta për kthim dhe siguri

Avokati i Popullit konstaton se sipas të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2021, ka vazhduar trendi i rënies së numrit të personave të kthyer, të cilët ishin zhvendosur nga Kosova për shkak të luftës. Sipas të dhënave të Komisarariatit të Lartë për Refugjatë (UNHCR), 306 pjesëtarë të komuniteteve joshumicë janë kthyer në Kosovë gjatë vitit 2021<sup>156</sup>, që nëse krahasohet me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar shihet se janë 55 persona të kthyer më pak sesa gjatë vitit paraprak. Përkundër faktit se shumica e qendrave kolektive ku ishin të vendosur personat e zhvendosur janë mbyllur dhe strehimi i tyre banesor është zgjidhur, kanë mbetur të vendosen në banesa edhe 139 persona të tjerë që ende jetojnë në qendra kolektive.<sup>157</sup>

Sipas informacioneve të pranuar nga UNHCR-ja, gjatë vitit 2022 është planifikuar mbyllja e qendrave kolektive të mbetura dhe përkujdesja e përhershme për personat e zhvendosur në bazë të planit të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK). Komuna e Zveçanit dhe e Leposaviqit kanë ndarë hapësira për ndërtimin e njësive banesore për personat të cilët banojnë në qendra kolektive. Problemet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen ende personat e zhvendosur dhe të kthyerit gjatë kësaj periudhe raportuese kanë të bëjnë me problemet e pronës, problemet infrastrukturore, gjendjen jo të mirë ekonomike dhe sociale dhe qëndrueshmërinë e kthimit të personave të pa përgatitur për tregun e punës, marrjen e dokumenteve personale etj. Të gjitha të cekura më sipër, si në vitet e kaluara, vazhdojnë të ndikojnë në procesin e mëtutjeshëm të kthimit të personave të zhvendosur, cilësinë e jetës dhe perceptimin e tyre për qëndrueshmërinë e saj pas vendimit për kthim në Kosovë.

Mekanizmat kompetentë që kanë të bëjnë me kthimin në nivel lokal duket se nuk i përfillin siç duhet politikat e kthimit dhe ka mungesë të buxhetit të mjaftueshëm lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme të strehimit për të kthyerit. Personat e kthyer në Kosovë ballafaqohen edhe me probleme të tjera, përfshirë shkallën e lartë të papunësisë, mungesa e arsimit dhe mungesa e aftësive profesionale ua pamundëson atyre punësimin e rregullt.

154 Për të përgatitur këtë pjesë të raportit, përfaqësuesit e IAP-së mblodhën informacione në mbarë Kosovën dhe kanë biseduar me një numër bashkëbiseduesish vendorë (përfaqësues të komunitetit, qytetarë, OJQ vendore etj.) si dhe me organizatat ndërkombëtare: OSBE dhe UNHCR.

155 Ankesat e dorëzuara nga pjesëtarët e komuniteteve pakicë në IAP: 54 serbë, 26 turq, 11 goranë, 18 ashkalinj, 11 romë, 14 egjiptianë, 15 boshnjakë dhe 2 të tjerë, që është 13% r numrit total të ankesave të pranuar nga IAP-ja gjatë vitit 2021, ndërsa numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar në vitin 2021 ishte 673 nga 1612 ankesa të dorëzuara, dhe 45 raste ex officio janë hapur deri më 31.12.2021.

156 Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-së, nga janari deri në fund të nëntorit 2021, janë kthyer 244 serbë, 27 ashkalinj dhe egjiptianë dhe 35 romë.

157 Sipas të dhënave statistikore të UNHCR-së, deri në fund të nëntorit 2021, 139 persona kanë mbetur ende në qendrat kolektive në veri të Kosovës: 21 në veri të Mitrovicës, 71 në Leposaviç, 20 në Zubin Potok dhe 27 në Zveçan;

Disa familje të kthyerë rome, ashkalinjësh dhe egjiptiane nga Maqedonia e Veriut në Plemetin të Obiliqit vazhdojnë të ballafaqohen me probleme të shumta. Gjatë këtij viti, Avokati i Popullit është takuar me kryetarin e komunës së Obiliqit, i cili ka premtuar një zgjidhje të qëndrueshme familjeve të kthyerë dhe për këtë çështje Avokati i Popullit, me kryetarin e Komunës kanë takuar përfaqësuesit e fshatit Plemetin të të tri komuniteteve: shqiptar, serb dhe rom, të cilët kanë paraqitur shqetësimet e tyre. Këto shqetësime kryesisht kanë të bëjnë me faktin se procesi i kthimit nuk po përcillet me investime në përmirësimin e gjendjes së rëndë sociale, kushteve minimale për jetesë, strehimit të qëndrueshëm, punësimit, të sigurisë dhe probleme të tjera, me të cilat po ballafaqohet komuniteti pritës. Ishte konstatim i banorëve që kthimi i të zhvendosurve pa u përcjellë me investime nga autoritetet publike, po e vështirëson situatën dhe po e bën të papërbalueshme jetesën në këtë lokacion.

Avokati i Popullit vëren se të kthyerit nuk janë në dijeni të mekanizmave dhe procedurave ankimore në rast të diskriminimit të tyre në ofrimin e shërbimeve publike. Përfaqësuesit e Avokatit të Popullit gjatë punës në terren, në disa raste kanë informuar familjet e kthyerë lidhur me mundësitë e parashtrimit të ankesave të tilla sikurse në Ferizaj, Fushë Kosovë, Mitrovicë të Jugut etj.

Gjatë periudhës raportuese kanë ndodhur disa incidente, është regjistruar dëmtimi i monumenteve në varrezat ortodokse në Kishnicë, mbishkrime të grafitëve me përmbajtje të papërshtatshme, ngacmime verbale mbi baza nacionale. Me këtë rast duhet të vlerësojmë reagimin e shpejtë të policisë në zgjidhjen e incidenteve të caktuara, por gjithsesi është e nevojshme të rritet prezenca e policisë në vendet ku incidentet janë të shpeshta për të rritur besimin e komunitetit të prekur në punën e policisë, sigurinë dhe mbrojtjen e pasurisë dhe integritetit fizik të këtyre personave. Gjithashtu, Avokati i Popullit, si edhe në raportet e mëparshme, inkurajon Policinë e Kosovës që të rrisë kapacitetin në radhët e saj në mënyrë që të rritet besimi dhe të krijohet një ambient më i sigurt.

Bazuar në të dhënat që Avokati i Popullit ka pranuar nga Policia e Kosovës, gjatë vitit 2021 janë regjistruar 21 incidente të cilat si të tilla mund të cilësohen si incidente që mund të hyjnë në fushëveprimin e nenit 141 të KPP-së.<sup>158</sup> Ndërsa sipas misionit të OSBE-së në Kosovë janë regjistruar 148 incidente që lidhen me komunitetet pakicë, kryesisht në qytetet e të kthyerë dhe zonat rurale të banuara kryesisht nga serbët.<sup>159</sup> Megjithatë gjendja e sigurisë në Kosovë është stabile, incidentet që ndodhin kohë pas kohe në vendet e të kthyerë dhe zonat rurale të banuara nga pakicat ndikojnë negativisht në perceptimin e të kthyerë potencial në Kosovë, në radhë të parë të pjesëtarëve të komuniteteve serb dhe rom, gjë që reflektohet në vetë procesin e kthimit.

Avokati i Popullit vlerëson angazhimin e Policisë së Kosovës, e cila në vitin 2021, sipas informatave të tyre, ka mbajtur punëtori dhe trajnime të ndryshme nga Sektori për Bashkëpunim me Forumet e Sigurisë. Në nivel vendi ka mbajtur 156 takime me komunitetin lokal për Siguri Publike, ku vullnetarët e këtyre forumeve janë të të gjitha grupeve etnike që jetojnë në Kosovë dhe këto takime janë mbajtur nga stacionet policore në nivel lokal dhe temë e këtyre takimeve ishin: parandalimi, inicimi i zgjidhjes së problemeve, bashkëpunimi, vetëdijesimi etj. Gjithashtu, sipas Policisë së Kosovës, janë mbajtur takime me përfaqësues të OJQ-ve që merren me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, janë mbajtur takime informuese për konkursin për pranimin e zyrtarëve policorë me qëllim inkurajimin e kandidatëve për aplikim nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Për më tepër, sipas informatave të Policisë së Kosovës, janë mbajtur shtatë punëtori lidhur me temën: *“Parandalimi i Ekstremizmit dhe Radikalizmit të Dhunshëm që shpie në Terrorizëm*

158 Informacioni është dorëzuar nga Policia e Kosovës në IAP në mënyrë elektronike më 23 dhjetor 2021.

159 Informacioni i pranuar nga OSBE-ja, më 30 dhjetor 2021.

*përmes aktiviteteve parandaluese së Policimit në bashkësi*”, me anëtarë të Forumeve të Sigurisë. Gjithashtu Avokati i Popullit vlerëson faktin se Policia e Kosovës në muajin qershor 2021 ka publikuar udhëzuesin për trajtimin e krimeve të urrejtjes.<sup>160</sup>

Avokati i Popullit ka pranuar një ankesë nga disa të rinj të komunitetit ashkali nga Fushë Kosova, për përdorim joproporcional të forcës nga ana e policisë. Në përgjigjen e Policisë theksohet se nuk ka asnjë dëshmi për përdorimin eventual të forcës nga ana e zyrtarëve policorë dhe çështja është dërguar për hetime të mëtutjeshme në Inspektoratin Policor të Kosovës.<sup>161</sup>

### **Masat e autoriteteve publike për përmirësimin e respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të komuniteteve joshumicë**

Avokati i Popullit vlerëson vendimin e Qeverisë për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e fazës së dytë të prioriteteve politike të dakorduara ndërmjet BE-së dhe Republikës së Kosovës - Programi për Reforma Evropiane (ERA II AP).<sup>162</sup> Në kuadër të planit të veprimit të përmendur në pjesën që ka të bëjë me të drejtat dhe liritë themelore, është miratuar Strategjia për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre 2021-2025, është themeluar Grupi koordinues ndërministror për zgjidhje të qëndrueshme për personat e zhvendosur, është krijuar dhe është në funksion sistemi i menaxhimit të të dhënave lidhur me personat e zhvendosur dhe të kthyerit, është krijuar Komisioni Qendror i Ankesave, i cili parashikohet me Rregulloren Nr. 1/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme, ndërsa është parashikuar sigurimi i mbështetjes për afarizëm të grave të cilat u takojnë komuniteteve pakicë për zbatimin e të cilave është përgjegjëse MKK-ja dhe mbështetet nga UNHCR-ja.

Ministria për Komunitete dhe Kthim (MKK) vazhdon të ofrojë mbështetje për të gjithë të kthyerit në Kosovë, kështu që me partnerët e saj vendorë dhe ndërkombëtarë, deri në fund të vitit 2021 janë ndërtuar gjithsej 22 shtëpi, janë rinovuar 4, ndërsa në fazën përfundimtare janë shtëpitë për personat që kthehen nga vendet e zhvendosjes në komunat relevante për kthim dhe familjet që kanë nevojë për ndihmë për shkak të cenimit social.<sup>163</sup> Përveç realizimit të projekteve lidhur me kthimin, MKK-ja ka realizuar edhe 31 projekte në fushën e arsimit, kulturës, sportit, shëndetësisë dhe ngjarjeve fetare të rëndësishme për qytetarët.<sup>164</sup> Është e rëndësishme të theksohet se që nga viti 2020, MKK-ja, në bashkëpunim me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe në kuadër të programit të stabilizimit të komunitetit të financuar nga BE-ja, janë ndarë mjetet për nevojat e komuniteteve pakicë për të gjeneruar të ardhura dhe për të përmirësuar kushtet e jetesës. Nga viti 2020 deri në fund të vitit 2021 janë realizuar 156 projekte. Bazuar në informacionin në dispozicion, këto projekte janë dhënë me qëllim të realizimit të sigurimit të vendeve të punës të qëndrueshme ku përfitues të drejtpërdrejtë në 40% të projekteve kanë qenë gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe të kthyerit nga komunitetet pakicë, që gjatë vitit 2021 mund të vlerësohet si një zhvillim pozitiv dhe të mbështetet si një praktikë e mirë për vitin 2022.

Avokati i Popullit thekson angazhimin e Iniciativës ndërinstytucionale për personat e zhvendosur dhe refugjatët nga Kosova, e njohur më mirë si “Iniciativa e Shkupit”.<sup>165</sup> Avokati i Popullit i jep mbështetjen kësaj iniciative dhe në përputhje me mandatin e tij, ka marrë pjesë në dy takime ku grupet e punës për dokumentet personale dhe çështjet pronësore

160 Informatë e pranuar nga Policia e Kosovës përmes postës elektronike, më 23 dhjetor 2021.

161 Rasti A.nr.400/2021.

162 Vendimi nr. 03/24 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 08.11.2021.

163 Informatata e pranuar nga MKK-ja më 23 dhjetor 2021.

164 Po aty.

165 „Iniciativa e Shkupit“ funksionon në 5 grupe punuese për zbatim, përkatësisht për: 1. çështjet pronësore, 2. sigurinë, dialogun dhe integrimin, 3. dokumentet personale, 4. menaxhimin e të dhënave dhe 5. planifikimi dhe zgjidhjet e qëndrueshme.



shqyrtuan punën e deritanishme dhe dhanë udhëzime si të tejkalohen sfidat me të cilat përballen të kthyerit dhe personat e zhvendosur në periudhën e ardhshme.<sup>166</sup>

Avokati i Popullit me këtë rast thekson problemin e vazhdueshëm me marrjen e dokumenteve personale, me të cilin ende ballafaqohen të zhvendosurit nga Kosova. Personat e zhvendosur, edhe pse në kuadër të “Iniciativës së Shkupit” është krijuar mundësia e qasjes më të lehtë në procedurat administrative dhe marrjes së dokumenteve personale për personat e zhvendosur, ende në disa komuna të Kosovës nuk zbatohet Udhëzimi Administrativ në fuqi për njohjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës për personat të cilët kanë jetuar në Kosovë deri më 1 janar 1998 dhe kanë pasur nënshtetësi të ish-RSFJ-së dhe kanë banuar në territorin e Kosovës. Në disa komuna ende ekziston problemi i interpretimit selektiv të udhëzimit në fjalë dhe nuk mundësohet që të kthyerit ose/dhe personat e zhvendosur të ushtrojnë lirisht të drejtën e tyre për shtetësi dhe marrjen e dokumenteve personale të identifikimit.<sup>167</sup> Në disa komuna vërehet se ka vështirësi administrative në realizimin e të drejtave për nxjerrjen e dokumenteve personale, veçanërisht të shtetësisë.

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesat individuale të parashtruara kundër Drejtorisë për Shtetësi, Azil dhe Migrim e Ministrisë së Punëve të Brendshme të Kosovës, si dhe kundër Agjencisë së Regjistrimit Civil dhe shërbimit përkatës të gjendjes civile në komunat ku këta persona banojnë apo kanë lindur. Këto ankesa janë në shqyrtim dhe në hetim me autoritetet komE drejta në pronë është një nga të drejtat themelore të njeriut dhe si e tillë është e rregulluar me Kushtetutë dhe ligjet të Republikës së Kosovës. E drejta në pronën e paluajtshme i jep titullarit të drejta që ta përdorë lirisht pronën e tij, ta tjetërsojë atë dhe të përjashtojë të tjerët nga çdo ndërhyrje, ta ketë lirisht atë dhe me vullnetin e tij/saj të lirë.<sup>168</sup> Mirëpo, një numër i qytetarëve që u përkasin komuniteteve nuk mund ta gëzojnë këtë të drejtë pa pengesë apo lirisht të disponojnë me pasurinë e tyre të paluajtshme ngase ose nuk kanë qasje në të ose janë në procedura gjyqësore që zakonisht zgjasin shumë. Është fakt se në vitet e fundit ka pasur një progres në zgjidhjen e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat pronësore. Megjithatë, autoritetet duhet të sigurojnë që të gjithë personat, të disponojnë me pronën e tyre në përputhje të plotë me ligjin dhe t’i gëzojnë të drejtat e tyre duke iu garantuar mbrojtje gjyqësore dhe institucionale.

Gjendje e njëjtë është edhe për qytetarët shqiptarë që kanë prona në komunat në veri të Kosovës.

Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim, e cila zëvendësoi ish-Agjencinë Kosovare të Pronës, u ballafaqua me një numër të çështjeve pronësore të pazgjidhura dhe me paqartësi të Ligjit Themelor dhe çështjet e hapura lidhur me mandatin e Agjencisë për Krahasimin dhe Verifikimin e Pasurive (AKKVP). Avokati i Popullit ka dhënë rekomandimet e tij për ndryshime në Ligjin për Agjencinë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës dhe pret që këto rekomandime të zbatohen. Sipas informatave nga MKK-ja, mbeten edhe 500 lëndë të pazgjidhura pronësore, nga këto rreth 350 lëndë kanë vendim të formës së prerë, ndërsa 143 vendime për kompensim janë në proces të ekzekutimit (janë mbyllur 50 lëndë dhe janë siguruar mjete për lëndët tjera të zgjidhura).

166 Takimi i Grupit të Punës për Dokumentet Personale është mbajtur më 4 nëntor 2021, ndërsa mbledhja e Grupit të Punës për Çështje Pronësore është mbajtur më 16 nëntor 2021 (në takimin e grupit të punës për dokumentet personale kanë marrë pjesë edhe përfaqësues të IAP-së, ndërsa për takimin tjetër IAP-ja ka marrë informacion nga MKK-ja, si procesverbal i këtij takimi).

167 Qëndrim që ka dalë nga takimi i datës 15 dhjetor 2021.

168 Ligji nr. 03/L-154 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2643>

Kjo tregon se vazhdon të ekzistojë problemi i ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë, përfshirë këtu edhe Vendimin KI 132\15 e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

## E drejta në arsim

Avokati i Popullit vlerëson se, sikur edhe gjatë gjithë viteve të kaluara, polarizimi i sistemit arsimor është ende i pranishëm në Kosovë. Sistemi arsimor menaxhohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe atë në gjuhën shqipe, turke dhe boshnjake, ndërsa jashtë sistemit arsimor ende zhvillohet arsimi në gjuhën serbe për komunitetin serb, si dhe për disa qytetarë të komunitetit malazez, pjesërisht për pjesëtarët e komunitetit boshnjak (në veri të Kosovës), për një pjesë të caktuar të pjesëtarëve të komunitetit goran dhe kryesisht pjesëtarë të komunitetit rom.

Si pozitive mund të vlerësohet themelimi i Katedrës për Studime Ballkanike, në gjuhën shqipe dhe serbe, në Fakultetin Filologjik në Prishtinë. Sipas informatave që posedon IAP-ja, deri më tani është regjistruar vetëm 1 student nga komuniteti serb. Një zgjidhje e përkohshme kompromisi, së paku kur bëhet fjalë për kushtet për regjistrim në Katedrën e Studimeve Ballkanike dhe për aplikim dhe regjistrim në Akademinë Policore, ishte që ata që të përfundojnë arsimin e mesëm në një sistem tjetër të kenë mundësi prapë të kalojnë provimin e maturës sipas sistemit arsimor të Kosovës që t'u pranohet arsimimi i mesëm dhe t'u mundësohet regjistrimi. Ende nuk dihet nëse ministria kompetente ka ndërmarrë ndonjë iniciativë për zgjidhjen e përhershme të kësaj çështjeje, sepse kjo praktikë nuk mund të konsiderohet e qëndrueshme dhe e përhershme, sepse nuk zbatohet në të gjitha fakultetet e universitetit shtetëror.

Sikurse në vitet e shkuara, mbetet ende problematike çështja e përmirësimit të cilësisë së teksteve dhe manualeve ndihmëse për arsimin fillor dhe të mesëm në gjuhët e komuniteteve turk dhe boshnjak. Bazuar në informacionin e marrë nga grupi i autorëve të përzgjedhur në konkursin për tekste të reja në gjuhën turke dhe boshnjake, si për shkollat fillore ashtu edhe për ato të mesme, botimi dhe prezantimi i teksteve të reja nuk ka ndodhur deri në fund të vitit 2021.<sup>169</sup>

Edhe komuniteti goran si problem përmend polarizimin në arsim, gjegjësisht vijueshmërinë e një numri të fëmijëve në shkolla sipas sistemit paralel të Republikës së Serbisë, ndërsa pjesa tjetër e fëmijëve pjesëtarë të komunitetit goran vijnë arsimin sipas sistemit të Republikës së Kosovës, sipas plan programit në gjuhën boshnjake. Si në të gjitha vitet e mëparshme, problemi i mungesës së hapësirave për nxënësit mbetet i pazgjidhur, si dhe mungesa e nyjeve sanitare në disa shkolla (në fshatin Mlike nuk ka fare tualet), të cilat sipas mësuesve janë të rrënuara dhe jofunksionale, por mësimet ende zhvillohet në këto hapësira.

Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian ende ballafaqohen me vështirësi në ndjekjen e shkollimit. Mungon vetëdijesimi i këtyre komuniteteve përkitazi me rolin dhe rëndësinë që ka shkollimi i fëmijëve të tyre, e në anën tjetër shpeshherë varfëria me të cilën ballafaqohen këto komunitete vështirësojnë vijimin e rregullt të shkollimit.

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka vazhduar me ndarjen e bursave për nxënësit e shkollave të mesme të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian për vitin shkollor 2021/22. Në këtë thirrje, kanë aplikuar gjithsej 543 nxënës, ndërsa Komisioni vlerësues i MASHTI-t ka konstatuar se 500 prej tyre i kanë përmbushur kriteret e kërkuara të thirrjes dhe janë përfitues/e të kësaj mbështetjeje financiare në vlerë prej 300 euro për

<sup>169</sup> Ankesa e dorëzuar në IAP nga një grup autorësh të teksteve shkollore në gjuhën boshnjake dhe turke më 15.09.2021, A.nr. 532/2021

vit mësimor. Nga numri i përgjithshëm i përfutuesve 247 prej tyre janë vajza, dhe 253 janë djem.<sup>170</sup> Këtu nuk janë përfshirë nxënësit nga këto komunitete që ndjekin mësimet në shkolla fillore sipas sistemit paralel.

## E drejta në përdorim të gjuhës

Kushtetuta e Republikës së Kosovës si gjuhë zyrtare i njeh gjuhën shqipe dhe serbe, e që më tej është rregulluar me Ligjin për Përdorimin e Gjuhëve.<sup>171</sup> Avokati i Popullit konstaton se në përgjithësi autoritetet publike në Republikën e Kosovës respektojnë të drejtën në dygjuhësi në raportet e tyre individuale me pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, mirëpo vazhdojnë të evidentohen probleme në aplikimin e kësaj norme si nga autoritetet lokale ashtu edhe nga ato qendrore, sidomos në informatat e publikuar në portalet zyrtare të tyre.

Përkundër faktit se Zyra e Komisionarit për Gjuhët ka mandatin parësor për paraqitjen e ankesave në fushën e të drejtave gjuhësore, edhe në këtë vit IAP-ja ka pranuar një sërë ankesash lidhur me mosrespektimin e së drejtës së përdorimit të gjuhëve në Republikën e Kosovës.<sup>172</sup> Njëra nga ankesat i referojë pabarazisë në informimin e nxënësve dhe studentëve që studiojnë në gjuhën boshnjake kur është fjala për dhënien e bursave nga niveli qendror, ngase mungonte përkthimi në gjuhën e këtij komuniteti. Avokati i Popullit ka pranuar gjithashtu një ankesë lidhur me mungesën e përkthimit të formularit të aplikimit të Ministrisë së Financave në gjuhën serbe për të ndihmuar familjet që kanë humbur një nga anëtarët e tyre për shkak të COVID-19. Pas pranimit të ankesave lidhur me pohime të tilla, Avokati i Popullit e ka njoftuar edhe Komisionarin për Gjuhët, i cili paralelisht i ka regjistruar ankesat dhe ka punuar në zgjidhjen e çështjeve të cekura.<sup>173</sup>

## Komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian

Avokati i Popullit vëren se komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian vazhdojnë të përballen me vështirësi ekonomike e sociale. Gjendjen e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian e ka vështirësuar më shumë pandemia Covid-19, sepse anëtarët e këtyre komuniteteve përballen me qasje të kufizuar në ujë të pastër dhe kanalizime, pajisje mbrojtëse dhe kujdes shëndetësor, ndërsa qasja në arsim dhe punësim formal mbeten të vështira. Për më tepër, mundësitë e punësimit brenda institucioneve të Kosovës janë kryesisht në pozita pune të nivelin të ulët.<sup>174</sup>

Avokati i Popullit ka vazhduar të pranojë ankesa nga qytetarët e këtyre komuniteteve dhe nga numri i gjithmbarshëm i ankesave të pranuar, 11 (njëmbëdhjetë) janë ankesa nga komuniteti rom, 18 (tetëmbëdhjetë) ankesa nga komuniteti ashkali, dhe 14 (katërmëdhjetë) ankesa nga komuniteti egjiptian.

Gjithashtu, punësimi i komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian vazhdon të jetë ndër problemet më të mëdha me të cilin ballafaqohen këto komunitete. Edhe pse legjislacioni në Kosovë garanton mundësi të përfaqësimit të barabartë në institucione publike, një gjë e tillë nuk ndodh në praktikë. Për më tepër, Ligji nr.06/L-114 për Zyrat Publike përcakton: *“Në institucionet publike qendrore, minimum 10% e vendeve të punës në të gjitha kategoritë e zyrarëve publikë duhet të plotësohen nga pjesëtarët e komuniteteve, të cilat nuk janë*

170 Informatë zyrtare në faqen e Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit: <https://masht.rks-gov.net/article/500-nxenes-te-shkollave-te-mesme-te-larta-te-komuniteteve-rom-ashkali-dhe-egjiptian-kane-perfituar-bursa-nga-mashti>

171 <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2440>

172 A.nr.570/2021 A.nr. 593/2021, A.nr.698/2021, dhe ankesa të tjera të cilat, përveç pretendimeve të tjera për shkelje të të drejtave të njeriut, i referoheshin edhe mosrespektimit të të drejtave gjuhësore nga institucionet me rastin e dorëzimit të dosjeve gjyqësore, aktvendimeve të disa institucioneve publike, vendimeve etj.

173 Takimi me Komisionarin për Gjuhët në Zyrën e IAP-së në Graçanicë, më 29 tetor 2021.

174 Raporti i Progresit për Kosovën 2021, faqe 37, versioni në gjuhën angleze: [https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021\\_en](https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/kosovo-report-2021_en)

*shumicë në Kosovë dhe që përmbushin kriteret e pranimit, ndërsa në nivelin komunal, plotësimi i numrit të vendeve të punës për pjesëtarët e komuniteteve bëhet në pajtim me përqindjen e popullatës në atë komunë<sup>175</sup>, në disa institucione nuk është arritur kjo kuotë.*

Nga informatat e pranuar më 24 janar 2022 nga përfaqësuesi i Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratë bëhet e ditur që raporti për përfaqësimin e komuniteteve joshumicë në shërbimin civil të Kosovës për vitin 2021 është në proces të hartimit, por informatat në terren nuk flasin për një ndryshim pozitiv në këtë aspekt.

Lidhur me këtë, nga të dhënat e pranuar nga Policia e Kosovës del se në këtë institucion janë të punësuar 18 zyrtarë që i përkasin komunitetit ashkali, 13 janë romë dhe 7 egjiptianë, kurse si staf civil vetëm 1 zyrtar është i komunitetit ashkali dhe 1 është i komunitetit rom.<sup>176</sup>

Siç është përmendur tashmë, pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian kryesisht vetëpunësohen duke mbledhur gjësende dhe me punë sezonale, një numër i madh bën punë të rënda fizike për një kompensim të vogël monetar. Të ardhurat financiare dhe në përgjithësi situata materiale në komunitetet romë, ashkali dhe egjiptian u përkeqësuan edhe më shumë gjatë vitit 2021, për shkak të pandemisë COVID-19, që sipas informatave të Avokatit të Popullit shumë prej pjesëtarëve të këtyre komuniteteve humbën punën e tyre në sektorin joformal.

### **Strategjia dhe Plani i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rom dhe Ashkali (2017-2021)**

Strategjia për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë Kosovare 2017-2021 kryesisht është një udhëzues për politikat publike dhe programet në lidhje me arsimin, punësimin dhe mirëqenien sociale, shëndetësinë dhe banimin. Avokati i Popullit vëren se përkundër disa të arriturave rreth zbatimit të këtij dokumenti strategjik, ky dokument nuk është jetësuar ashtu siç ishte parashikuar. Një konstatim i tillë ka dalë edhe nga reagimet e shoqërisë civile, që merren me komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, e që kanë kritikuar Qeverinë e Republikës së Kosovës për moszbatim të këtij dokumenti.

Avokati i Popullit vlerëson se është me rëndësi nxjerrja dhe hartimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Komunitetet Rom dhe Ashkali në shoqëri kosovare, proces të cilin është duke e udhëhequr Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit sipas mandatit të saj<sup>177</sup>, në të cilën strategji duhen të merren parasysh të gjitha nevojat dhe kërkesat e komuniteteve në fjalë e të cilat objektiv duhet pasur përmirësimin e gjendjes së këtij komuniteti.

### **Grupi teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian**

Qeveria e Kosovës, duke e marrë me shumë përkushtim Deklaratën e Poznan-it, me vendim të Kryeministrit të Republikës së Kosovës ka themeluar grupin teknik për mbrojtjen nga diskriminimi të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Qëllimi i themelimit të grupit teknik të punës është përgjegjës për të zbatuar përgjegjësitë që dalin nga Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për Integrimin e Romëve në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian. Për këtë qëllim, ushtron kompetencat: bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për të adresuar ankesat nga pjesëtarët e komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian për diskriminim ndaj tyre, si dhe bën procedimin e këtyre rasteve tek institucionet kompetente; bashkëpunimi me institucionet përgjegjëse

<sup>175</sup> Ligji nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 9.

<sup>176</sup> Informatë e pranuar nga Policia e Kosovës nëpërmjet postës elektronike më 23 dhjetor 2021.

<sup>177</sup> Informatë e pranuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë/Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës, përmes postës elektronike, datë 21 dhjetor 2021.

për të siguruar mbështetjen ligjore për viktimat e pretenduara dhe identifikon skemat e diskriminimit, përfshirë diskriminimin institucional dhe të fshehur, në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë; realizon aktivitetet për vetëdijesimin e publikut për parandalimin e diskriminimit ndaj pjesëtarëve të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian.

Sipas informatave të pranuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2021 janë organizuar gjithsej 3 takime me Grupin Teknik, takimi i parë është organizuar me 18 maj 2021, takimi i dytë më 4 gusht 2021, kurse takimi i tretë është organizuar më 25 nëntor 2021.

Me qëllim të funksionalizimit dhe fuqizimit të kësaj Grupi Teknik janë hartuar dokumentet, si: rregullat e punës të Grupit Teknik punues për mbrojtjen nga diskriminimi për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, udhëzuesi për identifikimin dhe raportimin e rasteve të diskriminimit kundër komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian dhe procedura për vendosjen e të dhënave në kuadër të bazës së të dhënave të Zyrës për Qeverisje të Mirë /Zyra e Kryeministrit.

Më 14 prill 2021, përfaqësuesit e organizatave joqeveritare, sikurse OJQ Zëri i Romëve, Ashkalinjve dhe Egjiptasve, Balkan Sunflowers Kosova, Roma and Ashkali Documentation Center, Advancing Together, Bethany Christian Services, Syri i Vizionit, Kosovo Education Center, the Ideas Partnership dhe Terre des hommes, dërguan një shkresë zëvendëskryeminstres për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete, pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, sipas së cilës theksuan se romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët në përgjithësi janë të përjashtuar nga shoqëria; ata nuk kanë qasje në shërbime dhe mundësi ekonomike në krahasim me pjesën më të madhe të popullatës, madje edhe në krahasim me jo-romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët që jetojnë në afërsi të tyre; ata përballen me boshllëqe të mëdha në qasje në shërbime, mundësi ekonomike dhe mirëqenie në krahasim jo vetëm me popullsinë e përgjithshme në Ballkanin Perëndimor, por me jo-romët, ashkalinjtë dhe egjiptianët që jetojnë afër tyre; gjasat janë shumë më të ulëta që ata të ndjekin shkollën (përfshirë arsimin e detyrueshëm), të gëzojnë qasje në kujdesin shëndetësor, në ujë të pijshëm apo edhe në kanalizim dhe shumica e tyre jetojnë në vendbanime/banesa nën standard; gjasat janë shumë më të ulëta të marrin pjesë në tregun e punës dhe, nëse marrin pjesë në tregun e punës, mundësitë janë të pakta që do të punësohen, gjithashtu duke marrë parasysh pabarazinë e madhe gjinore; ata që janë të punësuar fitojnë shumë më pak dhe përballen me kthim më të ulët në arsim dhe një mundësi më të madhe për të pasur një punë joformale me të cilën nuk mund ta mbulojnë sigurimin shoqëror.

Gjithashtu, përfaqësuesit e disa organizatave joqeveritare theksuan se sipas Barometrit Ballkanik, qytetarët e Ballkanit Perëndimor (përfshirë Kosovën) besojnë se diskriminimi ndaj romëve dhe bashkësive të tjera etnike të stigmatizuara si ‘maxhup-cigan’ është i përhapur në rajon, ndërsa antigjipsizmi i rrënjosur thellë, i vazhdueshëm dhe strukturor dhe shpesh institucional dhe qeveritar vazhdon të ekzistojë në të gjitha nivelet e shoqërisë së Ballkanit Perëndimor dhe manifestohet çdo ditë dhe njihet si pengesë kryesore në arritjen e potencialit të plotë të romëve dhe të tjerëve që stigmatizohen si “maxhup – cigan” duke qenë qytetarë të Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht si qytetarë të Kosovës për të gëzuar plotësisht të drejtat themelore, përfshirjen sociale dhe barazinë, drejtësinë sociale në të gjitha sferat e jetës, përfshirë strehimin, arsimin, kujdesin shëndetësor dhe punësimin.

Ata i bëjnë thirrje Qeverisë së Republikës së Kosovës të paraqesë një propozim legjislativ dhe një dokument strategjik për barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, përfshirë këtu luftimin e antigjipsizmit, mbi bazën e një vlerësimi të plotë të ndikimit dhe në konsultimet sistematike me organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësuesit politikë të komuniteteve të lartpërmendura.

Duke marrë parasysh gjendjen e komuniteteve joshumicë në vend dhe në përgjithësi gjuhën e përdorur në komunikimin publik, Avokati i Popullit ka iniciuar një hulumtim sipas detyrës zyrtare, për gjuhën e urrëjtjes në mediat elektronike, televizion, radio, rrjete sociale, me qëllim që të ketë një pasqyrë të qartë për gjuhën që përdoret dhe ndikimi i saj në shoqërinë demokratike.



## V. Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës (MKP)

Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në seancën e pesëdhjetë e shtatë (57), me Rezolutën A/RES/57/199 më 18 dhjetor 2002,, miratoi Protokollin Fakultativ të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese. Ky protokoll hyri në fuqi më 22 qershor 2006.<sup>178</sup> Qëllimi kryesor i protokollit është krijimi i një sistemi të vizitave të rregullta, të cilat ndërmerren nga organe të pavarura ndërkombëtare dhe nacionale, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, me qëllim të parandalimit të torturës dhe të trajtimeve e ndëshkimeve të tjera mizore, jonjerëzore dhe poshtëruese.<sup>179</sup> Në harmoni me këtë Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili u publikua në Gazetën Zyrtare me 26 qershor 2015, në nenin 17, paragrafi 1, përcakton se Avokati i Popullit vepron si Mekanizëm Kombëtar për Parandalim të Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore, Jonjerëzore dhe Poshtëruese (tani e tutje, MKP).<sup>180</sup>

Vizitat e rregullta dhe pa paralajmërim në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë ndalimin policor,

178 Zyra e Komisionarit të Lartë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, në: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opcat.aspx>.

179 Neni 1 i Protokollit Fakultativ i Konventës Kundër Torturës.

180 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.2.





paraburgimin, qëndrimin në institucionet shëndetësore, ndalimin doganor, ndalimin në qendrat e emigracionit dhe në çdo vend tjetër kur dyshohet se ka shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut, janë detyra që MKP-ja është e obliguar t'i përmbushë.<sup>181</sup>

Ligji për Avokatin e Popullit përcakton se gjatë kryerjes së funksionit si MKP, Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë të drejtë qasjeje në informatat për gjendjen shëndetësore të personave të privuar nga liria, përfshirë këtu edhe qasjen në dosjet e tyre mjekësore, me pajtimin e tyre, si dhe në të dhënat personale të këtyre personave.<sup>182</sup> Zyrtarisht MKP-ja u themelua me vendimin e Avokatit të Popullit më 16 janar 2016.

## Metodologjia e vizitave e MKP-së

Metodologjia e vizitave e MKP-së konsiston në monitorim, dokumentim dhe në intervistim të personave të privuar nga liria, të zyrtarëve korrektues dhe policorë, si dhe të atyre shëndetësorë. Neni 17 i Ligjit për Avokatin e Popullit përcakton se MKP-ja kryen vizita, pa paralajmërim, në vendet ku mbahen personat e privuar nga liria. Kjo metodologji parasheh përgatitjen e vizitës, përcaktimin e llojit të vizitës, si dhe veprimet të cilat zbatohen me të arritur në institucionin i cili vizitohet.

Gjatë vizitave ekipi monitorues fokusohet kryesisht në shqetësimet më të rëndësishme, siç mund të jenë: marrëdhëniet ndërmjet personelit dhe të burgosurve, incidentet ndërmjet të burgosurve, kushtet e akomodimit, nëse kujdesi shëndetësor është adekuat, moszbatimi i garancive procedurale (qasja tek avokati, e drejta në shërbime mjekësore, kontaktet me familjen etj.).

181 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 2.

182 Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 17, paragrafi 4.

## Përbërja e MKP-së gjatë vitit 2021

Përbërja e tanishme e MKP-së është shumë disiplinore dhe në pajtim me dispozitat e Ligji nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, i cili parasheh që në kuadër të MKP-së duhet të ketë personel me profesione të ndryshme, përfshirë jurist, mjekë, psikologë dhe punëtorë socialë me përvojë në këtë fushë. Përbërja e tanishme e MKP-së është si në vijim:

- Zëvendësja e Avokatit të Popullit, përgjegjëse për MKP-në
- Drejtoresha e MKP-së
- Këshilltari i lartë juridik për parandalim të torturës
- Këshilltarja juridike për parandalim të torturës
- Këshilltare-mjeko
- Këshilltare-psikologe
- Këshilltare-punëtore sociale

## Vizitat e realizuara gjatë vitit 2021

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19 në mbarë botën, MKP-ja, herë pas here u detyrua të ndryshojë metodologjinë e vizitave duke iu përshtatur gjendjes me COVID-19 në vend, bazuar në parimin e mosshkaktimit të dëmit më të madh.

Kështu, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, ka realizuar 62 vizita në të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria e tyre. Nga to, 42 janë vizita të përgjithshme, 15 vizita *Ad Hoc*, 3 vizita përcjellëse dhe 1 vizitë në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës në kuadër të monitorimit të operacioneve të kthimit me forcë nga Zvicra, në kuadër të bashkëpunimit me Komisionin Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.

MKP-ja ka kontaktuar vazhdimisht me të burgosurit përmes numrave të telefonit të cilët janë të vendosur në të gjitha vendet e privimit nga liria (janë realizuar 80 telefonata me të burgosurit), përmes kutive të ankesave të vendosura nga Avokatit të Popullit (në të cilat kanë qasje vetëm personeli i autorizuar nga Avokati i Popullit), nëpërmjet familjarëve të të privuarëve nga liria si dhe nëpërmjet burimeve të tjera. Po ashtu, MKP-ja ishte në komunikim të vazhdueshëm me autoritetet kompetente nëpërmjet postës elektronike zyrtare, nëpërmjet telefonit, si dhe nëpërmjet kontakteve të drejtpërdrejta në raste të caktuara.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, përveç ekipit të MKP-së, vizita në vendet e privimit nga liria janë realizuar edhe zyrtarët nga zyrat rajonale të Avokatit të Popullit në Mitrovicë Veri dhe Jug, Pejë, Gjiilan, Ferizaj, Prizren dhe në stacionet policore të regjionit të Gjakovës. Gjatë vitit 2021, zyrtarët e zyrave rajonale, çdo muaj në mënyrë të rregullt hapën kutitë e ankesave, intervistuan të privuarit nga liria, me qëllim të trajtimit të ankesave individuale.

## Raportet me rekomandime të publikuara gjatë vitit 2021

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, ka publikuar 15 raporte me rekomandime pas vizitave të realizuara në vendet e privimit nga liria. Përmes këtyre raporteve, MKP-ja, u ka adresuar institucioneve kompetente 46 (dyzetegjashtë) rekomandime me qëllim të avancimit të të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.<sup>183</sup>

<sup>183</sup> Të gjitha raportet me rekomandime të publikuara në vitin 2021 gjenden në: <https://oik-rks.org/raportet/raporte-MKP-1/>.

Deri më tani, autoritetet kompetente implementuan 9 rekomandime, 2 rekomandime u implementuan pjesërisht, ndërsa 35 janë në pritje për implementim. Të gjitha përgjigjet e autoriteteve kompetente ishin pozitive dhe në frymën e bashkëpunimit të ndërsjellë, duke njohur domosdoshmërinë e zbatimit të rekomandimeve dhe vullnetit për të përmirësuar respektimin e të drejtave themelore të të privuarve nga liria e tyre.

Lidhur me vizitat e realizuara në vendet e privimit nga liria të cilat menaxhohen nga Policia e Kosovës, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka publikuar raportin me rekomandime për vizitat në stacionet policore në rejonin e Pejës,<sup>184</sup> dhe raportin me rekomandime për vizitat në stacionet policore në vijim: Gjilan, Lipjan, Prizren, Ferizaj, Shtime, Shtërpcë, Rahovec, Kamenicë, Viti, Suharekë, Malishevë, Mitrovicë dhe Vushtrri.

Sa i përket vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit, qendrën e mbajtjes për të huajt dhe qendrat për azilkërkues, MKP-ja, ka publikuar raportet me rekomandime si në vijim, për Qendrën Korrektuese në Dubravë, Qendrën Korrektuese Smrekonicë, Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe Femra në Lipjan, Qendrat e Paraburgimit në Pejë, Mitrovicë, Gjilan, Prishtinë, Prizren, Burgun e Sigurisë së Lartë, Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll si dhe Qendrat për Azilkërkues.<sup>185</sup>

## Bashkëpunimi me MKP-në i institucioneve të vizituara

Gjatë vizitave të MKP-së në institucionet ku mbahen personat e privuar nga liria, në institucionet e shëndetit mendor dhe në ato të kujdesit social, zyrtarët e institucioneve të vizituara i ofruan ekipit monitorues bashkëpunim të plotë dhe qasje të menjëhershme. Ekipi, pa vonesa, pati qasje në të gjitha hapësirat e vizituara. Ekipit iu siguruan të gjitha informatat e nevojshme për ta kryer detyrën dhe iu mundësuan intervistat me personat e arrestuar, të paraburgosur dhe të dënuar, pa praninë e zyrtarëve korrektues, të zyrtarëve policorë, apo të personelit mjekësor dhe as të personelit të institucioneve psikiatrike dhe të kujdesit social.

## Policia e Kosovës

### Keqtrajtimi fizik

Gjatë vizitave në vendet e privimit nga liria të menaxhuara nga Policia e Kosovës, MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e arrestuar dhe as nga ata të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitës, për keqtrajtimit fizik apo për mosrespektim të të drejtave themelore, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Po ashtu, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, gjatë vizitave në qendrat e paraburgimit dhe ato korrektuese, MKP-ja, nuk mori ankesa të besueshme nga të burgosurit për keqtrajtimit apo mos respektim të të drejtave themelore gjatë periudhës sa ata ishin të arrestuar apo të ndaluar nga Policia e Kosovës.

184 Raport me rekomandime për vizitat në stacionet policore në rejonin e Pejës (stacionet policore: Pejë, Klinë, Istog, Deçan), të realizuara më 24 dhe më 26 maj 2021, publikuar më 27 gusht 2021. Gjatë këtyre vizitave u vizituan Stacioni Policor në Pejë, në Deçan, në Istog dhe në Klinë. Për më shumë shih në: <https://oik-rks.org/2021/09/03/raport-me-rekomandime-i-MKP-se-per-vizitat-ne-stacionet-policore-ne-peje-istog-kline-dhe-decan/>

185 Të gjitha raportet me rekomandime të publikuara në vitin 2021 gjenden në: <https://oik-rks.org/raportet/raporte-MKP-1/>

Në vitin 2021, Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar 5 raste për hetim kundër Policisë së Kosovës bazuar në pretendimet e qytetarëve se janë keqtrajtuar fizikisht.<sup>186</sup>

Në përgjithësi, MKP-ja, bazuar në vizitat e realizuara gjatë këtij viti dhe në vizitat e mëhershme, shqyrtimin e ankesave të pranuar, si dhe hetimet sipas detyrës zyrtare, vlerëson se nuk ka keqtrajtim fizik sistematik apo të përhapur nga Policia e Kosovës, por bëhet fjalë për raste të izoluar.

Të drejtat e personave të arrestuar nga Policia e Kosovës janë të përcaktuara dhe të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Policinë dhe me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë, në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për t'i njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin që është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.

### **Kushtet fizike në stacionet policore të vizituara**

Procedura Standarde të Operimit (PSO), e cila u miratua nga Policia e Kosovës në tetor 2020, përcakton se qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhshmëri me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (më tej, *KEDNJ*) dhe me rekomandimet e KPT-së duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore Jonjerëzore dhe Poshtëruese.<sup>187</sup>

Sa u përket kushteve fizike në qendrat e mbajtjes në stacione policore, MKP-ja, gjatë vizitave të realizuara në vitin 2021, ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara, sa i përket hapësirës, ndriçimit natyral, artificial dhe higjienës i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të ndaluar.

Megjithatë, MKP-ja, gjatë vizitave ka vërejtur se në disa stacione policore, nuk ka ndryshime edhe pas rekomandimeve të dala nga vizitat e mëhershme, andaj MKP-ja përsërit rekomandimet për Stacionin Policor në Deçan, si dhe i ka njoftuar autoritetet kompetente për të gjeturat nga vizitat në Stacionet Policore në Malishevë, Prizren, Shtërpçë dhe Gjakovë<sup>188</sup>

186 Rasti 495/2021, ankuesi u ankua për keqtrajtim nga Policia e Kosovës, pas hetimit, u konstatua se ankesa e ankuesit është e pabazuar dhe u mbyll sipas nenit 22, para. 1, të Ligjit për Avokatin e Popullit. Rasti 311/2021, ankuesi u ankua për keqtrajtim nga Policia e Kosovës. MKP-ja u njoftua nga Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) se rasti është referuar tek Drejtoria për Hetime të Brendshme dhe Verifikim të së Kaluarës e Policisë së Kosovës për trajtim disiplinor, pasi IPK-ja gjatë hetimit nuk gjeti elemente të veprës penale. Rasti 196/2021, ankuesi u ankua për keqtrajtim nga Policia e Kosovës. IPK-ja e njoftoi MKP-në se rasti është proceduar me kallëzim penal në Prokurorinë Themelore. Rasti 100/21, ankuesi ankohet për keqtrajtim nga Policia e Kosovës. IPK-ja e njoftoi MKP-në se rasti i ankuesit është proceduar me raport të veçantë në Prokurorinë Themelore në Prizren. Rasti 24/21 OIK/PK, rast sipas detyrës zyrtare, lidhur me arrestimin e anëtarëve të Partisë Social Demokrate, të cilët janë arrestuar gjatë një proteste. MKP-ja, u njoftua nga IPK-ja, se ky rast është ende nën hetime. Po ashtu sipas IPK-së, lidhur me këtë rast është suspenduar një zyrtar, i cili ka menaxhuar me veprimet policore, ndaj të cilit njëkohësisht është iniciuar edhe procedura administrative për përgjegjësi komanduese.

187 Policia e Kosovës, Procedurat Standarde të Operimit për Qendrat e Ndalimit, DDO-04/0121/2016, pika 1.6, faqe 4.

188 Të gjitha raportet me rekomandime të publikuara në vitin 2021 gjenden në: <https://oik-rks.org/raportet/raporte-MKP-1/>

Në të gjitha stacionet e vizituara, MKP-ja ka vërejtur se të ndaluarit nuk furnizohen me mjete higjienike personale. Po ashtu, jo të gjitha qendrat e mbajtjes u sigurojnë të ndaluarve çarçafë për shtretër. MKP-ja, bazuar në këto gjetje i rekomandoi Policisë së Kosovës që të ndaluarit të furnizohen me mjete higjienike dhe çarçafë. Më 27 shtator 2021, Policia e Kosovës e njoftoi MKP-në se në shtator të ndaluarit janë furnizuar me mjete higjienike dhe çarçafë.

Sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët arrestohen apo ndalohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: Qendrat e mjekësisë familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e intervistuar për mosrespektim të kësaj të drejte. Po ashtu, nga dokumentacioni i shqyrtuar është vërejtur se policia ka evidentuar në dosjet e tyre personale njoftimin për të drejtën për të pasur shërbime mjekësore.

Përmes vizitave gjatë periudhës për të cilën po raportohet, por edhe gjatë vizitave të mëhershme, MKP-ja ka vërejtur se në asnjë qendër të ndalimit policor, të ndaluarve nuk u ofrohej dalja në ajër të pastër nëse qëndronin në ndalim më shumë se 24 orë. Në këtë drejtim, MKP-ja vëren se legjislacioni themelorë vendor nuk përmban dispozita të cilat u garantojnë të ndaluarve daljen në ajër të pastër nëse qëndrojnë në ndalim më gjatë se 24 orë.

Ndërsa, PSO, pika 1.13 (PROCEDURAT) përcakton që të ndaluarve të cilët qëndrojnë në ndalim më shumë se 24 orë duhet tu sigurohet dalje në ajër të pastër së paku një orë nëse kushtet infrastrukturore të Qendrës së Ndalimit e mundësojnë këtë. Përmes shkresave zyrtare të dërguara më herët pas pranimit të rekomandimit, Policia e Kosovës e ka njoftuar MKP-në se për shkak të infrastrukturës aktualisht nuk është në gjendje t’iu ofrojë të ndaluarve dalje në ajër të pastër.

Po ashtu, KPT-ja, në standardet e publikuara për ndalimin policor, thekson rëndësinë e daljes në ajër të pastër për personat të cilët qëndrojnë në ndalim policor më gjatë se 24 orë, sa herë që një gjë e tillë është e mundur.<sup>189</sup>

Sa i përket të drejtës për të parashtruar ankesë lidhur me trajtimin e tyre nga Policia e Kosovës, të arrestuarit kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në stacionin policor ku mbahen, si dhe në Inspektoratin Policor të Kosovës (më tej, IPK). Përveç kësaj, të arrestuarit mund t’i drejtojnë ankesë edhe Avokatit të Popullit. Për t’u ofruar qasje më të lehtë në shërbimet e këtij institucioni dhe për t’ua mundësuar të arrestuarve dhe ndaluarve parashtrimin e ankesës në mënyrë konfidenciale, Avokati i Popullit ka instaluar kuti të ankesave në stacionet policore ku ekzistojnë qelitë për mbajtjen e të arrestuarve.

Po ashtu, Avokati i Popullit ka zyrat regjionale në çdo qytet të Kosovës dhe zyrtarët regjionalë i vizitojnë rregullisht dhe pa paralajmërim stacionet policore, i hapin kutitë e ankesave dhe i trajtojnë ankesat individuale. Përveç kësaj, të gjitha stacionet policore mund të vizitohen pa paralajmërim edhe nga organizata joqeveritare, të cilat nënshkruajnë marrëveshje me Policinë e Kosovës për të monitoruar respektimin e të drejtave themelore të personave të arrestuar apo në ndalim policor.

<sup>189</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Standardet lidhur me ndalimin policor, Raport i Përgjithshëm i 12, paragrafi 47, Strasburg, 2002. Shih në: <https://rm.coe.int/16806cd1ed>.

## Qendrat korrektuese dhe të paraburgimit

### Kufizimi i të drejtave të caktuara të të burgosurve në kohë pandemie COVID-19

Edhe gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19, disa të drejta të të burgosurve të cilat garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. -04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (më tej, LESP), me ligjet e tjera në relevante dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, varësisht nga situata me COVID-19, u kufizuan dhe sërish u rikthyen pas përmirësimit të gjendjes me COVID-19. Këto të drejta në përgjithësi janë e drejta për kontaktet me botën jashtme, realizimi i vizitave familjare dhe i vizitave të lira, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme brenda burgjeve siç janë: të drejtat për aktivitete sportive, për punë, për trajnime dhe edukim.

Lidhur me kufizimet e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre, Avokati i Popullit, më 10 dhjetor 2021, publikoi raportin me rekomandime,<sup>190</sup> në të cilin konstatoi se paraqitja e pandemisë dhe shpallja e së njëjtës nga OBSH-ja si pandemi me përmasa globale, shtroi domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave konkrete nga Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të luftimit dhe parandalimit të COVID-19.

Mbrojtja e shëndetit publik është obligim i të gjitha autoriteteve kompetente dhe i qytetarëve të një vendi. Përmes këtij raporti, Avokati i Popullit, konstatoi se kufizimi i të drejtave dhe i lirive të caktuara të personave të privuar nga liria e tyre ishte i domosdoshëm, proporcional, i bazuar në ligjet vendore, në rekomandimet e institucioneve kompetente shëndetësore të vendit dhe në rekomandimet e OBSH-së, si dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare, të cilat monitorojnë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria e tyre.

Përmes raportit në fjalë, Avokati i Popullit u rekomandoi institucioneve kompetente si në vijim:

- Vendimet për kufizime të të drejtave të të burgosurve të kenë mbështetje dhe bazë ligjore në dispozitat e LESP-së dhe në Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese.
- Komunikimi i të burgosurve përmes SKYPE dhe mjeteve të tjera *online* duhet të rregullohet me akte konkrete juridike.
- Kontakti dhe komunikimi me avokatin mbrojtës të garantohet edhe në kohë pandemie dhe të sigurohet që ky kontakt të vazhdohet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

### Trajtimi

Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit në vitin 2021, MKP-ja nuk ka marrë ankesa të besueshme për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Në përgjithësi, MKP-ja ka vërejtur komunikim dhe raporte të mira ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues. Megjithatë, IAP përmes familjarëve dhe formave të tjera të parashtrimit të ankesave, gjatë periudhës për të cilën po raportojmë ka shqyrtuar 98 ankesa. Nga këto, 39 ankesa pas vlerësimit nga zyrtarët përgjegjës janë

<sup>190</sup> Raport me rekomandime i Avokatit të Popullit, Emergjencia shëndetësore dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës, publikuar më 10 dhjetor 2021, Të drejtat e personave të privuar nga liria dhe ndikimi i pandemisë COVID-19, nga këndvështrimi i MKP-së, Kapitulli VII, f. 57. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/12/10/raport-i-vecante-emergjenca-shendetesore-dhe-ndikimi-i-pandemise-covid-19-ne-te-drejtat-e-njeriut-ne-republiken-e-kosoves/>.

cilësuar si ankesa “brenda juridiksionit dhe kompetencës”, ndërsa 59 ankesa janë shpallur të papranueshme. Ndërsa, Ex.Officio-6 raste të hapura sipas detyrës zyrtare nga MKP-ja.

### **Ankesat për korrupsion dhe favorizime**

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë (më tej: QKD), MKP-ja, mori nga të burgosurit pohime për korrupsion dhe favorizime, që përfshijnë jo vetëm personelin korrektues, por edhe personelin shëndetësor. Sipas këtyre pohimeve, bazuar në një pagesë të caktuar të parave apo në ndonjë mënyrë tjetër, të burgosurit mund të përfitojnë trajtim favorizues sa u përket mundësive për të punuar, vizitave familjare, largim të përkohshëm jashtë institucionit, trajtim mjekësor etj. MKP-ja po ashtu mori një numër të pohimeve nga të burgosurit, sipas të cilëve, të burgosurit e caktuar të kategorive të caktuara trajtohen me favorizime krahasuar me të burgosurit e tjerë.

Lidhur me këto pretendime, MKP-ja, ka vërejtur përpjekje të Ministrisë së Drejtësisë dhe Shërbimit Korrektues për ti luftuar këto dukuri. Po ashtu, pati raste të arrestimeve dhe dënimeve ndaj zyrtarëve korrektues për të cilët u konstatua se kryen shkelje disiplinore apo kanë kryer vepra penale të cilat ndërlidhen me veprime korruptive.

Edhe përmes këtij raporti, MKP-ja, duke mos paragjykuar nëse pohimet e tilla janë të vërteta apo jo, konsideron se drejtoria e QKD-së dhe organet kompetente të Shërbimit Korrektues të Kosovës (më tej: ShKK) duhet të zhvillojnë hetime gjithëpërfshirëse dhe të pavarura sa herë që ka pohime për korrupsion dhe favorizime. Autoritetet në fjalë duhet t'i forcojnë përpjekjet e tyre për t'i luftuar këto fenomene përmes masave parandaluese, edukimit dhe aplikimit të sanksioneve adekuate.

### **Incidentet ndërmjet të burgosurve**

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, në përgjithësi nuk janë shënuar incidente serioze ndërmjet të burgosurve. MKP-ja gjatë vizitave dhe përmes komunikimit zyrtar me autoritetet kompetente ka vërejtur se këto incidente janë evidentuar në formularë përkatës, në dokumente të tjera administrative, si dhe në protokollet adekuate të njësive shëndetësore. Për më shumë, bazuar në njoftimet zyrtare dhe në dokumentacionin të cilin Institucioni i Avokatit të Popullit (më tej, IAP) e ka pranuar nga autoritetet, janë zhvilluar hetime të brendshme dhe hetime nga Policia e Kosovës në raste të caktuara, u ndërmorën masa disiplinore bazuar në gjetjet e komisioneve disiplinore, si dhe u ndërmorën masa për të garantuar sigurinë fizike të të burgosurve.

### **Kushtet e akomodimit në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit**

Neni 3 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale shprehimisht përcakton: *“Lokalet në të cilat jeton dhe punon personi i dënuar duhet të kenë hapësirë të mjaftueshme ashtu që secili person i dënuar të ketë së paku tetë (8) metra katrorë hapësirë për qeli të vetme dhe katër (4) metra katrorë për të dënuarit në qeli të përbashkëta, dhe sasi të mjaftueshme të dritës natyrore dhe artificiale për punë dhe lexim, ngrohje dhe ajrosje.”*

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për Femra (më tej: QKF) dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur (më tej, QKM) në Lipjan, MKP-ja, vërejti se qelitë ku akomodohen të burgosurat në QKF dhe të miturit të burgosur në QKM kanë ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial, si dhe nuk kanë lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, MKP-ja vërejti se hapësira në dispozicion është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Po ashtu MKP-ja gjatë vizitës nuk vërejti mbipopullim në këto dy qendra.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë<sup>191</sup>, MKP-ja ka vërejtur se numri i të burgosurve u reduktua dukshëm për shkak të pandemisë COVID-19. Kështu, gjatë vizitës ishin të pranishëm 572 të burgosur, ndërsa kapaciteti zyrtar i QKD-së është 1030. MKP-ja, ka vërejtur se kushtet e akomodimit në përgjithësi mund të konsiderohen në pajtim me LESP-në dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, përveç në pavijonet 2, 3 dhe 5, ku MKP-ja ka vërejtur se janë të nevojshme rinovime të caktuara, ndërsa në disa qeli kishte depërtuar lagështia.

MKP-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë kushteve të akomodimit të të burgosurve, të cilëve u ishte shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore. MKP-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit në këto qeli janë në pajtim me standardet e përcaktuara me LESP-ja dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja.

Në raportin për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë,<sup>192</sup> MKP-ja, sa i përket kushteve të akomodimit në këtë qendër ka vërejtur se qelitë, në kuptim të ndriçimit dhe ventilimit nuk janë në pajtim me LESP-në<sup>193</sup> dhe as me standardet e përcaktuar nga KPT-ja.<sup>194</sup>

Edhe përmes këtij raporti, MKP-ja, ka ripërsëritur rekomandimin që kushtet e akomodimit në QPP, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara në LESP; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

Lidhur me këtë rekomandim Ministria e Drejtësisë më 16 shtator 2021, e njoftoi MKP-në se planifikon të ndërtoj një objekt të ri për këtë institucion në një të ardhme jo shumë të largët dhe se kjo ministri synon të garantojë standardet minimale të parapara me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, standardet e KPT-së dhe instrumentet tjera ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Në raportin me rekomandime për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë<sup>195</sup> (më tej, *BSL*), MKP-ja, ka theksuar se, në përgjithësi kushtet e akomodimit, janë në nivel të kënaqshëm në shumicën e pavijoneve dhe hapësirave të tjera, në kuptim të hapësirës, pastërtisë, si dhe qasjes në dritë natyrale dhe artificiale. Të gjitha qelitë kanë TV, tualete të ndara dhe të burgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që duan. Përveç kësaj, qelitë janë të pajisura me krevate, me çarçafë, me tavolinë, me karrige dhe me sistem të thirrjes.

Në raportin me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë (më tej, *QKS*)<sup>196</sup>, MKP-ja vërejtë se në përgjithësi qelitë ku qëndronin të dënuarit, sa i përket madhësisë dhe ndriçimit natyral dhe artificial, në shumicën e qelive ku akomodohen të dënuarit, janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga KPT-ja<sup>197</sup> dhe LESP-ja.<sup>198</sup>

191 MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë, publikuar më 22 prill 2021. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/04/29/raport-me-rekomandime-i-MKP-se-per-viziten-ne-qendre-korrektuese-ne-dubrave/>.

192 MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, publikuar më 3 shtator 2021. Për më shumë shih në: <https://oik-rks.org/2021/09/04/raport-i-MKP-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-peje/>.

193 Ligji nr. 05/L0-129, neni 3 i Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale.

194 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Hapësira e Banimit për një të Burgosur, shih: <https://rm.coe.int/16806cc449>.

195 MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë, publikuar më 14 korrik 2021. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/07/28/raport-i-MKP-per-viziten-ne-burgun-e-sigurise-se-larte/>.

196 <https://oik-rks.org/2021/10/18/raporti-i-MKP-se-per-viziten-ne-qendren-korrektuese-ne-smrekonice/>

197 <https://rm.coe.int/16806cc449>

198 Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sankcioneve Penale, neni 36, paragrafi 2.



Përveç kësaj, pavijoni i cili deri më tani u përdor si karantinë pas paraqitjes së pandemisë COVID-19, tani është në dispozicion të të burgosurve për banim dhe do të ofrojë edhe më shumë hapësirë për banim për të burgosurit.

Në raportin për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë,<sup>199</sup> sa i përket kushteve të akomodimit, MKP-ja, ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë dritë të mjaftueshme natyrore, hapësirë banimi, e cila shkon përtej standardit të përcaktuar me LESP dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Po ashtu, MKP-ja, vërejtë se ka qeli adekuate në dispozicion të të burgosurve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, në disa qeli mungojnë orenditë adekuate për t'i vendosur gjësendet. Përmes raportit të lartpërmendur, MKP-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë, që të furnizohen qelitë e të burgosurve me orendi të nevojshme për t'i vendosur gjësendet e tyre. Ministria e Drejtësisë, u përgjigj se ShKK në dhjetor 2021, ka filluar procedurat për furnizime me ordeni dhe inventar të nevojshëm dhe se një rekomandim i tillë është edhe në raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2020.

Në raportin për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren,<sup>200</sup> MKP-ja, vërejtë se qelitë ku qëndronin të paraburgosurit kishin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial dhe nuk kishin lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, MKP-ja, sikurse edhe në raportin e mëhershëm me rekomandime, konstatoi se hapësira për banim, në disa qeli, nuk është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe as me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. MKP-ja ka vërejtur se jo të gjitha qelitë janë furnizuar me dyshekë të rinj. Kështu që, në disa qeli dyshekët janë të vjetërsuar dhe nuk janë ndërruar për kohë të gjatë dhe për pasojë, në disa shtretër ka depërtuar lagështia. Përmes raportit me rekomandime pas vizitës, MKP-ja, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që kjo qendër të furnizohet në tërësi me dyshekë të rinj dhe cilësorë. Ministria e Drejtësisë, lidhur me këtë rekomandim, përmes një shkrese zyrtare e njoftoi MKP-në, se në fund të muajit nëntor 2021, qendra u furnizua me 70 dyshekë, 70 jastëk, 140 batanije kundër zjarrit dhe se janë iniciuar procedurat për edhe 20 dyshekë tjerë për nevojat e kësaj qendre.

Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Gjiilan,<sup>201</sup> MKP-ja ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet e KPT-së, kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi dhe po ashtu kanë ngrohje adekuate dhe pastërti. Në qeli janë të vendosur nga një ose dy të burgosur. MKP-ja mori ankesa nga të burgosurit për shtretër të papërshtatshëm, pasi ishin të dizajnuar në dy kate dhe personat e vendosur sipër nuk kishin kufizim anash (nuk kishin mbrojtje) dhe ishin të lartë, disa prej tyre vendosnin dyshekun në dysheme. Nga të burgosurit e akomoduar në katet më të larta, MKP-ja mori ankesa për mungesë të shtypjes së ujit dhe të ujit të ngrohtë.

Në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë<sup>202</sup>, kushtet e akomodimit, në përgjithësi ishin të pranueshme, përveç në raste të caktuara, në kuptim të hapësirës për banim për një të burgosur, ku kushtet e akomodimit nuk janë në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me standardet e KPT-së.

Përmes raportit me rekomandime për vizitën në këtë qendër, MKP-ja, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që përderisa kjo qendër është në përdorim të burgosurve duhet t'u garantohen kushtet e akomodimit, ndërsa Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e dërguar

199 <https://oik-rks.org/2021/12/06/raporti-i-MKP-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prishtine/>

200 <https://oik-rks.org/2021/12/06/raporti-MKP-es-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-prizren/>

201 <https://oik-rks.org/2021/12/16/raporti-i-MKP-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-gjilan/>

202 MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, publikuar më 18 tetor 2021. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/10/18/raport-i-MKP-se-per-viziten-ne-qendren-e-paraburgimit-ne-mitrovice/>.

lidhur me këtë rekomandim theksoi se po përgatitet projekti i kondicionimit së bashku me donatorë të organizuar nga OJQ-të për vitin 2022.

## Mbipopullimi

Në asnjë qendër të paraburgimit dhe korrektuese nuk është vërejtur mbipopullim. MKP-ja, mirëpret zvogëlimin e dukshëm të numrit të të burgosurve në QKD.

## Regjimi

Me qëllim të risocializimit të të burgosurve, LESP-ja dhe Kodi i Procedurës Penale<sup>203</sup>, si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, shprehimisht përcaktojnë obligimin e autoriteteve kompetente që të burgosurit t'i angazhojnë në punë, në aktivitete kulturore, arsimore dhe sportive.<sup>204</sup>

Gjatë vizitës në QKD, MKP-ja, bazuar në dokumentacionin relevant, ka vërejtur se janë rreth 262 të burgosur të angazhuar në punë. Angazhimi në punë është më i madh gjatë stinës së verës. Zakonisht të dënuarit angazhohen për punë në kuzhinë, për pastrim dhe në ferma të QKD-së. Në kuadër të QKD-së funksionon edhe shkolla e mesme, në të cilën mësimin e vijnë 35 nxënës në tri klasa. Të dënuarit mund të lëviznin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur dhe kanë të drejtë në 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit, deri në 2 orë në ditë.

Sa i përket regjimit, në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, gjatë vizitës së realizuar u vërejt se rreth 16 të dënuar janë të angazhuar në punë. Në kuadër të kësaj qendre funksiononin pesë punëtori, në të cilat të dënuarit mund të angazhohen në punë dhe në trajnime të ndryshme. Të dënuarit kanë të drejtë në së paku 2 orë shëtitje në ditë. Në dispozicion të të burgosurve janë edhe biblioteka, shëtitoret dhe salla e fitnesit. Të paraburgosurit nuk angazhohen në punë pasi angazhimi në punë dhe në aktivitetet e tjera është subjekt i lejes nga gjykata kompetente. MKP-ja mori ankesa nga të paraburgosurit, të cilët, sipas pohimeve të tyre dhe të drejtorit, kalojnë shumicën e kohës në qelitë e tyre (rreth 22 orë).

Sa i përket regjimit në Burgun e Sigurisë së Lartë, gjatë vizitave të realizuara në vitin 2021, MKP-ja vërejt se rreth 70% e të burgosurve janë të angazhuar në punë të ndryshme, siç është mirëmbajtja, pastrimi i pavijoneve, puna në kuzhinë, në punëtorinë për prodhim të letrës higjienike dhe të qeseve, nga ku furnizohen edhe institucionet e tjera të ShKK-së.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese për Femra, MKP-ja, vërejt se shumica e të dënuarave angazhohen në punë në furrë, kuzhinë, pastrim, ndërsa gjatë stinës së verës në kopshte dhe në serrën e qendrës. Kurse, të paraburgosurat janë shumë pak të angazhuara në punë dhe aktivitete të tjera pasi që angazhimi i tyre është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.

Në këtë drejtim, MKP-ja, vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, në paragrafin 45 të raportit, ndër të tjera u rekomandon autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës që të ndërmarrin veprime me prioritet për të ofruar dhe zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë për të gjithë të të dënuarit (punë, edukim, sport, rekreacion etj.). Më tej, në këtë raport theksohet se vëmendje e veçantë duhet tu kushtohet të burgosurve me dënime afatgjata.<sup>205</sup>

Sa i përket regjimit për të miturit në QKM, MKP-ja, ka vërejtur se atyre, përveç ajrimit ditorë, u ofrohet një regjim gjithëpërfshirës duke përfshirë shkollim, trajnime për fusha të ndryshme, punë, si dhe aktivitete sportive dhe rekreative. Në QKM ishin katër të mitur që

<sup>203</sup> Kodi i Procedurës Penale, neni 199, paragrafi 2, dhe neni 200.

<sup>204</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 55, si dhe neni 200, paragrafi 1.

<sup>205</sup> Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës, Raporti për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, publikuar në vitin 2016.

do duhej t'i ndiqnin mësimet në nivelin fillorë, ndërsa dy nga ta nuk e kanë mbaruar as klasën e parë fillore dhe nuk dinin shkrim dhe lexim.

### **Regjimi për të paraburgosurit**

Megjithatë, për MKP-në, edhe për këtë periudhë të raportimit, mbetet shqetësues regjimi që u ofrohet të paraburgosurve në të gjitha qendrat e paraburgimit. MKP-ja, ka vërejtur se shumica e të paraburgosurve, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të qendrave të paraburgimit, shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qelita të tyre, për shkak të infrastrukturës (Qendra e paraburgimit në Prizren dhe ajo në Pejë dhe pjesërisht ajo në Mitrovicë) dhe për shkak se angazhimi i tyre në aktivitetet jashtë qelisë është subjekt i lejes së gjykatës kompetente.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, në të gjitha raportet me rekomandime pas vizitave në qendrat e paraburgimit, ka konsideruar se bazuar në legjislacionin në fuqi, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që t'i rrisin angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur dhe deri në shkallën sa nuk pengohet procedura penale.

Sa i përket të drejtës për dalje në ajër të pastër, në përgjithësi në të gjitha qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit, kjo e drejtë u realizua pa kufizime, në pajtim me LESP,<sup>206</sup> përveç në raste kur kishte dyshime se i burgosuri mund të jetë i infektuar me COVID-19, ku dalja në ajër të pastër u reduktua në një orë.

### **Kontaktet me botën e jashtme**

Legjislacioni në fuqi,<sup>207</sup> në rastin e personave të dënuar, përcakton se të burgosurit e dënuar kanë të drejtë të pakufizuar për korrespondencë (që u nënshtrohen përjashtimeve të caktuara), kanë të drejtë për një vizitë në muaj, e cila zgjat minimum një orë, si dhe në vizitë nga fëmijët dhe bashkëshortet e tyre, së paku një herë në 3 muaj, me kohëzgjatje minimale prej tri orësh. Përveç kësaj, ata kanë të drejtë për të bërë telefonata.

Lidhur me telefonatat, Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese<sup>208</sup> përcakton se i dënuari ka të drejtë në biseda telefonike me anëtarët e familjes së ngushtë dhe me personat e tjerë. Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit, MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë nga të paraburgosurit dhe as nga të dënuarit lidhur me

Avokati i Popullit ose përfaqësuesit e tij mund t'i vizitojnë të paraburgosurit dhe të korrespondojnë me ta, pa paralajmërim paraprak dhe pa mbikëqyrjen e gjyqtarit të procedurës paraprake, as të gjyqtarit të vetëm gjykues apo kryetarit të trupit gjykues ose personave të tjerë të emëruar nga gjyqtari i tillë. Letrat e të paraburgosurit dërguar Institucionit të Avokatit të Popullit nuk mund të kontrollohen. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij mund të komunikojnë gojarisht ose me shkrim në mënyrë konfidenciale me të paraburgosurit.

Në rastin e shtetasve të huaj, atyre u ofrohet mundësia që me shkrim ose me gojë të kontaktojnë me përfaqësinë diplomatike apo me zyrën përkatëse të shtetit, shtetësinë e të cilit e ka ai.<sup>209</sup> Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19 ShKK-ja kohë pas kohe u detyrua t'i ndalonte vizitat familjare, vizitat e lira,

<sup>206</sup> Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 37.

<sup>207</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, nenet 62-65.

<sup>208</sup> Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 54.

<sup>209</sup> Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 33, paragrafi 1.

takimet me avokatët mbrojtës dhe kontakte të tjera me botën e jashtme. Ndërsa kufizimi i së drejtës për kontakte me botën e jashtme u kompensua përmes ofrimit të llojeve të tjera të komunikimit (SKYPE, shtimit të telefonatave). Pas përmirësimit të gjendjes, këto të drejta u rikthyen sërish dhe të burgosurit i gëzuan plotësisht ose pjesërisht.

Në këtë drejtim, MKP-ja, rithekson se e drejta për të kontaktuar me avokatin mbrojtës është e drejtë themelore e personit të privuar nga liria e tij, e garantuar me Kushtetutën e vendit, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të njeriut. Prandaj autoritetet kompetente edhe në kohë pandemie duhet të sigurojnë që ky kontakt të vazhdohet në mënyrë të sigurt dhe konfidenciale.

### **Kujdesi shëndetësor në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit**

Neni 4 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton të drejtën e personit të dënuar që t'i gëzojë të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor, të cilat janë në dispozicion në komunitet. Personi i dënuar ka qasje në shërbimet e nevojshme shëndetësore pa pagesë.

Numri i personeli mjekësorë në të gjitha nivelet, në përgjithësi ishte adekuat në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit. Të burgosurit dërgohen edhe në institucionet tjera publike shëndetësore sipas rekomandimit të mjekut kompetent.

Hapësirat në të cilat ofrohen shërbimet mjekësore, në përgjithësi janë në nivel të kënaqshëm, përveç në Qendrën e Paraburgimit në Pejë dhe Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë. Gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë, MKP-ja, ka vërejtur se hapësira ku ofrohen shërbimet mjekësore nuk është adekuate për ofrim të shërbimeve mjekësore dhe nuk mbron konfidencialitetin e shërbimeve mjekësore. Ministria e Drejtësisë, e njoftoi MKP-në përmes një shkresë zyrtare se është në dijeni për mungesë të dukshme të hapësirës në këtë qendër dhe se po planifikon renovime në shkallë të gjerë për të evituar këto mangësi.

### **Ankesat lidhur me trajtimin mjekësor**

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, mori ankesa nga të burgosurit sa i përket trajtimit mjekësorë në qendrat korrektuese dhe të paraburgimit. Disa nga këto ankesa u regjistruan për hetim të mëtejshëm. MKP-ja, në të gjitha rastet përveç vizitave, kërkoi nga Drejtoria Shëndetësore e Burgjeve (DShB), raporte të hollësishme për trajtimin shëndetësorë të ankuesve në fjalë. Në asnjërin rast, MKP-ja, nuk konstatoi shkelje serioze të të drejtës për trajtim shëndetësorë, përveç disa rasteve kur për shkak të transportit i burgosuri nuk u dërgua menjëherë në trajtim mjekësor sipas rekomandimit të mjekut. MKP-ja gjatë vitit që po raportojmë, në vazhdimësi është njoftuar nga DShB për rastet e lëndimeve dhe vetëlëndime, çofshin raste që në pranim kanë pasur lëndime, raste të lëndimeve që i kanë shkaktuar njeri-tjetrit ose lëndime të shkaktuara nga oficeret korrektues. Të gjitha këto raste janë analizuar nga mjeku i MKP-së dhe bazuar në faktet e ofruara dhe dosjet e shikuara ka dhënë rekomandime për 17 raste.

### **Prezenca e të burgosurve me sëmundje mendore në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit**

Prezenca e të burgosurve me sëmundje mendore vazhdon të jetë sfidë për qendrat e paraburgimit dhe për ato korrektuese, për shkak të mungesës së kapaciteteve për t'i akomoduar të burgosurit e kësaj kategorie në institucione përkatëse shëndetësore. Edhe gjatë vizitave të realizuara në vitin 2021, MKP-ja ka vërejtur se për shkak të pamundësisë për ti akomoduar në institucione përkatëse sipas rekomandimit të mjekut kompetent, të

burgosurit me probleme serioze mendore vazhdojnë të mbahen në qendra të paraburgimit dhe ato korrektuese.

Në këtë drejtim, MKP-ja vëren se neni 43 i Ligjit nr. 05/L-129 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale përcakton: *“Personi i dënuar të cilit nuk mund t’i ofrohet trajtim i duhur mjekësor në institucionin korrektues dërgohet në spitalin e institucionit korrektues, në institucionin psikiatrik adekuat, ose në ndonjë institucion tjetër për përkujdesje shëndetësore.”*

MKP-ja me keqardhje vëren se më 19 gusht 2021, në QPP një i burgosur me probleme të shëndetit mendor kreu vetëvrasje. Më 3 korrik 2021, Gjykata Themelore në Prishtinë vendosi që të burgosurit (tani të ndjerit) t’i caktohej masa e paraburgimit dhe që paraburgimi të mbahej në Institutin e Psikiatrisë Forenzike. Për shkak të mungesës së vendeve të lira në IPFK, i burgosuri u akomodua në QPP, ku iu bë vlerësimi psikologjik dhe iu dha terapia psikiatrike sipas rekomandimit.

MKP-ja konsideron se çdo vdekje e të burgosurve duhet të jetë subjekt i hetimit të hollësishëm nga autoritetet për të konstatuar, ndër të tjera, shkakun e vdekjes, përfshirë faktorët kontribuues, si dhe nëse vdekja ka mundur të evitohet. MKP-ja mirëpret faktin që gjatë vizitës në QPP pas lajmit për vdekjen e të burgosurit, ka vërejtur se të gjitha autoritetet kompetente menjëherë filluan hetimet bazuar në mandatin që kanë.

MKP-ja, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, organizuan tryeza të rrumbullakëta dhe konferenca ku së bashku me autoritetet kompetente u diskutuan sfidat e trajtimit të të burgosurve me probleme të shëndetit mendor, si dhe sfidat tjera rreth trajtimit të detyrueshëm psikiatrik.

Gjatë këtyre takimeve, të pranishmit u pajtuan se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprime adekuate për t’i trajtuar të burgosurit e kësaj kategorie në pajtim me legjislacionin vendor dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve. Ministritë kompetente, gjatë këtyre takimeve, prezantuan edhe planet e tyre për të gjetur zgjidhje adekuate për këtë kategori të burgosurish.

## Kontrollet mjekësore për të sapopranuarit

KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2015, ka theksuar rëndësinë esenciale që kanë kontrollet mjekësore, sidomos në rastet e të burgosurve apo të të paraburgosurve të sapo pranuar jo vetëm për identifikimin e sëmundjeve infektive dhe parandalimin e vetëvrasjeve, por edhe nëpërmjet kontributit i cili jepet në aspektin e parandalimit të torturës përmes evidentimit të duhur të lëndimeve.<sup>210</sup>

LESP-ja<sup>211</sup> dhe Praktika Standarde e Veprimit (më tej PSV)<sup>212</sup> e DShB-së përcaktojnë obligimin që i burgosuri i sapo pranuar t’i nënshtrohet kontrollimit mjekësor brenda 24 orëve nga momenti i pranimit. Obligime të tilla përcaktohen edhe me aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve, siç janë: Rregullat e Mandelës,<sup>213</sup> Rregullat

210 KPT, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2015, publikuar në vitin 2016, paragrafi 62. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>

211 Ligji nr. 04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 31.

212 Praktika Standarde e Veprimit, pika 1. Shih në: <https://msh.rks.gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

213 Rregullat e Mandelës, Rregulli 34. Shih në: [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/GA-RESOLUTION/E_ebook.pdf)

Evropiane të Burgjeve, etj.<sup>214</sup> MKP-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, bazuar në vizitat e realizuara dhe në raportet e dërguara nga DShB-ja, ka vërejtur se të gjithë të burgosurve të sapo pranuar u bëhen kontrollet mjekësore brenda 24 orëve nga momenti i pranimit.

### **Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore**

Konfidencialiteti i shërbimeve mjekësore parashihet me PSV-në,<sup>215</sup> e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, me LESP-në<sup>216</sup> dhe me Udhëzimin Administrativ për Rendin Shtëpiak në Qendra Korrektuese,<sup>217</sup> si dhe me aktet relevante ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.<sup>218</sup> Edhe gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportohet, MKP-ja, bazuar në intervistat e zhvilluara me të burgosurit dhe me personelin shëndetësor, vëren se në përgjithësi këto shërbime shëndetësore jepen nën kushte të cilat respektojnë konfidencialitetin, respektivisht jepen pa praninë e zyrtarëve korrektues, përveç në rastet kur prania e tyre kërkohet nga mjeku. Ndërsa në dosjen mjekësore të të burgosurit ka qasje vetëm personeli shëndetësor.

### **Personeli i qendrave korrektuese dhe të paraburgimit**

Edhe gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja vëren se në disa qendra korrektuese dhe të paraburgimit evidentohet mungesë e personelit korrektues dhe punëtorëve social. Po ashtu moshë mesatare dhe sëmundjet e ndryshme tek disa zyrtarë korrektues raportohen si problem për ShKK-në. Pavarësisht shpalljes së konkurseve për rekrutim të personelit korrektues nuk janë vërejtë ndryshime konkrete në këtë drejtim deri më tani.

Po ashtu, MKP-ja, gjatë vizitave, vërejtë frustrimet në rritje të zyrtarëve korrektues për shkak të kushteve të punës, prezencës në qendra të paraburgimit dhe ato korrektuese të të burgosurve me probleme mendore (të cilët bazuar në rekomandimet e mjekut do të duhej të trajtoheshin në institucione adekuate shëndetësore), pagave të vogla, si dhe mungesës së uniformave dhe pajisjeve tjera të cilat sipas pohimeve të tyre nuk furnizohen që disa vite.

MKP-ja konsideron se mënyra se si personeli e percepton kualitetin e jetës në punë dhe mënyra se si ata trajtohen nga stafi udhëheqës dhe kolegët e tyre ka një ndikim të rëndësishëm në atmosferën në burg dhe në trajtimin e të burgosurve. Zyrtarët korrektues, të cilët ndihen të vlerësuar, të besueshëm dhe të respektuar në vendin e tyre të punës, kanë gjasa më të mëdha që këto vlera t'i zbatojnë edhe në trajtimin e të burgosurve. Kushtet e favorshme të punës në burg po ashtu janë të rëndësishme për të tërhequr dhe mbajtur personelin e duhur në burg.

Standardet ndërkombëtare në këtë aspekt janë të qarta dhe përcaktojnë se personeli në burgje duhet të emërohet me orar të plotë të punës, të kenë status civil, të kenë paga adekuate dhe benefite të favorshme të punësimit dhe kushte adekuate për të kryer shërbimin e tyre. Pagat e ulëta, kushtet jo adekuate të punës dhe mungesa e benefiteve tjera të cilat janë të nevojshme për të stimuluar punën adekuate në ambiente siç janë burgjet mund të kenë ndikim negativ në motivimin dhe kryerjen e detyrave nga personeli i angazhuar në punë në burgje. Përveç kësaj një situatë e tillë mund të nxisë korrupsionin në burgje.

214 Këshilli i Evropës, Rekomandimi (2006) 2 i Këshillit të Ministrave për Shtetet Anëtare mbi Rregullat Evropiane të Burgjeve, pika 42.1. Shih në: <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016804c221d>

215 Praktika Standarde e Veprimit, pika 11. Shih në: <https://msh.rks-gov.net/wp-content/uploads/2013/11/1.-Praktikat-Standarde-te-Veprimit-n%C3%AB-DShB.pdf>

216 Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, neni 49

217 Udhëzimi Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese, neni 25, paragrafi 3.

218 Rregullat e Mandelës, Rregullat Evropiane të Burgjeve, Standardet e KPT-së, dhe Rregullat e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Miturve të Privuar nga Liria.

Edhe në vitin 2021, qendrat korrektuese dhe burgjet u përballën me ngarkesë shtesë për shkak se disa zyrtarë korrektues u infektuan me COVID-19, por edhe për shkak të angazhimeve shtesë gjë të cilën e shkaktoi kjo pandemi.

## Qendrat për Azilkërkues

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet MKP-ja ka vizituar Qendrat për Azilkërkues në Magurë, Vranidoll dhe Mitrovicë.<sup>219</sup> Qëllimi i vizitave në qendrat e lartpërmendura për akomodim të azilkërkuesve ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të azilkërkuesve nga autoritetet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Qendra për Azilkërkues në Mitrovicë pas shpërthimit të zjarrit në një pjesë të saj u mbyll, ndërsa azilkërkuesit u transferuan në qendrën për azilkërkues në Vranidoll.

Gjatë vizitave të realizuara, MKP-ja ka evidentuar se në Qendrën për Azilkërkues në Magurë ishin të vendosur 57 azilkërkues, në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë ishin 55 azilkërkues, ndërsa në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll ishin 61.

Të gjithë azilkërkuesit kanë deklaruar se kanë trajtim të mirë dhe human nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur komunikim shumë miqësor dhe interaktiv ndërmjet azilkërkuesve dhe zyrtarëve policorë dhe atyre të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

MKP-ja, gjatë intervistave grupore dhe individuale, nuk mori asnjë ankesë nga azilkërkuesit sa i përket së drejtës për t'i ushtruar ritet fetare në qendër në formë individuale apo grupore. Megjithatë, ka pranuar dhe hetuar dy ankesa të personave që kërkonin mbrojtje ndërkombëtare.<sup>220</sup>

Sa i përket shërbimeve mjekësore, ato ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare më e afërt dhe nga Qendra Klinike Universitare e Kosovës. MKP-ja nuk ka pranuar ankesa nga azilkërkuesit sa u përket shërbimeve mjekësore, përkundrazi azilkërkuesit kanë pohuar se shërbimet e nevojshme u jepen në afat sa më të shpejtë.

## Qendra e Mbjajtjes për të Huajt

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, realizoi një vizitë të përgjithshme në Qendrën e Mbjajtjes për të Huajt (më tej, QMH) në Vranidoll.<sup>221</sup> Në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, paraburgimi (dërgimi i të huajit në mbajtje) duhet të jetë masa e fundit të cilën e zbatojnë autoritetet e një shteti për ta larguar të huajin nga territori, i cili është subjekt i kthimit me forcë. MKP-ja vëren se Ligji 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës parasheh se masat e tjera alternative kanë përparësi në raport me dërgimin e të huajit në mbajtje.

219 Raport me rekomandime për vizitat në Qendrat për Azilkërkues në Magurë, Mitrovicë dhe Vranidoll, publikuar më 23 shkurt 2021. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/02/23/raport-i-mekanizmit-kombetar-per-parandalimin-e-tortures-per-vizitat-ne-qendrat-e-azilkerkuesve/>.

220 Rasti Anr.141/2021 U.Y kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe. Rasti Anr.733/2020 M.K kundër Ministrisë së Punëve të Brendshme, të cilat raste kanë përfunduar dhe Avokati i Popullit ka ndërprerë hetimet pasi rastet janë zgjidhur në pajtim me kërkesën e ankuesit.

221 MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Qendrën e Mbjajtjes për të Huajt në Vranidoll, publikuar më 14 prill 2021. Shih në: <https://oik-rks.org/2021/04/29/raport-i-MKP-per-viziten-ne-qendren-e-mbjajtjes-per-te-huajt-ne-vranidoll/>.

Po ashtu, KPT-ja, në standardet e përcaktuara në vitin 2017, përcakton se paraburgimi i të huajit sipas ligjit për të huajt duhet të jetë masë e fundit dhe se masave të tjera alternative duhet t'u jepet epërsi.

Sa i përket trajtimit, MKP-ja nuk ka pranuar asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe zyrtarët e QMH-së, e cila nuk do të ishte në pajtim me respektimin e dinjitetit të tyre.

Gjatë vizitës nga MKP-ja, janë kontrolluar regjistrat dhe dosjet e personave të huaj të akomoduar në këtë Qendër. Në janar 2021 ishte evidentuar 1 rast tentim-vetëvrasjeje. Bazuar në dosjet shëndetësore, 8 të huaj ishin me terapi psikiatrike dhe vështirë të menaxhueshëm, prandaj MKP-ja inkurajon institucionet kompetente që përveç rritjes së numrit të personelit në QMH, të angazhojnë së paku një infermier/infermiere, ashtu siç ka rekomanduar MKP-ja në Raportin me rekomandime gjatë viteve 2018, 2019.<sup>222</sup>

Bazuar në të gjeturat e lartcekura, MKP-ja, sërish i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Brendshme që QMH duhet të ketë në dispozicion së paku një infermier/e, i/e cila do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në qendër.

MKP-ja **vëren** se QMH përballet edhe me mungesë serioze të personelit tjetër përveç atij shëndetësorë. Gjatë vizitës së MKP-së, QMH kishte në dispozicion vetëm drejtorin e Qendrës, i cili kryente të gjitha punët. Lidhur me këtë, MKP-ja, më 3 shkurt 2021, u takua me drejtorin e DShAM-së, të cilit i shprehu këtë shqetësimin që vlerësohet të jetë serioz në kuptimin e funksionimit të qendrës në fjalë.

Më 21 dhjetor 2021, MKP-ja kërkoi nga Departamenti për Shtetësi dhe Azil (MPB) që të njoftohet nëse gjatë periudhës për të cilën po raportohet ishte organizuar rekrutim i personelit në qendrat për azil dhe atë të mbajtjes. Departamenti për Shtetësi dhe Azil, më 21 dhjetor 2021 e njoftoi MKP-në se në QMH, u angazhua një zyrtar, ndërsa në qendrat për azil kërkues nuk kishte rekrutime të reja.

Gjatë vizitave të MKP-së, u vërejt se detyrat e sigurisë në qendër kryheshin nga njësisia e Policisë së Kosovës për siguri të cilët nuk janë të trajnuar për të punuar me persona të huaj të privuar nga liria. Në këtë drejtim MKP-ja vëren se standardet e KPT-së përcaktojnë se personeli i sigurisë në qendrat e mbajtjes për të huajt duhet të përzgjidhet me kujdes dhe të ketë trajnime të duhura për të punuar me këtë kategori.

### **Monitorimi i operacioneve të kthimit me forcë përmes linjave ajrore**

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka monitoruar në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës një operacion të kthimit me forcë të shtetasve të Republikës së Kosovës nga autoritetet zvicerane. Ky monitorim bazohet në Memorandumin e Mirëkuptimit të nënshkruar ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës.<sup>223</sup> Gjatë monitorimit të operacioneve në fjalë, MKP-ja ka vërejtur se të kthyerit me forcë janë trajtuar në mënyrë humane dhe korrekte nga autoritetet policore të Republikës së Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka hasur në bashkëpunim të plotë të Policisë së Kosovës gjatë realizimit të këtyre operacioneve.

<sup>222</sup> Po aty.

<sup>223</sup> Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Komisionit Nacional Zviceran për Parandalim të Torturës për monitorim të operacioneve të kthimit me forcë, i nënshkruar më 24 prill 2019. Për më shumë shih në: <https://www.oik-rks.org/2019/04/25/nenshkruhet-memorandumi-i-mirekuptimit-ne-mes-te-zvices-dhe-kosoves-per-parandalim-te-tortures-dhe-monitorim-te-perbashket-te-operacioneve-te-kthimit-me-force/>



## Institucionet e shëndetit mendor dhe ato të kujdesit social

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (tani e tutje, IPFK), Repartin e Urgjencës dhe të Kujdesit Intensiv Psikiatrik të Klinikës Psikiatrike (tani e tutje, UKIP), Shtëpinë Integruese në Bashkësi në Prizren dhe Pejë (SHIB) Shtëpinë me Bazë në Komunitet në Deçan (ShBK), dhe Shtëpinë për të Moshuar dhe pa Përkujdesje Familjare në Gurrakoc.

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të hulumtimit për ndikimin e COVID 19 në shëndetin mendorë, janë realizuar pyetësorë në të gjitha Qendrat e Shëndetit Mendorë, dhe janë intervistuar **drejtëpërdrejt** rezidentët e Shtëpive Integruese në Bashkësi (SHIB), ku u pranuan informacione edhe për trajtimin dhe jetën e tyre në institucione rezidenciale.

Qëllimi i vizitave ishte vlerësimi i gjendjes së institucioneve në fjalë, menaxhimi i situatës gjatë pandemisë, progresit të autoriteteve kompetente në implementimin e rekomandimeve të MKP-së, të dërguara përmes raporteve të mëhershme me rekomandime.

## Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës

Instituti i Psikiatrisë Forenzike i Kosovës (IPFK) ishte hapur në gusht të vitit 2014. Aktualisht është nën menaxhimin e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK). Në bazë të Ligjit për Shëndetin Mendor, IPFK-ja është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas ligjit në fuqi, IPFK-ja ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (i vetmi në Kosovë).<sup>224</sup> Baza ligjore relevante gjendet në Kodin Penal të Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale, në Ligjin për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe në Ligjin për Shëndetin Mendor.

Në IPFK akomodohen personat të cilët kanë kryer vepër penale në gjendje të paaftësisë mendore ose të aftësisë esencialisht të zvogëluar mendore, të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës kompetente për trajtim të detyrueshëm psikiatrik, si dhe personat të cilët janë subjekt i urdhrit të gjykatës për vlerësim psikiatrik me ndalim në institucionin shëndetësor.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja e ka vizituar Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës (IPFK) më 17 qershor 2021. Gjatë vizitës në IPFK dhe në Repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP) të Klinikës Psikiatrike, me përkrahje të Këshillit të Evropës (KE), ekipit të MKP-së i është bashkangjitur edhe psikiatri.

Kapaciteti i këtij institucioni është 36 shtretër (nga 12 shtretër në secilin repart). IPFK-ja përbëhet nga Reparti A (Pranimi/Pacientët jo të shtrirë); Reparti B (Trajtimet e detyrueshme psikiatrike); Reparti C (Ekspertizat psikiatrike); dhe Reparti D i risocializimit. Në Repartin C janë të vendosur pacientët, të cilët sillen nga ShKK-ja, të cilët janë të paraburgosur, kur gjykata kërkon vlerësimin e gjendjes mendore (ekspertizë psikiatrike), ose të dënuar, të cilët

<sup>224</sup> Ligji nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor, neni 13, paragrafi 1.2.

sillen për trajtim nga burgjet. Në Repartin B janë të vendosur pacientët të cilëve gjykata ua ka shqiptuar masën e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik me ndalim në institucion.

### **Trajtimi**

MKP-ja gjatë vizitës intervistoi pacientët e pranishëm dhe nuk mori ankesa për keqtrajtim. Po ashtu, MKP-ja, nuk vërejt shenja të dhunës fizike tek pacientët. Për më shumë, MKP-ja vërejt raporte të mira dhe interaktive ndërmjet pacientëve dhe personelit të IPFK-së.

### **Incidentet ndërmjet pacientëve**

Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se në tre muajt e fundit në Repartin B, ka ndodhur një incident (përleshje në mes dy pacientëve), i cili është menaxhuar nga personeli. Gjatë pandemisë ka pasur numër të madh të pacientëve dhe njëri nga pacientët (tani i ndjerë), vlerësohej më problematik me sjellje jo të përshtatshme duke ngacmuar shpeshherë pacientët e tjerë. Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, nga janari e deri në kohën e vizitës së MKP-së (qershor 2021), kanë ndodhur 3 incidente. Edhe nëpërmjet këtij raporti, MKP-ja rrit obligimin e institucionit për ofrimin e kujdesit dhe mbrojtje të mjaftueshme për personat në trajtim. MKP-ja e konsideron shumë të nevojshëm organizimin e trajnimeve për të gjithë personelin, për mënyrat e menaxhimit të çështjes së dhunës ndërmjet pacientëve.

### **Kushtet e akomodimit**

Kushtet materiale dhe higjienike në IPFK, në përgjithësi janë të mira. Dhomat e pacientëve janë me nga dy shtretër, posedojnë ventilim adekuat dhe pacientët kanë qasje në dritë natyrale, dhomat e pacientëve kanë dollapë, por janë të dëmtuar dhe nuk mund të mbyllen. MKP-ja konsideron se Autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin veprimet adekuate për të evituar këtë mangësi. Po ashtu ka hapësirë për qëndrimin ditor, të pajisur me karrige, televizor, lojëra (shahu) si dhe hapësirë të përshtatshme për kuzhinë.

Privatësia në dushe dhe tualet ishte adekuate pasi që dyert e tualetit mbuloheshin me perde. Gjatë vizitës, MKP-ja, ka vërejtur se IPFK nuk posedon një repart të veçantë për pacientët femra dhe të mitur. MKP-ja, edhe përmes këtij raporti, rrit se autoritetet kompetente duhet të ndërmarrin hapa konkret për të evituar këtë mangësi.

Sipas njoftimit të fundit të drejtorit të IPFK-së (në shtator 2021), kapaciteti i IPFK me gjithsej 24 shtretër për trajtim të detyrueshëm me ndalim, ishte në kapacitet të plotë 100%. 12 shtretër janë në dispozicion për ekzaminim psikiatrik.

Po ashtu, sfida për mirëfunksionim të institucionit përbën trajtimi i personave, të cilët janë përdorues të substancave narkotike.

Problem shtesë përbën edhe mos ndryshimi i masës nga gjykata kompetente, pavarësisht arritjes së objektivave për trajtim të atyre rasteve. Sipas drejtorit të IPFK-së, kanë bërë kërkesë për 7 pacientë për ndërrim të masës, por nuk kanë pranuar përgjigje nga gjykatat.

Njëra ndër problemet që u theksua është edhe kujdestari ligjor, pasi që shpesh herë nuk është e qartë se kush është kujdestari ligjor i personit i cili pranohet me vendim të Gjykatës

dhe në vendim nuk ka të përcaktuar një kujdestar ligjor, kjo po i paraqet problem mjekëve gjatë trajtimit dhe se institucioni nuk di me kë ta mbaj komunikimin për gjendjen e pacientit.

### Trajtimi dhe aktivitetet

Në IPFK, përveç vlerësimit dhe trajtimit me medikamente, ofrohen edhe aktivitete psiko-sociale. Trajtimi psiko-social konsiston në aktivitetet, si: lojëra, shikim televizori, vizatime, daljet ditore brenda institucionit (në shëtitore të IPFK-së), seanca individuale me psikologun etj. Orari i aktiviteteve ditore ishte i vendosur në vende të dukshme, por ky orar është uniform.

Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se trajtimi në thelb është me farmakoterapi dhe kishte mungesë të aktiviteteve të strukturuar terapeutike. Për më tepër, MKP-ja ka vërejtur se disa pacientë kishin plane individuale të trajtimit por nuk ishin hartuar në mënyrë sistematike. Kjo gjetje është theksuar edhe në Raportin e fundit të KPT-së për Kosovën.<sup>225</sup>

### Personeli i IPFK-së

Në IPFK aktualisht janë 43 të punësuar, përveç drejtorit (neuropsikiatër), janë edhe 6 psikiatër, 2 psikolog, 2 infermier, 2 punëtor social, dhe personeli administrativ, personeli i kuzhinës si dhe personeli i sigurimit. Personeli në fillim ka pasur një trajnim bazik – kapje/kontrolle për menaxhimin e rasteve të vështira, mirëpo nuk është mbajtur një vazhdimësi të trajnimeve të kësaj natyre në mënyrë që stafi të jetë në gjendje të përmbushë detyrat.

Lidhur me personelin e sigurisë në IPFK, dhe në repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (më tej, UKIP), situata mbetet e njëjtë, që nga gjetjet e raportit të fundit të MKP-së, i dërguar në vitin 2018.<sup>226</sup> Në raport janë theksuar gjetjet se personeli i sigurisë i ndihmon stafit mjekësorë në menaxhimin e situatave të krizave dhe nuk kanë kryer trajnime adekuate për punë me këtë kategori të pacientëve.

### Progresi në zbatimin e rekomandimeve të MKP-së

MKP-ja, përmes vizitave të realizuara dhe komunikimit zyrtar me autoritetet kompetente, ka vërejtur se deri më tani nuk është shënuar ndonjë progres domethënës në zbatimin e rekomandimeve të dërguara përmes raportit me rekomandime për vizitën në IPFK, të publikuar më 8 gusht 2018.

Megjithatë, MKP-ja, në fund të vitit 2021, bazuar në informatat zyrtare të publikuara nga Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe informatat e dërguara nga Departamenti Shëndetësorë i Burgjeve, ka vërejtur se janë ndërmarrë disa veprime të caktuara për të evituar mangësi të caktuara në trajtimin e të burgosurve me çrregullime mendore, duke synuar rritjen e kapaciteteve në institucionet ekzistuese dhe përshtatjen e një pavijoni në QKD, si dhe angazhimin e personelit adekuat.

## Reparti i Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, më 16 qershor 2021, ka vizituar repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik (UKIP), i cili funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës.

<sup>225</sup> KPT, Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2020, publikuar në tetor 2021, paragrafi 154. Shih në: [https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset\\_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo](https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo)

<sup>226</sup> Shih raportin, <https://oik-rks.org/2018/08/28/raporti-nga-vizita-ne-institutin-e-psikiatrike-forenzike/>

Në bazë të Ligjit për Shëndetësinë, të nenit 13 të Ligjit për Shëndetin Mendor i Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 të Statutit të ShSKUK-së, Klinika Psikiatrike është njësi organizative e ShSKUK-së. Sipas ligjit në fuqi, UKIP ofron shërbime të nivelit terciar për tërë vendin (e vetmja klinikë në Kosovë), por është e detyruar të ofrojë edhe shërbime të nivelit sekondar për regjionin e Prishtinës, në mungesë të një spitali të përgjithshëm.

UKIP është njësi e mbyllur dhe funksionon në kuadër të Klinikës Psikiatrike. Moshë e pacientëve të vendosur zakonisht është nga 16-65 vjeç. Në këtë repart trajtohen rastet e çrregullimeve të ndryshme psikotike, të çrregullimeve bipolare dhe çrregullimeve të personalitetit, që nuk mund të trajtohen në repartet e tjera. Ky repart është i vetmi në tërë territorin e Kosovës. Në spitalet e tjera regjionale, në repartet psikiatrike nuk janë funksionale dhomat e veçanta ku trajtohen rastet urgjente. Rastet e tilla nga tërë Kosova sillen në repartin e UKIP-it të Klinikës Psikiatrike në Prishtinë.

MKP-ja, edhe përmes këtij raporti, konsideron se repartet psikiatrike në spitalet e tjera regjionale duhet t'i aktivizojnë dhomat e veçanta për trajtimin e rasteve urgjente. MKP-ja, përmes raportit me rekomandime në vitin 2018<sup>227</sup> u ka rekomanduar autoriteteve kompetente aktivizimin e këtyre dhomave të veçanta për trajtim të rasteve urgjente, mirëpo gjendja mbetet e njëjtë dhe ky rekomandim nuk është zbatuar ende.

### **Kushtet e akomodimit dhe trajtimi në repartin e Urgjencës dhe Kujdesit Intensiv Psikiatrik**

Kapaciteti i këtij reparti është 14 shtretër, ndërsa reparti është i ndarë në dy krahë: 7 shtretër për meshkuj dhe 7 shtretër për femra. MKP-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit nuk i plotësojnë standardet për akomodim të pacientëve të kësaj kategorie, nuk është bërë asnjë renovim bazuar në rekomandimet që janë dhënë qysh në vitin 2018.

Gjatë vizitës së MKP-së, në qershor 2021 ishin prezent 4 pacientë. MKP-ja i intervistoi dy prej tyre dhe nuk ka marrë ankesë për keqtrajtim fizik apo për sjellje jo të mirë të personelit, ndërsa dy të tjerë ishin në dhoma të izolimit, me të cilët nuk mund të zhvillohej intervista për shkak të gjendjes së tyre.

MKP-ja, po ashtu vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë, të publikuar në tetor të vitit 2021, u rekomandoi autoriteteve kompetente që të ndërmarrin hapa konkret për të evituar mangësitë e konstatuara sa i përket kushteve të akomodimit.<sup>228</sup>

Gjatë vizitave në këtë repart, MKP-ja ka vërejtur se trajtimi kryesor është me medikamente. Furnizimi me barna ishte i kënaqshëm. Megjithatë, MKP-ja ka vërejtur se aktivitetet psiko-sociale nuk ishin të mjaftueshme. MKP-ja ka vërejtur se mungon ekipi shumë disiplinor, si: psikologu, punëtori social, terapist okupacional dhe mungon plani individual i trajtimit. MKP-ja konsideron se autoritetet dhe institucionet duhet të sigurojnë llojshmërinë e nevojshme të profesionistëve psiko-socialë si parakusht për një trajtim adekuat të pacientëve.

Pacientët në përgjithësi sillen këtu nga familjarët ose nga policia dhe janë pacientë të cilët akomodohen pa vullnetin e tyre. MKP-ja ka vërejtur se gjykata kompetente nuk njoftohet për pranimin e pacientit për trajtim të pavullnetshëm.

<sup>227</sup> MKP, Raport me rekomandime për vizitën në Klinikën Psikiatrike në Prishtinë, publikuar më 26 tetor 2018. Shih në: <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-klinikene-psikiatrike-ne-qkuk/>.

<sup>228</sup> KPT, Raporti për vizitën në Republikën e Kosovës, publikuar në tetor 2021, paragrafët 124 dhe 125. Shih në: [https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset\\_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-](https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-)

MKP-ja, gjatë periudhës për të cilën po raportohet, por edhe gjatë vizitave të mëparshme, ka vërejtur se ky kriter ligjor nuk po zbatohet, pra, nuk njoftohet gjykata kompetente ashtu siç përcakton ligji. Për më shumë, ky moszbatim i ligjit vazhdon për vite me radhë dhe përveç MKP-së, këtë gjendje me shqetësim e kishte konstatuar edhe KPT-ja në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2007, 2010, 2015 dhe së fundmi raportin për vizitën në Kosovë të publikuar në tetor 2021.<sup>229</sup> Në të gjitha këto raporte, ky Komitet kishte shprehur shqetësimin serioz për shkak të moszbatimit të ligjit relevant në këtë pikë.

### Mjetet e kufizimit

Në UKIP nuk përdoret kufizimi mekanik, por vetëm masa e izolimit dhe kufizimi kimik. Gjatë vizitës, MKP-ja ka vërejtur se dosjet e pacientëve përmbanin vlerësimin e tre mjekëve, anamnezën, historinë e sëmundjes, formularin për vendosjen në dhoma të izolimit, kërkesën për pranim në spital, por nuk ka pëlqim për trajtim dhe nuk ka miratim të informuar.

MKP-ja konsideron se përderisa reparti e përdorë masën e izolimit, ky mjet kufizimi duhet të jetë subjekt i një politike të detajuar për pacientët të cilët vendosen në dhoma izolimi, e cila duhet t'i përmbajë informatat për situatat kur mund të përdoret izolimi, objektivat e synuara, kohëzgjatjen dhe nevojën për shqyrtim të rregullt të vendimit për izolim, ekzistimi i kontakteve të mirëfillta njerëzore, nevojën që personeli të jetë në mënyrë të veçantë vigjilentë.

MKP-ja ka vërejtur se reparti nuk ka regjistër të veçantë për personat të cilët vendosen në izolim. Prandaj, MKP-ja konstaton se ende nuk është zbatuar rekomandimi për të krijuar një regjistër të tillë, i cili iu dërgua autoriteteve kompetente përmes raportit me rekomandime i publikuar më 26 tetor 2018.<sup>230</sup>

Edhe KPT-ja, në raportin për vizitën në Kosovë në vitin 2020, publikuar në tetor 2021, ka vërejtur se izolimi i pacientëve ishte një praktikë e shpeshtë e kombinuar me administrimin me forcë të ilaçeve. KPT-ja, theksoi se përdorimi i mjeteve të kufizimit duhet të jetë subjekt i një i një politike gjithëpërfshirëse dhe ka dërguar një numër rekomandimesh specifike në këtë drejtim.

### Kontakti me botën e jashtme

Për shkak të paraqitjes së pandemisë COVID-19 dhe bazuar në vendimet e autoriteteve të cilat parashohin masa për parandalim të COVID-19, vizitat e familjarëve janë pezulluar, përveç ndonjë rasti shumë specifik, ku është realizuar vizita 5 minuta, por në distancë, por kjo ka ndodhur shumë rrallë. Gjatë pandemisë është rritur numri i telefonatave. Standardet e KPT-së, lidhur me trajtimin e pavullnetshëm, theksojnë se kontakti i pacientit me botën e jashtme është esencial jo vetëm në kuptim të parandalimit të keqtrajtit, por edhe nga pikëpamja terapeutike.

Pacientët duhet ta kenë mundësinë për dërgimin dhe për pranimin e korrespondencës, të kenë qasje në telefon dhe të pranojnë vizita nga familja dhe miqtë e tyre. Drejtori i klinikës

229 Komiteti Evropian për Parandalim të Torturës (KPT), Raporti për vizitën në Kosovë në vitin 2007, paragrafi 131, publikuar në vitin 2009. Shih në: <https://rm.coe.int/168069727c>. Raporti i KPT për vizitën në Kosovë në vitin 2010, paragrafi 88, publikuar në vitin 2011. Shih në: <https://rm.coe.int/16806972c7>. Raporti i KPT për vizitën në Kosovë në vitin 2015, paragrafi 111, publikuar në vitin 2016. Shih në: <https://rm.coe.int/16806a1efc>. Raporti i KPT për vizitën e fundit në Kosovë në vitin 2020, publikuar në tetor 2021, paragrafi 142, 143. Shih në: [https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset\\_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-](https://www.coe.int/en/web/cpt/kosovo/-/asset_publisher/WsovygSd8qFK/content/council-of-europe-anti-torture-committee-publishes-report-on-kosovo-)

230 Po aty. <https://www.oik-rks.org/2018/10/29/raport-me-rekomandime-lidhur-me-viziten-ne-kliniken-pskiatrike-ne-qkuk/>.

duhet të kufizojë daljen dhe aktivitetet e tjera psiko-sociale, në pajtim me gjendjen me COVID-19 dhe me rekomandimet e organeve kompetente. Ky kufizim nuk duhet të jetë parim në asnjë mënyrë dhe duhet t'i nënshtrohet rishqyrtimit të kohëpaskohshëm.

## **Qendrat e Shëndetit Mendor dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi**

Legjislacioni relevant për këto institucione gjendet në Ligjin nr. 05/L-025 për Shëndetin Mendor dhe në Udhëzimin Administrativ (në Shëndetësi) nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës.

Bazuar në dispozitat e akteve juridike të lartpërmendura, Shtëpia për Integrim në Bashkësi (ShIB) ofron kujdes shëndetësor në funksion të rehabilitimit dhe të ri integritit social të klientëve me sëmundje dhe me çrregullime kronike të shëndetit mendor.<sup>231</sup>

Qendra të Shëndetit Mendor (QShM) ka në qytete të ndryshme si në Prishtinë, Gjakovë, Podujevë, Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë. Në QShM puna organizohet në dy mënyra: në atë të brendshme, që zhvillohen aktivitete psikosocial brenda në Qendër, ju japin terapi me medikamente falas, dhe në atë që bëhet në teren nga ekipi mobil i qendrës, ku i mbulojnë regjionet e atij qyteti ku ndodhet QShM. Këto vizita të ekipit mobil bëhen me qëllim të mbështetjes psikosocial, dhënies së terapisë me rregull, njëkohësisht ofrojnë mbështetje edhe për familjen.

Në kuadër të Qendrave të Shëndetit Mendorë janë edhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi (ShIB), në çdo qytet të Kosovës. Këto shtëpi janë rezidenciale dhe secila me kapacitet për 10 rezidentë, përveç ShIB Mitrovicë e cila ka kapacitet për 20 rezidentë. Shtëpitë për Integrim në Bashkësi ofrojnë kujdes kohë-gjatë shëndetësor në funksion të rehabilitimit dhe re-integritit social të klientëve me sëmundje dhe çrregullime kronike psikiatrike.

Në kuadër të hulumtimit që ka bërë Avokatit të Popullit për ndikimin e Covid 19 në shëndetin mendorë, përfaqësuesi i MKP-së i ka vizituar të gjitha Qendrat e Shëndetit Mendorë në Kosovë dhe Shtëpitë Integruese në Bashkësi, janë realizuar intervista me rezidentë, personel shëndetësorë lidhur me trajtimin e pacientëve gjatë pandemisë. Intervistat janë realizuar gjatë muajve qershor dhe korrik 2021.

231 Udhëzimi Administrativ (në Shëndetësi) nr. 07/2009 për Shërbimin Profesional të Shëndetit Mendor në Republikën e Kosovës, neni 9 paragrafi 1.



# VI. Qëndrimet e Avokatit të Popullit për të drejtat dhe liritë themelore të shprehura në raportet për rastet e hetuara gjatë vitit 2021

## DINJITETI I NJERIUT, E DREJTA PËR JETËN, MBROJTJA SHËNDETËSORE DHE SOCIALE dhe BARAZIA PARA LIGJIT

### Ndikimi i pandemisë COVID-19 në shëndetin publik

Raporti analizon edhe ndikimin e pandemisë në shëndetin publik dhe veprimin e institucioneve të kujdesit shëndetësor përgjatë kësaj periudhe. Pavarësisht faktit se MSh-ja kishte hartuar planin për gatishmëri dhe reagim kundër COVID-19 dhe Qeveria kishte ndarë mjete financiare shtesë, kishte vështirësi dhe vonesa për furnizim me mjete mbrojtëse, me teste, me barna, me respiratorë dhe me materiale të tjera të nevojshme.

Mbi bazën e informatave nga institucionet shëndetësore, nga organizatat sindikale si dhe nga qytetarët, Avokati i Popullit vlerëson se ekzistojnë mangësi në sistemin shëndetësor për shkak të kontributit të ulët buxhetor për shëndetësi, moszbatimi i ligjeve dhe i politikave, moskoordinimi në mes sektorëve, monitorimi i pamjaftueshëm dhe mungesa e llogaridhënies.

Fokusi në parandalimin dhe trajtimin e të sëmurëve me COVID-19, veç të tjerash, ka lënë anash shumë qytetarë të cilët kishin nevoja shëndetësore të natyrave të tjera, përfshirë edhe ato kronike, e që solli sfida të





shumta të institucionet shëndetësore, të personeli shëndetësor si dhe ndikoi në buxhetin e të infektuarve me COVID-19 dhe të familjarëve të tyre.

### **Shëndeti mendor dhe ndikimi i pandemisë COVID-19**

Sa i përket shëndetit mendor, ndikimet e para të pandemisë u vërejtën në shumë vende të botës, ashtu edhe në Kosovë. Izolimi shoqëror, mungesa e lëvizjes së lirë, humbja e vendeve të punës, problemet ekonomike, humbja e familjarëve, numri i vdekjeve në përgjithësi, frika nga infektimi etj., të gjitha këto kanë ndikuar drejtpërdrejt në shëndetin mendor në përgjithësi. **Që nga fillimi i pandemisë, ekspertë nga e gjithë bota kanë paraqitur pikëpamje në lidhje me ndikimet e mundshme negative të pandemisë në shërbimet e shëndetit mendor dhe kanë ngritur vetëdijen lidhur me nevojën e adresimit të problematikës së shëndetit mendor e me këtë edhe të çështjes së mundësisë së shtuar për cenimin/injorimin e të drejtave të personave me çrregullime mendore.**

Nga raportimet në media është vërejtur se pandemia ka prishur ofrimin e shërbimeve të shëndetit mendor duke privuar shumë njerëz nga mbështetja e nevojshme. Gjithashtu **është vërejtur se** përkundër kërkesës në rritje për mbështetje të shëndetit mendor, Ministria nuk ka ndarë ndonjë fond shtesë për shërbimet e shëndetit mendor ngase sipas zëdhënësit në këtë ministri, buxheti për shëndetin mendor ekziston. Dihet se në Kosovë vetëm 2% e buxhetit shëndetësor është shpenzuar për shërbimet e shëndetit mendor, që është përsëri më i ulët se mesatarja e BE-së prej 4%.

### **Dhuna në familje gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë**

Me ndër marrjen e masave për parandalimin e COVID-19 janë rritur rastet e dhunës në familje. Këto masa kanë vështirësuar punën institucionale në parandalimin, trajtimin dhe kujdesin e grupeve të rrezikuara, siç janë edhe viktimat të dhunës në familje. Sipas informatave të siguruar nga Policia del se rastet e dhunës në familje gjatë pandemisë janë rritur, duket qartë se në vitin 2020 kishte rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje në krahasim me vitin 2019. Gjatë vitit 2019, sipas informatave janë të regjistruar 1915 raste, ndërsa në vitin 2020 janë regjistruar në Polici 2069 raste të dhunës në familje. Ndërsa, deri në muajin maj të vitit 2021, në Policinë e Kosovës ishin të regjistruara 897 raste të dhunës në familje. Këto statistika tregojnë se gjatë vitit 2020, gjatë pandemisë janë paraqitur 154 raste të dhunës në familje më shumë se në vitin 2019.

Është evident moskoordinimi i rregullt i strehimores me institucione të tjera, siç janë: QPS, Mbrojtësi i viktimave dhe gjykatat, për shkak të orarit të reduktuar të punës gjatë pandemisë.

Avokati i Popullit vlerëson se ndër sfidat kryesore gjatë periudhës së pandemisë mars-shtator 2020, ishin: rritja e numrit të rasteve të dhunës në familje, infektimi i stafit, mungesa financiare për menaxhim të rasteve të dhunës në familje, numri i vogël i stafit, izolimi gjatë pandemisë, i cili ka pamundësuar lëvizjen dhe paraqitjen e rasteve të dhunës në familje gjatë pandemisë COVID-19, dhe mungesa e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve që veprojnë gjatë paraqitjes së rasteve të dhunës në familje nga ana e viktimave.

## Të drejtat e komuniteteve joshumicë dhe ndikimi i pandemisë COVID-19

### Informimi i komuniteteve joshumicë lidhur me pandeminë COVID-19

Shpërndarja e saktë, e besueshme dhe në kohë e informacionit lidhur me situatën epidemiologjike dhe për masat e ndërmarra për ta parandaluar përhapjen e virusit pandemik COVID-19 nga autoritetet publike, në gjuhët zyrtare dhe në gjuhët zyrtare në nivel komune, ka ndikim të drejtpërdrejtë në parandalimin e përhapjes së pandemisë te qytetarët e vendit, pa dallim. Marrja e informacionit me kohë është një faktor për t'ua mundësuar qytetarëve dhe zyrtarëve ta organizojnë sjelljen e tyre në përputhje me interesin publik dhe me rregullat ligjore në lidhje me pandeminë. Në këtë drejtim, dhe në situatë pandemie, rol kryesor dhe përgjegjësi të veçantë për sigurimin e informacionit në kohë, të saktë dhe të besueshëm për publikun kanë autoritetet publike, në veçanti ato funksionet e të cilave kanë të bëjnë me shëndetin publik, mediat dhe gazetarët profesionistë. Me shpalljen e gjendjes tremujore të emergjencës së shëndetit publik, në mes të marsit 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi masa të menjëhershme që synonin parandalimin e përhapjes së virusit.

Në komunikimet e përfaqësuesve të Avokatit të Popullit me përfaqësuesit e komuniteteve joshumicë të Kosovës: serb, boshnjak, goran, kroat, turk dhe rom, ka treguar se çështja kryesore me të cilën u përballën gjatë urgjencës së shëndetit publik ishte pamundësia për të marrë informacion me kohë. Duke theksuar se çështjet e përkthimit në gjuhët e komuniteteve joshumicë janë çështje të përgjithshme dhe të vazhdueshme dhe nuk është një dukuri e izoluar e periudhës pandemike.

Përkitazi me ankesën që kishte të bënte me mosarritjen e Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) dhe të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike në Kosovë (IKShPK) që t'i informonin qytetarët në gjuhën serbe lidhur me pandeminë, nëpërmjet faqes së tyre zyrtare në internet,<sup>232</sup> Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 5 (paragrafi 1) të Kushtetutës dhe të Ligjit nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, i rekomandoi MSh-së dhe IKShPK-së që t'i informoi qytetarët dhe publikun përmes faqeve të tyre në internet në të dy gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës.<sup>233</sup> Në përgjigjen e pranuar nga IKShPK-ja dhe MSh-ja, më 15 prill 2020, respektivisht më 17 prill 2020, IAP-ja u njoftua: komunikimet e tyre bëhen në të dy gjuhët zyrtare; në komunikim medial ata përgjigjen në gjuhën serbe sa herë që pyetjet bëhen në këtë gjuhë; rrjetet e tyre sociale/profili në Facebook përmban informacion në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe se bëjnë përpjekje që informacioni në lidhje me COVID-19 të jetë në gjuhët zyrtare.<sup>234</sup> Nga përgjigjja u kuptua se për shkak të situatës urgjente të pandemisë, autoritetet janë duke u ballafaquar me mungesë të kapaciteteve

<sup>232</sup> Ankesa nr.250/2020, Z. V. kundër Ministrisë së Shëndetësisë dhe Institutit të Shëndetësisë Publike të Kosovës, i datës 15 prill 2020.

<sup>233</sup> Po aty.

<sup>234</sup> Divizioni i Komunikimit me Publikun, Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës, Ref. Nr. 280/2020, i datës 17.04.2020, dhe përgjigjja ndaj Ankesës nr. 250/2021, Instituti i Shëndetësisë Publike i Kosovës, datë 15.4.2021.

të mjaftueshme për përkthime. Megjithatë, pas rekomandimit të IAP-së është vërejtur përmirësim i përkthimeve.

### Ndihma ekonomike - procedurat për qasje në Paketën Fiskale Emergjente

Qeveria e Republikës së Kosovës, duke synuar zbutjen e pasojave ekonomike nga COVID-19, më 3 prill 2020 miratoi Planin Operacional për Paketën Fiskale të Emergjencës (PFE), masa që përfituesit do të përfitonin sipas kriterëve dhe procedurave rigorozë.<sup>235</sup> Pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që nuk flasin dhe/ose nuk i kuptojnë gjuhët zyrtare, pranuan me vonesë informacionin. Publikimi i informacionit në ueb-faqet zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Transfereve (MFT) dhe të Agjencisë së Punësimit ishte përkthim jo cilësor. Për më tepër, aplikimet për ndihmë pritej të plotësoheshin dhe të dorëzoheshin personalisht ose përmes një formati elektronik online, por për shkak të problemeve me përkthim të pjesshëm, mungesë të pajisjeve elektronike ose mungesës së e-edukimit, qytetarët shpesh personalisht aplikonin në Qendrat për Punë Sociale (QPS)<sup>236</sup> duke krijuar kështu turma dhe radhë të panevojshme që përbënin po ashtu edhe ambient potencial për infektim me virus.

Ministria e Financave dhe Transfereve, në përgjigjen për Avokatin e Popullit sqaroi 15 masat e përgjithshme të PFE-së: Masa 1 – që synon dyfishimin e të hyrave për përfituesit e ndihmës sociale deri në 80 EUR për dy (2) muaj;<sup>237</sup> Masa 2 – që synon dhënien e kontributit shtesë prej 30 EUR për përfituesit e ndihmës sociale deri në 100 EUR për tre (3) muaj; dhe Masa 15 - që synon të ndihmojë kategoritë e qytetarëve/familjeve pa të ardhura financiare, të cilët gjithashtu nuk janë përfitues të skemës sociale dhe jetojnë në gjendje të rëndë shoqërore.<sup>238</sup> Për shqetësimet e ngritura se shpërndarja e dobët e informacionit për komunitetet joshumicë dhe sigurimi i përkthimit joadekuat i informacionit mund të kenë ndikuar në ndikimin e dëshiruar të PFE-së, MFT-ja shpjegoi se komunitetet pakicë ishin përfituese të PFE-së dhe ndihma financiare arriti efektet e saj. Më tutje shpjeguan “... nga një shumë totale e masës 15 Komuna e Leposaviqit përfitoi 2.5% megjithëse strehon 0.9% të familjeve në skemën e rregullt të ndihmës sociale” dhe “Komuna e Klllokotit përfitoi 0.5% nga shuma totale e masës 15, ndërsa familjet në skemën e ndihmës sociale janë saktësisht e njëjta, 0.5% e totalit të skemës sociale.”<sup>239</sup>

Avokati i Popullit e vlerëson pozitive qasjen e Qeverisë, e cila përmes Masës 9 të PFE-së ndau 2.000.000 EUR për fonde të veçanta për iniciativa dhe projekte që synojnë përmirësimin e jetës së komuniteteve joshumicë të prekura nga gjendja emergjente e shëndetit publik. Masa u zbatua përmes Zyrës për Komunitete, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.<sup>240</sup> Kjo ndihmë u shpërnda në tri aranzhime: 900.000 EUR u ndan për organizatat e sektorit të shoqërisë civile (OJQ) përmes projekteve të shpërndarjes së paketave të ushqimit dhe higjienës për familjet sociale të rrezikuara, në të gjithë Kosovën; 800.000 EUR u alokuan si ndihmë për bizneset e vogla; dhe 300.000 EUR u alokuan si ndihmë për personat me nevoja

235 Vendimi 31/2020 i Ministrisë për Financa dhe Transfere, i datës 3.4.2020, e cila miratoi Planin Operacional të Paketës Fiskale Emergjente.

236 Mbi procedurën e aplikimit, rolin dhe detyrat e QPS-së në ekzekutimin e Masës 15 të Paketës Fiskale Emergjente, shih Vendimin nr. 35/2020 të Ministrisë për Financa dhe Transfere, i datës 16.4.2020.

237 Referuar përfituesve të skemës sociale, siç rregullohet me Ligjin nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale dhe me Ligjin nr.04 / L-096 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr. 2003/15 për Skemën e Ndihmës Sociale. Shikoni pikën 11 të parashtrimit të MFT-së ndaj IAP-së, siç përmendet në fusnotën më lart.

238 Ministria për Financa dhe Transfere: “Memorandum Shpjegues në lidhje me ankesat e pranuar nga IAP lidhur me Paketën Fiskale Emergjente”, Nr.373/2020, i datës 26.6.2020. Në veçanti shih pikat 10 deri 16.

239 Pikat 17 deri në 18 të Memorandumit Shpjegues, më lart.

240 Masa 9, Plani Operacional i Pakos Emergjente Fiskale. Kjo masë fokusohet posaçërisht për situatën e rënduar socio-ekonomike të romëve, ashkalive dhe egjiptianëve pa përjashtuar komunitetet e tjera jo shumicë (paragrafi 2).

të veçanta. Sipas informacionit të IAP-së, marrë drejtpërdrejt nga Zyra për Komunitete në kuadër të ZKM-së, kjo ndihmë është zbatuar plotësisht.<sup>241</sup>

Vështirësitë në ndjekjen e procedurave të aplikimit të asistencës së paketës së PFE-së prekën kryesisht pjesëtarët e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, për shkak të niveleve të ulëta të e-edukimit, mungesës së pajisjeve elektronike (telefonave të mençur, kompjuterëve etj.), mungesës së dokumentacionit të identifikimit, si dhe qasja e dobët në informacion dhe në shërbime për personat dhe familjet e pafavorizuara në shoqëri.

Avokati i Popullit i vlerëson pozitive veprimet e Ministrisë për Komunitete dhe Kthim në lidhje me shpërndarjen e paketave të ndihmës për të kthyerit më të rrezikuar dhe për anëtarët e komunitetit joshumicë.<sup>242</sup> Kështu, nga 31 marsi deri më 10 prill 2020, në 22 komuna anembanë Kosovës, MKK-ja shpërnda mbi 606 pako që përmbajnë ushqime dhe artikuj higjienikë për të kthyerit dhe për familjet e rrezikuara, nga të gjitha komunitetet. Për më tepër, MKK-ja, në bashkëpunim me Zyrën e BE-së në Kosovë, si pjesë e programit “Kthimi dhe Ri-integrimi”, bashkëfinancoi shpërndarjen e 253 paketave shtesë të ushqimit dhe higjienës, kryesisht për të kthyerit nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian.<sup>243</sup>

### **Qasja në arsim dhe në shërbimet shëndetësore e komuniteteve**

E drejta për arsimim, e mbrojtur me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet dhe me instrumentet përkatëse të të drejtave të njeriut, në parim është e garantuar, edhe gjatë periudhave të emergjencave të shëndetit publik. Që nga mesi i marsit 2020, sistemi arsimor në Kosovë, në vazhdimësi është duke u zhvilluar duke iu përshtatur nevojave të imponuara për mbrojtjen e shëndetit publik. Karakteristikë e rëndësishme e një përshtatjeje të tillë është të sigurohet një vëmendje e veçantë për të siguruar që të gjithë, përfshirë anëtarët e grupeve të cenueshme, të vazhdojnë të përfitojnë nga e drejta për arsimim dhe të kenë qasje të barabartë në mjetet dhe në materialet arsimore gjatë urgjencës shëndetësore.

Nga mesi i marsit deri në shtator 2020, sistemi arsimor i vitit shkollor 2019/2020 funksionoi përmes mësimin në internet (mësim në distancë). Përveç problemeve të përgjithshme të hasura veçanërisht në fillimin e organizimit të procesit të mësimin në distancë, studentët që vinin nga pjesa më e ndjeshme e komuniteteve joshumicë: romë, ashkali dhe egjiptian ishin kryesisht të ekspozuar ndaj vështirësive për të ndjekur arsimin për shkak të shumë faktorëve të ndërlikur.

Avokati i Popullit vëren se edhe më tej fëmijët nga komuniteti serb dhe një pjesë e komunitetit rom nuk ndjekin mësimin sipas planprogramit të Republikës së Kosovës, ndërsa fëmijët nga komunitetet joshumicë, të cilët janë të integruar në planprogramet mësimore të Republikës së Kosovës, kanë ndjekur mësimin në distancë i transmetuar nga transmetuesi publik i Kosovës - RTK, mirëpo hasën në vonesa dhe në vështirësi në ndjekjen e mësimin. Si edhe të gjithë të tjerët, nxënësit boshnjakë dhe turq, sikurse edhe mësuesit, hasën në vështirësi për të kaluar në mësim përmes internetit; mungesë apo lidhje të dobët të internetit në zonat rurale; mungesë e pajisjeve elektronike për ta ndjekur mësimin; vonesa në fillimin

241 IAP e mori këtë informacion përmes postës elektronike nga një punonjës i Zyrës për Komunitete në Zyrën e Kryeministrit më 29 qershor 2021; duhet të theksohet se nuk ishte specifikuar se çfarë lloji i ndihmës u ishte dhënë personave me nevoja të veçanta.

242 Shih: Raport mbi shpërndarjen e pakove ushqimore dhe dimërore në 16 komuna të cenueshme (Raporti i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim (MKK); Raport mbi paketat e dhëna të ndihmës për personat e pambrojtur gjatë pandemisë Virus COVID 19 në Kosovë, Faza I, dhe Faza II (Raporti i MKK-së).

243 Raporti i Ministrisë së Komuniteteve dhe Kthimit për paketat e ndihmave të dorëzuara të të cenuarve gjatë pandemisë së virusit COVID-19 në Kosovë, faza e parë dhe e dytë, prill 2020. “Raporti i paraqitur në IAP më 16 qershor 2021 përmes e-mailit.

e regjistrimit të njësive mësimore; dhe në fillim një numër tejet i vogël i mësimdhënësve pranuan të merrnin pjesë në mësimdhënie të regjistruar. Komuniteti boshnjak i Kosovës pranoi një numër të laptopëve dhe tabletëve, por jo i mjaftueshëm për të gjithë nxënësit të cilët kishin nevojë për këto mjete për ta ndjekur dhe për t'u angazhuar aktivisht në mësimin në distancë. Fëmijët e komuniteteve ashkali, egjiptian dhe rom, në masë më të madhe nuk e kanë ndjekur mësimin në distancë, tërësisht edhe për shkak të mungesës së mjeteve të teknologjisë informative.

MAShTI e informoi Avokatin e Popullit për masat që ka ndërmarrë kjo ministri për të krijuar kushte për nxënësit e komuniteteve joshumicë në periudhën e pandemisë si më poshtë:

- Për shkak të situatës me pandeminë MAShTI ka organizuar dhe realizuar xhirrimet e njësive mësimore për mësimin në distancë edhe në gjuhën turke dhe gjuhën boshnjake që në fillim të pandemisë nga muaji mars kur ka kaluar procesi mësimor në formë online, por xhirimet pastaj kanë vazhduar të realizohen edhe nga shtatori 2020 deri në fund të muajit shkurt 2021 kur edhe kanë përfunduar, gjithashtu janë realizuar edhe xhirimet për mësimin në distancë të gjuhës rome që mësohet si mësim plotësues (në muajin janar 2021). Të gjitha janë transmetuar në kanalën televiziv RTK. Tani nxënësit mund ti ndjekin në youtube.
- OSBE dhe MAShTI ka ndarë donacion për nxënësit e arsimit të obligueshëm, janë ndarë 215 tablet e që 60% e tabletëve janë ndarë për nxënësit e komuniteteve.
- Për shkak të situatës me pandeminë në edukimin e hershëm MAShTI në bashkëpunim me Save the Children dhe UNICEF kanë lansuar platformën online : “Edukimi në distancë - Kujdesi Zhvillimi dhe Edukimi në fëmijërinë hershme për moshën 0-6 vjeç.” Kjo platformë është edhe në gjuhën turke, serbe dhe rome.

Sa i përket ofrimit të shërbimeve shëndetësore për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, të dhënat nga Ministria e Shëndetësisë tregojnë se janë ndërmarrë masa që u mundësojnë marrjen e masave përkatëse sipas rrethanave dhe nevojave që janë paraqitur si pasojë e pandemisë:

- Komunitetet jo-shumicë kanë qenë pjesë e aktiviteteve, duke filluar nga informimi përmes materialeve informuese që në fillim të pandemisë në disa gjuhë: shqip, serbisht, anglisht, turqisht dhe në gjuhën rome (materiale të përgatitura në bashkëpunim me Zyrën e OBSH-së dhe UNKT), e deri te përfshirja e tyre në vaksinim, ku secilës komunë në Kosovë, i janë ofruar mundësitë e njëjta për vaksinim kundër COVID 19.
- Me qëllim të përfshirjes së komunitetit Rom, Ashkali, dhe Egjiptian në një shkallë më të lartë të vaksinimit, atyre u është ofruar vaksinimi edhe përmes ekipeve mobile të MSh-së dhe të QKMF-ve (komunave), derisa me përkrahjen e UNICEF-it, përmes vullnetarëve dhe pjesëtarëve të organizatave të shoqërisë civile është bërë dhe po bëhet edhe këtyre ditëve edhe fushatë “derë më derë” që grupet e cënueshme të popullatës për t'i bindur për vaksinim.
- MSh nuk ka pranuar asnjë ankesë nga komunitetet jo-shumicë për mos ofrim të ndonjë shërbimi që lidhet me COVID 19, përjashtimisht kërkesave të Komisionerit të gjuhëve që të ketë respektim të zbatimit të Ligjit për gjuhët zyrtare në republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit vlerëson se është me rëndësi që Ministria të vazhdojë me aplikimin e masave gjithëpërfshirëse për ofrimin e shërbimeve shëndetësore për të gjithë pjesëtarët e komuniteteve joshumicë në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.

### **Raport ex-officio nr. 621/2018 në lidhje me masat operative parandaluese për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, sipas Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës**

Gjykata Evropiane për të Drejta të Njeriut vlerësoi se shteti ka obligim që të ndër marrë masa operative parandaluese për të mbrojtur një apo më shumë individë të identifikuar paraprakisht si cak i mundshëm i akteve të dhunshme edhe në kontekstin e dhunës në familje. Kjo përfshin obligimin e shtetit për të siguruar që korniza ligjore duhet t'i mbrojë njerëzit, të cilët janë potencialisht viktimë të dhunës në familje. Në përmbledhje të këtyre rasteve rrjedh përfundimi se shtetet janë të obliguara që krahas miratimit të legjislativioneve përkatëse, të ndër marrin edhe masa operative parandaluese për të mbrojtur një apo më tepër individë, të identifikuar paraprakisht si caqe potenciale të akteve të dhunshme përbrenda familjes.

Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjen së institucioneve përgjegjëse për obligimet pozitive të shtetit që dalin nga neni 25, paragrafi 1, i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke mos zbatuar Ligjin për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës në kontekstin e mbrojtjes së viktimave të dhunës në familje. Deri më tani viktimat e dhunës në përgjithësi janë mbrojtur nëpërmjet dispozitave të Kodit Penal të Kosovës, ndërsa viktimat e dhunës në familje nëpërmjet dispozitave të Ligjit për Mbrojtjen e Viktimave të Dhunës në Familje, mirëpo deri më tani nuk janë aplikuar dispozitat e Ligjit nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës.

Avokati i Popullit vlerëson se zbatimi i këtij ligji që është në fuqi do të ishte një garanci që shteti t'i ofronte mbrojtje efektive edhe viktimave të dhunës në familje. Veprimet konkrete që do të ndërmerreshin nga institucionet përgjegjëse në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, në përputhje me këtë ligj, do të ndikonin drejtpërdrejt në respektimin e urdhërmbrojtjes së shqiptuar nga gjykata ndaj kryerësve të dhunës në familje, në parandalimin e veprimeve të mëtejme të dhunës, si dhe në parandalimin e përfundimit me fatalitet të rasteve të dhunës në familje.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit ka rekomanduar që prokuroria dhe gjykatat t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës. Ndërsa Ministria e Punëve të Brendshme dhe Policia e Kosovës t'i zbatojnë dispozitat e Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës; në përputhje me nenin 10 të Ligjit për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, të cilëve u Kufizohet Lëvizja me Vendim të Gjykatës, ta realizojnë mbikëqyrjen elektronike, t'i mbledhin, t'i përpunojnë dhe t'i raportojnë të dhënat që vijnë nga pajisja; t'i zbatojnë dispozitat e Udhëzimit Administrativ për realizimin e mbikëqyrjes elektronike dhe raportimin nga Policia e Kosovës, për personat të cilëve u kufizohet lëvizja.

### **Raport ex-officio nr. 434/2020 përkitazi me kufizimet e ofrimit të shërbimeve shëndetësore gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë**

Raporti ka për qëllim të vlerësojë realizimin efektiv të të drejtave shëndetësore gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, në raport me qasjen në kujdes dhe në trajtim shëndetësor, kryesisht në institucionet e nivelit sekondar dhe terciar, duke u fokusuar në veçanti tek kufizimet në ofrimin e shërbimeve shëndetësore (vizitat specialistike dhe operacionet elektive) për personat që nuk ishin të infektuar me COVID-19.

Mbrojtja e të drejtave dhe e lirive themelore të njeriut është thelbësore dhe shumë e rëndësishme për një përgjigje efektive në parandalimin dhe trajtimin e rasteve me COVID-19,

por pa lënë anash cilindo qytetar që kërkon shërbime në institucionet shëndetësore me fokus të veçantë të grupet e ndjeshme<sup>244</sup> dhe personat e tjerë, të cilëve u duhet përkujdesje e vazhdueshme shëndetësore. Për më shumë, kjo është në funksion të përmbushjes së Agjendës së Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (Agjenda 2030)<sup>245</sup>, me fokus në përmbushjen e objektivit 3 - sigurimin e jetës së shëndetshme dhe promovimit të mirëqenies për të gjithë e për të gjitha moshat.

Raporti gjithsesi ka parasysh problemet e shtresuara dhe të trashëguara përgjatë viteve në sistemin shëndetësor në Kosovë dhe synon që duke vënë fokusin në vështirësitë që pandemia COVID-19 i nxori në pah, t'u rekomandojë autoritetet përgjegjëse për hapat që duhet të ndërmerren, me qëllim eliminimin gradual të problemeve në sektorin shëndetësor dhe progresin në ofrimin e shërbimeve shëndetësore. Në këtë drejtim, Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, siç është edhe Avokati i Popullit në Kosovë, luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimeve të shtetit, në arritjen e aplikimit të mbulimit shëndetësor universal.

Avokati i Popullit me këtë raport konstaton se institucionet përkatëse shtetërore nuk kanë përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore kundrejt qytetarëve dhe kjo kishte implikime negative drejtpërdrejt në shëndetin dhe në jetën e personave që potencialisht kanë pasur nevojë për shërbime shëndetësore. Veprimi i autoriteteve shëndetësore përkitazi me ndërprerjen e operacioneve elektive dhe ambulancave specialiste, përveçse nuk kishte bazë juridike, nuk kishte lënë asnjë lloj alternative se ku mund të trajtoheshin.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës që të rritet buxheti për nevojat e ShSKUK-së dhe të MSh-së, në mënyrë që mungesat financiare të mos reflektojnë tek ofrimi i shërbimeve, në të gjitha nivelet e sistemit shëndetësor; derisa të fillojë zbatimi për Sigurimin Shëndetësor, në situatat kur shërbimet shëndetësore nuk mund të ofrohen nga sektori publik, qytetarëve t'u mundësohet që këto shërbime t'i marrin nga sektori privat dhe qeveria t'i marrë përsipër shpenzimet.

Ministresë së Shëndetësisë i rekomandoi që të funksionalizohet Sistemi Unik dhe i Integruar i Informimit Shëndetësor, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 49 të Ligjit për Shëndetësi; të ndërmerren të gjitha masat ligjore për t'i detyruar institucionet private shëndetësore që t'i grumbullojnë të dhënat shëndetësore, t'i ruajnë dhe t'i raportojnë ato në Sistemin Informativ Shëndetësor, në pajtim me Udhëzimin Administrativ (MSh) nr. 11/2013, Sistemi i Informatave Shëndetësore dhe Raportimi i të Dhënave Statistikore Shëndetësore.

Ndërsa Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës i rekomandoi që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe t'i krijojë të gjitha parakushtet që vizitat specialiste në ambulancat specialiste dhe operacionet elektive në sallat operative të kryhen pa pengesa në njësitë përkatëse të ShSKUK-së, në mënyrë që situatat e shmangies nga këto të drejta pa bazë ligjore të mos përsëriten në të ardhmen; të vazhdojë me vendosjen e rezervuarëve

244 Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, grupe senzitive i përcakton: *"Familjet një prindërore, fëmijët jetim, të varfrit ekstrem, viktimat e trafikimit, të sëmurit kronik, të moshuar, të burgosurit, të pa strehët, përdoruesit e drogës me injektim, të sëmurët mental e veçmas PTSD (post-traumatic stress disorders) - personat me çrregullime post-traumatike."*

245 Agjenda 2030 përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Ato janë thirrje urgjente për veprim për të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim për një partneritet global në zbatimin e tyre. Objektivat kanë synimin kryesor për t'i dhënë fund varfërisë dhe privimeve të tjera, përmes zhvillimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve strategjike që përmirësojnë shëndetin, arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, ka miratuar njëzëri rezolutën për OZhQ.

të oksigjenit në spitalet e përgjithshme ku është e nevojshme, që të mos përsëriten situata të mungesës së oksigjenit për pacientët.

### **Raporti A.nr.645/2020 dhe A.nr.650/2020, në lidhje me diskriminimin për pranimin e kandidatëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021 në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”**

Raporti tërheq vëmendjen e Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” (më tej: UP) përkitazi me kriterin e parashikuar nga UP-ja në Konkursin për pranimin e kandidatëve në studimet e doktoratës për vitin akademik 2020/2021, i datës 9 shtator 2020, me nr.prot.2/262, konkretisht në pikën 13, që përcakton: *“Kandidatët i nënshtrohen parimit të ndalimit të konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi, Kodit të Etikës dhe Udhëzuesit për Parandalimin e Konfliktit të interesit të Këshillit të Etikës në UP. Në mënyrë të veçantë, do të konstatohet që ekziston konflikt i interesit nëse kandidati/kandidatja ka në lidhje të drejtë gjaku një apo më shumë anëtarë të personelit akademik të njësisë akademike përkatëse.”* Ankuesit pretendojnë se janë diskriminuar në konkursin publik, i shpallur më 23 tetor 2020, me nr.prot.2/262.

Raporti konstaton se konkursi për studimet e doktoratës, i datës 23 tetor 2020, me nr.prot.2/262, përbën diskriminim. Tutje raporti konstaton se ankuesit në rastin konkret janë kandidatë për doktoratë, janë fëmijë dhe të afërm të profesorëve në Fakultetin Ekonomik dhe në Fakultetin e Mjekësisë në UP, megjithatë ata duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë në raport me kandidatët e tjerë. Trajtimi i pabarabartë përbën një praktikë në kundërshtim me konceptin e barazisë para ligjit, i përcaktuar me nenin 24 të Kushtetutës.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” që të krijojë politika të përshtatshme për të parandaluar urgjentisht çdo praktikë që paraqet trajtim të pabarabartë me rastin e publikimeve të konkurseve publike të tilla, si dhe ta anulojë kriterin diskriminues të përcaktuar në pikën 13 të Konkursit për studimet e doktoratës të UP-së, i datës 23 tetor 2020, me nr.prot.2/262, që: *“Kandidatët i nënshtrohen parimit të ndalimit të konfliktit të interesit sipas legjislacionit në fuqi, Kodit të Etikës dhe Udhëzuesit për Parandalimin e Konfliktit të interesit të Këshillit të Etikës në UP. Në mënyrë të veçantë, do të konstatohet që ekziston konflikt i interesit nëse kandidati/kandidatja ka në lidhje të drejtë gjaku një apo më shumë anëtarë të personelit akademik të njësisë akademike përkatëse.”* Po ashtu raporti rekomandon që UP-ja në të ardhmen dilemat e tilla për vlerësim të konfliktit të interesit t'i adresojë pa zvarritje në institucionin përgjegjës për vlerësimin e konfliktit të interesit-Agjencisë Kundër Korrupsionit, si organ përgjegjës.

### **Raport ex officio nr. 150/2021 përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën në jetë dhe mbrojtjen nga dhuna në familje**

Hetimi i këtij rasti është iniciuar sipas detyrës zyrtare duke u bazuar në raportimet e mediave të shkruara dhe elektronike, të cilat raportuan se më 14 mars 2021, në lagjen Emshir në Prishtinë, u gjetën të vrarë me armë zjarri një grua (me inicialet: S. S.) dhe një burrë (me inicialet: L. S.). Në këtë drejtim, mediat raportuan se dyshohej se bëhej fjalë për vrasje dhe vetëvrasje, duke precizuar se e vrara dhe i vetëvrari ishin bashkëshortë për shumë vite dhe nga kjo bashkësi martesore kishin katër fëmijë, por si pasojë e dhunës në familje, bashkëshortët jetonin të ndarë dhe kishin filluar procedurën e shkurorëzimit. Më tej u raportua se S. S. dy herë e kishte raportuar rastin e dhunës në familje, por velërsohej se autoritetet përkatëse nuk kishin ndërmarr masat e duhura dhe si rrjedhojë kishte përfunduar tragjikisht.<sup>246</sup> Kishte edhe reagime të ndryshme edhe nga organizata të shoqërisë civile, si

246 Shih linkun: <http://www.ekonomia-ks.com/sq/siguri/shteti-po-deshton-ne-mbrojtjen-e-gruas>



Rrjeti i Grave të Kosovës, e cilat theksoi se dhuna ndaj S. S. u neglizhua nga institucionet e drejtësisë në vend.<sup>247</sup>

Raporti ka për qëllim vlerësimin e aplikimit të parimeve kryesore të detyrimeve pozitive të shtetit përkitazi me të drejtën për jetë, lidhur me vrasjen dhe vetëvrasjen e cila ndodhi më 14 mars 2021, në lagjen Emshir në Prishtinë, me ç' rast mediat raportuan se një burrë ka vvarë me armë zjarri gruan e vet, e pastaj bëri vetëvrasje. Gjithashtu raporti vlerësoi aplikimin e dispozitave kushtetuese, instrumenteve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ligjeve, politikave dhe strategjive kundër dhunës në familje.

Avokati me këtë raport konstaton se institucionet përkatëse edhe përkundër faktit se nga viti 2013 është hartuar Procedura Standarde e Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje në Kosovë, në të cilën janë përcaktuar edhe lista të kontrollit për veprimet që autoritetet përgjegjëse janë të obliguara t'i ndërmarin, në rastin që është objekt i trajtimit të këtij raporti, këto procedura nuk janë respektuar. Autoritetet përgjegjëse nuk e kishin vlerësuar mjaftueshëm rrezikun potencial të rastit, edhe pse viktima kishte deklaruar për vazhdimësinë e veprimeve të L. S. dhe kishte dhënë indikacione të problemeve me shëndetin mendor.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandoi Policisë së Kosovës që të formojë komision profesional (ad-hoc) për t'i vlerësuar veprimet e zyrtarëve përgjegjës policor përkitazi me rastin e dhunës në familje, i paraqitur më 3 mars 2021 në Stacionin Policor të Graçanicës, nëse të njëjtët kishin vepruar në pajtim me Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, si dhe me Ligjin për Mbrojtje nga Dhuna në Familje; të kërkojë nga të gjitha stacionet policore që në rastet kur ballafaqohen me raportim të dhunës në familje, zyrtarët përgjegjës të veprojnë në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit; të kërkojë nga të gjitha stacionet policore që në rastet kur ballafaqohen me raportim të dhunës në familje, zyrtarët përgjegjës të veprojnë në përputhje me nenin 24, paragrafi 4, të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial i rekomandoi që nëpërmjet Akademisë së Drejtësisë, të organizohen module të veçanta trajnimi për gjyqtarë dhe prokurorë për vlerësimin e rrezikshmërisë së rasteve të tilla dhe masat që duhen ndërmarrë për pengimin e dhunës në familje; Këshilli Gjyqësor të kërkojë nga të gjithë gjykatësit që në të gjitha rastet kur marrin vendim për urdhër-mbrojtjeje, të veprojnë në pajtim me nenin 17, paragrafi 2, të Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje.

Ndërsa Zyrës për Mbrojtje dhe Ndihmë Viktimave i rekomandoi që nëpërmjet trajnimeve adekuate, të ngrejë kapacitete profesionale të mbrojtësve të viktimave, që gjatë ushtrimit të detyrave të punës të jenë në gjendje t'i kuptojnë nevojat e viktimave të dhunës në familje dhe trajtimin e palëve përgjegjëse, që situatat e dhunës në familje të mos përsëriten.

### **Raport ex-officio nr. 698/2020 në lidhje me qasjen në shërbime të kujdesit shëndetësor të personave të prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB), gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë**

Masat e ndërmarra për ta kontrolluar COVID-19 dhe ridrejtimi i burimeve shëndetësore në luftimin e kësaj pandemie kanë vështirësuar punën në parandalimin, trajtimin dhe kujdesin e grupeve të rrezikuara, siç janë: njerëzit e prekur me Virusin e Imunodeficiencës Humane (HIV) dhe me Tuberkuloz (TB). Kjo gjë ka kërcënuar përparimin drejt synimeve botërore për eliminimin e këtyre sëmundjeve dhe ka pasur ndikim negativ në të drejtat e tyre. Investimi jo i mirë në sistemin shëndetësor ka zvogëluar aftësinë për t'iu përgjigjur kësaj pandemie

247 Shih linkun: [https://twitter.com/KWN\\_Rrggk/status/1372478958126653447](https://twitter.com/KWN_Rrggk/status/1372478958126653447)

dhe njëkohësisht ka ndikuar në mosofrimin e shërbimeve të tjera shëndetësore. COVID-19 po tregon se aplikimi i mbulimit shëndetësor universal (MShU)<sup>248</sup> duhet të jetë imperativ i së ardhmes.<sup>249</sup> Kjo do të arrihet vetëm atëherë kur shtetet do të kenë ngritur sisteme të qëndrueshme shëndetësore, që janë në gjendje t'u përgjigjen kërkesave themelore të qytetarëve të tyre, në mënyrë të barabartë, të drejtë dhe pa diskriminim, pa lënë askënd prapa. Në këtë drejtim, institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut, siç është edhe Avokati i Popullit, luajnë një rol të rëndësishëm në monitorimin e veprimeve të shtetit, në arritjen e qasjes universale për këto grupe.

Raporti ka dy qëllime kryesore: Të vlerësojë ofrimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor, me qasje të bazuar në të drejtat e njeriut dhe pa diskriminim, për personat me HIV/AIDS dhe TB në Kosovë gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, në ndërlidhje me mbulimin shëndetësor universal, si objektivë e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm.<sup>250</sup> Dhe, të tërheqë vëmendjen për rëndësinë e trajtimit të personave me HIV/AIDS dhe TB, duke pasur parasysh pasojat e dëmshme që mund të ketë mostrajtimi i tyre i vazhdueshëm si dhe të japë rekomandime lidhur me veprimet që duhet të ndërmerren nga autoritetet përgjegjëse për përmirësimin e gjendjes aktuale me fokus në respektimin e plotë të të drejtave të njeriut.

Raporti konstaton shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut, meqë autoritetet përkatëse nuk kanë arritur t'i përmbushnin detyrimet kushtetuese dhe ligjore kundrejt personave të afektuar me HIV/AIDS dhe me TB, si pasojë e gjendjes së krijuar nga pandemia COVID-19.

Nëpërmjet këtij raporti Avokati i Popullit ka adresuar rekomandime Ministrisë së Shëndetësisë që nëpërmjet Zyrës së Koordinatorit për Programin e HIV dhe AIDS, ta mbikëqyrë trajtimin e personave me HIV dhe AIDS, që të njëjtët të mos ndihen të diskriminuar, të nëpërkëmbur dhe të lënë pas dore gjatë trajtimit në Klinikën Infektive dhe në institucionet e tjera shëndetësore; ta funksionalizojë Qendrën për Këshillim dhe Testim Vullnetar në Klinikën Infektive, duke u siguruar që pacientët t'i marrin të gjitha shërbimet e nevojshme sipas standardeve me të mira ndërkombëtare; nëpërmjet Zyrës së Koordinatorit për Programin e TB, të kërkojë nga klinikat/repartet gjegjëse që gjatë trajtimit spitalor eventual për pacientët me TB, t'i krijojnë kushtet/infrastrukturën e nevojshme që ata të mos jenë burim infeksioni për pacientët e tjerë dhe anasjelltas; t'i ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për rritjen e numrit të pulmologëve në Klinikën Pulmologjike dhe në spitale të tjera të përgjithshme, sipas nevojës; ta funksionalizojë sistemin digjital të monitorimit të trajtimit dhe të marrjes së terapisë së pacientëve me TB (monitoruesit digjital dhe video-terapia, sipas udhëzimeve të OBSH-së); të kërkojë nga resorët përgjegjës që të funksionalizohen ekipet patronazhe për gjurmim të rasteve të reja në terren me fokus në parandalimin e përhapjes së TB-së.

248 Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, Mbulimi Shëndetësor Universal (MShU) nënkupton që të gjithë njerëzit dhe komunitetet mund t'i shfrytëzojnë shërbimet shëndetësore promovuese, parandaluese, shëruese, rehabilituese dhe paliative që u nevojiten, të cilësisë së mjaftueshme për të qenë efektive, duke siguruar po ashtu që shfrytëzimi i këtyre shërbimeve nuk e ekspozon përdoruesin ndaj vështirësive financiare.

249 Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Përmbledhje politikash lidhur me të drejtat e njeriut dhe COVID-19, i qasshëm në: [https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un\\_policy\\_brief\\_on\\_human\\_rights\\_and\\_covid\\_23\\_april\\_2020.pdf](https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/un_policy_brief_on_human_rights_and_covid_23_april_2020.pdf), faqe 4

250 Agjenda 2030 përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Ato janë thirrje urgjente për veprim për të gjitha vendet e zhvilluara dhe për ato në zhvillim për një partneritet global në zbatimin e tyre. Objektivat kanë synimin kryesor për t'i dhënë fund varfërisë dhe privimeve të tjera, përmes zhvillimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve strategjike që përmirësojnë shëndetin, arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, miratoi njëzëri rezolutën për OZhQ.

Ndërsa Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës i është rekomanduar që t'i ndërmarrë të gjitha veprimet për ngritjen e kapaciteteve profesionale të zyrtarëve të Klinikës Infektive, të cilët punojnë me pacientët me HIV dhe AIDS, në kuptim të zbatimit praktik të ligjit dhe të respektimit të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Të nxjerrë qarkore me *shkrim* dhe t'i informojë të gjitha njësitë vartëse, të cilat punojnë me pacientët me HIV dhe AIDS, përkitazi me detyrimin dhe obligimin, t'ua kumtojnë pacientëve rezultatet e analizave me shkrim, në pajtim me ligjin; në bashkëpunim me njësitë vartëse, t'i ndërmarrë masat e nevojshme që Dhoma nr. 2 e Repartit A (e dedikuar për nevojat e trajtimit të personave me HIV dhe AIDS) në Klinikën Infektive në Prishtinë të përdoret vetëm për nevojat e trajtimit të tyre, në mënyrë që ata të ndihen të papenguar nga personat e tretë.

### **Raport për rastin A. nr. 822/2017, A. nr. 864/2018, A. nr. 571/2019 dhe A. nr. 518/2020 lidhur me diskriminimin në zbatimin e së drejtës së lirit nga detyrimet e importit për automjete të pasagjerëve për personat me paraplegji dhe tetraplegji si dhe për persona të verbër**

Dogana e Kosovës ua mundëson privilegjin e lirit nga zhdoganimi doganor i automjeteve vetëm një kategorie të personave me aftësi të kufizuara nga mosha 18 vjeç dhe të cilët posedojnë patentë shoferi, duke i trajtuar kështu njësoi kategoritë e ndryshme të personave me aftësi të kufizuara dhe duke mos marrë parasysh dhe bërë dallim në bazë të shkallës dhe natyrës së mungesës së aftësisë së tyre fizike.

Duke vendosur një kusht të përgjithshëm (posedimin e patentë shoferit) për të gjitha kategoritë e personave me aftësi të kufizuara, Dogana e Kosovës i përjashton personat me paraplegji, tetraplegji, personat e verbër, si dhe personat e tjerë me aftësi të kufizuara që ta gëzojnë të drejtën e dhënë ligjërisht për privilegjet doganore në fjalë. Kushti i vënë për përfituesit e së drejtës në fjalë, për shkak të natyrës së invaliditetit të tyre, është një kusht objektivisht i pamundur, të cilin ata nuk mund ta plotësojnë në asnjë mënyrë dhe i vendosë ata në një pozitë të pabarabartë në raport me kategorinë tjetër të personave me aftësi të kufizuar, për të cilët, për nga natyra dhe shkalla e aftësisë së tyre të kufizuar ky kusht është i arritshëm.

Avokati i Popullit konsideron se qëllimi i së drejtës për përfitime të caktuara që u jepen personave me aftësi të kufizuar duhet të pasqyrohet në parimin e qasjes së barabartë të të drejtave të dhëna për të gjithë, bashkë me kushtet dhe mënyrën e duhur të përdorimit të tyre, duke u nisur nga këndvështrimi i llojit dhe i shkallës së invaliditetit të tyre.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandon Doganës së Kosovës, që pa vonesa të mëtejshme, të krijojë kushte për zbatimin e plotë të së drejtës së dhënë me ligj për lehtësimet doganore, në lidhje me importin e automjeteve të pasagjerëve, të përshtatura për nevojat e personave me paraplegji dhe tetraplegji, si dhe për personat e verbër, me mundësi të ushtrimit indirekt të të drejtave të përfituesit përmes kujdestarit ligjor ose personave të autorizuar, të pajisur me patentë shoferi (neni 10 i Ligjit për Statusin dhe të Drejtat e Personave me Paraplegji dhe Tetraplegji, dhe neni 6 i Ligjit për Personat e Verbër.). Po ashtu i ka rekomanduar Doganës së Kosovës që në të ardhmen, praktikën e vet ta harmonizojë me legjislacionin kundër diskriminimit, të ketë kujdes të përmbahet nga bërja e pajustificuar e dallimeve ose e trajtimeve të pabarabarta (siç është: përjashtimi, kufizimi ose dhënia e përparësive) në raport me personat ose me grupet e *personave që bazohet në një karakteristikë personale me praktikën dhe me vendimet e veta.*

**Mendimi Juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e Mikut të Gjykatës (Amicus Curiae) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për mbrojtjen nga dhuna në familje si dhe kundër diskriminimit në bazë gjinore**

Më 12 mars 2021, Avokati i Popullit ia ka dërguar GjThP-së Mendimin Juridik në lidhje me Padinë A-1483/2019 të ankueses L.A.K. kundër Policisë së Kosovës.

Ky Mendim Juridik, (*Amicus Curiae*) përqendrohet në sqarimin e bazës dhe të analizës ligjore përkitazi me ankesën së znj. L.A.K. në lidhje me mosveprimin e shtetit sa u përket detyrimeve pozitive përkitazi me mbrojtjen nga dhuna në familje dhe në lidhje me diskriminimin në bazë të gjinisë.

Avokati i Popullit, në bazë të të gjeturave dhe të fakteve të mbledhura, si dhe analizimit të ligjeve relevante, të cilat e përcaktojnë të drejtën për jetë dhe detyrimet pozitive të shtetit për të drejtën për jetë, ka konstatuar shkelje të të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut. Është konstatuar se Policia e Kosovës nuk i ka përmbushur detyrimet kushtetuese dhe ligjore, e as standardet ndërkombëtare të aplikueshme në Republikën e Kosovës, për të ndërmarrë veprime konkrete për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

Avokati i Popullit vlerësoi se Policia e Kosovës, me rastin e refuzimit të regjistrimit të rastit të ankueses, nuk ka ndërmarrë masa parandaluese dhe efektive për të penguar dhunën në familje, për të mënjeluar rrezikun ndaj viktimës që ka mundur të sillte edhe pasoja serioze.

**Mendim juridik i Avokatit të Popullit në cilësinë e mikut të gjykatës (amicus curiae) drejtuar Gjykatës Themelore në Prishtinë, përkitazi me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, respektivisht mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike për personat me aftësi të kufizuar në hapësirat publike dhe private në Komunën e Prishtinës**

Avokati i Popullit, më 2 dhjetor 2021 ia ka dërguar GjThP-së mendimin juridik në lidhje me Padinë C.nr.3663/18 të ankuesit F. K. kundër Komunës së Prishtinës, përkitazi me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, respektivisht mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike për personat me aftësi të kufizuar në hapësirat publike dhe private në Komunën e Prishtinës.

Ky mendim juridik në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) fokusohet në sqarimin e bazës dhe të analizës ligjore përkitazi me ankesën e F. K., drejtor i organizatës Handikos në Prishtinë dhe shfrytëzues i karrocës elektrike si mjet për lëvizje, i cili ka parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP) kundër Komunës së Prishtinës, përkitazi me padinë e parashtruar në Gjykatën Themelore në Prishtinë (GjThP), e datës 12 dhjetor 2018, me numër të lëndës C.nr.3663/18, me pretendimet për diskriminim në bazë të aftësisë së kufizuar, gjegjësisht për mosrespektimin e dispozitave ligjore lidhur me krijimin e kushteve të përshtatshme fizike në hapësirat publike në komunën e Prishtinës për personat me aftësi të kufizuar.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se personat me aftësi të kufizuara, pavarësisht aftësive të tyre, kanë të drejta dhe nevoja për të cilat shoqëria, shteti dhe posaçërisht qeverisja lokale, duhet t'i përmbushin në bazë të konventave, standardeve ndërkombëtare, si dhe të legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se mosdhënia e një përshtatjeje/akomodimi të arsyeshëm për personat me aftësi të kufizuar, në përputhje me nevojat e tyre specifike, përbën diskriminim mbi bazën e aftësisë së kufizuar, të përcaktuar sipas nenit 1 të Ligji nr.05/L-021 për Mbrojtje nga Diskriminimi, si dhe është në kundërshtim me praktikën ndërkombëtare.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Komuna e Prishtinës, me një angazhim dhe me një buxhet të përballueshëm, mund t'i rregullojë pjerrinat dhe të krijojë kushte të përshtatshme në Prishtinë për qasjen fizike për personat me aftësi të kufizuara, të cilat obligime dalin nga Ligji për Mbrojtje nga Diskriminimi, nga Ligji për Vetëqeverisje Lokale si dhe nga Udhëzimi Administrativ nr.33/2017 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Avokati i Popullit rikujton se në bazë të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi, barra e provës i bie palës së paditur, prandaj Komuna e Prishtinës duhet të dëshmojë se nuk ka pasur shkelje të parimit të trajtimit të barabartë. Përcaktimi i lokacioneve në Prishtinë nga pala paditëse në gjykatë, që has në pengesa fizike dhe të cilat i konsideron që janë në kundërshtim me standardet ekzistuese të ndërtimit dhe me Udhëzimin Administrativ nr.33/2007 për Kushtet Teknike të Objekteve Ndërtimore për Qasjen e Personave me Aftësi të Kufizuara, përbën kufizim të qasjes fizike të ankuesit dhe të personave të tjerë me aftësi të kufizuara, por në rastin konkret, Komuna e Prishtinës duhet t'i ofrojë informata GjThP-së në atë mënyrë përmes së cilës do të vlerësohej situata ekzistuese e kushteve fizike për qasjen e personave me aftësi të kufizuara.

## **NDALIMI I TORTURËS, TRAJTIMIT MIZOR, ÇNJERËZOR OSE POSHTËRUES**

### **Raportet e Avokatit të Popullit në cilësinë e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës**

#### **Të drejtat e personave të privuar nga liria dhe ndikimi i pandemisë COVID-19 nga këndvështrimi i Mekanizmit Kombëtar për Parandalim të Torturës**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit (MKP), për shkak të paraqitjes së rasteve me COVID-19 dhe duke u bazuar në parimin e mosshkaktimit të dëmit më të madh, vendosi t'i pezullonte vizitat në vendet e privimit nga liria, deri në ndryshimin e gjendjes. Njëkohësisht, Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) mori vendim për të ndaluar për një kohë të caktuar të gjitha vizitat familjare në të gjitha qendrat korrektuese dhe të paraburgimit.

Më 12 mars 2020, Departamenti Shëndetësor i Burgjeve (DShB), bazuar në vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, mori masa shtesë për parandalimin e COVID-19 në burgje. Njoftimi për këto masa shtesë iu dërgua ministrive relevante dhe institucioneve të tjera kompetente. Një ndër këto masa ishte edhe kufizimi i lëvizjeve të të burgosurve brenda dhe jashtë institucionit korrektues apo të paraburgimit, për aq sa kjo nuk e dëmtonte shëndetin e askujt. Këto masa u ndërmorën përmes urdhrave operacionalë. Ndërsa në shtator 2020, MKP-ja rifilloi vizitat në vendet e privimit nga liria. Nga muaji mars 2020 deri në gusht 2021 janë realizuar 53 vizita në të gjitha vendet e privimit nga liria, përfshirë këtu edhe Qendrën e Mbajtjes për të Huajt dhe qendrat për azilkërkues.

MKP-ja përmes vizitave të deritanishme ka vërejtur se shërbimet shëndetësore në përgjithësi ishin adekuate, furnizimi me barna ishte në nivel të kënaqshëm, dhe personeli shëndetësor në dispozicion ishte në nivel të kënaqshëm. Autoritetet shëndetësore ndërmorën masa shëndetësore për të luftuar dhe parandaluar pandeminë COVID-19, të burgosurve iu siguruan udhëzime se si të respektoheshin këto masa, si dhe iu siguruan informata për COVID 19.

Nga informatat e grumbulluara përmes vizitave dhe takimeve me zyrtarët kompetentë të ShKK-së, Avokati i Popullit u njoftua se deri më tani një zyrtar i ShKK-së humbi jetën si pasojë e COVID-19 dhe 237 të tjerë u infektuan. Si pasojë e infektimeve, autoritetet e

burgjeve u detyruan t'i përdornin edhe zyrtarët e njësisë të tjera për t'i plotësuar nevojat e tyre me personel. Në radhët e të burgosurve pati 44 të infektuar dhe 5 të vdekur.

Lidhur me sfidat për kryerjen e punës dhe sfida të tjera, MKP-ja më 18 qershor 2021, zhvilloi takim me zyrtarët kompetentë të Policisë së Kosovës, ku u njoftua se si pasojë e pandemisë COVID-19, deri më tani 4109 zyrtarë policorë ishin në vetizolim, 1942 të infektuar dhe 22 zyrtarë policorë nuk arritën t'i mbijetojnë infektimit.

Avokati i Popullit konstaton se kufizimi i të drejtave dhe i lirive të caktuara të personave të privuar nga liria e tyre në parim ishte i domosdoshëm, proporcional, i bazuar në ligjet vendore, në rekomandimet e institucioneve kompetente shëndetësore të vendit dhe në rekomandimet e OBSH-së, si dhe të organizatave të tjera, të cilat monitorojnë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria e tyre.

Vendimet për kufizime të të drejtave të të burgosurve, të cilat kufizojnë të drejtat themelore, nuk iu referuan dispozitave të LESP-së dhe as Udhëzimit Administrativ për Rendin Shtëpiak në Institucionet Korrektuese. Kufizimet iu nënshtruan rishikimit të kohëpaskohshëm dhe varësisht nga gjendja në vend me pandeminë COVID-19, këto masa u ashpërsuan apo u lehtësuan. Ndërsa kufizimi i së drejtës për kontakte me botën e jashtme u kompensua përmes ofrimit të llojeve të tjera të komunikimit (SKYPE, shtimit të telefonatave). Po ashtu në periudha të caktuara pati kufizime të së drejtës për t'u takuar dhe komunikuar me avokatin mbrojtës.

### **Raport për vizitën në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, në Mitrovicë dhe në Vranidoll**

Më 14 janar 2021, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, si pjesë e Institucionit të Avokatit të Popullit, realizoi vizitë në Qendrën për Azilkërkues në Magurë, më 19 janar 2021, realizoi vizitë në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë, ndërsa më 25 janar 2021 realizoi vizitë në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll.

Të gjeturat nga vizitat iu dërguan autoriteteve kompetente me raport me rekomandime më 23 shkurt 2021. Qëllimi i vizitave në qendrat e lartpërmendura për akomodim të azilkërkuesve ishte vlerësimi i respektimit të të drejtave themelore të azilkërkuesve nga autoritetet e Republikës së Kosovës në pajtim me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të mishëruara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Qendra për Azilkërkues në Mitrovicë, pas shpërthimit të zjarrit në një pjesë të saj, u mbyll, ndërsa azilkërkuesit u transferuan në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll.

Gjatë vizitave të realizuara, MKP-ja ka evidentuar se në Qendrën për Azilkërkues në Magurë ishin të vendosur 57 azilkërkues, në Qendrën për Azilkërkues në Mitrovicë ishin 55 azilkërkues, ndërsa në Qendrën për Azilkërkues në Vranidoll ishin 61 të tillë.

Të gjithë azilkërkuesit janë shprehur në favor të një trajtimi shumë të mirë dhe human nga zyrtarët e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe nga Policia e Kosovës. Përveç kësaj, MKP-ja ka vërejtur komunikim shumë miqësor dhe interaktiv ndërmjet azilkërkuesve dhe zyrtarëve policorë dhe atyre të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Gjatë kësaj periudhe, qendrat për azilkërkues, bazuar në vendimet e marra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe nga Ministria e Shëndetësisë, kohë pas kohe morën vendime me qëllim të parandalimit dhe të luftimit të pandemisë, të cilat kufizuan të drejtat e azilkërkuesve. Vendimet për këto masa janë sqaruar edhe në gjuhë të tjera (arabe, angleze, serbe etj.).

Përmes raportit me rekomandime, MKP-ja i rekomandoi Ministrisë së Punëve të Brendshme që të evitohen mangësitë teknike të funksionimit të sistemit të kanalizimit në mënyrë që azilkërkuesit të kenë trajtim të denjë dhe human dhe të angazhohet personeli i nevojshëm në të gjitha qendrat për azilkërkues.

### **Raport për vizitën në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll**

MKP-ja më 20 janar 2021 realizoi një vizitë të përgjithshme në Qendrën e Mbajtjes për të Huajt në Vranidoll. Në pikëpamje të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, paraburgimi (dërgimi i të huajit në mbajtje) duhet të jetë masa e fundit të cilën e zbatojnë autoritetet e një shteti për ta larguar të huajin nga territori, i cili është subjekt i kthimit me forcë. MKP-ja vëren se Ligji 04/L-219 për të Huajt i Republikës së Kosovës parasheh se masat e tjera alternative kanë përparësi në raport me dërgimin e të huajit në mbajtje.

MKP-ja, gjatë vizitës, ka vërejtur se të huajt në QMH informohen për të drejtat e tyre, përmes broshurave të shkruara në gjuhët më të shpeshta dhe në gjuhën arabe. Përveç kësaj, ata njoftohen për të drejtat e tyre nga përkthyesi i gjuhës arabe, i cili është angazhuar nga Organizata Ndërkombëtare për Migrim (IOM).

MKP-ja nuk ka marrë asnjë ankesë nga personat e intervistuar për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës fizike apo për sjellje nga zyrtarët e sigurisë dhe apo nga zyrtarët e QMH-së, e cila nuk do të ishte në pajtim me respektimin e dinjitetit të tyre.

Rekomandimi i dhënë në vitin 2019 që QMH-ja të nxirrte protokollet për vetminë, vetëlëndim, tentim vetëvrasje, abuzim seksual dhe të rasteve të vdekjeve, ishte përmbushur. Udhëheqësi kishte krijuar regjistrat sipas rekomandimit të MKP-së.

Bazuar në dosjet shëndetësore, 8 të huaj ishin me terapi psikiatrike dhe vështirë të menaxhueshëm, prandaj MKP-ja inkurajon institucionet kompetente që përveç rritjes së numrit të personelit në QMH, të angazhojnë së paku një infermier/infermiere, ashtu siç ka rekomanduar MKP-ja në raportin me rekomandime gjatë viteve 2018, 2019. Rekomandim që e përsëriti edhe në këtë vit, QMH-ja duhet të ketë në dispozicion së paku një infermier/e, i/e cila do ta shpërndante terapinë dhe do të kujdesej për dosjet mjekësore të të huajve në qendër. Po ashtu, Ministrisë së Punëve të Brendshme i ka rekomanduar që të shtohet numri i personelit si dhe të ofrohen trajnime adekuate për personelin e sigurisë për të punuar me këtë kategori.

### **Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese në Dubravë**

Edhe gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19, disa të drejta të të burgosurve, të cilat garantohej me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. -04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale (LESP), me ligjet e tjera relevante dhe me standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve, varësisht nga situata me COVID-19, u kufizuan dhe sërish u rikthyen pas përmirësimit të gjendjes me COVID-19. Këto të drejta në përgjithësi janë e drejta për kontaktet me botën jashtme, realizimi i vizitave familjare dhe vizitave të lira, zhvillimi i aktiviteteve të ndryshme brenda burgjeve, siç janë: të drejtat për aktivitete sportive, për punë, për trajnime dhe edukim, si dhe e drejta e lirisë fetare në aspekte të caktuara.

Gjatë vizitave në qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit në vitin 2021, MKP-ja nuk ka marrë ankesa të besueshme për keqtrajtim fizik apo për përdorim të tepruar të forcës fizike nga zyrtarët korrektues. Në përgjithësi, MKP-ja ka vërejtur komunikim dhe raporte të mira ndërmjet të burgosurve dhe zyrtarëve korrektues.

Gjatë vizitës në Qendrën Korrektuese në Dubravë (QKD), MKP-ja mori nga të burgosurit pohime për korrupsion dhe favorizime, që përfshijnë jo vetëm personelin korrektues, por edhe personelin shëndetësor. Lidhur me këto pretendime, MKP-ja ka vërejtur përpjekjen e Ministrisë së Drejtësisë dhe të Shërbimit Korrektues për t'i luftuar këto dukuri. Po ashtu, pati raste të arrestimeve dhe dënimeve ndaj zyrtarëve korrektues për të cilët u konstatua se kanë kryer shkelje disiplinore apo kanë kryer vepra penale të cilat ndërlidhen me veprime korruptive.

Numri i të burgosurve u reduktua dukshëm për shkak të pandemisë COVID-19. Gjatë vizitës ishin të pranishëm 572 të burgosur, ndërsa kapaciteti zyrtar i QKD-së është 1030 persona. Në pavijonet 2, 3 dhe 5, janë të nevojshme rinovime të caktuara, ndërsa në disa qeli kishte depërtuar lagështia.

MKP-ja u ka kushtuar vëmendje të veçantë kushteve të akomodimit të të burgosurve, të cilëve u ishte shqiptuar masa disiplinore e vetmisë, për shkak të shkeljeve disiplinore. MKP-ja ka vërejtur se kushtet e akomodimit në këto qeli janë në pajtim me standardet e përcaktuara me LESP-ja dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja.

MKP-ja ka vërejtur se të burgosurit në Qendrën Korrektuese në Dubravë, në përgjithësi janë furnizuar me dyshekë të rinj dhe batanije, si dhe me çarçafë, gjë që në të kaluarën përbënte problem serioz, pasi dyshekët e mëparshëm ishin të cilësisë së dobët dhe me lagështi. Megjithatë, MKP-ja ka hasur në raste kur të burgosurit ende nuk ishin furnizuar me dyshekë, çarçafë dhe batanije. Shqetësim që është përcjellë tek autoritetet.

Gjatë vizitës në QKD, MKP-ja, bazuar në dokumentacionin relevant, ka vërejtur se janë rreth 262 të burgosur të angazhuar në punë.

MKP-ja ka pranuar ankesa sa i përket trajtimit shëndetësor, disa nga këto ankesa u regjistruan për hetim të mëtejshëm. MKP-ja, në të gjitha rastet, përveç vizitave, kërkoi nga DShB-ja raporte të hollësishme për trajtimin shëndetësor të ankuesve në fjalë. Në asnjërin rast, MKP-ja nuk konstatoi shkelje serioze të të drejtës për trajtim shëndetësor, përveç disa rasteve kur për shkak të transportit i burgosuri nuk u dërgua menjëherë në trajtim mjekësor sipas rekomandimit të mjekut.

### **Raport për vizitën në Burgun e Sigurisë së Lartë**

MKP-ja ka vizituar BSL-në më 30 mars dhe më 12 prill dhe ka gjetur se në përgjithësi kushtet e akomodimit janë në nivel të kënaqshëm në shumicën e pavijoneve dhe të hapësirave të tjera, në kuptim të hapësirës, pastërtisë, si dhe qasjes në dritë natyrale dhe artificiale. Të gjitha qelitë kanë TV, tualete të ndara dhe të burgosurit mund të bëjnë dushe sa herë që duan. Përveç kësaj, qelitë janë të pajisura me krevate, me çarçafë, me tavolinë, me karrige dhe me sistem të thirrjes.

Megjithatë, MKP-ja ka vërejtur se dyshemetë në Pavijonin 2 (krahët D dhe E në korridore dhe nëpër qeli) janë dëmtuar shumë, për çka edhe e ka ripërsëritur rekomandimin për t'i mënjanuar dëmtimet. Lidhur me këtë rekomandim, më 1 shtator drejtori i BSL-së e ka njoftuar MKP-në se është duke u rinovuar dyshemeja e Pavijonit 2 dhe se kanë përfunduar rinovimet në katin e dytë. Gjithashtu, drejtori e njoftoi MKP-në se kanë filluar ndërmarrjen e veprimeve edhe sa u përket fushave sportive, të cilat për shkak të ngjyrës së bardhë janë problem gjatë kohës së verës për shkak të reflektimit.



Rreth 70% e të burgosurve janë të angazhuar në punë të ndryshme, siç është mirëmbajtja, pastrimi i pavijoneve, puna në kuzhinë, në punëtorinë për prodhim të letrës higjienike dhe të qeseve, nga ku furnizohen edhe institucionet e tjera të ShKK-së.

Të dënuarit mund të lëvizin të lirë brenda pavijoneve ku ishin të vendosur, përveç në rastin e të paraburgosurve. Të burgosurit kanë të drejtë për 3 orë shëtitje në ditë gjatë stinës së verës, kurse gjatë dimrit deri në 2 orë në ditë. Po ashtu, 10 të burgosur përfunduan trajnimin për menaxhim të zemërimit.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19 ShKK-ja kohë pas kohe u detyrua t'i ndalonte vizitat familjare, vizitat e lira, takimet me avokatët mbrojtës dhe kontakte të tjera me botën e jashtme. Pas përmirësimit të gjendjes, këto të drejta u rikthyen sërish dhe të burgosurit i gëzuan plotësisht ose pjesërisht.

Ndërsa kufizimi i së drejtës për kontakte me botën e jashtme u kompensua përmes ofrimit të llojeve të tjera të komunikimit (SKYPE, shtimit të telefonatave). Po ashtu në periudha të caktuara, varësisht nga gjendja me COVID-19, pati kufizime të së drejtës për t'u takuar dhe komunikuar me avokatin mbrojtës.

### **Raport për vizitën në stacionet policore në Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan**

Nga data 24 deri më 26 maj 2021, MKP-ja ka realizuar vizita në stacionet policore në Pejë, Istog, Klinë dhe Deçan. Gjatë këtyre vizitave, MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e arrestuar dhe as nga ata të cilët ishin në mbajtje në kohën e vizitës, për keqtrajtim fizik apo për mosrespektim të të drejtave themelore, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Megjithatë, bazuar në pretendimet e qytetarëve se policia ka përdorur forcë ndaj tyre, në vitin 2021, Institucioni i Avokatit të Popullit ka regjistruar 5 raste për hetim kundër Policisë së Kosovës.

Sa u përket të drejtave, si: njoftimi i familjes për arrestim, caktimi i avokatit sipas përzgjedhjes së tij ose sipas detyrës zyrtare dhe të drejtën për kontroll mjekësor, MKP-ja nuk ka pranuar ankesa që ndërlidhen me këto të drejta.

Procedura Standarde e Operimit, e cila u miratua nga Policia e Kosovës në tetor 2020, përcakton se qendrat e ndalimit duhet të jenë në përputhshmëri me Konventën Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (*KEDNj*) dhe me rekomandimet e KPT-së duke u bazuar në Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve e Ndëshkimeve të tjera Mizore Jonjerëzore dhe Poshtëruese.

Sa u përket kushteve fizike në qendrat e mbajtjes në stacione policore, MKP-ja, gjatë vizitave të realizuara në vitin 2021, ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara, sa u përket hapësirës, ndriçimit natyral, artificial dhe higjienës i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të ndaluar.

Megjithatë, u dhanë rekomandime për Stacionin Policor në Deçan pasi MKP-ja vërejtë se stacioni ka nevojë për renovime dhe inventar të caktuar, në mënyrë që të krijohen kushte më të mira për punë për zyrtarët policorë, si dhe qelitë të cilat nuk kanë dritë të mjaftueshme natyrore, por ka llamba e të cilat fatkeqësisht munden lehtë të kapen nga personat në

mbajtje, të cilët synojnë eventualisht të kryejnë ndonjë veprim tjetër të dëmshëm për ta dhe për të tjerët.

Sa u përket shërbimeve mjekësore, si e drejtë themelore, personave të cilët arrestohen apo ndalohen nga policia, këto shërbime u ofrohen nga institucionet publike, siç janë: Qendrat e mjekësisë familjare dhe Qendra Klinike Universitare, varësisht nga nevojat për trajtim. MKP-ja nuk ka marrë ankesa nga personat e intervistuar për mosrespektim të kësaj të drejte.

### **Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë**

Në raportin për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, MKP-ja, sa u përket kushteve të akomodimit në këtë qendër, ka vërejtur se qelitë, në kuptim të ndriçimit dhe ventilimit, nuk janë në pajtim me LESP-në dhe as me standardet e përcaktuar nga KPT-ja.

MKP-ja gjatë vizitës ka vërejtur se dhomat e të burgosurve ishin gëlqerosur, në kuadër të përpjekjeve për të krijuar kushte më të mira të akomodimit për të burgosurit. Megjithatë, përkundër gëlqerosjes, disa dhoma prapë kishin lagështi. MKP-ja është njoftuar se kjo qendër është furnizuar me dyshekë të rinj, çarçafë dhe jastëk. Të burgosurit mund të bënin dush dy herë brenda javës, kurse ata të cilët janë të angazhuar në punë mund të bënin dush çdo ditë. Megjithatë, MKP-ja ka vërejtur se hapësirat ku të burgosurit bëjnë dush dhe nyjat sanitare janë në gjendje shumë të keqe dhe nevojiten renovime të menjëhershme.

Edhe përmes këtij raporti, MKP-ja ka ripërsëritur rekomandimin që kushtet e akomodimit në QPP, përderisa kjo qendër është në përdorim, të jenë në pajtim me standardet e përcaktuara në LESP; me standardet e KPT-së dhe me standardet e tjera ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve.

### **Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë**

Qëllimi i vizitës në Qendrën Korrektuese në Smrekonicë (QKS) ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave të personave të dënuar, i shërbimeve shëndetësore të cilat u ofrohen, si dhe kushteve të akomodimit në pajtim me standardet vendore dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, vizita kishte për qëllim përcjelljen e rekomandimeve të dhëna për këtë qendër në raportin e vitit 2019.

MKP-ja vërejtë se në përgjithësi qelitë ku qëndronin të dënuarit, sa u përket madhësisë dhe ndriçimit natyral dhe artificial, në shumicën e qelive ku akomodohen të dënuarit, janë në pajtim me standardet e përcaktuar nga Komiteti për Parandalimin e Torturës dhe LESP-ja. Përveç kësaj, pavijoni i cili deri më tani u përdor si karantinë pas paraqitjes së pandemisë COVID-19, tani është në dispozicion të të burgosurve për banim dhe do të ofrojë edhe më shumë hapësirë për banim për të burgosurit.

MKP-ja vërejtë se në katin e dytë të ndërtesës është i nevojshëm renovimi i kulmit, nga ku depërtojnë të reshurat atmosferike dhe në disa qeli vërehej depërtimi i lagështisë në tavane. Lidhur me këtë, MKP-ja sërisht i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të rinovohet kulmi i pavijonit ku akomodohen të dënuarit. Më 3 nëntor 2021, Ministria e Drejtësisë e njoftoi MKP-në se është në dijeni të nevojës për rinovim urgjent të kulmit në katin e dytë dhe se është bërë planifikimi për rinovim, mundësisht, brenda vitit 2021.

### **Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë**

Më 29 korrik 2021, MKP-ja e vizitoi Qendrën e Paraburgimit në Mitrovicë (QPM). Qëllimi i vizitës ishte shqyrtimi i respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria. Në këtë qendër janë të vendosur të paraburgosur dhe të dënuar deri me 20 vjet.

MKP-ja gjatë vizitës vërejt se kushtet e akomodimit në përgjithësi ishin të pranueshme, përveç në raste të caktuara, në kuptim të hapësirës për banim për një të burgosur, ku kushtet e akomodimit nuk janë në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të të burgosurve dhe me standardet e KPT-së.

Po ashtu, MKP-ja mori ankesa nga të burgosurit për shkak të temperaturave të larta në qelitë e tyre. MKP-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të ndër marrin veprime për të evituar këtë mangësi, e cila është më e theksuar gjatë stinës së verës.

Përmes raportit me rekomandime për vizitën në këtë qendër, MKP-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që përderisa kjo qendër është në përdorim, të burgosurve duhet t'u garantohen kushtet e akomodimit në pajtim me LESP-në, me standardet ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve, si dhe me standardet e KPT-së.

Ministria e Drejtësisë, në përgjigjen e dërguar lidhur me këtë rekomandim, theksoi se po përgatitet projekti i kondicionimit së bashku me donatorë të organizuar nga OJQ-të, për vitin 2022, dhe se planifikon që brenda dy vjetëve të ardhshme të kryhen rinovime në shkallë të gjerë për të përmirësuar gjendjen sa u përket kushteve të akomodimit.

Gjatë vizitës së realizuar u vërejt se rreth 16 të dënuar janë të angazhuar në punë. Në kuadër të kësaj qendre funksiononin pesë punëtori, në të cilat të dënuarit mund të angazhohen në punë dhe në trajnime të ndryshme. MKP-ja **përmes raportit me rekomandime i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të paraburgosurve**, sa herë që një gjë e tillë është e mundur dhe plotësohen kriteret ligjore, t'u ofrohet punë dhe aktivitete të tjera të mirëfillta. Ministria e Drejtësisë, **në përgjigjen e dërguar**, theksoi se përmes ligjit për ShKK-në ka paraparë aktivizimin e njësisve ekonomike në qendrat korrektuese dhe kjo do të mundësojë edhe angazhimin e të paraburgosurve në disa aktivitetet pune, por për shkak të statusit të tyre si të paraburgosur, aktualisht mundësitë për angazhimin e tyre në punë dhe aktivitete të mirëfillta mbeten të kufizuara.

### Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë

MKP-ja më 5 tetor 2021 realizoi vizitë të përgjithshme në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë (QPP), me qëllim të vlerësimit të respektimit të të drejtave të personave të privuar nga liria, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës si dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

Sa u përket kushteve të akomodimit, MKP-ja ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit kanë dritë të mjaftueshme natyrore, hapësirë banimi, e cila shkon përtej standardit të përcaktuar me LESP dhe me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. Po ashtu, MKP-ja vërejt se ka qeli adekuate në dispozicion të të burgosurve me aftësi të kufizuara. Megjithatë, në disa qeli mungojnë orenditë adekuate për t'i vendosur gjësendet. Përmes raportit të lartpërmendur, MKP-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të furnizohen qelitë e të burgosurve me orendi të nevojshme për t'i vendosur gjësendet e tyre. Ministria e Drejtësisë u përgjigj se ShKK-ja, në dhjetor 2021, ka filluar procedurat për furnizime me ordeni dhe inventar të nevojshëm dhe se një rekomandim i tillë është edhe në raportin e KPT-së për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2020.

Për më shumë, MKP-ja vërejt se janë kryer disa rinovime me qëllim të evitimit të dëmtimeve në pjesë të caktuara të kësaj qendra, pasi, edhe pse është objekt i ri, u përball me probleme të shumta infrastrukturore menjëherë pas futjes në funksion.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja, në të gjitha raportet me rekomandime pas vizitave në qendrat e paraburgimit, ka konsideruar se bazuar në legjislacionin në fuqi, autoritetet kompetente duhet të bëjnë përpjekje që t'i rrisin angazhimet jashtë qelisë për të paraburgosurit në qendrat e tjera të paraburgimit, për aq sa një gjë e tillë është e mundur, dhe deri në shkallën sa nuk pengohet procedura penale.

### **Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Prizren**

Më 19 tetor 2021, MKP-ja realizoi vizitë në Qendrën e Paraburgimit në Prizren (QPPz), me qëllim të vlerësimit të përgjithshëm të situatës dhe trajtimit të personave të paraburgosur dhe të dënuar. QPPz ka kapacitet për 92 persona, ndërsa në kohën e vizitës ishin të vendosur 76 persona, prej tyre 60 të paraburgosur dhe 16 të dënuar.

MKP-ja vërejt se qelitë ku qëndronin të paraburgosurit kishin ndriçim të mjaftueshëm natyral dhe artificial dhe nuk kishin lagështi. Sa i përket hapësirës për banim për të burgosurit, në disa qeli, nuk është në pajtim me dispozitat e LESP-së dhe as me standardet e përcaktuara nga KPT-ja. MKP-ja ka vërejtur se jo të gjitha qelitë janë furnizuar me dyshekë të rinj. Kështu që, në disa qeli dyshekët janë të vjetërsuar dhe nuk janë ndërruar për kohë të gjatë dhe për pasojë, në disa shtretër ka depërtuar lagështia. Përmes raportit me rekomandime pas vizitës, MKP-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që kjo qendër të furnizohet në tërësi me dyshekë të rinj dhe cilësorë. Ministria e Drejtësisë, lidhur me këtë rekomandim, përmes një shkrese zyrtare e njoftoi MKP-në se në fund të muajit nëntor 2021, qendra u furnizua me 70 dyshekë, 70 jastëk, 140 batanije kundër zjarrit dhe se janë iniciuar procedurat edhe për 20 dyshekë të tjerë për nevojat e kësaj qendre.

MKP-ja mori ankesa nga disa shtetas të huaj për mungesë të veshmbathjeve. Shtetasit e huaj të cilët praktikojnë fenë islame, pohuan se për shkak të mungesës së rrobave adekuate, ata nuk janë në gjendje ta kryejnë faljen e namazit sipas dispozitave fetare islame. Bazuar në gjetjet e lartpërmendura, MKP-ja i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të burgosurit, sipas nevojës, të furnizohen me veshmbathje. Ministria e Drejtësisë në përgjigjen e dërguar theksoi se do të kërkojë nga ShKK-ja, që në pajtim me LESP-në, të sigurojë veshmbathje pa pagesë për të burgosurit, të përshtatshme për kushtet klimatike dhe stinën e vitit.

Numri i personeli mjekësor në të gjitha nivelet, në përgjithësi ishte adekuat në të gjitha qendrat korrektuese dhe në të paraburgimit. Të burgosurit dërgohen edhe në institucionet të tjera publike shëndetësore sipas rekomandimit të mjekut kompetent.

### **Raport për vizitën në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan**

Më 3 nëntor 2021, MKP-ja realizoi vizitë të përgjithshme në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan (QPGj), me qëllim të vlerësimit të kushteve të mbajtjes së personave të privuar nga liria të cilat u garantohen me ligjet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.

MKP-ja ka vërejtur se qelitë ku akomodohen të burgosurit janë në pajtim me LESP-në dhe me standardet e KPT-së, kanë ndriçim të mjaftueshëm, nuk kanë lagështi dhe po ashtu kanë ngrohje adekuate dhe pastërti. Në qeli janë të vendosur nga një ose dy të burgosur. MKP-ja mori ankesa nga të burgosurit për shtretër të papërshtatshëm, pasi ishin të dizajnuar në dy kate dhe personat e vendosur sipër nuk kishin kufizim anash (nuk kishin mbrojtje) dhe ishin të lartë, disa prej tyre vendosnin dyshekun në dysheme.

MKP-ja edhe në këtë qendër ka vërejtur se të burgosurve u mungojnë hapësira (dollarë) adekuate për të vendosur gjësendet e tyre, si dhe mungonte inventarizimi, si: tavolinat e karriget. Nga të burgosurit e akomoduar në katet më të larta, MKP-ja mori ankesa për mungesë të shtypjes së ujit dhe të ujit të ngrohtë. Sipas drejtorit, problemi synohet të rregullohet përmes planit për investime kapitale, duke instaluar bojlerë të mëdhenj.

Megjithatë, për MKP-në, edhe për këtë periudhë të raportimit, mbetet shqetësues regjimi që u ofrohet të paraburgosurve në të gjitha qendrat e paraburgimit. MKP-ja ka vërejtur se shumica e të paraburgosurve, pavarësisht përpjekjeve të autoriteteve të qendrave të paraburgimit, shumicën e kohës e kalojnë të mbyllur në qelitë e tyre, për shkak të infrastrukturës.

### **Raport për vizitën në stacionet policore në Gjilan, Lipjan, Prizren, Ferizaj, Shtime, Shtërpçë, Rahovec, Kamenicë, Viti, Suharekë dhe Malishevë**

Gjatë muajit nëntor 2021, MKP-ja ka realizuar vizita në stacionet policore të lartpërmendura, me qëllim të vlerësimit të trajtimit dhe kushteve të mbajtjes së personave të arrestuar dhe ndalur.

Të drejtat e personave të arrestuar nga Policia e Kosovës janë të përcaktuara dhe të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, Kodin e Procedurës Penale, Ligjin për Policinë dhe me instrumentet ndërkombëtare të përfshira në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Neni 13 i Kodit të Procedurës Penale përcakton se çdo person i privuar nga liria duhet të njoftohet menjëherë, në gjuhën të cilën ai/ajo e kupton, për të drejtën për ndihmë juridike sipas dëshirës së tij, për të drejtën për t'i njoftuar anëtarët e familjes apo ndonjë person tjetër për faktin që është arrestuar dhe se këto të drejta aplikohen gjatë gjithë kohës së privimit nga liria.

MKP-ja gjatë vizitave në stacionet policore të lartcekura nuk mori ankesa nga personat e arrestuar dhe të ndaluar, të cilët i ka intervistuar, për mosrespektim të këtyre të drejtave themelore, të cilat u garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me Ligjin nr. 04/L-076 për Policinë, me Kodin e Procedurës Penale dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria e tyre.

Më 1 tetor 2020, Policia e Kosovës miratoi Procedurat Standarde të Operimit, me qëllim të krijimit të dokumentit bazik, përmes të cilit përcaktohen rregullat dhe procedurat e punës policore, të cilat do të jenë në pajtim me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi, me qëllim të respektimit të të drejtave të njeriut, të personave që ndalohen dhe mbahen në qendrat e ndalimit.

Sa u përket kushteve fizike në qendrat e mbajtjes në stacione policore, MKP-ja, gjatë vizitave të realizuara në vitin 2021, ka vërejtur se shumica e stacioneve policore të vizituara, sa u përket hapësirës, ndriçimit natyral, artificial dhe higjienës, i plotësojnë kushtet e domosdoshme për akomodim të personave të ndaluar. Megjithatë, për qendrat si në Malishevë, Prizren dhe Shtërpçë, ku ka nevojë për renovime, i ka njoftuar autoritetet kompetente përmes raportit me rekomandime i 22 dhjetor 2021.

Po ashtu, jo të gjitha qendrat e mbajtjes u sigurojnë të ndaluarve çarçafë për shtretër. MKP-ja, bazuar në këto gjetje, i rekomandoi Policisë së Kosovës që të ndaluarit të furnizohen me mjete higjienike dhe çarçafë. Më 27 shtator 2021, Policia e Kosovës e njoftoi MKP-në se në shtator të ndaluarit janë furnizuar me mjete higjienike dhe me çarçafë.

### **Raport për vizitën në Qendrën Korrektuese për Femra dhe Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan**

Më 26 dhe 27 tetor 2021, MKP-ja realizoi vizitë në qendrat e lartpërmendura, me qëllim të monitorimit të respektimit të të drejtave të personave të paraburgosur dhe të dënuar, siç parashihet me ligjet vendore dhe ndërkombëtare për të drejtat themelore të të burgosurve.

MKP-ja, gjatë vizitë në QK-në për Femra, vërejti se shumica e të dënuarave angazhohen në punë në furrë, kuzhinë, pastrim, ndërsa gjatë stinës së verës angazhohen në kopshte dhe në serrën e qendrës. Kurse të paraburgosurat janë shumë pak të angazhuara në punë dhe aktivitete të tjera pasi angazhimi i tyre është subjekt i lejes së gjykatës kompetente. MKP-ja mori ankesa nga të dënuarat, sidomos ato me burgim afatgjatë, të cilat pohuan se numri i aktiviteteve dhe angazhimeve të tjera në dispozicion është dukshëm më i vogël se në periudhën kur ato ishin të akomoduar në pjesën tjetër të Qendrës Korrektuese.

Në këtë drejtim, MKP-ja vëren se KPT-ja, në raportin për vizitën në Republikën e Kosovës në vitin 2015, në paragrafin 45 të raportit, ndër të tjera u rekomandon autoriteteve kompetente të Republikës së Kosovës që të ndër marrin veprime me prioritet për të ofruar dhe zbatuar një regjim gjithëpërfshirës të aktiviteteve jashtë qelisë për të gjithë të dënuarit (punë, edukim, sport, rekreacion etj.). Më tej, në këtë raport theksohet se vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet të burgosurve me dënime afatgjata.

MKP-ja vëren se këto ankesa, të dënuarat i pohuan edhe para ministres së Drejtësisë gjatë vizitës së saj në QKF në Lipjan. MKP-ja konsideron se autoritetet kompetente duhet të veprojnë në pajtim me rekomandimin e KPT-së, lidhur me ofrimin e një regjimi adekuat për këtë kategori.

MKP-ja gjatë vizitës në QK-në për të Mitur në Lipjan, ka vërejtur se atyre, përveç ajrimit ditor, u ofrohet një regjim gjithëpërfshirës duke përfshirë shkollim, trajnime për fusha të ndryshme, punë, si dhe aktivitete sportive dhe rekreative. Në QKM ishin katër të mitur që do duhej t'i ndiqnin mësimet në nivelin fillor, ndërsa dy nga ta nuk e kanë mbaruar as klasën e parë fillore dhe nuk dinin shkrim dhe lexim.

Sa i përket regjimit në të dyja qendrat e lartpërmendura, MKP-ja, përmes raportit me rekomandime, i rekomandoi Ministrisë së Drejtësisë që të shtohen aktivitetet jashtë qelisë për të burgosurat (përfshirë të paraburgosurat, kur një gjë e tillë është e mundur), duke u kushtuar vëmendje të veçantë të burgosurve të dënuar me dënime afatgjata dhe të organizohen kurse të veçanta për të burgosurit të cilët nuk dinë shkrim dhe lexim.

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, për shkak të pandemisë COVID-19, MKP-ja konstaton se kufizimi i të drejtave dhe i lirive të caktuara të personave të privuar nga liria e tyre në parim ishte i domosdoshëm, proporcional, i bazuar në ligjet vendore, në rekomandimet e institucioneve kompetente shëndetësore të vendit dhe në rekomandimet e OBSH-së, si dhe të organizatave të tjera, të cilat monitorojnë respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria e tyre.

Ndërsa kufizimi i së drejtës për kontakte me botën e jashtme u kompensua përmes ofrimit të llojeve të tjera të komunikimit (SKYPE, shtimit të telefonatave). Po ashtu në periudha të caktuara, varësisht nga gjendja me COVID-19, pati kufizime të së drejtës për t'u takuar dhe komunikuar me avokatin mbrojtës.

## **E DREJTA PËR GJYKIM TË DREJTË DHE TË PAANSHËM dhe MBROJTJA GJYQËSORE E TË DREJTAVE**

**E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm (funksionimi i sistemit: gjyqësor, prokurorial, veprimet e policisë në shqiptimin e gjobave, procedura kundërvajtëse gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë)**

Avokati i Popullit, në kuadër të kompetencave kushtetuese dhe ligjore, pas konfirmimit të rasteve të para me COVID-19 në Kosovë, me kujdes të shtuar ka ndjekur edhe funksionimin

e sistemit të drejtësisë në përgjithësi, në kuptim të respektimit të së drejtës së qytetarëve për qasje në drejtësi dhe të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Qeveria nxori vendime për gjendjen emergjente në shëndetin publik, me të cilat u kufizua puna e institucioneve publike, e në disa u ndalua plotësisht. Këto vendime ndikuan edhe në funksionimin e sistemit gjyqësor të vendit.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më 12 mars 2020, duke u bazuar në Ligjin për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nxori Vendimin 52/2020, me të cilin u kufizuan përkohësisht veprimet gjyqësore që kanë përfshirë praninë e publikut dhe qasja e publikut në të gjitha objektet e gjykatave të Republikës së Kosovës, ndërsa më 15 mars 2020, nxori Vendimin 53/2020 me të cilin u reduktuan thellësisht të gjitha aktivitetet në kuadër të KGJK-së dhe në të gjitha gjykatat e Republikës së Kosovës. Këto vendime u ndryshuan disa herë, përderisa më 27 korrik 2020, Asambleja e kryetarëve të gjykatave dhe e gjyqtarëve mbikëqyrës kërkoi që gjatë kohës së pandemisë COVID-19, seancat gjyqësore të mbaheshin nëpërmjet platformës online, ku edhe filloi mbajtja e seancave të para online në gjykatat e vendit.

Pothuajse njësoi veproi edhe Këshilli Prokurorial i Kosovës. KPK bazuar në Ligjin nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës si dhe në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave pas konfirmimit të rasteve pozitive me COVID-19, më 14 mars 2020, miratoi vendimin për reduktimin esencial të aktiviteteve në kuadër të KPK-së dhe Prokurorit të Shtetit. Gjithashtu ishte autorizuar Kryeprokurori i Shtetit dhe kryeprokurorët e prokurorive të Republikës së Kosovës që të caktonin prokurorët dhe stafin administrativ të mjaftueshëm për të mbajtur kujdestari dhe realizuar vetëm veprimtaritë e natyrës urgjente dhe veprimet e caktuara sipas afateve ligjore. Më 6 prill 2021, kryesuesi i KPK-së dhe Kryeprokurori i Shtetit, duke u bazuar në kompetencat kushtetuese dhe ligjore, si dhe në zbatim të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për marrjen e masave për parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19, kanë marrë Vendimin KPK/ Nr.208/2021 & A.nr.105/2021 për reduktimin esencial të aktiviteteve në kuadër të KPK-së dhe të Prokurorit të Shtetit.

Policia e Kosovës gjatë emergjencës shëndetësore për shkak të pandemisë COVID 19, më 12 mars 2020 ka lëshuar Urdhër Operacional për gatishmëri dhe reagim. Për zbatimin e Udhëzimit Operacional janë angazhuar 6500 zyrtarë policorë, në: a) patrullimin parandalues 24/7, fillimisht me dy ndërrime, në orarin 12 orësh; b) ofrimin e sigurisë në Qendrën Studentore, si karantinë e detyrueshme, dhe në Klinikën Infektive, me prezencën e saj 24/7; c) 166 pika të kontrollit në hyrje-daljet në 63 zona komunale në karantinë; d) 71.745 pika të tjera të kontrollit; e) në inspektimin e 12.880 qytetarëve të cilët gjenden në vet izolim në shtëpi; f) 2.326 përcjellje policore; g) 5.994 asistime inspektorëve komunalë, si dhe h) 485 asistime të shërbimeve shëndetësore.

Pas Vendimit nr. 01/10 të Qeverisë, i datës 5 korrik 2020, për shkak të numrit të vogël të inspektorëve dhe në pamundësi të mbulimit të çdo pike, Policia ofroi mbështetje në plotësimin e formave të kundërvajtjes dhe dorëzimi i tyre inspektorit sanitar, i cili pastaj vazhdoi me shqiptimin e masave ndëshkuese. Lidhur me aktivitetet e saj brenda 24 orësh, Policia njoftoi publikun nëpërmjet komunikatave për shtyp.

## **Raport për rastin A. nr. 482/2019 lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën Themelore në Prishtinë**

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C. nr. 66/2015, pa vonesa të mëtutjeshme.

Praktika e GjEDNj vërteton se zgjatja e procedurës normalisht llogaritet nga koha e inicimit të procedurave gjyqësore (shih, *në mes tjerash*, aktgjykimin Moldovan dhe të tjerët kundër Rumanisë, më 12 korrik 2005 dhe aktgjykimin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, më 30 shtator 2003) deri në kohën kur çështja ka përfunduar dhe/ose aktgjykimi është ekzekutuar (shih, aktgjykimin *Poitier kundër Francës*, më 8 nëntor 2005). GjEDNj thekson se një prej faktorëve që duhet të merret në konsideratë është sjellja e autoriteteve kompetente gjyqësore dhe administrative dhe se është përgjegjësi e gjykatës që ta organizojë punën e saj në atë mënyrë që individët të informohen për përparimin dhe rezultatet mbi çështjet e tyre, brenda një kohë të arsyeshme (shih Aktgjykimin *Zimmerman dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983). Vendoset në afat të arsyeshëm kohor paraqet element qenësor të së drejtës për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, siç është e garantuar me nenin 6 të Konventës për të Drejtat e Njeriut.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti Avokati i Popullit i rekomandon Gjykatës Themelore në Prishtinë që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet që të vendosë për lëndën C. nr. 66/2015.

### **Raport për rastin A. nr. 58/2020 në lidhje me zvarritjen e procedurës në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës në lëndën C-III-14-0315**

Qëllimi i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DhPGjS) lidhur me nevojën e ndërmarrjes së veprimeve përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C. nr. 66/2015, pa vonesa të mëtutjeshme.

Raporti rithekson se periudha përkatëse për t'u shqyrtuar lënda e ankuesit fillon prej datës 17 nëntor 2014, datë kur paditësi kishte paraqitur padinë në DhPGjS dhe se procedurat lidhur me rastin deri më tani kanë zgjatur mbi gjashtë vjet e shtatë muaj. Prandaj Avokati i Popullit vlerëson se ka shkelje të nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNj-së në kuptim të së drejtës për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm kohor.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i ka rekomanduar DhPGjS që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C-III-14-0315.

### **Raport për rastin A. nr. 543/2020 dhe A. nr. 544/2020 që kanë të bëjnë me vendimet e Agjencisë Kosovare të Privatizimit DM 220/2020 dhe DM 219/2020, të datës 1 shtator 2020**

Qëllimi i këtij raporti është paraqitja e konstatimeve dhe e rekomandimeve të Avokatit të Popullit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut të shkaktuara me vendimet DM 220/2020 dhe DM 219/2020, të datës 1 shtator 2020.

Më 19 shtator 2014, AKP-ja kishte nxjerrë dy vendime, me të cilat ankuesve u ishte shqiptuar masa e pezullimit parandalues me 50% të pagës deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata kompetente, për shkak të inicimit të procedurës penale ndaj tyre. Çështja më tej ka vazhduar në gjykatën kompetente. Më 1 shtator 2020, AKP-ja, duke u bazuar në nenin 58, paragrafi 4, të Ligjit për Zyrarët Publikë, ka nxjerrë vendimet DM 220/2020 dhe DM 219/2020, me të cilat ankuesve u ndalet përfitimi prej 50% të pagës, por mbeten punonjës të institucionit me pagë 0 EUR, deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga gjykata.

Raporti konstaton se ankuesve për çështjen e njëjtë u janë lëshuar dy vendime, pa u nxjerr një aktgjykim përfundimtar nga gjykata. Po ashtu konstaton se me nxjerrjen e vendimeve



DM 220/2020 dhe DM 219/2020, të datës 1 shtator 2020, u janë shkelur të drejtat e ankuesve me aplikimin dhe interpretimin e gabueshëm të dispozitave ligjore në fuqi.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti Avokati i Popullit i rekomandon Agjencisë Kosovare të Privatizimit që t'i anulojë vendimet DM 220/2020 dhe DM 219/2020, të datës 1 shtator 2020, dhe t'i lërë në fuqi vendimet e vitit 2014, deri në vendimin përfundimtar të gjykatës.

#### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 734/2020**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), për shkak të zvarritjes së procedurës gjyqësore për të proceduar me lëndën A. nr.1381/18, që ka të bëjë me kontest pune.

GjThP - Departamenti për Çështje Administrative, që nga koha kur pala kishte parashtruar padi kundër vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në vitin 2018, nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ta proceduar rastin.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se zvarritja e mëtejshme e procedurës në çështjen në fjalë përbën shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, prandaj Avokati i Popullit i ka rekomanduar Gjykatës Themelore në Prishtinë që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme që pa vonesa të mëtutjeshme ta trajtojë rastin A.nr.1381/18.

#### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 404/2020**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP), për zvarritje të procedurës gjyqësore për të proceduar me lëndën C.nr.1210/18, që ka të bëjë me kontest pune. GjThP - Departamenti për Çështje Administrative nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ta proceduar rastin që nga koha kur pala kishte parashtruar padi për anulimin e vendimit për lirim nga pozita drejtuese në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), i datës 17 mars 2017, si dhe shfuqizimin e Rregullores (MPB) nr. 01/2017 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në IPK dhe Udhëzimin Administrativ (MPB) nr. 01/2017 për Procedurat Lidhur me Kushtet e Punësimit dhe të Punës për Punonjësit e IPK-së.

Avokati i Popullit vlerësoi se zvarritja e mëtejshme e procedurës në çështjen në fjalë përbën shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm, prandaj Avokati i Popullit i ka rekomanduar Gjykatës Themelore në Prishtinë që t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme që pa vonesa të mëtutjeshme ta trajtojë rastin C.nr.1210/18.

#### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 168/2018**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Gjykatës Themelore në Prishtinë, që ka të bëjë me zvarritjen e procedurës gjyqësore lidhur me lëndën C.nr.3534/13. Ankuesi më 6 tetor 2009 kishte ngritur një padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë për konfirmimin e së drejtës së pronësisë, lirimin e pasurisë së paluajtshme nga personat dhe nga gjërat dhe kompensimin e dëmit. Sipas pohimit të ankuesit, ishin mbajtur tri seanca dëgjimore, kurse seanca e fundit ishte mbajtur më 20 janar 2017. Pas kësaj date, gjykatësi i lëndës nuk kishte caktuar seanca të tjera dhe ankuesi, deri në ditën që i ishte drejtuar IAP-së, nuk kishte marrë asnjë informacion për vazhdimin e procedimit të kësaj lënde.

Avokati i Popullit ka konstatuar se kjo lëndë pret të shqyrtohet në Gjykatën Themelore në Prishtinë për më shumë se dhjetë vjet dhe ende nuk është marrë një vendim përfundimtar për çështjen.

Prandaj Avokati i Popullit i ka rekomanduar Gjykatës Themelore në Prishtinë që pa vonesa të mëtutjeshme t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme për shqyrtimin dhe vendosjen e lëndës C.nr.3534/13.

## **E DREJTA PËR MJETE JURIDIKE**

### **Raport për rastin A. nr. 512/2021 në lidhje me mungesën e arsytimit dhe të këshillës juridike në vendimin mbi trajtimin e ankesës për mospërzgjedhje për angazhim si bashkëpunëtor i jashtëm**

Avokati i Popullit ka pranuar ankesën e parashtruar kundër Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës për shkak të mungesës së arsytimit dhe të këshillës juridike në vendimin me të cilin është refuzuar ankesa e tij, e parashtruar për shkak të moszgjedhjes së tij në pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm.

Në raport Avokati i Popullit konstaton se me rastin e marrjes së vendimit lidhur me ankesën e ankuesit nuk janë respektuar standardet dhe kërkesat ligjore për elementet e detyrueshme të një akti administrativ. Për shkak të mungesës së arsytimit në akt dhe mungesës së udhëzimit për shfrytëzimin e mjeteve juridike në dispozicion, palës i është cenuar e drejta për informim për faktet dhe për rrethanat mbi bazën e të cilave është refuzuar ankesa e tij. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se mungesa e këshillës juridike në vendim ka kufizuar të drejtën për shfrytëzim të mjeteve juridike të ankuesit. Ligji nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pjesa III në Kapitullin I, gjerësisht shtjellon formën dhe elementet e detyrueshme të një akti administrativ. Neni 47, paragrafi 1, i Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative përcakton strukturën dhe elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar, e cila më gjerësisht shprehimisht parasheh:

Raporti tërheq vëmendjen Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" për respektim të dispozitave ligjore të nenit 47 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, që ka të bëjnë me strukturën dhe elementet e detyrueshme të një aktit administrativ.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandon Fakultetit të Arkitekturës të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" që pa vonesa të mëtutjeshme të veproi sipas nenit 53 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe të nxjerrë vendim të ri në përputhje me nenin 47 të po këtij ligji.

### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 213/2020**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Gjimnazit "Kuvendi i Lezhës" për mospërgjigje/mosnjoftim, përkatësisht në rishqyrtimin e rekomandimit të Sektorit të Inspektoratit të Arsimit (SIA) në Gjiilan, e datës 16 nëntor 2019.

Avokati i Popullit, duke u bazuar në provat dhe në shkresat e ofruara nga ankuesi, si dhe në provat dhe në shkresat e ofruara nga gjimnazi, ka ardhur në përfundim se kjo e fundit ka dështuar në zbatimin e ligjit, sepse nuk e ka njoftuar me shkrim ankuesin dhe nuk i ka dhënë përgjigje/njoftim lidhur me rastin e tij, përkitazi me rekomandimin e SIA-s në Gjiilan, i datës 16 nëntor 2019, dhe rrjedhimisht palës në procedurë i është mohuar e drejta në shfrytëzimin e mjeteve juridike. Nisur nga kjo Avokati i Popullit i ka rekomanduar Gjimnazit "Kuvendi i Lezhës" në Viti që t'i përcjell ankuesit përgjigje në mënyrën siç e përcakton ligji, lidhur me rishqyrtimin e rekomandimit të SIA-s në Gjiilan, i datës 16 shtator 2019.

## E DREJTA E PRIVATËSISË

### E drejta e privatësisë gjatë pandemisë COVID-19

Gjykata Kushtetuese, në Aktgjykim në rastin KO 54/20, theksoi se edhe pse përveç Avokatit të Popullit, asnjëra nga palët nuk e ka përmendur faktin që Vendimi i kontestuar “ndërhyn” edhe në të drejtën e privatësisë të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese ka vërejtur se një ndërhyrje e tillë ka ndodhur edhe për sa i takon kësaj të drejte.<sup>251</sup> Sipas Gjykate Kushtetuese, kufizimi i kësaj të drejte në fjalë është bërë nga Qeveria në pikën 4 të vendimit të kontestuar, ku specifikisht thuhet se ndalohen tubimet në të gjitha mjediset “private”, qofshin ato “të hapura dhe të mbyllura”, përveç kur është e domosdoshme për të kryer detyra të punës për “parandalim dhe luftimin të pandemisë” si dhe ku lejohet distanca dy metra me të tjerët.<sup>252</sup> Më tej gjykata theksoi: “... *Një lexim literal i këtij kufizimi nënkupton që Qeveria, përmes Vendimit të kontestuar ka ndaluar të gjitha tubimet në mjediset private, respektivisht edhe në familje dhe shtëpi ose banesa private të qytetarëve të Republikës së Kosovës, përveç nëse ato tubime në mjediset private janë të domosdoshme për të kryer detyrat e punës për parandalimin dhe luftimin e pandemisë...*” Sipas këtij aktgjykimi, Gjykata Kushtetuese theksoi se një kufizim i tillë nuk është i paraparë me ligjet e Kuvendit të cilat Qeveria i ka cituar në vendimin e kontestuar si bazë për ta nxjerrë atë, sepse askund në ato dispozita ligjore nuk përmenden kufizimet që mund të bëhen në “mjediset private”.<sup>253</sup> Duke qenë se rrethanat e krijuara nga pandemia kishin krijuar një realitet të ri edhe në rrafshin legjislativ, me dy ligjet e reja të aprovuara nga Kuvendi i Republikës së Kosovës për luftimin dhe parandalimin e pandemisë, vërehet se tanimë është krijuar baza ligjore duke autorizuar MSh-në për kufizimin e së drejtës kushtetuese të privatësisë, në kuadër të masave të ndërmarra për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19.

Sa u përket gjetjeve të IAP-së në lidhje me publikimin e të dhënave personale nga media të ndryshme të shkruara, për personat që i janë nënshtruar testimi për COVID-19, si dhe për zbulimin e identitetit të personave që kanë rezultuar pozitiv, Avokati i Popullit rithekson se lëshime të tilla nga ana e mediave janë të papranueshme, duke qenë se si të tilla janë në kundërshtim me nenin 36 Kushtetutës, me nenin 8 të KEDNj-së, me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe me Kodin e Mediave të Shkruara të Kosovës.

Avokati i Popullit vlerëson se mungesa e rregullimit të akteve nënligjore për kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, përveçse vazhdon të paraqesë sfidë në zbatimin efektiv të Ligjit nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, e njëjta ka thelluar ndikimin negativ sa i përket zbatimit efektiv të këtij ligji në situatën aktuale pandemie, posaçërisht në kuadër të zbatimit të masave për parandalimin dhe kontrollimin nga përhapja e mëtejshme e COVID-19. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit e vlerëson të domosdoshme që IAP-ja, për të gjithë kontrolluesit dhe përpunuesit e të dhënave, të nxjerrë udhëzues për mbrojtjen e të dhënave personale në kuadër të masave kundër COVID-19. Një udhëzues i tillë do të ishte i domosdoshëm, posaçërisht për sektorët, si: punësimi, telekomunikacioni, shëndetësia dhe arsimiti.

### Opinion i Avokatit të Popullit për rastin ex-officio nr. 711/2020, në lidhje me vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës

Avokati i Popullit ka analizuar çështjen e ngritur nga Policia e Kosovës, që ka të bëjë me projektin e Policisë lidhur me vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë të Policisë së Kosovës. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit thekson se Policia e

251 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykimi nr. KO 54/20, 6 prill 2020.

252 Po aty, paragrafi 266.

253 Po aty, paragrafi 267.

Kosovës, si institucion kompetent për mbrojtjen e rendit në Republikën e Kosovës, ushtron veprimtarinë e saj sipas legjislacionit në fuqi, andaj në këtë drejtim është shumë me rëndësi që veprimtaria e zyrtarëve policorë të jetë e paanshme, me integritet, transparente dhe përgjegjëse në ushtrimin e mandatit që buron nga legjislacioni në fuqi.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka theksuar se përderisa veprimet e tilla policore realizohen në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, nuk bëhet fjalë për cenim të lirive dhe të të drejtave të njeriut. Mirëpo në rast se veprimet policore i tejkalojnë përcaktimet e parapara në Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, atëherë duhet të ndërmerren masa ndëshkuese për kryerësit e veprimeve të tilla. Prandaj, shikuar në këtë drejtim, Avokati i Popullit nuk ka vërejtur ndonjë pengesë në vendosjen e kamerave të trupit tek zyrtarët policorë, përderisa veprimet që kanë të bëjnë me të dhënat personale bëhen në pajtim të plotë me dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Avokati i Popullit gjithashtu ka vlerësuar se nuk përbën cenim të lirive dhe të të drejtave të njeriut një veprim apo një mjet i caktuar, i cili u shërben aktiviteteve policore, e që sipas të cilit ngrihet transparenca, llogaridhënia, integriteti, paanshmëria dhe përgjegjshmëria e zyrtarëve policorë gjatë kryerjes së detyrave të tyre të përcaktuara me ligj.

## E DREJTA E QASJES NË DOKUMENTE PUBLIKE

### **Raport për rastin A. nr. 454/2020 kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti është tërheqja e vëmendjes të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK) lidhur me ankesën e S. R. për qasje në dokumente publike dhe për detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve përkatëse që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesi kishte parashtruar në KPK kërkesë për qasje në Vendimin KPK/Nr.729/2019 i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i datës 12 nëntor 2019, dhe në Raportin Hetimor AD.nr.18/2019, i datës 11 tetor 2019, dokumente këto që kishin të bënin me procedurën disiplinore ndaj dy prokurorëve të Prokurorisë Themelore të Prishtinës. KPK-ja i kishte kthyer përgjigje ankuesit duke e njoftuar atë lidhur me epilogun e dy procedurave disiplinore që janë zhvilluar ndaj dy prokurorëve, por pa i bashkëngjitur dokumentet e kërkuara nga ankuesi. Me përgjigjen në kërkesën e përsëritur të ankuesit, KPK-ja e kishte njoftuar atë: “[...] Raporti i Panelit Hetimor AD nr.18/2019, është dokument konfidencial dhe nuk është publik, sipas Ligjit për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve vetëm vendimet përfundimtare bëhen publike, me përjashtim të vërejtjes jo publike me shkrim.”, si dhe ia kishte dërguar ankuesit edhe vendimin e Gjykatës Supreme për procedurën ankimore ndaj Vendimit KPK/Nr.729/2019, i datës 12 nëntor 2019.

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti konstaton se KPK-ja, kur e ka njoftuar ankuesin se Raporti i Panelit Hetimor AD nr.18/2019 i KPK-së, i datës 11 tetor 2019, është konfidencial, nuk ka arritur ta arsyetonte dhe ta dëshmonte se dokumenti i kërkuar ishte dokument i klasifikuar sipas nivelit të klasifikimit të dokumenteve bazuar në Ligjin nr. 03/L-178 për Klasifikimin e Informacioneve dhe Verifikimin e Sigurisë. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i kishte rekomanduar KPK-së që t’i lejonte ankuesit qasje në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, me Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 658/2020 kundër Komunës së Gjilanit në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti me rekomandim ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Komuna e Gjilanit lidhur me ankesën e Rrjetit të OJQ-ve AVONET, të

parashtruar për kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike; analizimin e Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP) përkitazi me ankesën në fjalë; si dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike në raport me zbatimin e këtij ligji në rastet e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike. Ankuesi i ishte drejtuar Komunës së Gjilanit me kërkesë për qasje në informacion dhe dokumente publike, përkitazi me projektin: “Ndërtimi i trotuarit në lagjen Dardania”, me nr. të prokurimit: GL 651 17 037 511, në Gjilan. Përkatësisht kishte kërkuar qasje në paramasën dhe në procesverbalin e menaxherit të projektit lidhur me procesin e realizimit të projektit. Po ashtu kishte kërkuar të dhëna lidhur me pikat 3.9 dhe 3.12 të pozicionit të projektit. Përkundër veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit dhe komunikimit me zyrtarët e komunës në fjalë, qasja në dokumentet e kërkuara ishte realizuar vetëm pjesërisht, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 22 mars 2021 i kishte dërguar kryetarit të komunës së Gjilanit Raportin me rekomandime duke konstatuar se Komuna e Gjilanit kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike, në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Po ashtu, Avokati i Popullit konsideron se Komuna e Gjilanit duhet të bëjë më shumë në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të saj në raport me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe në zbatim të LQDP-së. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komunës së Gjilanit që ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t’i ofrojë qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 2/2021 kundër Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Ministria e Shëndetësisë lidhur me ankesën e pranuar nga ankuesja gazetares në KTV, e parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesja i ishte drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me kërkesë për qasje në dokumente publike, përkatësisht për qasje në shpenzimet e kabinetit të ministrit, nga qershori deri në dhjetor 2020.

Përkundër veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit dhe komunikimit me zyrtarët e ministrisë në fjalë, qasja në dokumentet e kërkuara nuk ishte realizuar, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 23 mars 2021 i kishte dërguar Ministrisë së Shëndetësisë Raportin me rekomandim duke theksuar se bëhet fjalë për kërkesën e një gazetari dhe dokumentet e kërkuara kanë të bëjë me aktivitetin që ata zhvillojnë në informimin e publikut dhe e drejta për informim/qasje në dokumente publike konsiderohet element thelbësor për të zhvilluar debate në interes të publikut dhe kontributi i mediave dhe i shoqërisë civile është i rëndësishëm në diskutimin e çështjeve me interes publik. Avokati i Popullit në këtë raport ka konstatuar se në rastin e ankueses, Ministria nuk ka përmbushur detyrimet lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se në rastin konkret bëhet fjalë për një gazetare dhe aktivitetin që zhvillon për informim të publikut, dhe informacioni konsiderohet një e mirë që skadon, prandaj vonesa në dhënien e përgjigjes dhe trajtimin e kërkesës së saj përbën shkelje të ligjit njëjtë sikur mosdhënia e informacionit. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që t’i përgjigjet ankueses pa vonesa të mëtejme

dhe t'i ofrojë qasje në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjisllacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 756/2020 kundër Ministrisë së Shëndetësisë në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Ministria e Shëndetësisë, lidhur me ankesën e pranuar nga ankuesi gazetar në portalin Gazeta Shneta, të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike, si dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesi i ishte drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë me kërkesë për qasje në dokumente publike, përkatësisht për qasje në shpenzimet e kabinetit të ministrit për vitin 2020. Përkundër veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit dhe komunikimit me zyrtarët e ministrisë në fjalë, qasja në dokumentet e kërkuara nuk ishte realizuar. Rrjedhimisht Avokati i Popullit nëpërmjet këtij raporti thekson se bëhet fjalë për kërkesën e një gazetari dhe dokumentet e kërkuara kanë të bëjë me aktivitetin që ai zhvillon në informimin e publikut dhe e drejta për informim/qasje në dokumente publike konsiderohet element thelbësor për të zhvilluar debate në interes të publikut dhe kontributi i mediave dhe i shoqërisë civile është i rëndësishëm për diskutimin e çështjeve me interes publik. Avokati i Popullit në këtë raport ka konstatuar se në rastin e ankueses, Ministria nuk i ka përmbushur detyrimet lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Duke marrë parasysh se në rastin konkret bëhet fjalë për një gazetar dhe aktivitetin që zhvillon për informim të publikut, dhe informacioni konsiderohet një e mirë që skadon, prandaj vonesa në dhënien e përgjigjes dhe trajtimin e kërkesës së stii përbën shkelje të ligjit njëjtë sikur mosdhënia e informacionit. Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Shëndetësisë që t'i përgjigjet ankuesit pa vonesa të mëtejme dhe t'i ofrojë qasje në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjisllacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 580/2020 kundër Ministrisë së Pushtetit Lokal në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike**

Ankuesi në ankesën e parashtruar tek Avokati i Popullit ankohet për kufizimin e qasjes në dokumente publike. Ai i ishte drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal (MPL) me kërkesë për qasje në dokumente publike, përkatësisht qasje në vlerësimet e ligjshmërisë për: Vendimin për emërimin e nënkryetarit të komunës për komunitete, në komunën e Gjilanit; Vendimin për zgjedhjen e zëvendëskryesuesit për komunitete të Kuvendit të komunës; Vendimin për organizimin e dëgjimit publik për Planin Zhvillimor Komunal (PZhK) 2020-2028.

Përkundër veprimeve që Avokati i Popullit i kishte ndërmarrë përkitazi me ankesën dhe komunikimit të zhvilluar me zyrtarët përgjegjës në MPL, ankuesi nuk kishte realizuar qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 23 mars 2021 i kishte drejtuar Ministrisë së Pushtetit Lokal raportin me rekomandim, në të cilin kishte konstatuar se në rastin e ankuesit, MPL-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit i kishte rekomanduar MPL-së ta trajtojë kërkesën e ankuesit dhe t'i ofrojë qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, në pajtim me

Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 739/2020 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Në ankesën e parashtruar tek Avokati i Popullit, ankuesi ankohet për kufizimin e qasjes në dokumente publike respektivisht për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike. Ai, i ishte drejtuar MPJD-së me kërkesë për qasje në emrat e personave të shpallur konsuj nderi jashtë Republikës së Kosovës; në emrat e personave të shpallur konsuj nderi në Republikën e Kosovës, si dhe kopjet e dosjes të CV-ve të konsujve të nderit që ushtrojnë aktivitetin e tyre në emër të Republikës së Kosovës. Ankuesi kishte marrë një përgjigje nga MPJD-ja, me të cilën i ishte kërkuar ankuesit që t'ia dërgonte MPJD-së kopjen e një dokumenti të identifikimit me nënshkrimin e tij si dhe i ishte kërkuar arsyeja se përse i duheshin dokumentet e kërkuara. Ndërsa më vonë MPJD-ja e kishte njoftuar ankuesin se i ishte refuzuar qasja në dokumentet e kërkuara meqenëse ai nuk kishte vepruar sipas kërkesës së MPJD-së. Avokati i Popullit, në raportin me rekomandim të cilin ia kishte dërguar MPJD-së, kishte konstatuar se MPJD-ja kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Po ashtu kishte konstatuar se MPJD-ja nuk kishte vepruar në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, me nenin 10, paragrafët 2, 4, 5, dhe 10 të LQDP-së, dhe rrjedhimisht Avokati i Popullit i kishte rekomanduar MPJD-së që ta zbatonte Vendimin nr. 239/2020, i datës 22.12.2020, për lejimin e qasjes së plotë në dokumentet e kërkuara, në përputhje me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe me Ligjin nr.06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

### **Raport për rastin A. nr. 486/2020 kundër Komunës së Mitrovicës Veriore në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga ana e Komunës së Mitrovicës Veriore, lidhur me ankesën e OJQ-së Iniciativa për Progres - INPO, të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike; dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesja i ishte drejtuar Komunës së Mitrovicës Veriore me dy kërkesa për qasje në kontratën me numër prokurimi 647-19-5322-5-2-1, me titull: *“Mbrojtja dhe restaurimi i fasadës së oborrit në rrugën mbreti Petër I me rregullimin e parterit dhe renovimi i kulmit të objektit të banimit në rrugën Knjaz Milloshi, nr. 32, në Mitrovicën e veriut”*; si dhe në kontratën me numër prokurimi 647-19-5150-2-2-1, me titull: *“Shërbimet e sigurisë fizike të ndërtesës së Komunës së Mitrovicës së Veriut”*.

Përkundër veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit dhe komunikimit me zyrtarët e komunës në fjalë, qasja në dokumentet e kërkuara nuk ishte realizuar, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 29 mars 2021 i kishte dërguar komunës së Mitrovicës Veriore raportin me rekomandim duke konstatuar se në rastin e ankueses, Komuna e Mitrovicës Veriore kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankueses, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Po ashtu Avokati i Popullit ka konsideruar se Komuna e Mitrovicës Veriore duhet të bëjë më shumë në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të saj në raport me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe në zbatim të LQDP-së. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komunës së Mitrovicës Veriore që t'i trajtonte kërkesat e ankueses dhe t'i

ofronte qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 574/2020 kundër Komunës së Mitrovicës Veriore në lidhje me të drejtën e qasjes në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga ana e Komunës së Mitrovicës Veriore lidhur me ankesën e OJQ-së Iniciativa për Progres – INPO (ankuesja), të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike; dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesja i ishte drejtuar Komunës së Mitrovicës Veriore me kërkesë për qasje në informacion dhe në dokumente publike, përkatësisht për qasje në numrin e kontratave të nënshkruara nga Komuna e Mitrovicës Veriore, me kriterin çmimi më i ulët me peshim të çmimeve (poentim) për vitin 2019 dhe 2020, me kërkesë që informacioni duhet të përmbajë titullin e kontratës dhe numrin e prokurimit për kontratat përkatëse, nëse ka pasur të tilla.

Përkundër veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit dhe komunikimit me zyrtarët e komunës në fjalë, qasja në dokumentet e kërkuara nuk ishte realizuar, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 29 mars 2021 i kishte dërguar Komunës së Mitrovicës Veriore raportin me rekomandim duke konstatuar se në rastin e ankueses, Komuna e Mitrovicës Veriore kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankueses, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Po ashtu Avokati i Popullit kishte konsideruar se Komuna e Mitrovicës Veriore duhet të bëjë më shumë në ngritjen e kapaciteteve të zyrtarëve të saj në raport me trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe në zbatim të LQDP-së. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komunës së Mitrovicës Veriore që t'i trajtonte kërkesat e ankueses dhe t'i ofronte qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 737/2020 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) lidhur me ankesën e L. G., të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike; dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP). Ankuesja i ishte drejtuar MPJD-së me kërkesë për qasje në informacion dhe në dokumente publike, përkatësisht në informacion lidhur me arsyet objektive për të cilat ishte anuluar konkursi i datës 15.7.2020, për nëpunës konsullorë. Përkundër veprimeve që Avokati i Popullit i kishte ndërmarrë përkitazi me ankesën dhe komunikimit të zhvilluar me zyrtarët përgjegjës në MPJD-së, ankuesja nuk kishte realizuar qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 22 prill 2021 i kishte drejtuar MPJD-së raportin me rekomandim, në të cilin kishte konstatuar se në rastin e ankueses, MPJD-ja kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike, në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankueses, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Në rastin konkret, Avokati i Popullit kishte theksuar se interesi i publikut për llogaridhënien është thelbësor në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të qeverisjes së mirë. Rol të rëndësishëm në këtë aspekt kanë qytetarët, shoqëria civile dhe mediat. Po ashtu çështja e rrethanave të shkaktuara nga virusi COVID-19 nuk e justifikon vonesën në përgjigje të kërkesës së ankueses, duke



marrë parasysh se kërkesa për qasje në informacionin e kërkuar nuk ishte komplekse. Duke marrë parasysh se informacioni konsiderohet një e mirë që skadon, vonesa në trajtimin e kërkesës dhe në dhënien e përgjigjes përbën shkelje të ligjit njëjtë si mosdhënia e informacionit. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i kishte rekomanduar MPJD-së që t'i trajtojë kërkesat për qasje në informacion dhe në dokumente publike në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 175/2020 kundër Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës në lidhje me të drejtën për qasjes në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD) lidhur me ankesën e N. L., të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesi nëpërmjet postës elektronike disa herë kishte parashtruar kërkesë për qasje në informatat/kopjet elektronike të dokumenteve origjinale në lidhje me Republikën e Kosovës dhe Ishujt Cook, si dhe në informatat për marrëdhëniet diplomatike të Republikës së Kosovës me Ishullin Niue, por asnjëherë nuk kishte marrë përgjigje nga MPJD-ja. Pas veprimeve që kishte ndërmarrë Avokati i Popullit përkitazi me ankesën në fjalë, MPJD-ja kishte ndërmarrë veprimet e duhura sipas legjislacionit në fuqi. Megjithatë, më 22 prill 2021 Avokati i Popullit i kishte drejtuar MPJD-së një raport me rekomandim, në të cilin kishte konstatuar se MPJD-ja kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit kishte theksuar në këtë raport se interesi i publikut për llogaridhënien është thelbësor në drejtim të promovimit dhe të forcimit të demokracisë dhe të qeverisjes së mirë. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i kishte rekomanduar MPJD-së që t'i trajtojë kërkesat për qasje në informacion dhe në dokumente publike, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 506/2020 kundër Komunës së Ferizajt në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga ana e Komunës së Ferizajt lidhur me ankesën Q. A. nga organizata INPO, të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesi i ishte drejtuar Komunës së Ferizajt me kërkesë për qasje në informacion dhe në dokumente publike, përkatësisht për qasje në kontratën me titull: *“Furnizimi i QKMF-së dhe Spitalit të Ferizajt me mjete dhe pajisje mbrojtëse mjekësore”*, me numër të prokurimit 656-20-1616-1-2-5.

Përkitazi me kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentet e kërkuara, Komuna e Ferizajt kishte nxjerrë Vendim nr. 43/20, sipas të cilit ankuesit i ishte lejuar qasja në dokumente publike sipas kërkesës. Megjithatë ankuesi kishte njoftuar se qasja ishte realizuar përveç në Planin e Menaxhimit të Kontratës dhe në Raportin e Menaxherit të Kontratës. Meqenëse ankuesi nuk kishte realizuar qasjen e plotë në dokumentet e kërkuara, Avokati i Popullit kishte ndërmarrë veprime përkitazi me çështjen në fjalë dhe kishte komunikuar me zyrtarët përgjegjës në Komunën e Ferizajt, por qasja e plotë nuk ishte realizuar. Rrjedhimisht, më

28 prill 2020 Avokati i Popullit i kishte drejtuar kryetarit të komunës së Ferizajt, raport me rekomandime në të cilin kishte konstatuar se në rastin e ankuesit, Komuna e Ferizajt kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit i kishte rekomanduar Komunës së Ferizajt që ankuesit t'i ofronte qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, përkatësisht t'i ofronte qasje në Planin e Menaxhimit të Kontratës dhe në Raportin e Menaxherit të Kontratës.

### **Raport për rastin A. nr. 575/2020 kundër Prokurorisë Themelore në Prishtinë një lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Qëllimi i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Prokuroria Themelore në Prishtinë (PThP) lidhur me ankesën e drejtori ekzekutiv të Institutit të Kosovës për Drejtësi (IKD), E. M., të parashtruar për refuzim të qasjes në dokumente publike; dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesi kishte parashtruar kërkesë në PThP për qasje në *Aktvendimin për mbylljen/hudhjen e rastit të njohur si "Beni Dona" të furnizimit me ushqim të Forcës së Sigurisë së Kosovës*. PThP-ja e kishte refuzuar e kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentet e kërkuara. Ankuesi kishte paraqitur kërkesë në PThP për rishqyrtim të vendimit, për të cilën nuk kishte marrë përgjigje.

Pas ndërmarrjes së veprimeve nga Avokati i Popullit përkitazi me çështjen, ankuesi kishte marrë përgjigje lidhur me çështjen. Megjithatë, Avokati i Popullit më 28 prill 2020 i kishte drejtuar PThP-së raport me rekomandim në të cilin kishte konstatuar se PThP-ja nuk kishte vepruar në përputhje me nenin 17, paragrafët 7 dhe 8, të LQDP-së, që përcaktojnë qartë se kur një *institucion publik e refuzon qasjen në dokumentin e kërkuar, në tërësi apo pjesërisht, duhet të nxjerrë vendim për refuzim*. Po ashtu, lidhur me rastin në fjalë, Avokati i Popullit kishte theksuar se PThP-ja ka dhënë arsyet e refuzimit në përgjigjen drejtuar Avokatit të Popullit, por ka dështuar të nxirrte vendimin dhe t'ia dërgonte kërkuarit të dokumentit për çështjen në fjalë. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i kishte rekomanduar Prokurorisë Themelore të Prishtinës që të vepronte sipas nenit 17, paragrafët 7 dhe 8, të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Raport për rastin A. nr. 505/2020 kundër Komunës së Ferizajt në lidhje me kufizimin e së drejtës për qasje në dokumente publike**

Ankuesi i ishte drejtuar Komunës së Ferizajt me kërkesë për qasje në informacion dhe në dokumente publike, përkatësisht për qasje në kontratën me titull: *"Dezinsektimi, dezinfektimi i objekteve dhe i hapësirave publike për arsye të pandemisë globale Covid 19"*, me numër të prokurimit 656-20-1487-2-2-5.

Qëllimi i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga ana e Komunës së Ferizajt lidhur me ankesën e Q. A. të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Përkitazi me kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentet e kërkuara, Komuna e Ferizajt kishte nxjerrë Vendim nr. 42/20, sipas të cilit ankuesit i ishte lejuar qasja në dokumente publike sipas kërkesës. Megjithatë ankuesi kishte njoftuar se qasja ishte realizuar përveç në Planin e Menaxhimit të Kontratës, në Raportin e Pranimit Teknik apo Përfundimtar, dhe

në Raportin e Menaxherit të Kontratës. Meqenëse ankuesi nuk kishte realizuar qasjen e plotë në dokumentet e kërkuara, Avokati i Popullit kishte ndërmarrë veprime përkitazi me çështjen në fjalë dhe kishte komunikuar me zyrtarët përgjegjës në Komunën e Ferizajt, por qasja e plotë nuk ishte realizuar. Rrjedhimisht, më 28 prill 2020 Avokati i Popullit i kishte drejtuar kryetarit të komunës së Ferizajt raport me rekomandime në të cilin kishte konstatuar se në rastin e ankuesit, Komuna e Ferizajt kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit i kishte rekomanduar Komunës së Ferizajt që t'i ofronte ankuesit qasje të plotë në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi, përkatësisht t'i ofronte qasje në Planin e Menaxhimit të Kontratës; në Raportin e Pranimit Teknik apo Përfundimtar; dhe në Raportin e Menaxherit të Kontratës.

### **Raport për rastin A. nr. 187/2021 kundër Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës në lidhje me të drejtën për qasje në dokumente publike**

Qëllim i këtij raporti ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) lidhur me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (IDK), të parashtruar për refuzim të qasjes në dokumente publike; dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

IDK-ja i ishte drejtuar ShSKUK-së me kërkesë për qasje në Raportin vjetor për kontratat publike të nënshkruara për vitin 2020. IDK-ja kishte marrë një përgjigje nga ShSKUK-ja se kërkesa e tyre për qasje në dokumente publike ishte refuzuar.

Përkundër veprimeve që Avokati i Popullit kishte ndërmarrë përkitazi me ankesën dhe komunikimit të zhvilluar me zyrtarët përgjegjës në ShSKUK, ankuesi nuk kishte realizuar qasje në dokumentet e kërkuara, rrjedhimisht Avokati i Popullit më 25 maj 2021 i kishte drejtuar ShSKUK-së raport me rekomandim me të cilin kishte konstatuar se ShSKUK-ja nuk kishte vepruar në përputhje me nenin 12, paragrafi 1, të LQDP-së, i cili i përcakton qartë afatet kohore për trajtimin e kërkesave për qasje në dokumente publike dhe sipas të cilit institucioni publik detyrohet që brenda 7 ditësh, prej kohës së regjistrimit të kërkesës, të nxjerrë vendim për lejimin e qasjes në dokumentin e kërkuar ose vendim të arsyetuar për refuzimin e plotë apo të pjesshëm dhe ta njoftojë kërkuarësin e dokumentit për të drejtat që i ka në raste të tilla. Në rastin e IDK-së, ShSKUK-ja ka dështuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore lidhur me mundësimin, përkatësisht lejimin për qasje në dokumente publike, në përputhje me kërkesën e parashtruar të ankuesit, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit i kishte rekomanduar ShSKUK-së që ta trajtonte kërkesën e IDK-së për qasje në dokumente publike dhe t'i lejonte qasje në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, si dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 205/2021**

Qëllim i kësaj Letre me rekomandim ishte identifikimi i shkeljeve të të drejtave dhe të lirive themelore nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI) lidhur me ankesën e K. G., drejtor ekzekutiv i Rrjetit të OJQ-ve AVONET, të parashtruar për mospërgjigje në kërkesën për qasje në dokumente publike; dhe identifikimin e detyrave dhe të përgjegjësive të institucioneve/autoriteteve publike, që burojnë nga Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike (LQDP).

Ankuesi i ishte drejtuar MMPHI-së me kërkesë për qasje në informata: *“Në lëndën në të cilën është duke u zhvilluar kontesti gjyqësor “Sallahu shpk” si paditës, ndërsa e paditur Ministria e Infrastrukturës.”* Ndërsa qasje në dokumente publike ishte kërkuar në dokumentet: *“Të gjitha Aktvendimet dhe 2. Veprimet që janë ndërmarrë lidhur me këtë lëndë.”*, por nuk kishte marrë përgjigje.

Përkundër veprimeve të ndërmarra nga Avokati i Popullit përkitazi me ankesën në fjalë dhe komunikimin e zhvilluar me zyrtarët përgjegjës të MMPHI-së, ankuesi nuk kishte realizuar qasjen në dokumentet e kërkuara. Rrjedhimisht, më 1 dhjetor 2021 Avokati i Popullit i ishte drejtuar me Letër rekomandimi ministrit të MMPHI-së, me të cilën kishte konstatuar se në rastin e ankuesit, MMPHI-ja nuk kishte arritur t’i përmbushte detyrimet ligjore lidhur me mundësimin, përkatësisht lejin për qasje në dokumente publike, në përputhje me kërkesën e parashtruar, e drejtë kjo e garantuar me akte vendore si dhe me instrumente ndërkombëtare. Avokati i Popullit i kishte rekomanduar MMPHI-së që ta trajtonte kërkesën e ankuesit dhe t’i ofronte qasje në informatat dhe në dokumentet e kërkuara, në pajtim me Ligjin nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe në pajtim me legjislacionin përkatës në fuqi.

## LIRIA E TUBIMIT, LIRIA E BESIMIT, E NDËRGJEGJES DHE E FESË

### Liria e tubimit, liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë, si dhe kufizimet e këtyre të drejtave gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë

Bazuar në Urdhrin Operativ: *“Për gatishmëri dhe reagim për COVID-19”*,<sup>254</sup> Policia e Kosovës (PK) ka filluar koordinimin, planifikimin dhe zbatimin në terren të detyrave të policisë, sipas Ligjit për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19<sup>255</sup>, sipas vendimeve të Qeverisë si dhe sipas vendimeve dhe rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të IKShPK-së. Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19 ka paraparë që kufizimi i lirisë së tubimit duhet të ndiqet me arsyetime të bollshme dhe të detajuara. Këto arsyetime duhet të dëshmojnë që ekziston lidhja e drejtpërdrejtë mes kufizimit, në njërin anë, dhe masave të ndërmarra për luftimin dhe pengimin e përhapjes së sëmundjes COVID-19, në anën tjetër<sup>256</sup>. Megjithatë, edhe pas vendosjes së masave dhe ndalimit të grumbullimit të më shumë se dy personave, sipas informatave të siguruar nga PK-ja, në polici janë paraqitur 155 kërkesa për lejin e mbajtjes së tubimit, prej të cilave janë aprovuar 151 kërkesa.

Sipas Ligjit për Tubimet Publike, policia duhet të angazhohet në monitorimin e tubimeve publike, me qëllim të ruajtjes së rendit dhe të qetësisë publike, si dhe ndërmarrjen e të gjitha masave në rast se tubimi publik rrezikon të prishë ose të shkatërrojë të mirat e përgjithshme. Sipas statistikave të siguruar nga PK-ja, 253 tubime/organizime janë monitoruar nga PK-ja, prej tyre 4 tubime politike, dhe në të gjitha ato raste që nuk janë përfillur rregullat zgjedhore, janë raportuar tek institucionet përkatëse. Gjithnjë sipas statistikave të siguruar nga PK-ja për periudhën e kufizimeve, janë mbajtur 71 tubime publike, 180 protesta dhe 10 marshime.

Edhe pse Ligji parasheh se askush nuk duhet të diskriminohet në asnjë mënyrë dhe as të pengohet për të kryer ritualet dhe ceremonitë fetare, megjithatë, situata në të cilën u gjend

254 Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, *“Procedura Standarde të Operimit”*, miratuar me 01.10. 2020, Ref:DDO-04-023/2020

255 Kuvendi i Republikës së Kosovë miratoi Ligjin nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID 19, datë 25 gusht 2020. Ky ligj përcakton përgjegjësitë dhe rolin e institucioneve shëndetësore publike, private dhe publiko-private në marrjen e masave për parandalimin, kontrollin, trajtimin, monitorimin, sigurimin e financimit dhe ndarjen e përgjegjësisë gjatë pandemisë COVID 19.

256 Kuvendi i Republikës së Kosovës, Ligji nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID 19 në Territorin e Republikës së Kosovës, neni 4(1.5).

Kosova dhe mbarë bota, pas shpërthimit të pandemisë COVID-19, bëri që të kufizohej ushtrimi i kësaj të drejte. Bazuar në vendimet e Qeverisë, të cilat në periudha të caktuara, bazuar në situatën dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit të përgjithshëm, kjo e drejtë është kufizuar dhe ndaluar në disa periudha të caktuara.

Në Republikën e Kosovës, edhe pse nuk ka statistika zyrtare lidhur me përkatësinë fetare të popullsisë, konsiderohet se pjesa më e madhe e popullsisë i takon besimit mysliman, rreth 90%, ndërsa 6% konsiderohet se i takojë besimit ortodoks, 3% i takojnë besimit katolik dhe 1% i takon u takon besimeve të tjera<sup>257</sup>.

Sipas Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës<sup>258</sup>, masat e kufizimit nga Qeveria janë mirëpritur dhe konsideruar si masa të arsyeshme, në drejtim të ruajtjes së shëndetit publik. Masat e vendosura kanë ndikuar në kryerjen e riteve fetare, pasi për shkak të ndalimit të tubimit, janë mbyllur xhamitë dhe besimtarët janë privuar nga mundësia që të faleshin në xhami. Gjithashtu kufizimet kanë ndikuar edhe në ndalimin e manifestimit për festën e Bajramit, për festën e Mevludit, të Mirazhit e të tjera të ngjashme.

Në përgjigjen e Kishës Katolike thuhet se i kanë respektuar të gjitha vendimet e Qeverisë dhe nuk kanë pasur asnjë problem, kurse Kisha Ortodokse Serbe, Kisha Protestante Evangjelistë dhe Bashkësia Hebraike nuk janë përgjigjur në pyetjen se sa dhe si ka ndikuar pandemia gjatë kohës së kufizimit të përgjithshëm.

Avokati i Popullit vlerëson se kufizimi i të drejtave dhe i lirive të njeriut për t'u tubuar/organizuar ishte i domosdoshëm, proporcional dhe i bazuar në ligjet vendore dhe ndërkombëtare si dhe rekomandimet e dala nga Ligji për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë COVID-19; në vendimet e Qeverisë, në vendimet dhe në rekomandimet e Ministrisë së Shëndetësisë dhe të IKShPK-së.

Vendimet për kufizimet e lirisë së tubimit/organizimit, varësisht nga situata, janë rishikuar vazhdimisht dhe masat janë ashpërsuar apo lehtësuar por edhe janë ndaluar tubimet në tërësi.

Avokati i Popullit ka vërejtur se Qeveria e Republikës së Kosovës vazhdimisht ka nxjerrë vendime me të cilat ka ndërmarrë masa proporcionale me situatën e krijuar, me qëllim të mbrojtjes nga pandemia COVID-19.

## LIRIA E SHPREHJES dhe LIRIA E MEDIIVE

### Liria e shprehjes dhe liria e medieve gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë

Liria e shprehjes dhe liria e mediave në vendet demokratike, përveç me instrumente ndërkombëtare, janë të garantuara edhe me Kushtetutë dhe me ligj, me të cilat përcaktohen edhe limitet e ushtrimit të kësaj të drejte për të shmangur abuzimin potencial apo cenimin e të drejtave të tjera.

Kufizimet e lirisë së shprehjes sipas legjislacionit të Kosovës konsistojnë me qëllim të shmangies së gjuhës së urrejtjes, nxitjes së dhunës, gjuhës diskriminuese, fyese dhe shpifjes. Në këtë drejtim nxitja e urrejtjes është përcaktuar edhe në Kodin Penal të Republikës së Kosovës (KPK), i cili në nenin 147 të tij përcakton veprën penale të *“Nxitjes së urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik.”*

257 Portali Shtetëror i Republikës së Kosovës.

258 Përgjigje e pranuar përmes postës elektronike, datë 16 korrik 2021.

Sipas zëvendës drejtorit të përgjithshëm të RTK-së, që nga shfaqja e rasteve të para ka rezultuar mungesë e transparencës për numrin e testeve për COVID-19 dhe për numrin e rezultateve, duke qenë se si të tilla janë publikuar vetëm nëpërmjet ueb-faqes zyrtare të IKShPK-së në Facebook; me mosdhënie të qasjes në informacion lidhur me prejardhjen e rezultateve, posaçërisht rreth përfshirjes potenciale të rezultateve nga laboratorët e licencuar privatë, dhe të tjerë të testuar jashtë vendit. Andaj sipas tij, rezultatet nuk ishin të kategorizuara sipas prejardhjes së testeve.

Sipas Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës sa i përket respektimit të standardeve të etikës së mediave dhe transmetuesve të shtypur gjatë pandemisë, mediat në përgjithësi janë treguar jashtëzakonisht korrekte në informimin e qytetarëve, sepse të njëjtat i kanë shfrytëzuar kryesisht burimet zyrtare për informim. Përgjithësisht bëjnë rastet në fillimet e shfaqjes së COVID-19, ende pa u konfirmuar asnjë rast infektimi në Kosovë, është evidentuar se disa portale të lajmeve kanë manipuluar me burime të besueshme që në të vërtetë ishin prodhues paniku. Gjithashtu ka pasur dezinformata të shpërndara në rrjete sociale kryesisht nga faqe të pa verifikuara, por pavarësisht kësaj, raportimi i gazetarëve në vend është cilësuar i saktë.

Në prill të vitit 2021, organizata “Reporterët pa Kufij” ka publikuar indeksin për vitin 2021, në bazë të së cilit në mesin e 180 shteteve të botës, Kosova është renditur në vendin e 78-të, në raport me lirinë e shprehjes dhe mediave. Sipas këtij raporti, për vitin 2021 Kosova ka pësuar rënie për 8 vende në Indeks, në krahasim me vitin 2020. Raporti evidenton rritje të paqëndrueshmërisë të mediave në vend, si pasojë e krizës së koronavirusit, duke theksuar se media në Kosovë mbetet e ndarë në vija etnike; qasja në informacione të caktuara shpesh është e kufizuar në një grup etnik ose politik dhe se shumica e mediave priren t'i mbulojnë dhe përqendrohen në çështjet që lidhen me kombësinë e tyre.

Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, duke u thirrur në solidaritet dhe bashkëpunim për të ndaluar përhapjen e COVID-19, dhe në respektimin e të drejtave të njeriut, më 20 prill 2020 ka publikuar Udhëzimet për COVID-19 [Të drejtat e njeriut në zemër të përgjigjes]. Nëpërmjet këtij udhëzuesi, Zyra e Komisionarit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut, përveç të tjerash, bën thirrje për sigurimin e informimit të saktë për pandeminë COVID-19 dhe për pjesëmarrje në vendimmarrje.

Avokati i Popullit e konsideron pozitive sigurimin e hapësirës së konsiderueshme mediale për informimin mbi gjendjen e pandemisë, gjithashtu vlerësimin pozitiv të menaxhimit dhe luftimit të dezinformatave dhe keqinformimit nga gazetarët në kohë pandemie, megjithatë mbetet ende shqetësuese manipulimi me burime të besueshme nga disa portale për të krijuar konfuzion dhe panik te qytetarët, si dhe shpërndarja e informatave dhe e lajmeve në rrjete sociale nga ueb-faqe të paverifikuara.

Me këtë rasti Avokati i Popullit bën thirrje të rregullohet infrastruktura e duhur ligjore dhe efektive mbi përdorimin e rrjeteve sociale në vend me qëllim të luftimit të keqinformimit dhe shpërndarjes së lajmeve të pa verifikuara si dhe ndërtimi i një standardi që në mënyrë të balancuar garantohet liria e shprehjes duke vendosur kufijtë e domosdoshëm për mbrojtjen e lirive dhe të të drejtave të tjera të njeriut.

Avokati i Popullit konstaton se kërcënimet, sulmet dhe cenimi i sigurisë së gazetarëve si dhe pengimi i ushtrimit të lirë të profesionit të tyre, përbën një nga problemet kryesore të cenimit të lirisë së shprehjes dhe të lirisë së mediave në vend. Zbatimi i së drejtës për qasje në dokumente publike, si një nga parakushtet për realizimin e së drejtës së lirisë së shprehjes, ende mbetet sfidë për institucionet publike në vend, duke u përkeqësuar edhe më tej që nga shfaqja e pandemisë COVID-19.

## TË DREJTAT ZGJEDHORE DHE TË PJESËMARRJES

### Të drejtat zgjedhore në periudhën e pandemisë COVID-19

Situata e krijuar nga pandemia COVID-19 ka pasur refleksione në të gjitha sferat e jetës duke përfshirë edhe të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes. Avokati i Popullit ka ndjekur me kujdes të veçantë procesin e zgjedhjeve të parakohshme qendrore të mbajtura më 14 shkurt 2021. Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka ndërmarrë veprime të caktuara para procesit zgjedhor, e po ashtu ka mbikëqyrur këtë proces zgjedhor.

Më 13 janar 2021, Avokati i Popullit ka publikuar deklaratë nëpërmjet së cilës u ka bërë thirrje të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës dhe partive politike që ta kenë parasysh situatën e krijuar nga pandemia COVID-19, dhe gjatë aktiviteteve që ndërlidhen me zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që pritëshin të mbaheshin më 14 shkurt 2021, t'i respektonin në mënyrë rigorozë rekomandimet e IKShPK-së dhe masat e vendosura nga Qeveria dhe nga Ministria e Shëndetësisë për parandalimin e pandemisë COVID-19.

Më 8 shkurt 2021, Avokati i Popullit ka publikuar deklaratën e dytë përmes së cilës ka shfaqur shqetësimin e tij lidhur me zbatimin selektiv të masave të Qeverisë për parandalimin e pandemisë COVID-19, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhjet e Përgjithshme 2021. Avokati i Popullit ka vërejtur se që nga fillimi i fushatës parazgjedhore nuk janë respektuar masat anti-COVID nga partitë politike, ndërsa në anën tjetër institucionet që kanë për obligim t'i zbatojnë këto masa nuk kanë reaguuar. Këto veprime Avokati i Popullit i ka konsideruar si standarde të dyfishta që nuk mund të tolerohen dhe cenojnë barazinë e qytetarëve para ligjit. Përveç kësaj, Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij për rrezikimin e jetëve të qytetarëve për shkak të mosrespektimit të masave.

Avokati i Popullit u ka rikujtuar obligimin që kanë të gjitha institucionet dhe partitë politike për respektimin e masave për parandalimin e pandemisë, ndërsa ka ftuar autoritetet kompetente që të ndërmerrnin veprime konkrete për respektimin e këtyre masave nga subjektet politike. Avokati i Popullit konsideron se në tërësinë e vet, procesi zgjedhor është zhvilluar në një atmosferë të sigurt, i qetë, i lirë e demokratik. Pjekuria e qytetarëve në njërin anë, angazhimi maksimal të cilin KQZ-ja e ka treguar në tërësinë e vet në përgatitjet dhe në organizimin e këtyre zgjedhjeve, kanë shënuar moment jashtëzakonisht të rëndësishëm për respektimin e vullnetit të lirë të qytetarëve dhe nivelin e demokracisë në vend. Prandaj nga perspektiva e respektimit dhe e ushtrimit të kësaj të drejte politike, Avokati i Popullit shpreh konsideratën dhe vlerësimin e tij maksimal. Po ashtu Avokati i Popullit vlerëson Policinë e Kosovës për mbështetjen profesionale që ka ofruar përgjatë gjithë ditës së zgjedhjeve nëpër të gjithë territorin e Republikës së Kosovës, duke garantuar siguri dhe mbarëvajtjen e procesit elektorale.

### Raport për rastin A. nr. 757/2020 në lidhje me moszbatimin e nenit 61 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale

Në mënyrë që përfaqësuesit e komuniteteve pakicë të mund t'i realizojnë dhe mbrojnë të drejtat e tyre të garantuara me Kushtetutë është e domosdoshme që t'u sigurohet përfaqësimi përkatës në organet lokale publike. Kështu, në komunat ku më së paku 10% e banorëve u takojnë komuniteteve pakicë, të cilat në atë komunë nuk përbëjnë shumicën, vendi i nënkryetarit është i rezervuar për një përfaqësues të komunitetit sipas përcaktimit të nenit 62, paragrafi 1, i Kushtetutës. Raporti tërheq vëmendjen e Komunës së Graçanicës dhe të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përkitazi me moszbatimin e nenit 61 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 5, paragrafi 1, të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 02/2020 për Procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Vetëqeverisjen Lokale ua ka njohur komuniteteve të drejtën që ta kenë një nënkryetar komune për komunitete nëse të paktën 10% e qytetarëve të asaj komune u përkasin komuniteteve joshumicë. Sipas këtij përcaktimi, ligji nuk bën ndarjen e komuniteteve joshumicë, mirëpo e përcakton atë si tërësi, e cila duhet të jetë jo më pak se 10% e të gjithë qytetarëve të një komune.

Raporti konstaton se ekziston mospërputhje në emërtim të nenit 60 mes gjuhës shqipe dhe gjuhës serbe, si dhe nenit 61, e cila në praktikë mund të sjellë paqartësi rreth zbatimit të ligjit. Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kryetarit të Komunës së Graçanicës që të ndërmarrë veprime në pajtim me nenin 61 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe që sa më parë të emërojë nënkryetarin për komunitete në komunën e Graçanicës. Ndërsa Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal i rekomandoi të mbikëqyrë zbatimin e nenit 61 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale si dhe në bashkëpunim me Kuvendin e Republikës së Kosovës, të ndërmarrë veprime konkrete, me qëllim të harmonizimit gjuhësor të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht nenet 60 dhe 61.

### **Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën e subjekteve politike: Partia Liberale Egjiptiane (PLE), Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK)**

Avokati i Popullit, bazuar në ankesën e parashtruar nga V. B. nga komuniteti egjiptian, ka analizuar kërkesën e parashtruesve drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlerësimin e përputhshmërisë me Kushtetutën të Aktgjykimit AA.nr.29/2021 të Gjykatës Supreme të Kosovës, si dhe të Vendimit A.nr.736/2021 të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), përkatësisht pajtueshmërinë me nenin 58, paragrafi 4, të Kushtetutës [Përgjegjësitë e Shtetit], i ndryshuar me Amendamentin 1 në lidhje me nenin 15 të Konventës Kornizë të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, si dhe me të drejtat e garantuara në nenin 45 të Kushtetutës [Të Drejtat Zgjedhore dhe të Pjesëmarrjes] në lidhje me nenin 3 të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Përmes këtij opinioni, Avokati i Popullit ka vlerësuar se për raste të njëjta organet vendimmarrëse duhet të nxjerrin vendime të njëjta. Në këtë mënyrë garantohet realizimi pa dallim i të drejtave zgjedhore dhe të pjesëmarrjes, të garantuara me Kushtetutë dhe me instrumente ndërkombëtare, në të kundërtën, nëse për raste të njëjta nxirren vendime të ndryshme, atëherë krijohet situatë e pabarazisë dhe e standardeve të dyfishta të vendosura nga organet vendimmarrëse, duke theksuar se është me rëndësi që Gjykata Kushtetuese të vlerësojë këtë çështje dhe të vendosë se a janë cenuar të drejtat kushtetuese zgjedhore në këtë rast.

Po ashtu, me këtë opinion Avokati i Popullit konsideron se institucionet e Republikës së Kosovës duhet të jenë përgjegjëse dhe garantuese për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit zgjedhor në tërësi, duke respektuar plotësisht dhe pa dallim përcaktimet kushtetuese lidhur me të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes.

## **E DREJTA PËR PUNË DHE PËR USHTRIMIN E PROFESIONIT**

### **Ndikimi i pandemisë në të drejtat sociale dhe ekonomike dhe në të drejtën e punës në sektorin publik dhe privat**

Pandemia COVID-19 ndikoi edhe në ekonominë e Kosovës. Përkundër politikave mbështetëse, aktiviteti ekonomik sipas FMN-së vlerësohet të ketë rënë 6% për vitin



2020,<sup>259</sup> përderisa sipas ASK-së, kjo rënie ka qenë 5.3%.<sup>260</sup> Sipas vlerësimeve të Bankës Botërore, rënia pritët të jetë 6.9% (Banka Botërore, 2021). Deficiti fiskal u rrit për 7.7% të PBB-së, duke pasur parasysh rënien e madhe nga mbledhja e të hyrave nga taksat dhe zbatimin e masave zbutëse dhe rigjeneruese prej 4.2% të PBB-së (FMN, 2021). Rritja pritët të rikthehet në vitin 2021 dhe aktiviteti real do të arrijë nivelet para pandemike vetëm në vitin 2022 (FMN, 2021; Banka Botërore, 2021). Rreth 4.3% e PBB-së janë alokuar për masat e ndërmarra, për sistemin shëndetësor (0.4% e PBB-së), bonuset e pagave për punonjësit e shëndetësisë dhe sigurimit për orët shtesë të punës dhe për rrezikun e rritur me të cilin përballen në kryerjen e detyrave të tyre (0.5% e PBB-së), transferimet sociale dhe subvencionet për familjet në nevojë (1.6% e PBB-së), si dhe mbështetje për firmat në formë të subvencionimit të pagave dhe qasje më të lehtë për huazim (përfshirë NP dhe fermat me rreth 1.7% e PBB-së), dhe shpenzimet kapitale (më pak se 0.1% e PBB-së). për të stimuluar kërkesën agregate, Ligji për Rimëkëmbje Ekonomike lejoi tërheqjen e 10% të mjeteve të kursyera në llogaritë personale të kursimeve pensionale në FKPK (2.6% e PBB-së), shumica e të cilave (1.8% e PBB-së) do të rimbursohen nga buxheti duke filluar në vitin 2023 (rimbursohen vetëm ata që me rastin e tërheqjes kanë pasur deri në 10.000 euro kursime në llogaritë e tyre). Sipas ATK-së, Kosova ka përjetuar një rënie të konsiderueshme të të hyrave në nëntë muajt e parë të vitit 2020, mbi 1 miliard euro më pak se në vitin 2019 (Raporti i Shoqërisë Civile, 2021).<sup>261</sup>

Po ashtu pandemia ndikoi edhe në tregun e punës. Krahasuar me vitin 2019, ka rënie të shkallës së punësimit me 1.7%, ku kjo rënie tek meshkujt ishte 3.4%, përderisa tek femrat kemi rritje për 0.2 % (ASK, 2021).

Të dhënat nga Inspektorati i Punës, tregojnë se në vitin 2020 Inspektorati ka realizuar 18.506 inspektime, por 2.419 kanë qenë lidhur me monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse të vendosura nga qeveria, që do të thotë se nuk kanë pasur për qëllim të drejtat e punëtorëve. Nga 8.509 ankesa të pranuar, 84% kanë qenë nga sektori publik.

Sa u përket politikave tatimore, Ministria e Financave dhe Transfereve (MFT), në koordinim me ATK-në, ka zgjatur afatin për deklarimin dhe pagesat e detyrimeve tatimore, si dhe detyrimet dhe kontributet e pensioneve, deri më 30 qershor 2020. Një masë tjetër e përkohshme në lidhje me tatimet ishte heqja e TVSh-së në importe të grurit dhe të miellit, si dhe zgjatja e afatit të pagesave të shërbimeve publike, deri në fund të prillit. Krejt në fund, më 18 maj, MFT-ja mori edhe një vendim tjetër ku njoftoi se interesi për tatimet e pronave do të pezullohet deri në vitin 2021.

ATK që gjatë kësaj periudhe u mundësoi tatimpaguesve t'i kryejnë obligimet tatimore bazuar në mundësitë financiare të tatimpaguesve, me qëllim të ruajtjes së stabilitetit financiar. Megjithatë, u raportuan ankesa nga bizneset se në pamundësi për të paguar borxhin e akumuluar sipas marrëveshjes paraprake me ATK-në, për shkak të vështirësive financiare dhe për shkak të situatës me pandeminë, nga inspektorët e ATK-së vazhdimisht janë paralajmëruar se nëse nuk i paguajnë këstet me kohë, do t'u konfiskohet prona. Në përgjigjen e marrë nga ATK-ja theksohet se vendimi i Qeverisë nuk i ndërpret procedurat e ATK-së për të realizuar të drejtën e vet sipas ligjit, përmes Departamentit të Menaxhimit të Mbledhjes së Borxheve.

259 Fondi Monetar Ndërkombëtar, 2021, IMF Staff report for Republic of Kosovo, Volume 2021, Issue 041, <https://doi.org/10.5089/9781513569536.002>

260 ASK, 2021, Bruto produkti vendor (BPV) sipas aktiviteteve ekonomike dhe me qasjen e shpenzimeve 2008 – 2020: <https://ask.rks-gov.net/media/6311/bpv-2008-2020.pdf>

261 Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), "Raporti i Shoqërisë Civile për të Drejtat e Njeriut Në Kosovë në Vitin 2020", qershor 2020, (linku: <https://unmik.unmissions.org/file/158952/download?token=eZSA6ENf>)

Një nga masat e Qeverisë për të mbështetur qytetarët dhe për të rritur kërkesën agregate ishte mundësia për tërheqjen e deri në 10% të kursimeve pensionale nga Fondi i Kursimeve Pensionale.<sup>262</sup> Këtë të drejtë nga data 11 dhjetor 2020 deri më datën 31 dhjetor 2020 e kanë shfrytëzuar 397572 persona nga 644582, do të thotë 61% e kontribuesve. Aplikimi ka vazhduar deri më 6 prill të vitit 2021.

Masë tjetër e ndërmarrë ishte edhe shtyrja e kredive nga bankat komerciale. Në përgjigjet që Avokati i Popullit ka pranuar nga BQK-ja, është raportuar se numri total i personave që kanë aplikuar për shtyrje të kredive deri në fund të muajit korrik 2020 ishte 77.629 persona, nga të cilët 57.443 ishin persona fizikë (29.229 të punësuar në sektorin privat) dhe 20.186 ishin persona juridikë. Pas vendimit për shtyrje, BQK-ja ka nxjerrë edhe dy udhëzime lidhur me ristrukturimin e kredive, njëri në shtator 2020 e tjetri në shkurt 2021 në bazë të të cilëve klientët kanë mundur të shfrytëzonin të drejtën e ristrukturimit të kredive. Sipas të dhënave të fundit, vlera aktuale e gjithsej kredive të ristrukturuara, përfshirë të gjitha fazat (vendimin dhe udhëzimet) në maj 2021 ishte 975.6 milionë euro, apo 28.8% e portofolit kreditor. Me këtë rast duhet cekur që pas ristrukturimit, klientët kanë vazhduar të paguanin këstet në përputhje me marrëveshjet e nënshkruara me bankat dhe ka një stabilitet në kthimin e kësteve pas ristrukturimit. Përfaqësuesit e BQK-së sqaruan se shumica e ankesave të konsumatorëve kanë qenë të lidhura me interesin që bankat kanë aplikuar edhe për periudhën e moratoriumit. Edhe pse BQK-ja dhe bankat komerciale e kanë sqaruar se gjatë periudhës së moratoriumit nuk do të aplikohet interes ndëshkues dhe interesi për periudhën e moratoriumit do të paguhet përgjatë muajve pas fillimit të kthimit të kredive, klientët e kanë keqkuptuar duke vlerësuar se gjatë periudhës së moratoriumit bankat nuk do të llogarisin interesin për kreditë. Kjo tregon se ka pasur nevojë për shpërndarje më të madhe të informimit të saktë dhe eksplisit të publikut.

#### **Raport ex-officio nr. 49/2021 në lidhje me të drejtat e nënave (prindërve) vetushqyese në Kosovë lidhur me njohjen e pushimit vjetor edhe për dy ditë pune për prindin vetushqyes, i cili i takon sipas Ligjit nr.03/L-212 të Punës**

Raporti trajton çështjen e mosnjohjes së pushimit vjetor edhe për dy ditë pune shtesë për prindër vetushqyes, në përputhje me nenin 32 të Ligjit të Punës. Raporti konstaton se nënat me fëmijë deri në tre vjeç, prindi vetushqyes dhe personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë në pushim vjetor edhe për dy ditë pune shtesë. Rrjedhimisht punëdhënësit janë të obliguar që të zbatojnë nenin 32 të Ligjit të Punës.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandon Inspektoratit të Punës që të monitoroi zbatimin e nenit 32 të Ligjit të Punës, i cili përcakton të drejtën për pushim edhe për dy ditë pune shtesë për nënat me fëmijë deri në tre vjeç, për prindin vetushqyes dhe për personat me aftësi të kufizuara; si dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale që në legjislacion të japë definicion të saktë për prind vetushqyes.

#### **Raport për rastin A. nr. 928/2019 lidhur me harmonizimin e Rregullores (MKRS) nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksonimin e Ansambllit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve me Rregulloren (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore**

Ky rast është iniciuar për hetim në institucionin e Avokatit të Popullit duke u bazuar në ankesë individuale me të cilën ankuesi pretendon se Rregullorja nr. 04/2019 është në kundërshtim me Rregulloren nr. 15/2018.

<sup>262</sup> Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës, Raporti vjetor 2020, (linku: [http://www.trusti.org/ep-content/uploads/2021/05/RaportiVjetor\\_2020\\_shq\\_ueb.pdf](http://www.trusti.org/ep-content/uploads/2021/05/RaportiVjetor_2020_shq_ueb.pdf)), vizituar më 01/07/2020.

Raporti synon të vë në pah mospërputhjen e Rregullores nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansambllit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve (Rregullore nr. 04/2019), e miratuar nga MKRS-ja, me Rregulloren nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore (Rregullore nr. 15/2018), e miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Ankuesi pretendon se Rregullorja nr. 04/2019 është në kundërshtim me Rregulloren nr. 15/2018 dhe nuk ua njih aktorëve rolet e luajtura në teatrot e tjera publike të qyteteve. Ankuesi njofton se më 4 shtator 2019, ka paraqitur Ankesë nr. 3744/2019 në MKRS, mirëpo nuk ka pranuar përgjigje.

Raporti konstaton se Rregulloren nr. 04/2019, përkatësisht neni 8, është e nevojshme të harmonizohet me Rregulloren 15/2018 dhe të eliminohen paqartësitë në mes të këtyre akteve nënligjore. Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i ka rekomanduar MKRS-së që ta ndryshojë dhe ta plotësoi Rregulloren nr. 04/2019 për Themelimin dhe Funksionimin e Ansambllit Rezident të Teatrit Kombëtar dhe Teatrove të Qyteteve, përkatësisht neni 8 i kësaj rregulloreje të harmonizohet me nenin 6 të Rregullores (QRK) nr. 15/2018 për Gradat dhe Pagat e Krijuesve dhe Përformuesve të Kulturës dhe Punonjësve Profesionalë të Trashëgimisë Kulturore.

### **Raport për rastin A. nr. 933/2019 lidhur me nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për Procedurat për Licencimin e Institucioneve Publike Shëndetësore, si dhe zhvillimin e procedurave për licencimin e institucioneve shëndetësore publike**

Raporti tërheq vëmendjen e Ministrisë së Shëndetësisë lidhur me obligimin ligjor për nxjerrjen e Udhëzimit Administrativ për Procedurat për Licencimin e Institucioneve Publike Shëndetësore. Po ashtu raporti tërheq vëmendjen për zbatimin e nenit 42 të Ligjit për Shëndetësinë, që ka të bëjë me licencimin dhe akreditimin e institucioneve publike dhe private shëndetësore.

Raporti konstaton se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Procedurat për Licencimin e Institucioneve Shëndetësore Publike, e po ashtu institucionet shëndetësore publike nuk licencohen sipas përcaktimeve të nenit 42 të Ligjit për Shëndetësinë. Për më tepër Avokati i Popullit vëren se Ministria e Shëndetësisë nuk e ka zbatuar tërësisht obligimin që rrjedh nga neni 42 i Ligjit për Shëndetësinë, sipas të cilit duhet të ketë bazë ligjore për licencimin dhe akreditimin e institucioneve shëndetësore, pa dallim.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Shëndetësisë që ta nxjerrë Udhëzimin Administrativ për Procedurat për Licencimin e Institucioneve Shëndetësore Publike, sipas obligimeve që rrjedhin nga neni 42 i Ligjit për Shëndetësinë, në mënyrë që sa më parë të zhvillohen procedurat për licencimin e institucioneve shëndetësore publike, sipas përcaktimeve në nenin 42 të ligjit.

### **Opinion i Avokatit të Popullit për kërkesën e Gjykatës Supreme dërguar në Gjykatën Kushtetuese lidhur me vlerësimin e nenit 94 të Ligjit të Punës, që ndërlihet me kompetencat e Inspektoratit të Punës**

Avokati i Popullit ka analizuar kërkesën e Gjykatës Supreme drejtuar Gjykatës Kushtetuese lidhur me vlerësimin e pajtueshmërisë me Kushtetutën të nenit 94 të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, lidhur me juridiksionin e Inspektoratit të Punës, pjesa e dispozitës “Mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, të cilat rregullojnë marrëdhënien e punës” dhe ka vërejtur se çështje kontestuese në këtë rast janë veprimet e Inspektoratit të Punës, i cili sipas Gjykatës Supreme vendos për kërkesat nga marrëdhënia e punës lidhur me pagat

e të punësuarve dhe për kërkesat e tjera materiale, ligjshmërinë e vendimeve për masat disiplinore, kthimin e punëtorëve në punë etj.

Në këtë drejtim është me rëndësi që Gjykata Kushtetuese e Kosovës ta qartësojë pozicionin e Inspektoratit të Punës dhe të kompetencave të tij, në bazë të kërkesës së Gjykatës Supreme të Kosovës, në mënyrë që ta parandalojë Inspektoratin e Punës që me veprimet e tij t'i cenojë të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Avokati i Popullit vlerëson se sipas nenit 94, të Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, Inspektorati i Punës është kompetent për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave të Ligjit të Punës që bien në kompetencën e tij, në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe të Ligjit nr. 2003/19 për Siguri në Punë, Mbrojtje të Shëndetit të Punësuarve dhe Mbrojtjen e Ambientit të Punës (i shfuqizuar nga Ligji nr. 04/L- 161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë).

Avokati i Popullit vëren se shqyrtimi i rasteve që kanë të bëjnë me ndërprerjen e kontratës së punës, kompensimet që u takojnë punonjësve sipas këtij ligji, si dhe kthimin e punëtorit në punë dhe kompensimet e pagave gjatë kohës së largimit të kundërligjshëm nga puna nga Inspektorati i Punës, përbën tejkalim të kompetencave nga Inspektorati i Punës e që rrjedhimisht rezulton me cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve, sepse një organ i cili vepron në kuadër të pushtetit ekzekutiv nuk mund të shqyrtojë dhe të vendosë çështje të cilat ligji shprehimisht i ka lënë në kompetencë të gjykatave, pra në kuadër të pushtetit gjyqësor.

### **Opinion i Avokatit të Popullit lidhur me kërkesën për rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar në Gjykatën Supreme (ARJ.nr. 115/2021) nga Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore**

Avokati i Popullit nëpërmjet këtij opinionit ka analizuar kërkesën e parashtruesve drejtuar Gjykatës Supreme lidhur me rishqyrtimin e jashtëzakonshëm të Aktvendimit A.nr. 1430/21 të Gjykatës Themelore në Prishtinë (GjThP) dhe të Aktvendimit A.A.nr. 651/2021 të Gjykatës së Apelit të Kosovës (GjA). Rasti ka të bëjë me kërkesën e Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore për vlerësimin e ligjshmërisë së Rregullores MD - Nr. 01/2020 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Institutit të Mjekësisë Ligjore. Lidhur me këtë çështje, GjThP-ja më 5 korrik 2021 ka nxjerrë Aktvendimin A.nr. 1430/21, me të cilin ka hedhur poshtë si të palejuar padinë e Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore. Më tej GjA-ja më 6 gusht 2021 ka nxjerrë Aktvendimin AA.nr. 651/2021, me të cilin ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Sindikatës së Institutit të Mjekësisë Ligjore dhe ka vërtetuar Aktvendimin A.nr. 1430/21, i datës 5 korrik 2021. Rrjedhimisht, Sindikata e Institutit të Mjekësisë Ligjore, më 29 shtator 2021, kishte parashtruar në Gjykatën Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor.

Avokati i Popullit vlerëson se Ligji nr. 06/L-054 për Gjykatat, përkatësisht neni 26 [Kompetencat e Gjykatës Supreme], paragrafi 1, nënparagrafi 1.4, përcakton:

*“1.Gjykata Supreme është kompetente të vendosë lidhur me: 1.4. përcakton qëndrimet parimore, nxjerr mendime juridike dhe udhëzues për zbatimin unik të ligjeve nga gjykatat në territorin e Kosovës.”*

Andaj, Avokati i Popullit ka konsideruar se është me rëndësi që Gjykata Supreme, përmes një qëndrimi parimor apo mendimi juridik, të sqarojë çështjen e kompetencës së gjykatave në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë, por edhe të kushtetutshmërisë së akteve nënligjore (udhëzimeve administrative, rregulloreve), të nxjerra nga organet e administratës shtetërore apo publike e gjithashtu do të krijonte një praktikë, sipas së cilës do të veprohej në rastet

kur kërkohet vlerësimi i ligjshmërisë së akteve nënligjore të miratuara nga organet e administratës shtetërore apo publike.

Avokati i Popullit gjithashtu vlerëson se nëpërmjet qëndrimit të Gjykatës Supreme do të duhej të sqarohet procedura e cila duhet të ndiqet për vlerësimin e ligjshmërisë së akteve nënligjore, në mënyrë që qytetarët e vendit të mundë ta realizonin të drejtën kushtetuese që ka të bëjë me mbrojtjen gjyqësore të të drejtave dhe në të drejtën për mjete efektive juridike.

## E DREJTA PËR ARSIMIN dhe TË DREJTAT E FËMIJËS

### **Të drejtat e fëmijëve, ndikimi i emergjencës shëndetësore në jetën e fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuar, dhe vështirësitë e hasura gjatë pandemisë COVID-19 në Kosovë**

Të drejtat e fëmijëve janë pjesë e integruar e të drejtave të njeriut. Pra, fëmijët dhe të rinjtë kanë të njëjtat të drejta të përgjithshme njerëzore si të rriturit dhe gjithashtu të drejta specifike që u përshtaten nevojave të tyre të veçanta si fëmijë. Fëmijët konsiderohen si bartës të të drejtave dhe pjesëmarrës aktiv në realizimin e tyre, andaj edhe realizimi i këtyre të drejtave u mundëson fëmijëve që të zhvillojnë dhe të arrijnë potencialin e tyre të plotë, duke ua njohur dinjitetin themelor njerëzor dhe urgjencën për të siguruar mirëqenien e tyre. Pa dyshim, jeta, shëndeti, edukimi dhe mbrojtja e fëmijës janë themele mbi të cilat varet edhe e ardhmja e shoqërisë dhe e shtetit tonë. Duke qenë se fëmijët janë të varur nga trajtimi dhe mbikëqyrja e prindërve apo e kujdestarëve, çdo ndryshim që prek këta të fundit ndikon në të njëjtën kohë edhe tek fëmijët. Andaj veprimet ose mosveprimet e prindërve, të komunitetit dhe të institucioneve mund të ndikojnë tek fëmijët më shumë se tek çdo grup tjetër shoqëror. Rrjedhimisht, është e rëndësishme që këto veprime ta kenë parasysh interesin më të mirë të fëmijës gjatë hartimit të politikave dhe të legjislacionit.

Në Kosovë rreth 40% e popullatës është nën moshën 25 vjeçe, ndërsa rreth 30% janë fëmijë nën moshën 18 vjeçe.<sup>263</sup> Duke parë rëndësinë e të rinjve dhe të fëmijëve në të ardhmen e Kosovës, si dhe nevojën për të përcaktuar dhe mbrojtur interesin e tyre, shteti i Kosovës është përkujdesur që ta rregullojë këtë çështje në aspektin politik dhe juridik, duke përfshirë të drejtat e fëmijëve në nivel të Kushtetutës dhe nxjerrjen e ligjeve të tjera përkatëse.

Pandemia si dhe masat e ndërmarra për menaxhimin dhe parandalimin e saj kanë pasur efekte socio-ekonomike dhe rrjedhimisht kanë ndikuar në mirëqenien e fëmijëve, në shëndetin e tyre, në sigurinë dhe në arsimin. IAP-ja ka theksuar se këto efekte socio-ekonomike potencialisht mund të ndikojnë edhe në rrezikun nga varfëria. Përgjatë çdo analize IAP-ja i kushton rëndësi të veçantë faktorëve të ndryshëm të cilët ndërveprojnë në realizimin e të drejtave të fëmijëve, siç janë: gjinia, etniteti, dhe/apo aftësia e kufizuar. Në një shembull konkret, gjatë pandemisë IAP-ja ka vërejtur se në kalimin nga mësimi në shkollë në mësimin online, shumë fëmijë nuk kishin qasje në pajisje teknologjike dhe në internet. Mirëpo, veçanërisht fëmijët ashkalinj, romë, e egjiptianë dhe fëmijët me aftësi të kufizuara ishin të prekur nga ky proces. Për më tepër, mësimi dhe qasja ishte më e vështirë për fëmijët me aftësi të kufizuara, ku në fillim të pandemisë nuk kishte planprograme online të përshtatshme për nevojat e tyre.

Në nivel global, Komiteti për të Drejtat e Fëmijës, si autoritet interpretues i KDF-së, dhe njëherësh një ndër trupat më me ndikim në këtë fushë, qysh në fillim paralajmëroi shtetet

<sup>263</sup> Agjencia e Statistikave e Kosovës: Regjistrimi i fundit i popullsisë dhe i ekonomive familjare 2011.

palë për efektet serioze fizike, emocionale dhe psikologjike tek fëmijët të shkakuar nga pandemia COVID 19 si dhe u bëri thirrje shteteve palë të ndërmerrnin masa për të mbrojtur të drejtat e fëmijës.

Fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët edhe para pandemisë kanë qenë të cenueshëm dhe me shumë pengesa në kuptimin e realizimit të të drejtave të tyre, pandemia ua ka vështirësuar dhe pamundësuar edhe më tepër ato pak mundësi dhe të drejta që i gëzonin. Fëmijët me aftësi të kufizuar, për shkak të nevojave specifike si dhe mosrealizimit të shërbimeve të caktuara, janë vënë para vështirësive dhe rreziqeve për abuzim, keqtrajtim, rritje të stigmës, rrezikimin e shëndetit dhe jetës, thellimit të dallimeve sociale për shkak të varfërisë si dhe vështirësisë për rehabilitimin dhe aftësimin për jetë.

Pavarësisht ndikimit që mund të ketë pasur një veprim apo mosveprim i autoriteteve dhe i institucioneve karshi një të drejte apo një grupi të të drejtave të caktuara të fëmijës, si dhe shkeljes apo cenimit të supozuar të asaj të drejte, autoritetet dhe institucionet përgjegjëse, ndikimin e pandemisë duhet kuptuar dhe trajtuar nga qasja gjithëpërfshirëse, kjo për faktin që të drejtat e fëmijës janë të drejta të pandara dhe të ndërlidhura, shkelja apo cenimi i një të drejte ka ndikim dhe ndërlidhet me realizimin e një apo shumë të të drejtave tjera.

Avokati i Popullit konstaton se vendimet e Qeverisë dhe të institucioneve përkatëse, nuk kanë marrë për bazë nivelin e kërkuar të zbatimit të parimit të interesit më të mirë të fëmijës. Pandemia e COVID 19 dhe vendimet gjegjëse të nxjerra nga Qeveria dhe nga institucionet e tjera, kanë ndikuar në realizimin e të drejtave të fëmijës në Republikën e Kosovës. Edhe pse nga ky raport është e vështirë të nxirret konkluzioni i saktë se shkalla e shkeljes së të drejtave të fëmijëve, veçanërisht e atyre me aftësi të kufizuar, shkeljet nga veprimi apo mosveprimi i Qeverisë dhe i institucioneve të tjera janë evidentuar përgjatë hetimit në shumë fusha dhe aspekte.

Nuk ka pasur një strategji gjithëpërfshirëse mbështetëse për fëmijët me aftësi të kufizuar, në shumë raste mbështetja dhe ndihma ka qenë e përkohshme, e organizuar keq dhe nuk ka mbuluar të gjithë fëmijët në të njëjtën kohë.

Ndërprerja dhe pezullimi i disa shërbimeve shëndetësore ka përkeqësuar gjendjen shëndetësore të fëmijëve duke përfshirë edhe fëmijët me aftësi të kufizuar, si dhe në raste të caktuara ka mundur ta rrezikonte edhe vetë jetën dhe zhvillimin e fëmijëve.

Edhe pse nga të dhënat gjatë pandemisë vërehet një ulje e rasteve të privimit nga liria (ndalimit, paraburgimit dhe dënimit me burg), prapëseprapë rreziku për infektim ka qenë i lartë për të miturit që kanë qenë duke vuajtur masën edukuese korrektuese apo dënimit me burg. Kjo pandemi duhet të shërbejë si mësim që politikë bërësit dhe ligjvënësit t'i rishikojnë politikat dhe legjislacionin në mënyrë që të miturve në rrethana të tilla t'u mundësohet liri i parakohshëm apo kalimi në ndonjërin prej masave apo dënimeve alternative

Në këtë raport i cili tashmë është publikë Avokati i Popullit adresoi 22 (njëzetedy) rekomandime për autoritetet përgjegjëse.

## **E drejta për arsim dhe për aktivitete kulturore gjatë pandemisë**

Për shkak të kushteve dhe të rrethanave të krijuara nga pandemia COVID 19, MAShTI ka ndërmarrë masa për fillimin e vitit shkollor 2020/21, duke hartuar dokumente të cilat do t'ua lehtësojnë punën institucioneve arsimore, për këtë qëllim janë publikuar udhëzues të ndryshëm, por më i rëndësishëm është Master Plani për Zhvillimin e Mësimin në Kushte Pandemie 2020-2021 në Republikën e Kosovës, i aprovuar nga Qeveria e Republikës së

Kosovës më 26 gusht 2020.<sup>264</sup> Qëllimi i këtij dokumenti është që të pasqyrohet Projekti për fillimin e mësimit për vitin shkollor 2020 – 2021, me fokus në e-mësimin dhe mësimin në objektet shkollore, përfshirë një Plan të Veprimit dhe Koston e projektuar të përgatitjes, zbatimit dhe monitorimit të e-mësimit. Sipas këtij dokumenti, parashihet që mësimi të zhvillohet sipas Skenarit A: mësimi zhvillohet në shkolla; Skenari B: mësimi i kombinuar (mësim në shkolla dhe mësim në distancë) dhe Skenari C: mësimi online dhe në distancë.

Pas mbylljes së detyrueshme të të gjithë sistemit arsimor në Republikën e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, me ndihmën e partnerëve vendorë dhe ndërkombëtarë, arriti të zhvillonte dhe të ofronte mësimin nëpërmjet sistemit të mësimit në distancë, nëpërmjet këtyre formave: Platformën E-Mësimi – platforma kryesore online e transmetuar nga kanali publik RTK; Platformën e edukimit në fëmijërinë e hershme - edukimi në distancë – kujdesi, zhvillimi dhe edukimi në fëmijërinë e hershme për moshën 0 – 6 vjeç; Platforma e mësimit në distancë për fëmijët me nevoja të veçanta – Arsimi gjithëpërfshirës; Platforma e mësimit E-shkollari – Platformë e mësimit për fëmijë për klasat 1-9.

Tri platformat e para janë ofruar për fëmijët në katër gjuhë: shqip, serbisht, turqisht dhe boshnjakisht. Përkundër rezultateve të treguara, mësimi në distancë i ofruar përmes platformave online dhe aktiviteteve përcjellëse të organizuara nëpërmjet aplikacioneve online (Zoom, Teams, Skype etj) u shoqërua edhe me sfida dhe vështirësi, e të cilat nuk ishin të pakta dhe pa ndikim. Këto sfida cenuan kohë pas kohë të drejtën e fëmijës për arsim, kjo për faktin se jo të gjithë fëmijët në mënyrë të barabartë kishin mundësi të vijonin mësimin në distancë, sepse disa nga ta kishin mungesë interneti, mungesë të pajisjeve elektronike (telefon, tablet apo PC desktop), e disa nga ta edhe mungesë të hapësirës fizike në hapësirat ku banonin (sidomos tek rastet e familjeve që kishin dy apo më tepër nxënës). Gjendja më e rëndë sigurisht ka qenë tek fëmijët me aftësi të kufizuar, për shkak të nevojave të veçanta dhe kufizimeve për të përdorur apo për t'u qasur në platformë, si dhe fëmijët nga komunitetet: rom, ashkali dhe egjiptian.

Rrjedhimisht, vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës për lirim të punonjëseve shtatzëna kishte rëndësi të veçantë për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës, ndërsa zëvendësimi i mësimit ndërmjet shtatzënave me studentë të Fakultetit të Edukimit ishte në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 10/2018 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, institucionet edukativo-arsimore obligohen të kërkojnë kuadro sipas këtij udhëzimi administrativ (neni 2), si dhe parashihen kriteret e kandidatëve të cilët mund të pranohen si mësimitdhënës të kualifikuar (neni 10, paragrafi 1).

Duke u bazuar në këto dispozita, Avokati i Popullit vëren se angazhimi i studentëve për pozitat në të cilat ka pasur mundësi të angazhoheshin kandidatët e kualifikuar, të cilët i plotësonin kriteret sipas udhëzimit administrativ, ishte në kundërshtim me dispozitat e udhëzimit administrativ, pasi vetëm kandidatët të cilët i plotësonin kriteret e parapara konsideroheshin të kualifikuar për lëndët përkatëse, ndërsa eventalisht ndonjë pozitë për të cilën nuk mund të sigurohej kandidat i kualifikuar sipas udhëzimit administrativ, ka pasur

264 Zyra e Kryeministrit e Republikës së Kosovës, vendimet e mbledhjes, (linku: <https://kryeministri.rks-gov.net/wp-content/uploads/2020/08/Vendim-nga-mbledhja-e-27-t%C3%AB-e-Qeveris%C3%AB.pdf>)

mundësi të angazhoheshin studentë për një periudhë të caktuar kohore, por gjithnjë duke i shterur kërkesat për punësimin e personave të kualifikuar.

### **Raport ex officio nr. 381/2020 në lidhje me zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës**

Raporti identifikon aktet nënligjore të përcaktuara me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës, si dhe vë në pah mungesën e respektimit të afateve ligjore për nxjerrjen e të gjitha akteve të parapara me ligjin në fjalë, nga ana e institucioneve përgjegjëse.

Raporti konstaton se janë nxjerrë vetëm 2 (dy) akte nënligjore nga 18 (tetëmbëdhjetë) sa janë paraparë të nxirren në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve. Për më tepër raporti thekson rëndësinë dhe konstaton se nxjerrja e këtyre akteve, pos të tjerash, e mundëson: bashkërendimin e autoriteteve përkatëse në nivel qendror dhe lokal; funksionimin e Këshillit për të drejtat e fëmijës; themelimin dhe funksionimin e Ekipeve për të drejtat e fëmijës; funksionimin e themelimit të tryezave shumëdisiplinore për ndihmë në menaxhimin e rastit; organizimin dhe fushëveprimin e shtëpive për mbrojtjen e fëmijës; marrjen e masave të duhura në mbrojtjen e fëmijës nga substancat narkotike dhe psikotrope; marrjen e masave të duhura parandaluese dhe mbrojtëse në ndalimin e pjesëmarrjes në klubet e natës dhe në lojërat e fatit; mënyrat e mbrojtjes së fëmijëve në masmedia, me theks të veçantë për fëmijët të cilët janë nën përkujdesje institucionale; marrjen e masave të duhura për mbrojtjen e fëmijëve nga internet-kafetë dhe video-lojërat, duke përfshirë masat specifike ndaj përmbajtjeve pornografike, ndëshkimin e abuzuesve me fëmijë në internet, reduktimin e qasjes së fëmijës në materiale të dëmshme për shëndetin dhe jetën e tyre, ofrimi i ndihmës për fëmijën që është në rrezik nga të gjitha format e dhunës përmes internetit.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandoi Qeverisë së Republikës së Kosovës që për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktet nënligjore të parapara në nenin 9, paragrafët 3 dhe 4, në nenin 18, paragrafi 2, në nenin 20, paragrafi 2, nënparagrafi 2.7, në nenin 21, paragrafi 2, në nenin 26, paragrafi 6, në nenin 30, paragrafi 7, në nenin 43, paragrafi 4, në nenin 44, paragrafi 4, në nenin 46, paragrafi 4, në nenin 50, paragrafi 6, në nenin 53, paragrafi 3, në nenin 57, paragrafi 10, në nenin 63, paragrafi 6, të këtij ligji.

Këshillit Gjyqësor i rekomandoi që në zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 58, paragrafi 2, të këtij ligji. Ndërsa, Komisionit të Pavarur të Mediave i rekomandoi që për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, të nxjerrë aktin nënligjor të paraparë në nenin 45, paragrafi 8, të këtij ligji.

### **Raport ex officio nr. 597/2020 në lidhje me ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MASHT) Nr. 19/2016 për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë**

Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, për të harmonizuar procedurën dhe kriteret e pranimit të fëmijëve në institucionet parashkollore me parimet bazë dhe autorizimet që dalin nga Ligji mbi Edukimin Parashkollor dhe nga Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Raporti konstaton se Udhëzimi Administrativ nuk përcakton punësimin e të dy prindërve si kriter për regjistrimin e fëmijëve në institucionet parashkollore dhe nuk ofron siguri juridike, as alternativa të qarta dhe të përbalueshme për fëmijët me dëmtime të rënda në mënyrë që ata t'i gëzojnë të njëjtat të drejta si të gjithë fëmijët e tjerë, më specifikisht të drejtën e fëmijëve për arsim, për mosdiskriminim dhe për interesin më të mirë të tyre. Gjithashtu



raporti konstaton se Udhëzimi Administrativ nuk është i qartë, konciz dhe se normat përkatëse të tij janë kundërthënës, nuk kanë konsistencë si dhe nuk janë në pajtim me parimet bazë dhe autorizimet që dalin nga Ligji për Edukimin Parashkollor dhe Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ për Përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë duke rregulluar, pos të tjerash, procedurën dhe kriteret në pajtim me parimet bazë të Ligjit mbi Edukimin Parashkollor, përkatësisht me parimet e përcaktuara në nenin 4: “(a) Barazia; (b) Gjithë përfshirja; (c) Demokracia; (d) Autonomia e personelit; (e) Profesionalizmi dhe përgjegjësia; (f) Mundësitë e barabarta për fëmijët dhe prindërit, duke marrë parasysh ndryshimet në mes të fëmijëve; (g) E drejta për të qenë ndryshe; (h) Zhvillimi i gjithanshëm i personalitetit të fëmijëve”, si dhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijës.

### **Raport për rastin A. nr. 24/2018, A. nr. 790/2018, A. nr. 605/2019, A. nr. 635/2020, A. nr. 534/2020, A. nr. 254/2021 dhe A. nr. 276/2021 në lidhje me mosushtrimin e mbikëqyrjes efektive nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ndaj funksionimit të Bartësve të Arsimit të Lartë**

Raporti trajton disa aspekte: në rastin e parë, ankuesit kishin përfunduar programet studimore të Bartësve të Arsimit të Lartë në drejtime të cilat nuk kishin pasur akreditim dhe licencë; në rastin e dytë, me rastin e regjistrimit të ankuesit në kolegji, kolegji kishte akreditim, mirëpo me rastin e përfundimit të studimeve, kolegjit i ishte refuzuar kërkesa për riakreditim dhe si pasojë në këto raste diplomat e tyre ishin të pavlefshme, nuk mund të njiheshin/verifikoheshin dhe ankuesit nuk mund t'i vijonin studimet më tej. Në rastet e tjera, ankuesve nuk mund t'u njihen/verifikohen diplomat për shkak të mosdorëzimit të librave amë nga Bartësit e Arsimit të Lartë dhe të njëjtët po ashtu nuk mund t'i vijojnë studimet më tej dhe as studimet jashtë vendit.

Raporti konstaton se mosveprimi i institucioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit të dispozitave ligjore ka krijuar hapësirë që Bartësit e Arsimit të Lartë të funksionojnë në kundërshtim me dispozitat ligjore, në mungesë të akreditimit dhe pa e dorëzuar, ose thënë ndryshe, mosadministruar siç duhet dokumentacionin përkatës siç parashihet me dispozita ligjore, përveç të tjerash, ka krijuar pasiguri, humbje financiare e thyerje morale tek studentët. Për më tepër raporti konstaton se disa Bartës të Arsimit të Lartë kanë lëshuar diploma në kundërshtim të plotë me procedurat e akreditimit dhe të licencimit.

Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit që të angazhohet që komisionet e formuara nga MASHTI t'i përfundojnë detyrat e dhëna në një afat të arsyeshëm kohor dhe çështja e njohjes/verifikimit të diplomave të marrë epilog, duke u bazuar në dispozitat ligjore në fuqi dhe në pajtim me standardet evropiane; të sigurojë që Inspektorati i Arsimit, si organ ekzekutiv qendror, t'i ndërmarrë të gjitha veprimet efektive për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të aplikueshëm nga të gjithë Bartësit e Arsimit të Lartë, deri në ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë, në mënyrë që rastet e tilla të mos përsëriten.

### **Raport ex officio nr. 69/2021 në lidhje me mungesën e harmonizimit të Ligjit nr. 04/I-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës me Ligjin nr. 05/L-087 për Kundërvajtje**

Raporti ka për qëllim tërheqjen e vëmendjes së Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit për ndërmarrjen e veprimeve përkatëse për ndryshimin dhe plotësimin

e dispozitive përkatëse të Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, përkatësisht ta harmonizojë atë me Ligjin për Kundërvajtje.

Avokati i Popullit me këtë raport konstaton se Ligji për Arsimin Parauniversitar i Republikës së Kosovës, përkatësisht neni 15 [Vijueshmëria në shkollë] dhe neni 47 [Shkollimi në shtëpi] nuk janë në harmoni me dispozitat e Ligjit për Kundërvajtje edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vjet nga hyrja në fuqi e Ligjit për Kundërvajtje, nuk është bërë harmonizimi i tyre. Në bazë të konstatimeve të dala nga raporti, Avokati i Popullit i rekomandon Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës, përkatësisht nenet 15 dhe 47 të harmonizohen me Ligjin për Kundërvajtje.

#### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 152/2020**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Komunës së Vushtrrisë, përkitazi për mospërgjigjen në ankesën e parashtruar më 6 janar 2020 (*Ankesa nr.prot.02-104/02-0000526/20*) kundër drejtorit të Shkollës së Mesme të Ulët "2" Vushtrri, përkitazi me largimin nga shkolla të tre fëmijëve të palës, për të cilën nuk kishte marrë përgjigje.

Bazuar në faktet dhe në rrethanat e çështjes, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Komunës së Vushtrrisë që në kuadër të kompetencave dhe të përgjegjësisë ligjore të saj, t'i ndërmarrë veprimet e nevojshme urgjente që fëmijët M. A. dhe E. A. ta vijojnë mësimin në shkollat përkatëse.

#### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 272/2021**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Komunës së Fushë Kosovës, përkitazi me mospërgjigjen në kërkesën e parashtruar në Drejtorinë Komunale të Arsimit, përkitazi me sigurimin e transportit për fëmijët me aftësi të kufizuara. Sipas pohimit të ankuesit, dy fëmijët e tij vijojnë mësimet në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Xheladin Deda" në Pejë dhe se në këtë vit shpenzimet e transportit nga Fushë Kosova e deri në Pejë si dhe anasjelltas i është dashur t'i mbulonte vetë.

Andaj pas analizimit të çështjes dhe bazës ligjore, Avokati i Popullit ka konstatuar se Komuna e Fushë Kosovës ka dështuar që fëmijëve të ankuesit t'ua siguronte transportin nga Fushë Kosova e deri në Pejë në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Xheladin Deda" dhe anasjelltas, gjë që përbën shkelje të të drejtave të njeriut, në rastin konkret të të drejtave të fëmijëve me aftësi të kufizuara, përkatësisht shkelje të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të standardeve ndërkombëtare dhe të legjislacionit përkatës ë fuqi.

Prandaj Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Fushë Kosovës që t'i ndërmarrë masat e menjëhershme që fëmijëve të ankuesit, sipas nevojave të tyre, t'u sigurohet transporti, në mënyrë që ata ta kenë mundësinë për ndjekjen e mësimave në Qendrën Burimore për Mësim dhe Këshillim "Xheladin Deda" në Pejë.

#### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 408/2021**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Komunës së Prishtinës për mospërgjigje në ankesën (Nr.prot.03-070/01-0123544/21, datë 29.6.2021), përkatësisht në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), kundër shkollës "Meto Bajraktari" në Prishtinë, lidhur me mohimin e së drejtës për regjistrimin e fëmijës I. K. si nxënës në klasën parashkollore për vitin shkollor 2021/2022.

Duke u bazuar në provat dhe në shkresat e ofruara nga ankuesi, Avokati i Popullit ka konstatuar se DKA-ja në Prishtinë ka dështuar në zbatimin e ligjit, pasi ankuesi në ankesën e tij të parashtruar më 29 qershor 2021 nuk ka marrë përgjigje nga ajo përkundër detyrimit ligjor për të shqyrtuar ankesën e tij sipas ligjit në fuqi.

Prandaj Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Prishtinës që të vendosë urgjentisht lidhur me ankesën e palës, e datës 29 qershor 2021, duke e trajtuar atë në pajtim me dispozitat ligjore.

## PËRGJEGJËSIA PËR MJEDISIN JETËSOR

### Ndikimi i pandemisë COVID-19 në Kosovë dhe përgjegjësia për mjedisin jetësor

Kjo pjesë e raportit analizon atë se sa është arritur që brenda situatës së krijuar, Qeveria t'i përshtatë politikat për funksionimin e organeve për mbrojtje të mjedisit me përpjekje për të mbrojtur jetën dhe shëndetin e zyrtarëve, në përputhje me rregullat për mbrojtje nga COVID 19, në mënyrë që të respektohen parimet kryesore mjedisore (parimi i zhvillimit të qëndrueshëm, i integritetit dhe i parandalimit, i vlerësimit të ndikimit në mjedis, vlerësimit strategjik mjedisor, parimi i qasjes në informata, i pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, i qasjes në drejtësi etj.)

Krahas institucioneve të tjera në vend, edhe organet kompetente për mbrojtjen e mjedisit u gjenden para një situatë të panjohur, përballë vendimeve të vështira dhe urgjente të cilat ngërthenin në vete prioritetin për mbrojtje të shëndetit dhe të sigurisë publike. Përderisa shteti ishte përqendruar që nëpërmjet masave kufizuese të mbronte dhe të garantonte të drejtën për jetë dhe të drejtën për shëndet, ndikimi në mjedis nga veprimtaritë e ndryshme kishte vazhduar.

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (në vazhdim: MMPHI), si organ kompetent për hartimin dhe zbatimin e legjislacionit për menaxhimin e përgjithshëm të fushës së mjedisit, të ujërave, të planifikimit hapësinor dhe të ndërtimit e banimit, në periudhën mars 2020 - mars 2021 është gjendur para një situatë të komplikuar dhe me shumë paqartësi. Rezultat i mospërfshirjes në prioritetet e politikave shtetërore, të kapaciteteve të pamjaftueshme, mjedisi dhe mbrojtja e tij nuk u gjet as në vendimet e qeverisë për mbrojtje nga pandemia.

Si rezultat i ndryshimeve të qeverive, dhe në ministri brenda periudhës shkurt 2020 - mars 2021 si dhe në ndryshimin e strukturës së ministrisë, ka pasur vështirësi që kanë ndikuar në përshtatjen e veprimeve të ministrisë me situatën.

Përderisa në vitet e kaluara një inspektor ka realizuar mesatarisht 80-110 inspektime me procesverbal, në vitin 2020 janë realizuar mesatarisht rreth 20-30 inspektime. Të gjitha këto kanë ndikuar mjaftueshëm që Inspektorati të mos arrinte t'i përmbushte obligimet e veta ligjore dhe as realizimin e planit të punës për realizimin e inspektimeve për mbikëqyrjen e të gjitha ligjeve në sferën e mjedisit, të ujërave, të natyrës, të ndërtimit dhe të planifikimit hapësinor. Reagimet kanë qenë kryesisht në bazë të ankesave.<sup>265</sup>

### Raport ex officio nr. 365/2018 kundër Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit në lidhje çështjen e ligjshmërisë së procedurave që kanë të bëjnë me hidrocentralet në vend dhe

265 Informatë e pranuar nga Inspektorati i Mjedisit, MMPHI, më 8 shator 2021.

### **qasjes në dokumente përkitazi me hidrocentralet**

Qëllimi i këtij raporti me rekomandime ishte që të tërheqë vëmendjen e Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, të Komunës së Deçanit, të Komunës së Shtërpçës dhe të autoriteteve të tjera kompetente për respektimin e së drejtës për informim të qytetarëve duke ofruar qasje në dokumentacionin për hidrocentralet, respektimin e së drejtës së pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje dhe qasjes në drejtësi. Raporti me rekomandime u është drejtuar institucioneve përgjegjëse më 3 shkurt 2021.

Çështja e ngritur në këtë raport ka të bëjë me degradimin e lumit Lumbardh në Deçan, nga ndërhyrjet pa kriter në mjedis nga kompania "Kelkos". Rasti është iniciuar bazuar në informatat e pranuar nga A. G. në forumin e organizuar për zhvillim të qëndrueshëm, me temë: *"Ujë është jetë/krimet mjedisore"*.

Duke konsideruar se situata mund të ketë pasoja të pariparueshme në mjedis, Avokati i Popullit i kërkoi Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor që t'i pezullojë aktivitetet e hidrocentraleve në Deçan dhe në Shtërpçë, deri në dhënien e sqarimit për ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve në fjalë, si dhe sqarimet për kompetencat mes autoriteteve përgjegjëse.

Në raportin për çështjen në fjalë, Avokati i Popullit ka konstatuar se MMPH-ja dhe komunat, si organe kompetente, pavarësisht ndikimit në mjedis të hidrocentraleve, pakënaqësive, protestave dhe reagimeve të qytetarëve dhe të shoqërisë civile, nëpërmjet formave të ndryshme, nuk kanë arritur të japin informata të sakta dhe të plota lidhur me ligjshmërinë e operimit të hidrocentraleve dhe të respektonin parimin e pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje. Po ashtu, në këtë raport Avokati i Popullit ka konstatuar, duke u bazuar në nenin 52.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili parasheh obligimin e institucioneve përgjegjëse që të angazhohen në drejtim të sigurimit dhe të garantimit të procesit të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje, se mosfrimi i qasjes në dokumente që lidhen drejtpërdrejt, apo kanë të bëjnë me hidrocentralet, është veprim kundërkushtetues dhe kundërligjor. Rrjedhimisht, Avokati i Popullit, bazuar në autorizimet kushtetuese e ligjore, përkitazi me çështjen në fjalë, dhe me qëllim që informatat lidhur me operimin e hidrocentraleve në vend të bëhen publike, në mënyrë që në të ardhmen organizimi i proceseve të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje të merret me seriozitet nga institucionet, që Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial të ndërmarrin masa që rastet që lidhen me çështjen e kësaj natyre dhe që kanë të bëjnë me mjedisin, t'i trajtojnë me prioritet, i rekomandoi :

Ministrisë e Ekonomisë dhe Ambientit që ta bëjë publike tërë dokumentacionin lidhur me hidrocentralet në vend. Komunës së Deçanit, që ta bëjë publike tërë dokumentacionin lidhur me hidrocentralet në komunën e Deçanit; Komunës së Shtërpçës që të bëjë publike tërë dokumentacionin lidhur me hidrocentralet në komunën e Shtërpçës; Këshillit Gjyqësor të Kosovës që të ndërmarrë masa që rastet që lidhen me hidrocentralet t'i trajtojnë me prioritet; Këshillit Prokurorial të Kosovës që të ndërmarrë masa që rastet që lidhen me hidrocentralet t'i trajtojnë me prioritet.

### **Letër rekomandimi për rastin A. nr. 59/2020**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e parashtruar kundër Komunës së Prishtinës për mospërgjigje në kërkesën lidhur me dislokimin e kontejnerëve për mbeturina, të pozicionuar në lagjen Kodra e Diellit, rr. "Qamil Bala", dhe të dedikuar për hyrjet 4, 5, 6, 7 dhe 8, për shkak të shkakimit të ndotjes së mjedisit, ashtu që banorët e lagjes kanë kërkuar që të njëjtët të zhvendosen në pikën e njëjtë ku kanë qenë të vendosur më herët.

Duke u bazuar në provat dhe në shkresat e ofruara nga ankuesi, Avokati i Popullit ka konstatuar se Komuna e Prishtinës ka dështuar në trajtimin e kërkesës së palës, sipas dispozitave ligjore të cilat janë në fuqi. Avokati i Popullit i rekomandoi Komunës së Prishtinës që ta shqyrtojë kërkesën e palës, duke e trajtuar atë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi.

## KUFIZIMI I TË DREJTAVE DHE I LIRIVE THEMELORE

### Raport i veçantë për emergjencën shëndetësore dhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Republikën e Kosovës

Po bëhen më shumë se dy vjet nga shfaqja e virusit COVID-19 që preku pothuajse të gjitha vendet e botës dhe peshoi rënd mbi supet e secilit. Padyshim që pandemia ndikoi në funksionimin e të gjitha institucioneve shtetërore një pjese të të cilave u ra edhe barra e ndërmarrjes së veprimeve, masave, e vendimeve në funksion të ruajtjes së shëndetit publik të qytetarëve duke qenë se pandemia përbënte kërcënim për shëndetin publik në përgjithësi dhe për të drejtat e njeriut në veçanti, siç është e drejta për jetën.

Ekziston një lidhje racionale mes përgjegjësive që ka Qeveria në mbrojtjen e shëndetit publik dhe luftimin e pandemisë dhe rrezikun me të cilin përballen qytetarët me pasojë deri edhe jetën e tyre. Mirëpo, edhe sipas standardeve ndërkombëtare, qeveritë e kanë edhe përgjegjësinë për të treguar se çdo kufizim që vendosin mbi të drejtat e njeriut duhet të jetë i balancuara dhe proporcionale me kërcënimin real që kanoset.

Çdo masë e aplikuar e cila i kufizon të drejtat, duhet të synojë të arrijë një qëllim legjitim, e që kjo është e nevojshme të demonstron fuqishëm nga autoritetet. Duke u nisur nga kjo, Avokati i Popullit, nëpërmjet një raporti i cili u publikua në nëntor 2021, analizoi ndikimin e COVID-19 në të drejtat themelore të qytetarëve dhe aplikimin e masave qeveritare për parandalimin e përhapjes së pandemisë. Raporti reflekton qëndrimet e Avokatit të Popullit të shprehura nëpërmjet rekomandimeve, të cilat u adresohen autoriteteve publike me qëllim që të respektohen standardet për të drejtat e njeriut në secilën masë kufizuese që mund të vendoset në situata emergjente. Ai trajton ndikimin e këtyre masave, në veçanti kufizimet e të drejtave të njeriut dhe legjisllacionin në përgjithësi; ndikimin e pandemisë në shëndetin publik, në shëndetin mendor; ndikimin e pandemisë në të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm; të drejtat e personave të privuar nga liria; të drejtat ekonomike dhe sociale; të drejtën e punës dhe ndikimi i pandemisë në sektorin publik dhe privat; mjedisin jetësor; dhunën në familje; lirinë e tubimit, besimit e ndërgjegjes dhe të fesë si dhe kufizimet e këtyre të drejtave; lirinë e shprehjes, lirinë e mediave; të drejtën e privatësisë dhe të drejtat zgjedhore; të drejtat e fëmijëve dhe ndikimi i emergjencës shëndetësore në jetën e fëmijëve, përfshirë fëmijët me aftësi të kufizuara; të drejtën për arsim dhe aktivitete kulturore si dhe analizimin e standardeve ndërkombëtare dhe të praktikave të vendeve me demokraci të zhvilluar.

Raporti është ndarë në pesëmbëdhjetë kapituj që trajtojnë aspekte të ndryshme të ndikimi të pandemisë në të drejtat e njeriut. Në pjesën e parë, raporti flet për standardet ndërkombëtare dhe praktikave të vendeve me demokraci të zhvilluar sa i përket politikave të luftimit të pandemisë.

### Standardet ndërkombëtare dhe praktikave të vendeve me demokraci të zhvilluar

Analizimi i standardeve ndërkombëtare dhe i praktikave të mira të të drejtave të njeriut luajnë një rol të rëndësishëm në formësimin e rrugës për mënyrat se si shtetet duhet të reagojnë gjatë emergjencave shëndetësore kombëtare. Ato sigurojnë një kornizë unike gjithëpërfshirëse për mbrojtjen e të drejtave dhe të lirive të njeriut duke i udhëzuar shtetet drejt një reagimi, i cili merr për bazë perspektivën e të drejtave të njeriut, në çdo kufizim

apo shmangie që u bën këtyre të drejtave, të cilat janë të garantuara me ligje vendore, por edhe me të drejtën ndërkombëtare.

E drejta për standard më të lartë të arritshëm të shëndetit është një e drejtë e njeriut, e njohur në të drejtën ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, e konsideruar si instrumenti kryesor i mbrojtjes së të drejtës së shëndetit, njih: *“Të drejtën e të gjithëve në gëzimin e standartit më të lartë të arritshëm të shëndetit fizik dhe mendor.”* Në nenin 12, paragrafi 2.3, në mënyrë që të arrihet realizimi i kësaj të drejte, Konventa i obligon shtetet që të ndër marrin hapa për: *“Parandalimin, trajtimin dhe kontrollin e sëmundjeve epidemike, endemike, profesionale dhe sëmundje të tjera.”*<sup>266</sup>

Organizata të ndryshme botërore, që prej shfaqjes së pandemisë, janë angazhuar jashtëzakonisht shumë për hartimin e udhëzimeve adekuate për shtetet, në mënyrë që masat dhe kufizimet e ndërmarra të mos i shkelin të drejtat e njeriut. Këto udhëzime duhet të jenë pikë reference për çdo veprim që duhet të ndërmerret, në mënyrë që të mos shkelen garancitë themelore të të drejtave të njeriut.

### **Kufizimet e të drejtave të njeriut dhe legjislacioni në përgjithësi**

Në Kosovë, në mars të vitit 2020, kur edhe u evidentuan raste e para me virus, Qeveria e Republikës së Kosovës filloi marrjen e masave të para për parandalimin e përhapjes së këtij virusi. U vendosën në karantinë komunat në të cilat u evidentuan këto raste e gjithashtu u pezullua trafiku ndërrurban dhe ndërkombëtar, u mbyllën kafenetë, baret, restorantet, qendrat tregtare, aktivitetet sportive dhe kulturore, institucionet shkollore dhe universitare, institucionet publike reduktuan stafin në listën e personave esenciale dhe ato private u urdhëruan ta organizonin punën nga shtëpia.

Përkitazi me këtë çështje, Qeveria me Vendimin nr. 01/07, i datës 11 mars 2020, ndërpreu procesin edukativo – arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në tërë territorin e Kosovës, deri më 27 mars 2020. Po ashtu me këtë vendim është bërë kufizimi i aktiviteteve publike dhe private, si dhe është ndaluar transporti i organizuar ndërkombëtar.

Më 12 mars Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/08, ka formuar Komisionin e Posaçëm për Parandalim të Infeksionit COVID-19. Sipas këtij vendimi, Komisioni ka për detyrë ta menaxhojë procesin e parandalimit të infeksionit COVID-19 [...]. Pra, vërehet që me këtë vendim është krijuar një organ i posaçëm me të cilin është mundësuar menaxhimi i procesit për parandalimin e infektimit me COVID-19.

Më 13 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës ka nxjerrë Vendimin nr. 01/09, me të cilin vendosi që të ndalohen hyrje-daljet në komunën e Klinës dhe në të Vitisë. Po ashtu me këtë vendim është ndërprerë transporti ndërrurban në Republikën e Kosovës si dhe transporti i organizuar ndërkombëtar. Janë mbyllur kafenetë, baret, pabet, restorantet dhe qendrat tregtare, me përjashtim të farmacive dhe marketeve ushqimore, janë pezulluar të gjitha aktivitetet kulturore dhe sportive e po ashtu janë mbyllur tregjet e kafshëve dhe të automjeteve.

Lidhur me këtë çështje, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/11, i datës 15 mars 2020, ka shpallur emergjencën e shëndetit publik.

266 Kombet e Bashkuara, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, neni 12 (linku: <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/cescr.aspx>).

Më 23 mars 2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, me Vendimin nr. 01/15, ka ndaluar qarkullimin e qytetarëve dhe të automjeteve private nga data 24 mars 2020, gjatë orës 10:00 – 16:00 dhe prej orës 20:00 – 06:00. Po ashtu janë ndaluar tubimet në të gjitha mjediset private dhe publike, të hapura dhe të mbyllura [...].

Ky vendim ka aktivizuar edhe Gjykatën Kushtetuese të vendit, e cila më 31 mars 2020 njoftoi se ka marrë Aktgjykim në rastin KO 54/20 (i cili hyri në fuqi më 13 prill 2020), në rastin e ngritur nga presidenti i Republikës së Kosovës, përkitazi me vlerësimin e kushtetutshmërisë së Vendimit nr. 01/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 23 mars 2020, për të cilin parashtruesi i kërkesës pretendonte se nuk është në pajtueshmëri me dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, me nenin 2 të Protokollit nr. 4 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, me nenin 13 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut, si dhe me nenin 12 të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Çështja kushtetuese që ngërthen ky rast ishte përputhshmëria e Vendimit të kontestuar të Qeverisë me Kushtetutën, përkatësisht nëse me nxjerrjen e tij qeveria kishte kufizuar të drejtat dhe liritë themelore të garantuara apo kishte dalë përtej autorizimeve të përcaktuara me ligj.<sup>267</sup>

Në këtë drejtim, Gjykata Kushtetuese kishte gjetur se Vendimi i Qeverisë nuk ishte në përputhshmëri me nenin 55 (Kufizimi i të Drejtave dhe Lirive Themelore) të Kushtetutës, në lidhje me nenet: 35 (Liria e Lëvizjes), 36 (E drejta për privatësi), 43 (Liria e Tubimit) të Kushtetutës dhe me nenin 2 (Liria e lëvizjes) të Protokollit nr. 4, me nenin 8 (E drejta për jetë private dhe familjare) dhe me nenin 11 (Liria e tubimit dhe asociimit) të KEDNj-së, prandaj kishte vendosur që i njëjti të shfuqizohej. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij rasti konstatoi se kufizimet që përmban vendimi i kontestuar i Qeverisë përkitazi me të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të lartcekura, nuk janë të *“përcaktuara me ligj”*, andaj bien në kundërshtim me garancitë që përmbajnë nenet 35, 36 dhe 43 të Kushtetutës në lidhje me nenet respektive të KEDNj-së, dhe me nenin 55 të Kushtetutës, i cili në paragrafin e tij të parë përcakton qartë se të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë mund të kufizohen vetëm me ligj.

Për më shumë, Gjykata theksoi faktin që vendimi i kontestuar i Qeverisë i referohej zbatimit të të dy ligjeve, të cilat e autorizonin MSh-në që të ndërmernte masa të caktuara në ato ligje me qëllim të parandalimit dhe luftimit të sëmundjeve ngjithëse, por nuk e autorizonin qeverinë që t'i kufizonte të drejtat dhe liritë kushtetuese në nivel të tërë Republikës së Kosovës dhe për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës, pa përjashtim. Pra, Gjykata sqaroi se Qeveria nuk mund ta kufizonte asnjë të drejtë dhe liri themelore përmes vendimeve, nëse një kufizim i së drejtës përkatëse nuk është paraparë me ligj të Kuvendit.<sup>268</sup> Prandaj në frymën e këtij vendimi precizohet se qeveria vetëm mund të zbatojë një ligj të Kuvendit që kufizon një të drejtë dhe liri themelore dhe atë vetëm deri në masën specifike që e ka autorizuar Kuvendi përmes ligjit përkatës. Pra, duke marrë parasysh faktin se Ligji nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, si grupe të njëshme i përcakton familjet një prindërore, fëmijët jetim, të varfrit ekstrem, viktimat e trafikimit, të sëmurët kronikë, të moshuarit, të burgosurit, të pastrehët, përdoruesit e drogës me injektim, të sëmurët mentalë etj., autoritetet shëndetësore do të duhej t'i vënin në fokus të trajtimit së paku disa kategori personash.

267 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, Aktgjykim në rastin KO54/20, 31 mars 2020, publikuar më 6 prill 2020, Nr. ref.:AGJ 1543/20 (linku: <https://gjk-ks.org/decision/vleresim-i-kushtetutshmerise-se-vendimit-nr-01-15-te-qeverise-se-republikes-se-kosoves-te-23-marsit-2020/>)

268 Gjykata sqaroi se termi “kufizim” i përdorur në nenin 55 të Kushtetutës nënkupton faktin që Kuvendi ka të drejtë të kufizojë të drejta dhe liri themelore, përmes ligjit, por vetëm për atë sa dhe deri në atë masë sa është e domosdoshme që, në një shoqëri të hapur dhe demokratike, të përmbushet qëllimi për të cilin lejohet kufizimi, duke precizuar se “kufizimi” nënkupton një shkallë më të lehtë të ndërhyrjes dhe kjo mund të bëhet edhe pa shpalljen e Gjendjes së Jashtëzakonshme; ndërsa “shmangia” nënkupton një shkallë më të rëndë të ndërhyrjes, ngase nuk mund të bëhet kurrësi pa u shpallur Gjendja e Jashtëzakonshme.

Lidhur me këtë rast, Avokati i Popullit, më 27 mars 2020, ia dërgoi Gjykatës Kushtetuese Opinion, me të cilin ka shprehur qëndrimet e tij. Përderisa Gjykata Kushtetuese ishte duke vlerësuar kushtetutshmërinë e Vendimit nr. 1/15 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 27 mars 2020 Qeveria mori Vendimin nr. 02/17, me të cilin ka ndërmarrë masa parandaluese me qëllim të parandalimit dhe të mospërhapjes së virusit COVID 19, duke ndaluar qarkullimin e qytetarëve dhe të automjeteve private gjatë orës 17:00-06:00, përveç nevojave mjekësore, prodhim, furnizim dhe shitje të mallrave esenciale (ushqim dhe barna për njerëz dhe kafshë/shpezë) dhe për shërbime dhe aktivitete që ndërlidhen me menaxhim të pandemisë. Po ashtu me këtë vendim Qeveria ka ndaluar qarkullimin e qytetarëve në zonat (sheshet) e hapura të qyteteve të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit e vlerëson të rëndësishme sigurimin e informimit për vendimet e marra në gjuhën amtare komuniteteve dhe kategoritë personave me aftësi të kufizuara, qoftë nëpërmjet shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale, nëpërmjet shërbimeve të shtypit apo në ndonjë formë tjetër të përshtatshme, sidomos në një situatë pandemie ku rrezikohet shëndeti i gjithsecilit.

## **Kërkesat për Masë të Përkohshme**

### **Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar ministrit të Punëve të Brendshme, për pezullimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 07/2017 për ndërrimin e patentë shoferëve të huaj në patentë shoferë të Republikës së Kosovës**

Pas trajtimit të ankesës së palës A. S., Avokati i Popullit është informuar se pala me shtetësi të Republikës së Kosovës dhe të Republikës së Serbisë ka aplikuar për ndërrimin e patentë shoferit të Republikës së Serbisë me patentë shoferi të Republikës së Kosovës. Në bazë të informacioneve të ankuesit kuptohet se ai, më 16 prill 2019, kishte aplikuar në Agjencinë për Regjistrimin Civil (ARC) për t'u pajisur me patentë shoferi të Republikës së Kosovës dhe me këtë rast zyrtarët e ARC-së ia kishin kërkuar dorëzimin e patentë shoferit origjinal të lëshuar nga autoritetet e Republikës së Serbisë. Për më tepër, ankuesi kishte shfaqur shqetësimin e tij se Republika e Serbisë do ta fshinte nga regjistrat civilë në momentin që kuptohet se patentë shoferi i tij është dërguar në Serbi përmes institucioneve të Republikës së Kosovës.

Avokati i Popullit gjithashtu është informuar se shqiptarët e zonave: Preshevë, Medvegje dhe Bujanovc, janë duke u përballur me problemin e fshirjes nga regjistrat civilë dhe veprimet e tilla nga institucionet e Republikës së Kosovës po i vënë edhe më shumë në vështirësi qytetarët e atyre zonave. Avokati i Popullit vlerëson se fshirja nga regjistrat civilë prodhon pasoja të pariparueshme për qytetarët e Preshevës, Medvegjes dhe Bujanovcit, duke ua pamundësuar atyre realizimin e çfarëdo veprimi juridik civil në territorin e Republikës së Serbisë.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të Udhëzimit Administrativ (MPB) nr. 07/2017 për Ndërrimin e Patentë Shoferit të Huaj, në Patentë Shoferi të Republikës së Kosovës, përkatësisht pezullimin e zbatimit të nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, deri në përfundimin e hetimeve nga Avokati i Popullit lidhur me pretendimet në ankesën e parashtruar tek Avokati i Popullit nga A. S.

Avokati i Popullit ka konsideruar se kriteri substancial i një kërkesë për një pezullim të tillë është përmbushur qartazi në këtë rast, për shkak se veprimet sipas nenit 4, paragrafi 1, nënparagrafi 1.6, shkaktojnë dëme të pariparueshme të të drejtave të qytetarëve të Preshevës, Medvegjes dhe Bujanovcit, të cilët e kanë edhe shtetësinë e Republikës së Kosovës, të drejta këto të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe



me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, të zbatueshme drejtpërdrejt në Republikën e Kosovës.

### **Kërkesë e Avokatit të Popullit drejtuar Agjencisë për Verifikim dhe Krahasim të Pronës për pezullimin e zbatimit të vërejtjes së fundit për dëbim dhe kthim të pronës në ripozedim, nr. DS003164**

Avokati i Popullit ka trajtuar ankesën e M. K., të parashtruar kundër Agjencisë Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës (AKKVP) dhe, sipas pohimit të tij, banesën e cila është objekt kontesti e kishte blerë në vitin 2005, me ç' rast më 13 tetor 2005 kishte lidhur kontratë për shitblerjen e kësaj banese, e cila ishte vërtetuar nga Gjykata Komunale në Prishtinë (Vn.nr 8388/2005), të cilën pastaj e kishte regjistruar në librin kadastral në Komunën e Prishtinës. Ai gjithashtu ka pohuar se kjo marrëveshje ishte dorëzuar edhe në Drejtorinë për Çështje Banesore në Prishtinë. Ankuesi ka pohuar se më 20 tetor 2019 ishte ftuar nga AKKVP-ja, me ç' rast ishte njoftuar se atij nuk i ishte njohur e drejta e pronësisë dhe se tanimë kjo e drejtë i ishte njohur një personi tjetër, ndërsa më 6 qershor 2021 i është dërguar vërejtja e fundit për dëbim dhe kthim të pronës në ripozedim, nr. DS003164, duke kërkuar nga ankuesi lirim të banesës në fjalë, në të kundërtën, AKKVP-ja do ta dëbonte pa paralajmërime të tjera.

Avokati i Popullit gjithashtu është informuar se aktualisht Prokuroria Themelore në Prishtinë është duke hetuar origjinalitetin e Vendimit nr. 27774, i datës 31.8.1985, me të cilin XH. G. i ishte ndarë në shfrytëzim të përhershëm banesa në fjalë.

Avokati i Popullit ka vlerësuar se dëbimi i palës në këtë fazë kur Prokuroria Themelore në Prishtinë është duke hetuar origjinalitetin e vendimit të theksuar më sipër, prodhon pasoja të pariparueshme për ankuesin. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se në rastin konkret puna juridike mbi të cilën pala e ka fituar pronësinë nuk është anuluar dhe është akoma në fuqi.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit ka kërkuar pezullimin e ekzekutimit të vërejtjes së fundit për dëbim dhe kthim të pronës në ripozedim, nr. DS003164, e datës 6 qershor 2021, deri në përfundim të hetimeve nga Prokuroria Themelore në Prishtinë.

### **Vizita e Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës në Dhomat e Specializuara të Kosovës**

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më datë 3 gusht 2015, ka miratuar ndryshimet kushtetuese me aprovimin e amendamentit nr. 24, i përfshirë si dispozitë kushtetuese neni 162 i kushtetutës, ku përcaktohet: *“Për t’i përmbushur obligimet ndërkombëtare në lidhje me Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, Dokumenti 12462, datë 7 janar 2011, Republika e Kosovës mund të themelojë Dhoma të specializuara dhe një Zyre të Prokurorit të specializuar në kuadër të sistemit të drejtësisë të Kosovës. Organizimi, funksionimi dhe juridiksioni i Dhomave të specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të specializuar rregullohen me këtë nen dhe me ligj të veçantë.”*

Kjo dispozitë në vijim përcakton: *“Dhomat e specializuara mund t’i përcaktojnë Rregullat e veta të Procedurës dhe Provave, në përputhje me standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të përfshira në nenin 22 dhe të udhëzuara nga Kodi i Procedurës Penale. Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese do të rishikojë këto Rregulla për të siguruar pajtueshmëri me Kapitullin II të Kushtetutës.”*

Në po të njëjtën dispozitë përcaktohet: *“Do të emërohet një Ombudsperson i veçantë i Dhomave të specializuara, me përgjegjësi ekskluzive për Dhomat e specializuara dhe për Zyrën e Prokurorit të specializuar. Funkzioni dhe obligimet e tij/saj për raportim do të përcaktohen me [ligjin e veçantë]. Nenet 133(2), 134, 135(1) dhe (2) nuk do të aplikohen ndaj Ombudspersonit të Dhomave të specializuara. Ombudspersoni i Kosovës gjithashtu mund të referojë çështje në përputhje me Nenin 135(4).”*

Me Ligjin 05/L-053 për Dhomat e Specializuara themelohet dhe rregullohet organizimi, funksionet dhe juridiksioni i Dhomave të Specializuara dhe i Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Në nenin 1, paragrafi 2, përcaktohet: *“Dhomat e specializuara brenda sistemit të drejtësisë së Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të specializuar janë të domosdoshme për përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të parapara në Ligjin nr. 04/L-274, për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, si dhe për garantimin e procedurave penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe efikase në lidhje me pretendimet për krime të rënda ndërkufitare dhe ndërkombëtare të kryera gjatë konfliktit në Kosovë dhe pas tij, krime të cilat ndërlidhen me ato që janë raportuar në Raportin e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës Dok 12462, i datës 7 janar 2011, dhe të cilat kanë qenë objekt i hetimeve penale të kryera nga Task Forca Hetimore Speciale (“TFHS”) e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (“PSRK”).”*

Me ndryshimet kushtetuese dhe me ligjin për dhomat e specializuara, mandatit të Avokatit të Popullit i referohet vetëm në mandatin për të kontestuar ligjet përpara Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese dhe në mandatin për të ofruar mendime *amicus curiae*, siç është përcaktuar sipas nenit 34(9) të këtij ligji: *“Në pajtim me Amendamentin nr. 24 dhe nenin 135(4) të Kushtetutës, Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara i caktuar sipas nenit 34(9) të këtij ligji, si dhe Ombudspersoni i Republikës së Kosovës, mund t’i referohen sipas nenit 113(2) Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.”*

Avokati i Popullit vëren se në kuadrin e legjisllacionit të Dhomave të Specializuara, me të drejtë i është dhënë vend i posaçëm mbrojtjes së viktimave, është me shumë rëndësi që garancitë për mbrojtjen e të drejtave themelore për viktimat të jenë të vendosura në qendër të funksionimit të autoriteteve me qëllim që këto garanci të sigurojnë mbrojtje të plotë të viktimave. Neni 23 i ligjit përcakton: *“Rregullat Dhomave të specializuara për procedurën dhe provat e parashikojnë mbrojtjen e viktimave dhe të dëshmitarëve, përfshirë sigurinë, mirëqenien fizike dhe psikologjike, dinjitetin dhe privatësinë e tyre. Këto masa mbrojtëse i përfshijnë, por nuk limitohen, mjetet që janë të përcaktuara në nenet 221-226 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligji nr. 04/L-123, nenet 5-13 të Ligjit nr. 04/L-015 për mbrojtjen e dëshmitarëve, zhvillimin e procedurave me dyer të mbyllura, paraqitjen e provave me mjete elektronike ose mjete të tjera të veçanta, dhe mbrojtjen e identitetit.”* Nuk ka një informim të duhur sa u përket të drejta të viktimave në proceset gjyqësore, kjo do të jetë detyrë e autoriteteve që në të ardhmen të organizojnë fushata me qëllim të informimit të publikut për këtë çështje.

Me kërkesë të Avokatit të Popullit, më 9 prill 2021 është mbajtur takim pune me Avokatin e Popullit të Dhomave të Specializuara, ishte planifikuar të diskutohej për mundësitë e bashkëpunimit në të ardhmen në shkëmbimin e informatave, për ankesat e pranuar, vizitat e bëra në objektet e paraburgimit dhe nëse është përgatitur ndonjë raport nga Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara. Në këtë takim nga ana e Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara nuk është ofruar asnjë informatë, edhe pse ka pasur pajtim paraprak për temat, me justifikimin se janë informata konfidenciale.

Më 21 prill 2021, Avokati i Popullit i Republikës së Kosovës kërkoi nga kryetarja e Dhomave të Specializuara të Kosovës që t’i mundësohej realizimi i një vizite në Dhomat e Specializuara dhe në Qendrën e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë. Duke sqaruar se ka

një mungesë të plotë të informacionit zyrtar, edhe për faktin që Avokati i Popullit i Dhomave të Specializuara nuk kishte ndarë asnjë informatë, e kishte të domosdoshme ta vizitonte gjykatën dhe qendrën e paraburgimit me qëllim që të informohej drejtpërdrejt.

Më 5 maj 2021, duke iu përgjigjur shkresës së Avokatit të Popullit, kryetarja e Dhomave të Specializuara kishte refuzuar kërkesën e Avokatit të Popullit, duke theksuar se Ligji nr. 03/L-195 nuk zbatohet në rastin e Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe as të Zyrës së Prokurorit të Specializuar. Më tej në këtë shkresë zyrtare theksohej se çfarëdo inspektimi i “kushteve të paraburgimit dhe të trajtimit të të paraburgosurve” është mandat ekskluziv i Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara.

Më 8 shtator 2021, në Institucionin e Avokatit të Popullit u mbajt një takim i përbashkët ndërmjet kryetares së Dhomave të Specializuara (e shoqëruara nga bashkëpunëtorët e saj) dhe Avokatit të Popullit (i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij). Gjatë takimit, Avokati i Popullit ia rikujtoi rolin dhe mandatin e Avokatit të Popullit, veçanërisht mandatin si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, duke theksuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe interesimin e Avokatit të Popullit për t'i vizituar të ndaluarit në Qendrën e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Republikës së Kosovës në Hagë.

Avokati i Popullit, më 9 nëntor 2021, vizitoi Dhomat e Specializuara, ku u takua me kryetaren e Dhomave të Specializuara dhe me bashkëpunëtorët e saj. Gjithashtu realizoi edhe vizitë në qendrën e paraburgimit dhe takoi të paraburgosurit në Qendrën e Paraburgimit në Hagë.

Gjatë kësaj vizite, në takim me kryetaren e Dhomave të Specializuara, Avokati i Popullit theksoi se ka obligim kushtetues, ligjor dhe moral për t'i vizituar shtetasit e Kosovës kudo që ata gjenden në situatë të tillë, pavarësisht faktit se ka mandat të kufizuar me ndryshimet kushtetuese e ligjore. Kryetarja e Dhomave të Specializuara dhe bashkëpunëtorët e saj e njoftuan Avokatin e Popullit për ecurinë e procedurave gjyqësore, hapjen e një kanali në platformën *Youtube*, nëpërmjet të cilit mund të ndiqen seancat gjyqësore, deklaratat javore për shtyp, të cilat i organizon Zyra për Informim, dhe galerinë publike, e cila mbetet e hapur, ku mund të ndiqen dhe të dëgjohen seancat.

Avokati i Popullit në këtë takim theksoi se i janë adresuar shqetësime sa u përket rrethanave në të cilat funksionon gjykata dhe juridiksionit të saj dhe çështje të tjera, siç është: barazia e armëve, kohëzgjatja e paraburgimit, të drejtat e të akuzuarve në procedurë, si dhe mungesa e transparencës dhe e bashkëpunimit të Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara.

Gjatë kësaj vizite, Avokati i Popullit takoi të paraburgosurit dhe me secilin prej tyre iu mundësua bisedë në hapësirë të veçantë dhe në kohë të mjaftueshme. Nga të paraburgosurit u ngritën një mori shqetësimesh, si: *mosrespektimi i parimit të barazisë së armëve gjatë procesit gjyqësor, kohëzgjatja e paraburgimit, mungesa e mbikëqyrjes për të drejtën në mjet efikas juridik, duke aluduar në faktin se gjykata funksionon si një strukturë dhe nuk ka shkallëzim të shprehur për shqyrtimin efikas të mjeteve juridike, vonesa e përkthimeve të procesverbaleve të seancave gjyqësore në gjuhën shqipe, redaktimi i aktakuzës dhe i materialeve të tjera që ua mohon të drejtën që t'i kenë me kohë të gjitha provat dhe informatat në gjuhën që e kuptojnë, standardet e dyfishta të zbatimit të legjislacionit duke vendosur praktika që nuk janë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Kosovës, trajtimin jo të barabartë me të burgosurit e tjerë sa u përket masave kufizuese për mbrojtjen nga pandemia për vizita familjare, pasiviteti i Avokatit të Dhomave të Specializuara dhe mungesa e mënyrës konfidenciale për t'iu drejtuar etj.*

**Avokati i Popullit vëren se parimi i barazisë së armëve në procedurë penale** garantohet me nenin 21 të Ligjit për Dhomat e Specializuara, në kuadër të drejtave të të akuzuarit.

Në këtë nen përcaktohen të drejtat e të akuzuarit dhe ndër të tjera garantohet se të gjithë personat janë të barabartë para Dhomave të Specializuara, i akuzuari ka të drejtë t'i marrë në pyetje, ose t'i ketë marrë në pyetje, dëshmitarët kundër tij dhe të sigurojë praninë dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve në emër të tij në kushte të njëjta me ato të dëshmitarëve kundër tij, të gjykohet brenda një kohe të arsyeshme etj.

Po ashtu, **neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut** garanton të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Në këtë drejtim, neni 53 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Ky parim garantohet edhe me nenin 14 të Konventës për të Drejtat Politike dhe Civile, e cila është pjesë e sistemit juridik të Republikës së Kosovës dhe ka prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe të akteve të tjera të institucioneve publike të Kosovës. **Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Kosovës, në nenin 9**, përcakton se i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.

Avokati i Popullit rikujton se zhvillimi i procedurës penale në gjuhën të cilën i akuzuari e kupton, përfshirë edhe të drejtën për t'i marrë materialet e përkthyer, është e drejtë që garantohet me të gjitha standardet ndërkombëtare, me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me Kodin e Procedurës Penale të Republikës së Kosovës dhe **është obligim i gjykatave që gjatë gjithë kohës së procedurës gjyqësore të kujdesen që të respektohen të gjitha të drejtat e të akuzuarve të garantuara me konventat ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e sistemit juridik të Republikës së Kosovës: në Kushtetutën e Republikës së Kosovës, në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjet e tjera relevante të Republikës së Kosovës.**

**Në kuadër të Dhomave të Specializuara është themeluar Zyra e Avokatit të Popullit të Dhomave të Specializuara.** Ligji për Dhomat e Specializuara, në nenin 34, paragrafi 9, përcakton: *“Ombudspersoni i Dhomave të Specializuara mund t'i japë rekomandime kryetarit të Dhomave të Specializuara ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar sipas nenit 135(3) të Kushtetutës dhe mund të bëjë referime për tek Gjykata Kushtetuese në pajtim me nenet 113(2) dhe 135(4) të Kushtetutës dhe me nenin 49 të Ligjit për Dhomat e Specializuara.”*

Mandati dhe funksionet zyrtare të Avokatit të Popullit përshkruhen hollësisht në amendamentin kushtetues nr. 24, në Ligjin për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, në rregullën 28 dhe në rregullën 29 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave të Dhomave të Specializuara të Kosovës dhe në rregullën 26 të Rregullores së Punës të Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese.

Mënyra se si është përcaktuar të veprojë dhe të funksionojë kjo zyrë, duket se nuk është në përputhje me standardet dhe me parimet e pranuar nga instrumentet ndërkombëtare që garantojnë pavarësinë dhe paanësinë e Institucioneve të Avokatit të Popullit në ushtrimin e funksionit dhe të rolit që kanë. Sipas të dhënave në ueb-faqen zyrtare të Dhomave të Specializuara, Avokati i Popullit vepron si zyrë e pavarur në kuadër të Gjykatës: *“Ndonëse është pjesë e Zyrës Administrative, Avokati i Popullit vepron në mënyrë të pavarur për monitorimin, mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave dhe lirive themelore të personave që ndërveprojnë me Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar. Avokati i Popullit ka përgjegjësi ekskluzive për të dy institucionet (Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar).”<sup>269</sup>*

269 <https://www.scp-ks.org/sq/avokati-i-popullit/roli-i-avokatit-tyo-popullit>

## Qasja në drejtësi dhe e drejta në kompensim e viktimave të krimeve të luftës

Për krijimin e një shoqërie demokratike, ndërtimit të paqes, pajtimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm, ka obligim secila shoqëri në tranzicion, në periudhën e stabilizimit pas konfliktit, t'i adresojë pasojat e shkaktuara nga lufta dhe të shkuarën e shkeljeve të të drejtave dhe të lirive të njeriut.

Në periudhën e viteve të 90-a, në Kosovë ka pasur shkelje të vazhdueshme të të drejtave dhe të lirive të njeriut, që kanë kulmuar gjatë luftës së viteve 1998 dhe 1999 në Kosovë, kur janë kryer krime të rënda, si: vrasja e civilëve, zhvendosja e detyruar e popullatës civile, burgosja e paligjshme e njerëzve, torturë, dhunë seksuale, shkatërrimi i pronës dhe i pasurive ekonomike, i objekteve kulturore dhe religjioze etj.

Më shumë se njëzet vjet pas përfundimit të luftës së viteve 1998-1999, Kosova vazhdon të ballafaqohet me të kaluarën e saj pa arritur t'i përmbushë detyrimet për dokumentimin institucional të krimeve dhe të krejt pasojave që kanë ndodhur në këtë periudhë.

Janë ndërmarrë shumë nisma të drejtësisë tranzicionale, kryesisht këto nisma ishin të njëanshme, të pakoordinuara dhe jogjithëpërfshirëse. Nuk u arrit sukses që, duke vendosur urat e komunikimit e të dialogut, të arrihet një e ardhme paqësore, ku do të dokumentoheshin krimet e kryera, do të gjykoreshin ata që shkaktuan krime, do të vendosej e drejta e restitimit të viktimave përmes kompensimit dhe do t'u ofrohej drejtësi viktimave të krimit.

Avokati i Popullit vëren se sipas organizatave vendore e ndërkombëtare si dhe autoriteteve të Kosovës, gjatë luftës së Kosovës në vitet 1998-1999 janë vrarë dhe zhdukur më shumë se 13.500 persona. Këto shifra janë të publikuara edhe nga Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë, e që janë shfrytëzuar edhe nga autoritetet e Kosovës. Të dhëna të shumta janë dhënë edhe nga autorë të huaj edhe nga institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si nga Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut në Kosovë, Human Right, Amnesty International, Komiteti i Helsinkit etj.

Sipas këtyre burimeve, rreth 76% e këtyre personave kanë qenë civilë të vrarë. Në evidenca thuhej se janë vrarë 10.794 shqiptarë, 2.197 serbë, ndërsa pjesa tjetër u përket grupeve të tjera etnike që jetojnë në Kosovë. Sot, më shumë se 21 vjet nga përfundimi i luftës në Kosovë, 1.622 persona ende konsiderohen si të pagjetur dhe për ta ende nuk dihet asgjë.

Sipas disa përlllogaritjeve jozyrtare të ekspertëve ekonomikë nga Kosova, kostoja e përgjithshme e dëmeve materiale të shkaktuara nga Serbia gjatë luftës së viteve 1998-1999, është vlerësuar në afro 22 miliardë euro, por detajet ende nuk janë vërtetuar siç duhet nga autoritetet e Kosovës, të cilat gjithashtu nuk kanë ndërmarrë ende ndonjë hap zyrtar drejt vlerësimit të dëmeve apo kërkimit të dëmshpërblimeve për dëmet materiale të shkaktuara nga Serbia gjatë luftës në Kosovë.

Ligji nr. 04/L-023 për Persona të Zhdukur, i vitit 2011, përcakton mandatin e Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur, si një mekanizëm qeveritar që shqyrton dhe informon familjet e personave të pagjetur për rezultatet e kërkesave të kërkimit, udhëheq dhe harmonizon aktivitetet e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me çështjen e personave të pagjetur, përpiket të zbardhë fatin e personave të zhdukur si pasojë e luftës së viteve 1998-1999. Ky ligj garanton të drejtën e familjarëve për të ditur për fatin dhe vendndodhjen e anëtarëve të zhdukur të familjes si pasojë e luftës në Kosovë; rregullon statusin ligjor të personave të zhdukur; mundëson krijimin e një Regjistri qendror për personat e pagjetur. Më 10 dhjetor 2021, kryesuesi i Komisionit Qeveritar për Persona

të Zhdukur konstatoi se që nga përfundimi i luftës janë gërmuar mbi 2700 lokacione, megjithatë ende vazhdon të mbetet i paditur fati i mbi 1600 të zhdukurve gjatë luftës së fundit në Kosovë.

Sipas Komisionit, në Republikën e Kosovës gjatë këtij viti janë kryer gërmimet në nëntë lokacione të ndryshme dhe se gjatë këtij viti u janë dorëzuar familjeve për rivarrim mbetjet mortore të 25 personave.

Me qëllim të dokumentimit të krimeve të periudhës së luftës, më 2011, Qeveria e Republikës së Kosovës kishte themeluar Institutin për Hulumtimin e Krimeve të Luftës, i cili ishte funksional deri në vitin 2018 dhe i cili nuk ka arritur të bënte mjaftueshëm për të përmbushur misionin e tij dhe për dokumentimin e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe krimeve të kryera gjatë luftës, si dhe zbardhjen e së vërtetës. Materialet e mbledhura nga ky Institut si dhe publikimet që ka arritur t'i botonte nuk kanë arritur t'i promovonin dhe nuk janë plasuar në publik, duke mbetur jashtë qëllimit për të cilin janë punuar.

Avokati i Popullit vlerëson nismën e ndërmarrë së fundmi, në maj të vitit 2021, për themelimin e Grupit punues, me qëllim të vlerësimit të nevojave për themelimin e Institutit për krimet e kryera gjatë luftës, për dokumentimin e krimeve të luftës dhe për të ditur të vërtetën.

Në Raportin e punës për vitin 2020<sup>270</sup>, të Prokurorit të Shtetit, sa u përket rasteve për krime të luftës, thuhet se departamenti përkatës në kuadër të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, ka bartur nga viti paraprak gjithsej 1.166 lëndë, ka pranuar në punë 113 raste të reja dhe ka zgjidhur 60 raste.

Ndërsa në Raportin e punës të Prokurorit të Shtetit, për gjashtëmujorin e parë të vitit 2021<sup>271</sup>, Prokurori i Shtetit ka bartur nga viti paraprak gjithsej 1.152 lëndë për krime të luftës, ka pranuar në punë 43 raste të reja dhe ka zgjidhur 11 raste.

Numri i aktakuzave të ngritura për krimet e luftës në Kosovë, sipas kompetencave, nga muaji tetor 1999 e deri në muajin tetor 2018, është si në vijim: EULEX: 22 aktakuza, UNMIK: 10 aktakuza, Prokurorët vendorë: 16 aktakuza. Pra deri më tash gjithsej 48 aktakuza.

Gjykata Ndërkombëtare Penale për ish-Jugosllavinë, me seli në Hagë, e themeluar në vitin 1993, është marrë me hetimin dhe gjykimin e krimeve të luftës në ish-Jugosllavi dhe ka funksionuar deri në vitin 2017. Sipas të dhënave nga Fondi Humanitar, kjo gjykatë për krime lufte në Kosovë ka akuzuar 15 persona, të akuzuar: 9 serbë e 6 shqiptarë, prej të cilëve janë dënuar 6 serbë e 2 shqiptarë.

Avokati i Popullit është informuar nga takimet me përfaqësuesit e disa organizatave të shoqërisë civile se një numër i madh i padive janë parashtruar në gjyqësorin e Kosovës kundër Qeverisë së Republikës së Serbisë, për kompensimin e dëmeve materiale dhe jomateriale të shkaktuara gjatë luftës përgjatë viteve 1998 dhe 1999. Nga aktvendimet në fjalë shihet se gjykatat e rregullta i kanë refuzuar këto padi për mungesë juridiksioni dhe Gjykata Kushtetuese i ka vendosur si të papranueshme të gjitha këto ankesa të paraqitura kundër vendimeve të gjykatave të rregullta. Lidhur me paditë e lartpërmendura, në disa raste Gjykata Supreme, ndër të tjera, ka arsyetuar: *"[Me padi është paditur Republika e Serbisë-Qeveria R. S. ne Beograd, për kompensimin e demit (pra, ne rastin konkret fjala është për kontest juridiko-pasuror ne shtetin e huaj) për te cilin kontest gjykata e vendit nuk është kompetente për te vendosur, andaj Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se gjykatat*

270 <https://prokuroria-rks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/Raporti%20i%20Pun%C3%ABs%202020%20-%20SHQ.PDF>

271 <https://prokuroriarks.org/assets/cms/uploads/files/Dokumente%20Publikime/PSH/Publikime/Raporti%20i%20Prokurorit%20t%C3%AB%20Shtetit-gjasht%C3%ABmujori%20i%20par%C3%AB%202021.pdf>

*e instancës me te ulet ne mënyre te drejte kane zbatuar dispozitat e nenit 18.3 dhe nenit 39par. 1 e 2 te LPK-se, me rastin kur janë shpallur in kompetente për te gjykuar këtë çështje juridike dhe kane hedhur poshtë padinë e paditësit, ngase selia e Kuvendit te Republikës se Serbisë, ashtu qe, për te vendosur për këtë çështje juridike nuk është kompetente Gjykata e Republikës se Kosovës për faktin se selia e Kuvendit te Republikës se Serbisë si pale e paditur nuk ndodhet ne territorin e Gjykatave te Republikës se Kosovës}.”*

Avokati i Popullit vlerëson se autoritetet e Republikës së Kosovës deri më tani nuk kanë bërë sa duhet në trajtimin e problematikës së krimeve të luftës dhe të kompensimit të dëmeve materiale dhe jomateriale të shkaktuara gjatë luftës në Kosovë. Aktualisht, shumica e krimeve të kryera kanë mbetur të pa gjykuara e për rrjedhojë, palëve të dëmtuara dhe viktimave të krimeve të luftës u është mohuar e drejta për qasje në drejtësi, e drejta për kompensimin e viktimave të krimeve të luftës dhe e drejta për të hetuar dhe gjykuar kryerësit e këtyre krimeve si dhe e drejta për të ditur për fatin e familjarëve të tyre të zhdukur gjatë luftës. Qasja në drejtësi për viktimat e krimeve të luftës, kompensimi i viktimave të krimeve të luftës dhe hetimi e gjykimi i kryerësve të këtyre krimeve është i domosdoshëm të ndodhë. Është e domosdoshme të shtohet përgjegjësia shtetërore për të bërë më shumë drejt dokumentimit, hetimit të rasteve të krimeve të luftës dhe dënimit të kryerësve të këtyre krimeve, në mënyrë që të krijohet një paqe e qëndrueshme dhe familjet e viktimave ta kuptojnë se është vendosur drejtësia.

Gjithashtu, sa u përket personave të pagjetur, institucionet e Republikës së Kosovës nuk kanë bërë mjaftueshëm dhe kjo çështje duhet të trajtohet me prioritet. Në këto 22 vjet, institucionet e Republikës së Kosovës, krimet e luftës dhe të pagjeturit, duket se i kanë parë më shumë si punë të organizatave ndërkombëtare dhe të organizatave të shoqërisë civile. Avokati i Popullit thekson se duhet të zbulohen informacionet se ku janë të pagjeturit, është e papranueshme që fati i të pagjeturve vazhdon të mbetet peng i politikës. Duhet të ketë një strategji gjithëpërfshirëse nacionale për drejtësinë tranzicionale dhe të përfshihen të gjitha palët që t'i jepet zgjidhje kësaj çështjeje, e cila nuk bën të politizohet, por duhet të trajtohet si çështje humanitare. Shteti duhet siguruar të drejtën e qasjes në drejtësi për viktimat, të drejtën e familjarëve për të ditur për personat e zhdukur, të ndriçojë fatin e të gjithë personave të pagjetur, të bëjë përpjekje maksimale për t'i vënë para drejtësisë personat që kanë kryer krime lufte dhe ta dokumentojë e ta ruajë të vërtetën, si parakusht i domosdoshëm për krijimin e një shoqërie demokratike, pajtimin, ndërtimin e paqes dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Avokati i Popullit, sipas detyrës zyrtare, ka hapur rast për hetim, me qëllim që të vërtetojë se sa autoritetet po përmbushin detyrimin e tyre pozitiv që lidhet me katër shtyllat kryesore të drejtësisë tranzicionale: hetimi penal dhe dënimi për ata që kanë kryer krime lufte dhe krime kundër njerzimit; masat institucionale për dokumentim dhe kujtim të së kaluarës; përmbushjes së detyrimit për reparacione, si aspekt i rëndësishëm i vendosjes së drejtësisë për viktimat, njëkohësisht si komponent thelbësor i drejtësisë tranzicionale; dhe ndryshimet strukturore dhe legjislative me qëllim të rivendosjes së sundimit të ligjit dhe heqjes së kulturës së mosndëshkimit, duke rikthyer besimin institucional, si parakusht për krijimin e një shoqërie demokratike.

## VII. Bashkëpunimi ndërkombëtar

Bashkëpunimi i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj), siç është edhe Avokati i Popullit, me mekanizma ndërkombëtarë për të drejtat e njeriut, është kërkesë thelbësore e *Parimeve të Parisit*<sup>272</sup> dhe *Parimeve të Venedikut*,<sup>273</sup> sepse ato përveçse mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e njeriut, sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjen në nivel kombëtar, ato shërbejnë edhe si urë lidhëse në mbikëqyrjen e zbatimit efektiv të obligimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut që burojnë nga mekanizmat dhe dokumentet ndërkombëtare, të cilat janë pjesë e sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Ato gjithashtu janë një lidhje e rëndësishme ndërmjet autoriteteve shtetërore dhe shoqërisë civile, dhe si të tilla ndihmojnë në heqjen e pengesave në mbrojtjen e të drejtave individuale dhe përgjegjësive shtetërore në lidhje me realizimin e tyre.

Për shkak të rëndësisë që kanë këto institucione në nivel ndërkombëtar, Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm e Kombeve

272 Parimet e Parisit janë kriteret minimale që duhet t'i ketë një institucion kombëtar për të drejtat e njeriut që të konsiderohet kredibil, i pavarur dhe efektiv në arenën ndërkombëtare.

273 Parimet për Mbrojtjen dhe Promovimin e Institucioneve të Ombudsmanëve (Parimet e Venedikut) e Venedikut për Institucionet e Ombudsmanëve, Komisioni i Venedikut, [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD\(2019\)005-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdf=CDL-AD(2019)005-e)





të Bashkuara<sup>274</sup>, ka përfshirë, përmes objektivës 16.A.1: “Ekzistencën e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut të pavarura në pajtueshmëri me Parimet e Parisit”<sup>275</sup>, kjo për faktin se, siç e thotë edhe Deklarata e Meridës<sup>276</sup>: “Këto institucione do të ofrojnë një kornizë të rëndësishme për implementimin e Objektivave për Zhvillim të Qëndrueshëm, sikurse implementimi këtyre objektivave që do të kontribuojë në realizimin e të drejtave të njeriut.”

Vitin e kaluar, me qëllim të forcimit të pozitës së institucioneve të Ombudsmanëve në nivel botëror për ushtrimin e mandatit të tyre të pavarur, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, më 16 dhjetor 2020, miratoi rezolutën për “Rolin e institucioneve të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit”<sup>277</sup>, hap ky shumë i rëndësishëm, që përbën krijimin e një standardi global për këto institucione. Kurse në këtë vit, më 31 mars 2021, Këshilli i Evropës, duke i konsideruar këto institucione si shtylla për respektimin e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe demokracisë, ka miratuar Rekomandimin CM/Rec(2021)1 të Komitetit të Ministrave<sup>278</sup> lidhur me zhvillimin dhe forcimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, efektive, pluraliste dhe të pavarura. Ky rekomandim ka ripërsëritur

274 Agjenda 2030 përfshin 17 Objektiva të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZhQ). Ato janë thirrje urgjente për veprim për të gjitha vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim për një partneritet global në zbatimin e tyre. Objektivat kanë synimin kryesor për t'i dhënë fund varfërisë dhe privimeve të tjera, përmes zhvillimeve dhe ndërmarrjen e veprimeve strategjike që përmirësojnë shëndetin, arsimin, zvogëlojnë pabarazinë dhe nxisin rritjen ekonomike. Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 25 janar 2018, ka miratuar rezolutën për OZhQ-në.

275 Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, objektivi 16, i qasshëm në: [https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG\\_Indicator\\_16a1\\_Metadata.pdf](https://www.ohchr.org/Documents/Issues/HRIndicators/SDG_Indicator_16a1_Metadata.pdf)

276 Deklarata e Meridës lidhur me Rolin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në zbatimin e Agjendës 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm, neni 12, e qasshme në: <https://nhri.ohchr.org/EN/ICC/InternationalConference/12IC/Background%20Information/Merida%20Declaration%20FINAL.pdf>

277 Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara, Rezolutën lidhur me rolin e institucioneve të Ombudsmanëve dhe Mediatorëve në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit, 16 dhjetor 2020, e qasshme në: <https://undocs.org/en/A/RES/75/186>

278 Këshilli i Evropës, Rekomandimi CM/Rec(2021)1 i Komitetit të Ministrave lidhur me zhvillimin dhe forcimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut, efektive, pluraliste dhe të pavarura.

parimet që duhet të respektohen sa i përket Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut ( IKDNj), duke përfshirë:

- Të kenë bazë të fortë ligjore, në nivel kushtetues.
- T'u sigurohet qasje adekuate në informata dhe të përfshihen në të gjitha fazat e bërjes së ligjeve dhe politikave që kanë ndikim në të drejtat e njeriut.
- Të zbatohen rekomandimet e IKDNj-së dhe të bëhet obligim ligjor kthimi i përgjigjeve të arsyetuara dhe brenda afatit.
- Të ngrihet vetëdija dhe bashkëpunimi i të gjitha autoriteteve publike në ndërlidhje me mandatin, pavarësinë dhe rolin e IKDNj-së.
- Të mbrohet IKDNj-ja nga kërcënimet dhe frikësimet, duke e respektuar konfidencialitetin e informatave të mbledhura nga to.

Avokati i Popullit të Republikës së Kosovës është institucion me shumë mandate, e ndër to është edhe të veprorë si organ i barazisë (equality body). Organet e barazisë janë institucione të pavarura, që zakonisht funksionojnë në kuadër të një Institucioni Kombëtar për të Drejtat e Njeriut apo të veçanta, dhe si mision kryesor kanë ndihmën për viktimat e diskriminimit, monitorojnë dhe raportojnë për çështjet e diskriminimit dhe promovojnë barazinë në shtetet respektive. Prandaj, me qëllim të forcimit të rolit dhe pavarësisë së organeve të barazisë, Bashkimi Evropian (BE), më 24 korrik 2021, ka filluar një iniciativë të re<sup>279</sup> për vendosjen e standardeve minimale obliguese se si ato duhet të veprojnë në të gjitha bazat e diskriminimit, duke miratuar legjislacionin adekuat për vendet anëtare të Bashkimit Evropian, në formë të një direktive të re.

Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës, si institucion i pavarur kushtetues për të drejtat e njeriut, vazhdon të jetë i përkushtuar që të veprojë në pajtueshmëri të plotë me standardet ndërkombëtare për funksionimin e këtyre institucioneve, duke përfshirë bashkëpunimin e mirë me institucione të ndryshme ndërkombëtare, në kuadër të të cilit edhe në këtë vit, edhe përkundër problemeve të shkaktuara nga kriza me pandeminë globale COVID- 19, ka marrë pjesë në një numër të madh të takimeve ndërkombëtare, të renditura në listën më poshtë:

Nr	Përshkrimi i aktivitetit	Data	Organizatori
1.	Takim mes Ombudspersonëve të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë ( virtual)	20 janar 2021	Ombudsmani i Turqisë
2.	Takim lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut të krijuara nga draft protokollit i Konventës së Oviedos (virtual)	10 shkurt 2021	ENNHRI EQUINET
3.	Takim lidhur me Rezolutën e Kombeve të Bashkuara për institucionet e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve (virtual)	23 shkurt 2021	IOI
4.	Pjesëmarrje në lansimin e projektit “Përfundimi i dhunës ndaj grave në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi: Zbatimi i normave, ndryshimi i mendësisë”, Faza II - Adresimi i ndikimeve të COVID-19 (virtual)	26 shkurt 2021	UN Women
5.	Punëtorja “Trajtimi i diskriminimit në moshë: Rritja e angazhimit tonë me të rinjtë” (virtual)	1-2 mars 2021	EQUINET

279 Komisioni Evropian, Iniciativa e re për standarde obligative për organet e barazisë, [https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/13098-Equality-bodies-binding-standards\\_en](https://ec.europa.eu/info/law/better-regulation/have-your-say/initiatives/13098-Equality-bodies-binding-standards_en)

6.	Pjesëmarrje në lansimin e publikimit të ODIHR lidhur me të Drejtat e Njeriut të Personelit të Forcave të Armatosura (virtual)	5 mars 2021	ODIHR
7.	Takim virtual lidhur me hetimin e vdekjeve në burgje	12 mars 2021	Këshilli i Evropës Ombudsmeni i Burgjeve i Irlandës së Veriut
8.	Takim lidhur me punën e organeve të barazisë lidhur me fazën e vaksinimit për COVID-19 (virtual)	24 mars 2021	EQUINET
9.	Punëtori regjionale e Këshillit të Evropës "Adresimi i gjuhës së urrejtjes përmes përdorimit të komunikimit dhe qasjeve të bazuara në të drejtat e njeriut" (virtual)	29 mars 2021	Këshilli i Evropës
10.	Uebinar lidhur me punën e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut lidhur me Traktatin për Biznesin dhe të Drejtat e Njeriut (virtual)	14 prill 2021	ENNHRI
11.	Trajnim lidhur me inteligjencën artificiale (virtual)	22 prill 2021	EQUINET
12.	Takimi i Nivelit të Lartë lidhur me Rekomandimin e Këshillit të Evropës për themelimin dhe fuqizimin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, efektive, pluraliste dhe të pavarura (virtual)	26 prill 2021	ENNHRI
13.	Takimi i regjionit evropian të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (virtual)	6 maj 2021	IOI
14.	Takim rajonal lidhur me të drejtat e personave LGBTI (virtual)	17 maj 2021	Komisionari për Mbrojtje nga Diskriminimi i Shqipërisë
15.	Asambleja e Përgjithshme dhe Konferenca Botërore e Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI) (virtual)	25-27 maj 2021	IOI
16.	Vizita zyrtare tek Avokati i Popullit në Maqedoninë e Veriut Shkup, Maqedoni e Veriut	27 maj 2021	Avokati i Popullit të Maqedonisë së Veriut
	Takimi i grupit punues i Forumit Evropian të Mekanizmave Kombëtarë Parandalues	1 qershor 2021	Forumi Evropian i MKP-ve
17.	Takimi i nivelit të lartë me temë "Sigurimi i respektimit të të drejtave të njeriut të migrantëve në kufi: roli i IKDNj-së" (virtual)	2-3 qershor 2021	ENNHRI
	Takimi konsultativ i grupit punues i Forumit Evropian të Mekanizmave Kombëtarë Parandalues	18 qershor 2021	Forumi Evropian i MKP-ve
18.	Uebinari i SIGMA-s mbi zbatimin e ligjeve për procedurën administrative në Ballkanin Perëndimor (virtual)	22 qershor 2021	SIGMA
19.	Seri uebinaresh lidhur me të drejtën në shëndet dhe qasje në kujdesin shëndetësor (virtual)	22-30 qershor 2021	EQUINET
20.	Vizita zyrtare tek Avokati i Popullit në Shqipëri Tiranë, Shqipëri	22-23 qershor 2021	Avokati i Popullit të Shqipërisë

RAPORTI VJETOR 2021

21.	Vizita studimore tek Komisionari për Mbrojtje nga Diskriminimi në Shqipëri Tiranë, Shqipëri	23-25 qershor 2021	Komisionari për Mbrojtje nga Diskriminimi i Shqipërisë
22.	Konferenca Ndërkombëtare: COVID-19 dhe të Drejtat e Personave të privuar nga Liria Prishtinë, Kosovë	25 qershor 2021	Këshilli i Evropës
23.	Konferenca rajonale: Lufta kundër antigjipsizmit si parakusht për arritjen e barazisë për romët – Roli i institucioneve të Ombudsmanëve dhe organeve të barazisë (virtual)	22 qershor 2021	Equinet
24.	Uebinari i SIGMA-s lidhur me zbatimin e ligjeve për procedurën administrative në Ballkanin Perëndimor (virtual)	22 qershor 2021	SIGMA
25.	Video-konferencë lidhur me të drejtat e njeriut dhe migrantëve	7 korrik 2021	Raportuesi Special i OKB-së për të drejtat e njeriut dhe migrantëve
26.	Takim i mbyllur me institucione monitoruese lidhur me çështjen e dhunës seksuale dhe asaj me bazë gjinore në vendet në ndalim (virtual)	21 korrik 2021	ODIHR
27.	Takimi i Asociacionit të Ombudsmanëve të Frankofonisë(AOMF) me temën: “Mbrojtja e të drejtave të gjeneratave të ardhshme, cili është roli i Ombudsmanit (Avokatit të Popullit)? (virtual)	12 -13 korrik 2021	AOMF
28.	Takim lidhur me monitorimin e pavarur të paraburgimit në mbrojtjen e të drejtave të njeriut në burgje duke parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin ndaj terrorizmit (virtual)	15 korrik 2021	ODIHR
29.	Forumi i tetë rajonal lidhur me sundimin e ligjit në Evropën Juglindore Prishtinë, Kosovë	3-4 shtator 2021	Civil Rights Defenders
30.	Uebinar lidhur me teknologjitë moderne & media në punën e Ombudsmanëve (virtual)	10 shtator 2021	AOM & Mbrojtësi i të drejtave të Njeriut të Armenisë
31.	Sesioni i 71-të i Komitetit Regjional të OBSH-së për Evropën me temën: “Adresimi i pengesave në shëndetin publik dhe sigurimi se askush nuk po lihet prapa” (virtual)	17 shtator 2021	WHO
32.	Konferenca Evropiane e MKPT-së. me temën “Roli i MKPT-së në zbatimin efektiv të aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe rekomandimeve të KPT-së - Keqtrajtimi policor dhe hetimet efektive për keqtrajtimin e pohuar” (virtual)	20-22 shtator 2021	Këshilli i Evropës
33.	Takim vjetor i jashtëzakonshëm i Rrjetit Evropian për Organet e Barazisë (EQUINET) (virtual)	27 shtator 2021	EQUINET
34.	Asambleja e përgjithshme e Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI) (virtual)	29 shtator 2021	ENNHRI

35.	Takimi i dytë i Rrjetit të Mekanizmave Kombëtar kundër Torturës në Evropën Juglindore, me temën “Teknikat e intervistimit me grupet e cenushme” Budapest, Hungari	29-30 shtator 2021	Zyra e Komisionarit për të Drejtat e Njeriut të Hungarisë
36.	Asambleja e Përgjithshme dhe Konferenca Vjetore e Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM) Nafplio, Greqi	4-5 tetor 2021	AOM
37.	Kursi online lidhur me Rekomandimin e Përgjithshëm nr. 15 të ECRI për luftimin e gjuhës së urrejtjes (virtual)	13 shtator-24 tetor 2021	Këshilli i Evropës
38.	Konferenca e Trembëdhjetë Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forcat e Armatosura, me temën e përgjithshme “Kontributi i Ombudsmanëve në efektivitetin operacional të forcave të armatosura” (virtual)	18-22 tetor 2021	DCAF
39.	Seminar ndërkombëtar për përfaqësuesit e organeve të barazisë nga Ballkani Perëndimor dhe rajoni i Partneritetit Lindor, me temën: “Adresimi i gjuhës së urrejtjes përmes përdorimit të komunikimit dhe qasjeve të bazuara në të drejtat e njeriut” Strasburg, Francë	2-3 nëntor 2021	Këshilli i Evropës
40.	Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian për Organet e Barazisë (EQUINET) ( virtual)	9 nëntor 2021	EQUINET
41.	Seminar lidhur me Memorandumin e Mançesterit lidhur me themelimin e institucioneve kombëtare të Ombudsmanëve (virtual)	9-10 nëntor 2021	Ombudsmeni parlamentar për shëndetësi i Uellsit
42.	Uebinari me temën: “E Drejta për Arsimit e Personave me Aftësi të Kufizuara gjatë pandemisë COVID-19” (virtual)	10 nëntor 2021	ENNHRI Ombudsmeni i Gjeorgjisë
43.	Vizitë zyrtare në Qendrën e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara dhe në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë (virtual)	9-11 nëntor 2021	IAP
44.	Forumi për Leadership i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (virtual)	10-26 nëntor 2021	ENNHRI
45.	Konferencë e EQUINET me temën: “Ndërtimi i Qyteteve të Barabarta: Promovimi i barazisë dhe adresimin e diskriminimit në nivel lokal” (virtual)	25-26 tetor 2021	EQUINET
46.	Konferencë regjionale lidhur me krimet e urrejtjes në Evropën Juglindore Prishtinë, Kosovë	23 nëntor 2021	OSBE
47.	Kursi online lidhur me të Drejtat e Njeriut dhe Agjenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm: Çfarë roli për IKEDNJ-në në regjionin e UNECE? (virtual)	1 nëntor-31 janar 2021	ENNHRI
48.	Konferenca ndërkombëtare me temën : “Avancimi i të drejtave të të moshuarve në një epokë jetëgjatësie” (virtual)	1 dhjetor 2021	IOI AOM Ombudsmeni i Izraelit

49.	Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut: Zgjedhjet, plani strategjik, qëndrueshmëria financiare (virtual)	3 dhjetor 2021	ENNHRI
50.	Konferencë me temën: “Roli i digjitalizimit në përmirësimin e Institucioneve të Ombudsmanëve” (virtual)	6 dhjetor 2021	AOM Ombudsmani i Marokut
51.	Tryezë e rrumbullakët e shkëmbimit rajonal me temën: “Roli i organeve të barazisë dhe institucioneve të të drejtave të njeriut në gjyqësor” (virtual)	9 dhjetor 2021	OSBE
52.	Vizitë Studimore e përfaqësuesve të gjyqësorit dhe Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës në Këshillin e Evropës dhe Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut Strasbourg, Francë	13-14 dhjetor 2021	Këshilli i Evropës
53.	Trajnim lidhur me mandatin e Institucioneve Kombëtare me Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe praktikat e mira (virtual)	14 dhjetor 2021	Avokati i Popullit të Shqipërisë

Tabela: Pjesëmarrja në takime ndërkombëtare

## Bashkëpunimi me homologë dhe me organizata të tjera ndërkombëtare

Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP) i kushton një rëndësi të veçantë bashkëpunimit me homologë dhe me organizata e rrjete të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, rrjedhimisht është i përkushtuar që të përfshihet në aktivitete të ndryshme ndërkombëtare, të cilat kanë për qëllim shkëmbimin e informatave e praktikave të mira në fushën e të drejtave të njeriut dhe ngritjen e kapaciteteve. Në këtë vit, për shkak të krizës së shkaktuar nga pandemia COVID-19, IAP-ja ka realizuar më shumë takime me pjesëmarrje fizike në nivelin e shteteve fqinje, kurse takimet e tjera ndërkombëtare janë realizuar në mënyrë virtuale. Më poshtë po paraqesim, disa nga më të rëndësishmet.

IAP-ja ka memorandum bashkëpunimi të nënshkruar me Avokatin e Popullit dhe Komisionarin për Mbrojtje nga Diskriminimi të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut, prandaj në kuadër të tij, janë realizuar disa vizita.

Më 10 shkurt 2021, Avokati i Popullit të Kosovës, z. Naim Qelaj, priti në një vizitë zyrtare homologët e tij nga Shqipëria: znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit, dhe z. Robert Gajda, Komisionar për Mbrojtje nga Diskriminimi. Ata kishin ardhur për të uruar z. Qelajn për zgjedhjen e tij si Avokat i Popullit. Gjatë takimit palët po ashtu diskutuan edhe ndikimin e pandemisë COVID-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë dhe në Shqipëri dhe puna që është bërë nga të dyja institucionet në adresimin e ankesave të qytetarëve dhe u zotuan që tradita e krijuar e bashkëpunimit do të vazhdojë në shkëmbimin e ndërsjellë të stafit, si dhe mbështetje reciproke e institucioneve në rrjetet rajonale, evropiane dhe ndërkombëtare.

Më 27 maj 2021, Avokati i Popullit i Kosovës dhe ai i Shqipërisë realizuan një vizitë të përbashkët zyrtare tek homologu i tyre në Maqedoninë e Veriut. Kjo vizitë u realizua për të uruar z. Naser Ziberi për marrjen e mandatit si Avokat i Popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë kësaj vizite, z. Qelaj tha: *“Ne tashmë kemi krijuar një traditë të bashkëpunimit midis tre institucioneve. Kjo vizitë gjithashtu synon të vazhdojë në këtë frymë për të kontribuar më tej në punën tonë të përbashkët. Duke kaluar të gjithë situatën pandemike dhe duke u përballur me shumë sfida, ne kuptuam se bashkëpunimi dhe solidariteti janë dy shtyllat kryesore të shoqërisë.”*

Më datat 21-22 qershor 2021, një delegacion i kryesuar nga Avokati i Popullit, z. Naim Qelaj, realizoi një vizitë zyrtare tek institucioni homolog në Shqipëri, ku pati rastin të njihej më për së afërmi me punën dhe stafin. Gjatë kësaj vizite, ai po ashtu pati takime të ndara edhe me presidentin, kryetarin e Kuvendit dhe kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë. Pastaj, më datat 23-25 qershor 2021, një delegacion i IAP-së, i përbërë nga zyrtarët e Departamentin për Mbrojtje nga Diskriminimi, patën një vizitë studimore tek Komisionari për Mbrojtje nga Diskriminimi i Republikës së Shqipërisë. Në këtë vizitë u shkëmbyen informata lidhur me punën e këtij institucioni, organizimin, procedurat e veprimit, praktikat e trajtimit të rasteve si dhe metodologjia e hartimit të raportit vjetor. Fokus i diskutimit ishin edhe gjetja e mënyrave më të mira për përforcimin e bashkëpunimit mes mekanizmave për mbrojtje nga diskriminimi të Kosovës dhe të Shqipërisë, me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe praktikave më të mira, si dhe për të siguruar shkallë të nevojshme dhe efektive të mbrojtjes së këtyre të drejtave përballë fenomeneve negative të diskriminimit, apo sjelljeve diskriminuese.

Më 2 korrik 2021, IAP-ja priti në një takim kurtuazie Avokatin e Popullit të Turqisë, z. Seref Malkoc. Gjatë këtij takimi u diskutua puna dhe aktivitetet e institucioneve tona në çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut, me theks të veçantë në punën e bërë gjatë pandemisë. Avokati i Popullit i Turqisë, z. Malkoc, tha: *“Ai e përcjell punën e Avokatit të Popullit të Kosovës me interesim të madh dhe shtoi së në të ardhmen duhen të realizohen takime të ndërsjella në mënyrë që të thellohet bashkëpunimi ndërmjet dy institucioneve.”*

Më datat 1-2 dhjetor, IAP-ja ishte nikoqire e Takimit të Katërt Rajonal mes Avokatëve të Popullit dhe Komisionarëve për Mbrojtje nga Diskriminimi të Kosovës, të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut. Në ditën e parë të takimit, temë diskutimi ishte puna e institucioneve gjatë periudhës së pandemisë COVID-19, me theks të veçantë në sfidat rreth masave të qeverive për vaksinimin e popullatës dhe balancimi i tyre me standardet për të drejtat e njeriut, pavarësia e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut, si dhe planet dhe fushat specifike të bashkëpunimit në të ardhmen. Kurse në ditën e dytë të takimit, duke qenë se parimet lidhur me statusin e institucioneve për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut ( të ashtuquajturat: Parimet e Parisit) kërkojnë që institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut të krijojnë *“bashkëpunim efektiv me shoqërinë civile”*; në ditën e dytë të këtij takimi u realizua një forum diskutimi me përfaqësues të shoqërisë civile, i cili kishte për qëllim të spikatë sfidat e deritashme dhe mundësitë e së ardhmes në partneritetin e institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut me shoqërinë civile. Nga ky forum diskutimi dolën përfundime të rëndësishme, për të cilat do të punohet me përkushtim në të ardhmen. Në kuadër të këtij takimi, pjesëmarrësit realizuan takime të ndara edhe me presidenten dhe me kryetaren e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës.

Në anën tjetër, IAP-ja merr pjesë aktivisht edhe në aktivitetet e rrjeteve në të cilat është e anëtarësuar. Edhe në këtë vit raportues, ai mori pjesë në një sërë takimesh, shumica prej të cilave janë mbajtur në mënyrë virtuale dhe më poshtë do të përmenden ato më të rëndësishmet.

IAP-ja në këtë vit, më datat 26-27 maj 2021, mori pjesë në Asamblenë e Përgjithshme dhe Konferencën Botërore të Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanëve (IOI), e cila u organizua nga Ombudsmani i Irlandës. Temë e kësaj konference virtuale ishte *“Të japim zë atyre që nuk kanë zë”* dhe ajo mblodhi zyra të ombudsmanëve nga tërë bota, të cilët ndan praktikat e tyre më të mira në punën me grupe të cenueshme, si: të paraburgosurit, të moshuarit, fëmijët dhe adoleshentët, refugjatët dhe azilkërkuesit, të pastrehët, pakicat kombëtare si dhe personat me aftësi të kufizuara. Ajo gjithashtu trajtoi sfidat me të cilat janë përballur

ombudsmanët gjatë periudhës së krizës shëndetësore të shkaktuar nga COVID-19 dhe mënyrën se si ato janë tejkaluar. Në fund të saj u miratua edhe Deklarata e Dablinit.<sup>280</sup>

Një sërë aktiviteteve në të cilat ka marrë pjesë IAP-ja janë realizuar edhe nga ENNHRI, në të cilën ajo është anëtare.

Më datat 26-27 prill 2021 u organizua Takimi i Nivelit të Lartë lidhur me Rekomandimin e Këshillit të Evropës për zhvillimin dhe fuqizimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNj), të cilat janë të pavarura, efektive dhe pluraliste.<sup>281</sup> Sesioni i parë i këtij takimi të rëndësishëm kishte në fokus eksplorimin e rrugëve për forcimin e mëtejshëm të bashkëpunimit dhe mbështetjes midis Këshillit të Evropës dhe IKDNj-së në nivelin kombëtar dhe për pjesëmarrjen domethënëse të IKDNj-së dhe të ENNHRI-së në proceset dhe mekanizmat e Këshillit të Evropës, në pajtueshmëri me Rekomandimin e miratuar. Në këtë takim, përveç të tjerash, u kërkua edhe angazhimi i një Reporteri Special të Përhershëm të Këshillit të Evropës, i cili do të raportojë vazhdimisht për zbatimin e këtij Rekomandimi. Kurse sesioni i dytë u fokusua në ndërveprimin mes Këshillit të Evropës (mekanizmave të tij) dhe IKDNj-së dhe se si të avancohet zbatimi i Rekomandimit dhe Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në nivel nacional. Në këtë sesion u kërkua një angazhim më i shtuar i bashkëpunimit të ndërsjellë si dhe krijimi i mundësisë që IKDNj-ja të mundë të kërkojë opinione për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut nga Komisioni i Venedikut. Duke marrë parasysh diskutimet dhe rezultatet e ditës së parë të takimit, përfaqësuesit e IKDNj-së, anëtarë të ENNHRI-së, u mbledhën sërish në një takim të brendshëm në ditën e dytë, me qëllim të identifikimit të planeve strategjike për IKDNj-në dhe ENNHRI-në në ndjekjen e zbatimit të rekomandimit, dhe për krijimin e një bashkëpunimi më të ngushtë me Këshillin e Evropës, për promovimin dhe mbrojtjen më të mirë të të drejtave të njeriut në gjithë rajonin. Nga diskutimi i të dyja grupeve punuese të kësaj dite, u nxorën përfundimet në vijim:

- IKDNj kanë rol të rëndësishëm në përcjelljen e zbatimit të këtij Rekomandimi të Këshillit të Evropës;
- Organizimi i ngjarjeve me qëllim të promovimit të rekomandimit, i domosdoshëm;
- Të bëhet përkthimi dhe publikimi i tij në ueb-faqet respektive të IKDNj-së;
- Potencialisht të nxitet edhe debat parlamentar;
- Rekomandimi të promovohet duke u përfshirë në Raportin vjetor të IKDNj-së.

Përveç këtij takimi, ENNHRI-ja në periudhën prej 10-26 nëntor 2021, për herë të parë organizoi Forumin për Lidërsip të IKDNj-së. Ky forum kishte për qëllim t'i ofronte mbështetje udhëheqësve të IKDNj-së në përballjen e tyre me dilema sa u përket vendimeve të ndërlikuara që duhet të merren dhe mundësive lidhur me zgjidhjet më të mira në kuadër të punës së tyre në realizimin e mandatit. Synim kryesorë të këtij forumi ishte të kuptuarit dhe përmirësimi i udhëheqjes, përmirësimi i aftësive në fusha kritike për institucionin që drejtojmë, gjetja e zgjidhjeve dhe qasja ndaj çështjeve së bashku me ekspertë dhe me institucione të tjera homologe, si dhe ndërtimi dhe themelimi i marrëdhënieve më të forta me partnerë të tjerë për ndarjen e praktikave.<sup>282</sup>

280 Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve, Deklarata e Dablinit, e qashshme në: <https://www.theioi.org/ioi-activities/policies-principles-declarations>

281 ENNHRI, Takimi i Nivelit të Lartë lidhur me Rekomandimin e Këshillit të Evropës për zhvillimin dhe fuqizimin e Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (IKDNJ), të cilat janë të pavarura, efektive dhe pluraliste, <https://ennhri.org/online-high-level-meeting-council-of-europe-recommendation-on-the-development-and-strengthening-of-effective-pluralist-and-independent-nhris/>

282 ENNHRI, Forumi për Lidërsip të IKDNj-ve, <https://ennhri.org/news-and-blog/event/nhri-leadership-forum-2021-leading-with-others-nurturing-resilient-and-effective-nhri-leadership/>



Edhe në këtë vit, ENNHRI-ja publikoi *Raportin për Gjendjen e Sundimit të Ligjit në Evropë*<sup>283</sup>, i cili paraqet perspektivën e të gjitha institucioneve anëtare të këtij rrjeti, për gjendjen e sundimit të ligjit në shtetet e tyre, bazuar në monitorimin dhe mbledhjen e të dhënave nga institucionet anëtare, duke përfshirë edhe pjesën për Kosovën, sipas raportit të dërguar nga Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës. Të gjeturat e këtij raporti tregojnë rëndësinë e shtimit të përpjekjeve për të forcuar kornizën për respektimin e sundimit të ligjit, të drejtave të njeriut dhe demokracisë në vendet kandidatë dhe kandidatë potenciale në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian, siç parashihet në Strategjinë e Zgjerimit të Komisionit Evropian 2021 për Ballkanin Perëndimor. Në këtë kontekst, krijimi dhe forcimi i IKDNj-së është i një rëndësie të veçantë, gjithashtu si një mjet për t'ia mundur IKDNj-së të kontribuojë në një monitorim dhe ndjekje të rregullt dhe gjithëpërfshirëse të zhvillimeve që lidhen me sundimin e ligjit në rajonin e zgjerimit.<sup>284</sup>

Gjithashtu, më 3 dhjetor 2021, u mbajt Asambleja e Përgjithshme e ENNHRI-së, në të cilin u diskutua për punën e këtij rrjeti gjatë vitit. Në sesionin e parë u miratua raporti i kryesueses së rrjetit, raporti i sekretariatit, raporti financiar dhe ai i akreditimit; në sesionin e dytë u votua për zgjedhjen e kryesueses së ENNHRI-së, rol të cilin anëtarët ia besuan znj. Sirpa Rautio, nga Qendra Finlandeze për të Drejtat e Njeriut, si dhe u zgjodh bordi i ri drejtues, kurse në sesionin e tretë, të gjithë pjesëmarrësit u ndanë në grupe të vogla në të cilat u diskutua për Planin Strategjik të rrjetit për vitin 2022.

ENNHRI-ja, në bashkëpunim me Institutin Danez për të Drejtat e Njeriut, prej datës 1 nëntor kanë filluar zbatimin e një kursi online lidhur me “Agjendën 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm: Cili është Roli i NHRI-ve në rajonin e UNECE?”, i cili parashihet të zgjasë deri më 24 janar 2022. Në këtë trajnim kanë marrë pjesë 4 zyrtarë nga IAP-ja. Kursi ka për qëllim hulumtimin e mundësive se si të përdoret Agjenda për Zhvillim të Qëndrueshëm dhe platforma që ofron ajo, në nivelin, vendor, regjional dhe ndërkombëtar, për avancimin e të drejtave të njeriut dhe punës së institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut në rajon.

Siç është raportuar edhe në raportet e viteve të mëparshme, me Ligjin për Mbrojtje nga Diskriminimi, IAP-ja mori mandatin si organ i barazisë, kurse që prej vitit 2019 është edhe anëtare i Rrjetit Evropian të Organeve të Barazisë (EQUINET).

Në kornizën e këtij anëtarësimi, IAP-ja mori pjesë në disa ngjarje ndërkombëtare. Ndër më të rëndësishmet ishte edhe pjesëmarrja në një seri uebinaresh lidhur me të drejtën në shëndet dhe qasje në kujdesin shëndetësor, të cilat u mbajtën në datat 22-30 qershor 2021. Synim kryesor i këtyre uebinarëve ishte të rriste kapacitetet e organeve të barazisë lidhur me diskriminimin dhe pabarazinë në qasjen në shërbime shëndetësore, për mbrojtjen më të mirë të viktimave të diskriminimit në këtë fushë dhe të promovojë qasje të barabartë në shërbime të kujdesit shëndetësor.

Kurse më 16 tetor 2020 u mbajt edhe Asambleja e Përgjithshme e EQUINET-it, në të cilën u diskutua lidhur me punën e rrjetit gjatë vitit, si dhe u votua për kryesuesin e rrjetit dhe bordin udhëheqës, buxhetin, dhe planin e punës për vitin e ardhshëm. EQUINET gjatë vitit organizoi një sërë takimesh, konferencash dhe trajnimesh, të cilat kanë rol të jashtëzakonshëm në informimin e përgjithshëm lidhur me të rejtat në këtë fushë, por edhe në shkëmbimin dhe ngritjen e kapaciteteve të stafit të IAP-së, të cilët marrin pjesë në këto aktivitete.

283 Raporti i ENNHRI-t për Sundimin e Ligjit në Evropë, <https://ennhri.org/news-and-blog/ennhri-publishes-its-second-annual-report-on-the-state-of-the-rule-of-law-in-europe/>

284 Komunikata e ENNHRI-t lidhur me publikimin e Raportit për Sundimin e Ligjit në vendet në zgjerim, <https://ennhri.org/news-and-blog/ennhri-submits-a-report-on-the-rule-of-law-in-eu-candidate-and-potential-candidate-countries-to-inform-the-european-commission-enlargement-package-2021/>

Në kuadër të mandatit si organ barazie, IAP-ja më datën 9 dhjetor 2021, mori pjesë në tryezën rajonale më temë “Roli i Organeve të Barazisë dhe Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut në gjyqësor”, nën organizimin e Misionit të OSBE-së në Shqipëri, e cila mundësoi diskutimin e çështjeve kryesore që lidhen me punën kundër diskriminimit dhe zhvillimit të strategjive të përbashkëta për trajtimin e tyre. Fokusi kryesor i kësaj tryeze ishte diskutimi i fuqisë së padive në rastet e interesit kolektiv dhe inicimi i tyre në Gjykatën Kushtetuese, roli i organeve të barazisë në paraqitjen së rasteve gjyqësore strategjike (strategic litigation) si dhe paraqitja e rasteve Amicus Curiae nga organet e barazisë dhe Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Më datat 2-3 nëntor 2022, IAP-ja mori pjesë në Seminarin ndërkombëtar për përfaqësuesit e organeve të barazisë nga Ballkani Perëndimor dhe rajoni i Partneritetit Lindor, me temën: “Adresimi i gjuhës së urrejtjes përmes përdorimit të komunikimit dhe qasjeve të bazuara në të drejtat e njeriut”, i organizuar nga Këshilli i Evropës, në kuadër të projektit “Promovimi i diversitetit dhe barazisë në Ballkanin Perëndimor”. Seminari trajtoi nevojën për ngritjen e kapaciteteve të organeve të barazisë në adresimin e rasteve kritike të gjuhës së urrejtjes, duke përfshirë korrigjimin e dëmit të shkaktuar ndaj viktimave; shkëmbimin e përvojave të bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile, të cilat i përfaqësojnë grupet e cenueshme, duke vënë kështu kundërnarrativat e gjuhës së urrejtjes në praktikë.

Më datat 4-5 tetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në takimin e 11-të të Asociacionit të Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM), me temë “Nga deti që na ndan tek deti që na bashkon”, i cili u mbajt në Nafplio të Greqisë. Në ditën e parë të këtij takimi, fokusi i diskutimeve ishte tek njerëzit në lëvizje dhe migracioni, pastaj ndryshimet klimatike dhe katastrofat natyrore si dhe roli i rëndësishëm i institucioneve të Ombudsmanëve në trajtimin e këtyre temave. Kurse në ditën e dytë u mbajtën punimet e Asamblesë së Përgjithshme, në të cilat u diskutuan plani i aktiviteteve të kësaj shoqate për vitin e ardhshëm, raporti financiar, kërkesat e reja për anëtarësim si dhe votimi për anëtarët e rinj të bordit udhëheqës dhe ekzekutiv. Në pritjen e organizuar për nder të këtij takimi, e pranishme ishte edhe presidentja e Republikës së Greqisë, znj. Katerina Sakellariopoulou. Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës është anëtar me të drejta të plota në këtë Asociacion, që prej vitit 2016.

Bashkëpunim i mirë ekziston edhe me institucione të tjera homologe në rajon dhe më gjerë, me të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit të Republikës së Kosovës është në komunikim të përhershëm për çështje të interesit të përbashkët.

## **Anëtarësimi në organizata ndërkombëtare**

Anëtarësimi i institucioneve kombëtare për të drejtat e njeriut (IKDNj) në mekanizma dhe rrjete ndërkombëtare shërben për të avancuar marrëdhëniet dinamike që duhet të ekzistojnë ndërmjet tyre dhe sistemit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Meqë IAP-ja tashmë është anëtarësuar në rrjetet dhe organizatat më të rëndësishme ndërkombëtare, këtë vit është kujdesur që të ndërveprojë me to, duke mbajtur takime të përbashkëta, shkëmbim të informatave e praktikave të mira, që ndihmojnë në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

Më poshtë në paraqitje tabelore është evidentuar gjendja momentale e anëtarësimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit në mekanizma ndërkombëtarë:

Nr.	Rrjeti/Mekanizmi	Viti i anëtarësimit
1.	Instituti Evropian i Ombudsmanëve (EOI)	2002
2.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Fëmijë i Evropës Juglindore (CRONSEE)	2009
3.	Instituti Ndërkombëtar i Ombudsmanëve (IOI)	2012
4.	Rrjeti Evropian i Institucioneve Kombëtare për të Drejtat e Njeriut (ENNHRI)	2013
5.	Asociacionin e Ombudsmanëve dhe Ndërmjetësve të Frankofonisë (AOMF)	2015
6.	Konferenca Ndërkombëtare e Institucioneve të Ombudsmanëve për Forca të Armatosura (ICOAF)	2015
7.	Asociacioni i Ombudsmanëve të Mesdheut (AOM)	2016
8.	Rrjeti i Ombudsmanëve për Ambientin dhe të Drejtat e Njeriut <sup>285</sup>	2017
9.	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)	2019

Gjatë periudhës raportuese, Institucioni i Avokatit të Popullit ka bërë kërkesë formale për t'u anëtarësuar edhe në këto rrjete të të drejtave të njeriut:

- Më 18 qershor 2021, IAP-ja prezantoi kërkesën për aderim në Deklaratën për Bashkëpunim të Organeve të Barazisë në Evropën Juglindore, i cili është krijuar më qëllim të avancimit të bashkëpunimit për luftimin e diskriminimit dhe arritjes së barazisë së plotë për të gjithë shoqërinë në rajonin e Evropës Juglindore.
- Më 3 nëntor 2021, IAP-ja dërgoi kërkesë formale për anëtarësim edhe në Rrjetin Evropian të Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC) dhe është në pritje të përgjigjes. ENOC-i është rrjet i institucioneve të pavarura për të drejtat e fëmijëve në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Mandati i tij është të lehtësojë mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve, siç parashihet me Konventën për të Drejtat e Fëmijëve e Kombeve të Bashkuara.<sup>286</sup>

IAP-ja gjithashtu u ftuar dhe mori pjesë edhe në aktivitete të disa mekanizmave dhe rrjeteve të tjera, në të cilat, për shkak të barrierave politike, është vetëm anëtare vëzhgues, si në:

- Aleanca Botërore për Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut - GANHRI (nga e cila bëhet shqyrtimi i pajtueshmërisë së IKDNj-ve me Parimet e Parisit);<sup>287</sup>
- Rrjeti i Mekanizmave Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Evropës Juglindore - SEE NPM (në kuadër të të cilit IAP-ja merr pjesë në takime të ndryshme që kanë për qëllim bashkëpunimin, promovimin dhe shkëmbimin e përvojës, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të personave të privuar nga liria).<sup>288</sup>

## Raportimi në mekanizma të ndryshëm ndërkombëtarë

IAP-ja çdo vit pranon pyetësor të tematikave të ndryshme nga organizata ndërkombëtare për të raportuar për gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë. Edhe në këtë vit janë dërguar disa kërkesa për raporte dhe pyetësorë të cilët janë të listuar në tabelën e mëposhtme.

285 Ky rrjet është themeluar në vitin 2017 dhe është nënshkruar nga këto shtete: Bosnja, Kroacia, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Serbia dhe Sllovenia.

286 Rrjeti Evropian i Ombudspersonëve për Fëmijë (ENOC), i qasshëm në: [https://enoc.eu/?page\\_id=2316](https://enoc.eu/?page_id=2316)

287 Kusht për anëtarësim në këtë organizatë është anëtarësimi i Kosovës në Kombet e Bashkuara.

288 Kusht për anëtarësim në këtë rrjet rajonal është aderimi i Kosovës në Protokollin Opsional të Konventës kundër Torturës.

Data	Tema e raportit/hulumtimit	Organizata/institucionit të cilit i është dërguar raporti
21 qershor 2021	Përgjigje në pyetësonin hulumtues lidhur me zgjatjen e listës së bazave të mbrojtura brenda legjislacionit për mbrojtje nga diskriminimi në Evropë	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)
23 qershor 2021	Përgjigje në kërkesën për praktika të mira lidhur me integrimin e barazisë në punën e Avokatit të Popullit si organ barazie	Rrjeti Evropian i Organeve të Barazisë (EQUINET)
23 gusht 2021	Përgjigje në pyetësonin lidhur me shkallën e vetëvrasjeve brenda forcave të armatosura	Organizata Evropiane për Shoqatat dhe Sindikatat Ushtarake (EUROMIL)
17 shtator 2021	Raport lidhur me punën e Avokatit të Popullit sa i përket vaksinimit të obligueshëm për shërbyesit publikë	Zyra e Mbrojtësit të të Drejtave të Njeriut të Armenisë
2 nëntor 2021	Përgjigje në pyetësonin lidhur me kërcënimet me të cilat janë përballur Institucionet Kombëtare për të Drejtat e Njeriut dhe përgjigjet e organizatave ndërkombëtare dhe rajonale si dhe të rrjeteve të IKDNJ-ve lidhur me to	Zyra e OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejta të Njeriut (ODIHR)
3 dhjetor 2020	Raport lidhur me sistemin e ndërmjetësimit në Kosovë dhe mandatin e Avokatit të Popullit në këtë çështje	Instituti Evropian për Ndërmjetësim dhe Etikë Publike (IEMEP)

Tabela: Lista e raporteve të dërguara në organizata ndërkombëtare



## VIII. Komunikimi me publikun dhe me mediat

Si në fushat të tjera, edhe në fushën e komunikimit me publikun, Institucioni i Avokatit të Popullit i ka kushtuar vëmendje të madhe për të përçuar me kohë porositë dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit tek publiku. Gjatë vitit 2021, Avokati i Popullit ka pasur paraqitje të shumta të komunikimit me publikun, qoftë përmes mediave apo edhe përmes kanaleve të komunikimit të Institucionit, në funksion të ngritjes së vetëdijes dhe promovimit të të drejtave të njeriut.

Mediat vendore kanë mbuluar rregullisht aktivitetet e Avokatit të Popullit, ku ky i fundit ka siguruar rol aktiv në debate dhe forume duke diskutuar tema në fushën e të drejtave të njeriut. Niveli i bashkëpunimit të IAP-së me media dhe publikun është thelluar edhe më shumë gjatë këtij viti, dhe Institucioni ka vazhduar të ketë në fokus që përgjigjet në pyetjet e mediave të jenë në një afat sa më të shkurtër në mënyrë që gazetarët të raportojnë me kohë.

Gjatë tërë këtij viti, Avokati i Popullit, e po ashtu edhe përfaqësuesit e tij, kanë marrë pjesë në intervista, debate dhe diskutime online të mbuluara nga mediat online, televizione dhe radio. Përfaqësuesit e institucionit kanë folur për çështje të ndryshme të të drejtave të njeriut, siç janë: mbrojtja nga diskriminimi, barazia gjinore, të drejtat e njeriut gjatë

pandemisë, dhuna në familje, e tema të tjera që bien në mandatin dhe në kompetencat e Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit ka organizuar Ditë të Hapura, ku është takuar me qytetarët që kanë paraqitur ankesat e tyre lidhur me shkeljet e të drejtave të pretenduara.

Avokati i Popullit, po ashtu ka ndjekur me vëmendje punën e mediave dhe gjatë këtij viti ka nisur hetime për 12 raste, sipas informatave të cilat paraprakisht ishin publikuar nëpër media.

Tabela 1: Rastet e hapura Ex officio nga raportimet e mediave

<b>Raste të hapura Ex officio nga raportimet e mediave</b>	<b>12</b>
Portali "Koha.net"	2
Portali "Telegrafi.com"	2
Portali "Gazetaexpress.com"	1
Portali "Kallxo.com"	1
Portali "Frontonline"	1
Portali "Ferizaj press"	1
Portali "Arbresh.info"	1
Portali "Kossev.info"	1
Portali "o4online.info"	1
Televizioni "Kanali10"	1

Të gjitha ngjarjet, takimet dhe aktivitetet e organizuara nga Avokati i Popullit janë paraqitur gjerësisht në sektorë të ndryshëm të publikut, por edhe tek mediat. Mediat kanë qenë rregullisht të interesuara në çështjet që përfshijnë të drejtat e njeriut dhe Avokati i Popullit është përgjigjur gjithmonë pozitivisht në ftesat e mediave për të shprehur pikëpamjet e tij për çështjet që ata kanë ngritur. Publiku ka pasur mundësinë që të informohet për punën e Avokatit të Popullit edhe përmes platformës në rrjetin social Facebook, ku janë paraqitur takimet dhe opinionet e tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore dhe ka kontribuar në komunikimin intensiv në çështjet e rëndësishme për shoqërinë gjatë kohës së pandemisë. Gjatë vitit 2021, IAP-ja ka arritur që të shtojë 1.496 ndjekës të rinj duke ngritur numrin në 6.874 ndjekës (followers) deri në fund të dhjetorit.

Gjatë vitit 2021, IAP-ja ka publikuar në ueb-faqen e saj 26 raporte, prej tyre, 4 raporte mbi rastet, 9 raporte Ex officio dhe 13 raporte të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP). Këto raporte janë publikuar me informata përmbledhëse, janë dërguar tek mediat dhe janë shpërndarë po ashtu përmes faqes zyrtare dhe profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook.

Po ashtu, në periudhën raportuese 1 janar – 31 dhjetor 2021, publiku dhe mediat janë informuar me informata dhe njoftime të tjera të lidhura me aktivitetet dhe angazhimet e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të tij, të publikuara në ueb-faqen e Institucionit dhe në faqen e profilit të IAP-së në rrjetin social Facebook. Numri i përgjithshëm i komunikatave për media, lajmeve dhe informatave në ueb-faqe arrin në 99 sosh.

Në tabelën 3, paraqiten lajmet, komunikatat dhe informatat e tjera sipas muajve.

Tabela 3: Komunikata/informata/deklarata/njoftime të publikuara në ueb-faqe, sipas muajve

2021	I	II	III	IV	V	VI	VII	VIII	IX	X	XI	XII
	3	13	10	13	10	7	8	1	7	6	8	13
<b>TOTALI</b>	<b>99</b>											

Gjatë vitit 2021 janë realizuar paraqitje të shumta publike përmes masmediave (intervista, prononcime, emisione etj) nëpër televizione, portale dhe radio stacione. Ky numër i paraqitjeve në media nuk përfshin shpërndarjen apo riprodhimin e të njëjtave nga portalet elektronike apo mediat e tjera elektronike a të shkruara, që kanë huazuar materialet. Po ashtu, mediat kanë publikuar artikuj të shumtë bazuar në deklaratat e Avokatit të Popullit, reagimet apo informatat nga IAP-ja.

Në fund të vitit, Avokati i Popullit organizoi një konferencë të veçantë për media ku prezantoi të dhënat preliminare të statistikave dhe punës së bërë përgjatë vitit 2021.

Zyra për Komunikim me Publikun dhe Mediat, po ashtu menaxhon procesin e pranimit të kërkesave për qasje në dokumente publike (QDP) që i drejtohen IAP-së, si dhe procedimin e përgjigjeve të institucioneve tek palët. Gjatë vitit 2021, IAP-ja ka pranuar 15 kërkesa për qasje në dokumente publike dhe për të gjitha ka ofruar përgjigje brenda afateve ligjore. Palëve u janë dërguar dokumentet e kërkuara përmes e-mailit.





# IX. Aktivitetet e Avokatit të Popullit

## Aktivitetet e Avokatit të Popullit në promovimin e të drejtave të njeriut

Avokati i Popullit, edhe gjatë vitit raportues, përkundër sfidave të dala nga pandemia COVID-19, është përpjekur që me përkushtim ta përmbushte mandatin e tij për promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive themelore.

Edhe në këtë vit ka vazhduar aktiviteti e promovimit në fusha të ndryshme, si: nëpërmjet aktiviteteve të organizuara nga vetë Avokati i Popullit, po ashtu me përkrahje të mekanizmave ndërkombëtarë në vend, dhe të OShC-së.

Më 4 mars 2021, në Gjilan u mbajt seanca e tretë trajnuese, informuese dhe interaktive që mbështetet nga Projekti i BE-së “Mbështetje Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë”. Qëllimi ishte zhvillimi i kapaciteteve dhe rritja e vetëdijesimit për mandatin dhe rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit (IAP) në mesin e komuniteteve joshumicë.

Më 8 mars 2021, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Avokati i Popullit publikoi një komunikatë ku theksoi se një shoqëri e barabartë në aspektin gjinor, pashmangshëm nënkupton edhe pjesëmarrjen e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha sferat e jetës publike, duke filluar nga përfaqësimi i grave në pozita të larta vendimmarrëse e deri tek përfshirja

e tyre në planifikimin dhe hartimin e politikave publike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në jetesën dhe mirëqenien e të dy gjinive.

Më 17 mars 2021, Avokati i Popullit, në aktivitetin e organizuar me kryesuesin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës dhe me kryesuesin e Këshillit Prokurorial të Kosovës, dhe me bashkëpunëtorët e tyre, diskutuan lidhur me Ligjin për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Më 30 mars 2021, Avokati i Popullit ka organizuar tryezën në të cilën ka publikuar Strategjinë pesëvjeçare 2021-2025, dhe Plani për zbatimin e strategjisë 2021-2023, cila synon rritjen e ndikimit të institucionit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut dhe të lirive fundamentale si dhe në parandalimin e shkeljeve nga ana e institucioneve publike.

Më 22 prill 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tokës, publikoi deklaratë për të kërkuar vëmendjen e të gjithëve për rëndësinë e tokës, si burim i jetës dhe i shëndetit, dhe e drejtë e njeriut dhe ua rikujtoi institucionet përgjegjëse rëndësinë e orientimit të politikave në drejtim të mbrojtjes së tokës duke i kushtuar kujdes ekuilibrit në mes nevojave ekonomike dhe mirëqenies sociale me ato mjedisore, me qëllim të mbrojtjes së mjedisit për gjeneratat e sotme dhe të ardhshme, sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.

Më 27 prill 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Kombëtare për Personat e Pagjetur, publikoi deklaratë për të përkujtuar këtë ditë për personat e pagjetur dhe gjendjen e rëndë të familjeve të tyre, të cilët kërkojnë të dinë për fatin e më të dashurve të tyre. Avokati i Popullit theksoi se familjet e viktimave kanë nevojë ta përfundojnë këtë të kaluar tragjike dhe t'u lejohet të jetojnë si të tjerët duke u ofruar informacione dhe drejtësi, duke theksuar se fati i të pagjeturve duhet të jetë prioritet në çdo agjendë institucionale, në çdo takim dhe secilin rast të jetë kusht dhe adresimi i parë.

Më 1 maj 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Punës, publikoi deklaratë nëpërmjet së cilës tërhoqi vëmendjen për gjendjen jo të mirë të punëtorëve duke theksuar se shumë sfida mbesin përpara për të cilat duhet angazhim i të gjithë sektorëve për përmirësimin e kësaj gjendjeje.

Më 3 maj 2021 Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit, organizoi aktivitet si dhe nëpërmjet një deklarate të publikuar solli në vëmendje lirinë e shtypit dhe sigurinë e gazetarëve të cilat janë një ndër elementet thelbësore të një shoqërie demokratike. Avokati i Popullit ftoi sistemin e sigurisë dhe të drejtësisë t'i trajtojë me prioritet dhe t'i zgjidhë në mënyrë efektive rastet e sulmeve dhe kërcënimeve ndaj gazetarëve.

Më 11 maj 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në një tryezë diskutimi të organizuar nga Instituti GAP që prezantoi raportin e saj: "A kemi shkolla të tepërta? Nevoja për ristrukturimin e institucioneve edukativo-arsimore parauniversitare", ku theksoi se e drejta e fëmijës për arsimim nuk është vetëm çështje e qasjes në arsim por edhe e cilësisë së tij. Ai shtoi se duhet plan dhe strategji e analizuar mirë duke shfrytëzuar përvojat e vendeve që kanë kaluar këtë fazë, duke iu përshtatur nevojave dhe kushteve tona.

Më 5 qershor 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Botërore të Mjedisit, duke iu bashkuar fushatës botërore "Restaurimi i Ekosistemit", iu drejtua publikut me komunikatë përmes së cilës vuri në spikamë rëndësinë e mbrojtjes së mjedisit dhe ndikimin e tij në të drejtat e njeriut. Avokati i Popullit edhe një herë ftoi të gjitha institucionet në vend për nevojën e renditjes së mjedisit në prioritet duke u fokusuar në veçanti në masa parandaluese dhe mënjanuese, në mënyrë që të respektohet e drejta e qytetarëve për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm.

Më 2 korrik 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në hapje të fushatës për promovimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës, e organizuar nga shoqata Down Syndrome Kosova (DSK), e cila kishte në fokus të veçantë promovimin e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe ndalimin e ndëshkimit trupor, ku theksoi se fëmijët ende hasin në vështirësi për gëzimin e së drejtës për arsim dhe mbrojtje sociale dhe shëndetësore, dhe ftoi institucionet shtetërore të bëjnë më shumë në këtë drejtim, sidomos për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Më 7 shtator 2021, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me UNHCR-në dhe Programin për të Drejtat Civile (CRP/K), organizoi konferencën me temën: "*Mos lini askënd pas – Rëndësia e krijimit të identitetit ligjor dhe qasja në të drejta*". Kjo ngjarje u organizua me rastin e shënimit të përvjetorit të 60-të të Konventës së vitit 1961 për reduktimin e pashtetësisë, ku autoritetet përkatëse, përfaqësues të komunave, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile dhe personat e peregjistruar diskutuan mbi rëndësinë e regjistrimit të gjendjes civile, si dhe inkurajuan institucionet përkatëse për krijimin e mekanizmit për të identifikuar në mënyrë sistematike zgjidhjet që do t'u ofrohen personave të peregjistruar në rrezik të pashtetësisë, në përputhje me Konventën e vitit 1961 për Reduktimin e Pashtetësisë.

Më 28 shtator 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në një tryezë për të shënuar Ditën Ndërkombëtare për Qasje Universale në Informacione, e organizuar nga Agjencia për Informim dhe Privatësi.

Më 11 tetor 2021, Avokati i Popullit, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, organizuan një konferencë për shënimin e Ditës Botërore të Shëndetit Mendor, qëllimi i së cilës ishte rritja e ndërgjegjësimin të publikut për standardet evropiane në fushën e vendosjes së pavullnetshme në institucione të mbyllura psikiatrike të personave me çrregullime mendore të privuar nga liria. Konferenca u organizua në vazhden e gjetjeve dhe rekomandimeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (CPT) dhe të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKP) i Avokatit të Popullit, pas vizitave të tyre të shumta në institucionet e mbyllura psikiatrike.

Më 3 nëntor 2021, Avokati i Popullit organizoi Forumin e parë konstitutiv për dialog mes Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile,

qëllimi i të cilit ishte themelimi i një platforme të përbashkët bashkëpunimi me qëllim të identifikimit të sfidave dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut si dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në funksion të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Më 30 nëntor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në tryezën e organizuar nga OJQ “Advancing Together”, Misioni i UNHCR-së në Kosovë dhe Ministria për Komunitete dhe Kthim, me temën: “Zhvendosja në Kosovë – zbrazëtitë e vazhdueshme dhe zgjidhjet”. Në këtë ngjarje u diskutua lidhur me situatën aktuale të procesit të kthimit, sfidat e integritetit, si dhe identifikimi i nevojave për zgjidhje të qëndrueshme për të kthyerit në Kosovë dhe personat e zhvendosur brenda vendit.

Më 6 dhjetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën: “Përgjegjësia Institucionale për të Drejtat e Njeriut”, e organizuar nga Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, YIHR.

Më 10 dhjetor 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, publikoi një deklaratë në të cilën theksoi se Pandemia Covid-19 ishte një tjetër “luftë” e llojit të vet mes individit dhe shoqërisë, ku bota u desh të gjente “mesin e artë” në mes të ruajtjes së shëndetit të njerëzve dhe respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të individit, si vlera që, në një situatë të jashtëzakonshme, e kanë sfiduar jashtëzakonisht shumë njëra-tjetrën. Avokati i Popullit, në këtë ditë publikoi Raportit në lidhje me ndikimin e pandemisë Covid-19 në të drejtat e njeriut në Kosovë, me të cilin, respektimin e të drejtave dhe të lirive themelore të njeriut e ka vënë në qendër të të gjitha përpjekjeve dhe interesave të tjera shtetërore.

Më 12 dhjetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në tryezën e diskutimit: “Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut – Shkelja e të Drejtës për të Ditur”, e organizuar nga Qendra Burimore për Personat e Zhdukur, në të cilën u diskutua lidhur me shkeljet kryesore të të drejtave të njeriut, gërmimet në pritje, morgun e Prishtinës dhe Ligjin për Personat e Zhdukur, me ç’ rast pjesëmarrësit në panel u përgjigjen edhe në pyetjet e përfaqësuesve të familjarëve të personave të zhdukur në lidhje me shqetësimet e tyre sa u përket krimeve të luftës dhe zbulimit të fatit të personave të pagjetur.

Më 21 dhjetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në konferencën përmblyëse të projektit “Forcimi i Institucioneve në Luftën kundër Torturës, Keqtrajtimit dhe Trajtimeve të tjera Degraduese”, i mbështetur nga zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, e cila u organizua për t’i komunikuar rezultatet dhe arritjet e projektit që ka zgjatur 18 muaj, dhe për t’i falënderuar të gjithë partnerët, përfituesit dhe ekspertët për angazhimin e madh dhe bashkëpunimin e shkëlqyer gjatë zbatimit.

### **Bashkëpunimi me institucionet vendore dhe organizatat joqeveritare dhe promovimi i të drejtave të njeriut**

Bashkëpunimi institucional në fushën e të drejtave të njeriut me institucionet vendore dhe shoqërinë civile, ka vazhduar edhe gjatë këtij viti.

Gjatë vitit raportues, Avokati i Popullit dhe bashkëpunëtorët e tij kanë marrë pjesë në tryeza diskutimi, konferenca, takime virtuale, punëtori, trajnime, debate publike, takime konsultative e tematike si dhe në aktivitete kulturore, të organizuara nga institucionet publike dhe organizatat e shoqërisë civile. Në këto aktivitete janë trajtuar tema të ndryshme nga fusha e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut.

Në shkurt të vitit 2021, me qëllim të krijimit të bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta në fushën e të drejtave të njeriut, IAP-ja dhe Universiteti “Fehmi Agani” në Gjakovë nënshkruan një Memorandum dypalësh të Mirëkuptimit duke i dhënë fokus bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy institucioneve në frymën e barazisë, transparencës, zhvillimit e kapaciteteve të nevojshme në drejtim të studimeve shkencore, promovimin e iniciativave shkencore dhe shkëmbimin kulturor, promovimin e standardeve të larta dhe cilësisë së kërkimit dhe në veçanti promovimin dhe edukimin mbi të drejtat e njeriut.

Në maj të vitit 2021, Avokati i Popullit organizoi takim me gazetarët për nder të Ditës Botërore të Lirisë së Shtypit me të cilët diskutoi për sfidat e tyre në punë dhe për avancimin e bashkëpunimit në të ardhmen në fushën e të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtën e lirisë së mediave në veçanti.

Në qershor të vitit 2021, Avokati i Popullit dhe OJQ “Advancing Together (AT) nënshkruan vazhdimin e marrëveshjes së mirëkuptimit, e cila tashmë ka krijuar një platformë bashkëpunimi në zbatimin e projekteve në fushën e qeverisjes së mirë dhe të të drejtave të njeriut.

Më 29 korrik 2021, Avokati i Popullit priti në takim përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me aktivitete të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara, në të cilin u diskutua për punën dhe aktivitetet e shoqatave për personat e verbër, të shurdhër, fëmijët me autizëm dhe sindromin Down, e në veçanti për problemet që ata hasin në punën e tyre.

Më 25 tetor 2021, u themelua Task-forca avokuese joformale për standardet e ndjeshme gjinore të sigurisë dhe shëndetin në punë dhe punës së denjë, nga një grup i gjerë aktorë të kësaj fushe. Task-forca përbëhet nga Avokati i Popullit, si kryesues, ndërsa bashkëkryesuese do të jetë përfaqësuesja e Grupit të Grave Deputete dhe një numër i organizatave nga shoqëria civile si dhe Inspektorati i Punës, Oda Ekonomike e Kosovës, dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës. Sekretariati i Task-forcës do të sigurohet nga UN Women. Kjo Task-forcë është krijuar me qëllim të zhvillimit, avokimit dhe promovimit të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë, e cila do të krijojë një platformë për shkëmbimin e rregullt të informacionit, rritje të ndërgjegjësimit, dhe avokim për mekanizma zyrtarë funksionalë dhe dialog social në nivel kombëtar.

Më 3 nëntor 2021, Avokati i Popullit organizoi Forumin e parë konstitutiv për dialog mes Institucionit të Avokatit të Popullit në Kosovë dhe Organizatave të Shoqërisë Civile, qëllimi i të cilit është themelimi i një platforme të përbashkët bashkëpunimi me qëllim të identifikimit të sfidave dhe të shkeljeve të të drejtave të njeriut si dhe zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta në funksion të promovimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Kosovë.

Në dhjetor të vitit 2021, Avokati i Popullit dhe OJQ “Programi për të Drejtat Civile në Kosovë” (CRP/K) nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi me qëllim të bashkëpunimit për realizimin e aktiviteteve dhe projekteve të përbashkëta nga fusha e të drejtave të njeriut, synimit i së cilave konsiston me përmirësimin e respektimit të të drejtave të njeriut në vend. Fushëveprimi i marrëveshjes përfshin mbrojtjen, promovimin dhe avokimin e të drejtave të njeriut, mbrojtjen nga diskriminimi, bazuar në misionin dhe vizionin e Institucionit të Avokatit të Popullit dhe të CRP/K-së.

Sikurse Avokati i Popullit, ashtu edhe përfaqësuesit e Organizatave të Shoqërisë Civile diskutuan për rëndësinë dhe domosdoshmërinë e themelimit dhe të funksionimit të forumit, me qëllim të trajtimit të çështjeve të rëndësishme, si: të drejtat e njeriut dhe liritë

themelore në Kosovë; shkeljet sistematike të të drejtave të njeriut; promovimi i punës së Institucionit të Avokatit të Popullit dhe i Organizatave të Shoqërisë Civile që punojnë në çështjet e të drejtave të njeriut; koordinimi i aktiviteteve të përbashkëta në të ardhmen dhe bashkëpunimi i ndërsjellë.

Më 2 dhjetor 2021, Avokati i Popullit organizoi në Prishtinë tryezën e Forumit me shoqërinë civile në kuadër të Takimit të Katërt Rajonal midis Avokatëve të Popullit, Avokatit të Popullit të Shqipërisë dhe Avokatit të Popullit të Maqedonisë së Veriut, me pjesëmarrje edhe të Komisionarit të Shqipërisë për Mbrojtje nga Diskriminimi. Me këtë rast përfaqësuesit e shoqërisë civile kërkuan që në të ardhmen të jenë pjesë e këtij forumi.

## **Aktivitetet në promovimin e mbrojtjes nga diskriminimi**

Më 9 mars 2021, Avokati i Popullit organizoi tryezën në të cilën u prezantuan dy raporte me rekomandime që kanë të bëjnë me moszbatimin e ligjeve në lidhje me dhunën në familje dhe të drejtat e nënave (prindërve) vetushqyese lidhur me njohjen e pushimit vjetor. Rekomandimet për zbatimin e këtij ligji i janë bërë Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Policisë së Kosovës, prokurorive dhe gjykatave.

Më 17 maj 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare Kundër Homofobisë, Transfobisë dhe Bifobisë, publikoi deklaratë nëpërmjet së cilës vuri në spikamë garantimin e të drejtave të personave të komuniteteve LGBTI, të cilët vazhdojnë të jenë ndër grupet më të cenuara në shoqërinë tonë. Për ta shënuar këtë ditë, Avokati i Popullit iu bashkua OJQ-së CEL Kosovës për t'u solidarizuar në mbështetje të personave LGBTIQ+ duke ndarë një mesazh ndërgjegjësimit të solidaritetit.

Më 19 maj 2021, Avokati i Popullit organizoi tryezën me temën “Roli i shoqërisë civile dhe mediave në parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi”, ku morën pjesë përfaqësues nga shoqëria civile dhe nga media.

Më 29 korrik 2021, Avokati i Popullit priti në takim përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me aktivitete të dedikuara për personat me aftësi të kufizuara.

Më 15 shtator 2021, Avokati i Popullit organizoi një tryezë me përfaqësues të sistemit të drejtësisë në vend, në të cilën diskutuan për sfidat e zbatimit të Ligjit për Mbrojtje nga Diskriminimi. Duke qenë se viti 2021 ishte përcaktuar të jetë viti për promovimin e këtij ligji, në këtë tryezë ndër të tjera u vu në fokus kryesor ngritja e mëtutjeshme e vetëdijesimit të qytetarëve për ekzistimin dhe përfitimet që ky ligj ka për shoqërinë e gjerë.

Më 13 tetor 2021, Avokati i Popullit vizitoi Qendrën për Promovimin e të Drejtave të Grave në Drenas, me ç' rast u informua për së afërmi për punën dhe aktivitetet e qendrës, projektet, por edhe për sfidat me të cilat përballen. Avokati i Popullit vlerësoi lart angazhimin dhe punën e stafit të kësaj qendre në përmbushjen e misionit që kanë dhe u zotua për fuqizimin e bashkëpunimit në të ardhmen.

Më 22 tetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në shënimin e javës ndërkombëtare të njeriut me shkop të bardhë, e organizuar nga Komiteti i Grave të Verbra të Kosovës - KGVK, me temën “Fuqizimi i grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara për të forcuar vendimmarrjen e tyre”. Avokati i Popullit theksoi se institucionet vendore duhet të reflektojnë në zbatimin e legjisllacionit në mënyrë që të jetë një përfshirje më e madhe e grave me aftësi të kufizuara në tregun e punës dhe në sistemin arsimor, dhe se prapa ‘shkopit të bardhë’ fshihet një

potencial që mund të jetë kontribut i madh për shoqërinë dhe krejt çka duhet bërë është që të krijohen kushtet për të shprehur aftësinë e tyre krijuese.

Më 3 dhjetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në shënimin e Ditës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar, e organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës. Avokati i Popullit në këtë tryezë theksoi se kjo ditë e gjen komunitetin me aftësi të kufizuara me shumë probleme dhe këto vijnë për shkak të ngecjes në zbatim të ligjeve, strategjive dhe politikave sektoriale të dedikuara për këtë komunitet.

Më 3 dhjetor 2021, Avokati i Popullit takoi të verbrit e Kosovës me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, ngjarje e cila u organizua nga organizata joqeveritare Iniciativa e Pavarur e të Verbërve të Kosovës, në bashkëpunim me IAP-në. Në këtë takim morën pjesë edhe zyrtarët e tjerë institucionalë vendorë dhe ndërkombëtarë, përfaqësues të shoqërisë civile me të cilët patën rastin të bisedonin anëtarët e këtij komuniteti.

Më 7 dhjetor 2021, Avokati i Popullit mori pjesë në lansimin e raportit “Pajisjet elektronike: fokusi në parandalimin e rasteve të dhunës në familje”, i publikuar nga organizata joqeveritare “Fol”, i cili kishte për qëllim avokimin dhe tërheqjen e vëmendjes institucionale për rëndësinë e zbatimit të Ligjit për Mbikëqyrje Elektronike, që do të shërbente për mbrojtjen e viktimave të krimit në përgjithësi, e me fokus në mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje.

## **Aktivitetet në promovimin e të drejtave të fëmijëve**

Gjatë vitit raportues, në kuadër të IAP-së janë zhvilluar një sërë aktivitete për promovimin dhe avancimi e të drejtave të fëmijëve, gjithashtu përfaqësuesit e IAP-së kanë marrë pjesë në shumë aktivitete të organizuara nga institucione vendore, organizata ndërkombëtare dhe shoqëria civile në lidhje me të drejtat e fëmijëve.

Më 27, 28 dhe 29 janar 2021, përfaqësuesi i IAP-së mori pjesë në punëtorinë: *“Kontraktimin e shërbimeve sociale nga autoritetet publike (niveli qendror dhe komunal), skemën e kontraktimit, procedurat e prokurimit”*, organizuar nga Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve.

Më 3 mars 2021, Avokati i Popullit ka vizituar ekspozitën për fëmijët e vrarë gjatë luftës, në hapësirat e bibliotekës “Hivzi Sylejmani” në Prishtinë, me ç’ rast u ka bërë thirrje autoriteteve publike për nevojën e dokumentimit institucional të së kaluarës, posaçërisht për krimet që kanë ndodhur në raport me fëmijët.

Në mars 2021, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit vizituan Qendrën Ditore të Fëmijëve në Prishtinë, Qendrën Burimore “Përparimi” në Prishtinë, Qendrën e Kujdesit Ditor - PEMA në Prishtinë, me qëllim të njohjes nga afër të punës dhe veprimtarive të këtyre qendrave.

Më 23 mars 2021, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit morën pjesë në konferencën rajonale lidhur me dhunën në shkolla, e organizuar nga Child Protection Hub, ku u shpalosen gjetjet kryesore të hulumtimit rajonal, i cili u zhvillua në vitin 2020 në Shqipëri, Bosnjë-Hercegovinë, Bullgari, Kroaci, Kosovë, Moldavi, Rumania dhe Serbi, me qëllim të eksplorimit të normave shoqërore që ndikojnë në dhunën në shkolla.



Më 29 mars 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mori pjesë në një takim pune dedikuar “Ndikimit të pandemisë COVID-19 në shërbimet për mbrojtjen e fëmijës, mundësitë dhe sfidat që duhen adresuar”, organizuar nga Zyra për Qeverisje të Mirë.

Më 2 prill 2021, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit mori pjesë në takimin e trupit këshillues për kujdesin, zhvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme.

Në prill dhe maj të vitit 2021, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit, në kuadër të aktiviteteve promovuese, zhvilluan fushatën informuese “*Njihuni me Institucionin e Avokatit të Popullit*”, për nxënësit dhe mësimdhënësit e shkollës fillore dhe të mesme të ulët në komunën e Gjakovës, Suharekës, Ferizajt, Mamushës, Malishevës, Rahovecit, Han të Elezit, Podujevës, Gjilanit, Prizrenit, Shtërpcës, Shtimes, Pejës, Mitrovicës. Këto fushata u organizuan me qëllim të informimit të nxënësve dhe mësimdhënësve për rolin, mandatin dhe kompetencat e Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, veçmas në vetëdijesimin për domosdoshmërinë e parandalimit të ndëshkimit trupor nëpër shkolla, si dhe për mundësitë e tyre, që përkitazi me shkeljet e të drejtave të njeriut, t’i drejtohen këtij institucioni.

Më 1 qershor 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, nëpërmjet një deklaratë shprehu rëndësinë e kësaj date për të reflektuar si shoqëri lidhur me gjendjen e të drejtave të fëmijëve. Avokati i Popullit theksoi se fëmijët duhen të kenë një jetë pa dhunë, si e drejtë themelore dhe parakusht i domosdoshëm për shëndetin fizik dhe mendor të fëmijës. Që nga nxjerrja e ligjit të ri për mbrojtjen e fëmijëve, më 17 korrik 2020, Avokati i Popullit tërhoqi vëmendjen e të gjithë aktorëve dhe institucioneve përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji si dhe kërkon angazhim maksimal për mbrojtjen dhe garantimin e interesit më të mirë për fëmijët në Republikën e Kosovës.

Më 1 qershor 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, vizitoi qendrat burimore në Prizren “Nëna Terezë” dhe “Lef Nosi”, të cilat shërbejnë për fëmijët me nevoja të veçanta. Avokati i Popullit nënvizoi punën e mirë që po e bëjnë stafi i qendrave për këta fëmijë dhe shtoi rëndësinë e gjithëpërfshirjes në procesin edukativo-arsimor dhe obligimin që ka shteti për të siguruar qasje në edukim, shkollim dhe aftësim, e posaçërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Më 4 qershor 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mori pjesë në grupin e brendshëm punues për rishikimin e disa çështjeve që ndërliohen me Projekt Kodin Civil të Republikës së Kosovës, organizuar nga Ministria e Drejtësisë. Në këtë takim u adresua vetëm çështje nga tema “Martesa tek moshat e hershme në Projekt Kodin Civil”.

Më 4 qershor 2021, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit mori pjesë në lansimin e “Doracakëve për Mësimdhënës për Edukimin Gjithëpërfshirës Seksual me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare të Higjienës Menstruale”, organizuar nga Zyra e UNFPA-së në Kosovë.

Më 5 qershor 2021, Avokati i Popullit, me rastin e Ditës Universale të Fëmijëve, publikoi një deklaratë nëpërmjet së cilës kërkoi nga të gjitha institucionet e Kosovës që t’i shtojnë përpjekjet dhe veprimet në drejtim të përmbushjes së detyrimeve karshi fëmijëve për respektimin dhe realizimin e të drejtave të fëmijëve. Ai u bëri thirrje qeverisë dhe institucioneve përgjegjëse që në kuadër të planifikimit të tyre për rimëkëmbje ekonomike, ta marrin parasysh të drejtën e fëmijës për jetë dhe zhvillim, të hartojë dhe më pas të zbatojë një plan të përkrahjes së fëmijëve në përgjithësi, e atyre me aftësi të kufizuara në veçanti, për t’i kompensuar shërbimet shëndetësore të cilat janë pezulluar apo ndërprerë në perioda të caktuara gjatë pandemisë etj.

Më 19 nëntor 2021, për nder të Ditës Universale të Fëmijëve, në ditën e hapur për fëmijët, Avokati i Popullit priti në zyrë grupe të fëmijëve dhe diskutuan për çështjet që kanë rëndësi për ta. Ata u njoftuan më shumë për të drejtat e tyre dhe për punën e Avokatit të Popullit, si mbrojtës i të drejtave të tyre.

Më 8 dhjetor 2021, përfaqësuesi i Avokatit të Popullit mori pjesë në takimin vjetor për rishikimin e programit të UNICEF-it për vitin 2021. Qëllimi i takimit ishte: “Të rishikohet progresi i arritur për fëmijët gjatë vitit 2021 dhe të diskutohet puna në vijim për zbatimin e programit të UNICEF”

Më 15 dhjetor 2021, përfaqësuesja e Avokatit të Popullit mori pjesë në konferencën rajonale me temë “Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin – Lidhja ndërmjet sistemit të drejtësisë për të miturit dhe sistemit të mbrojtjes së fëmijëve”, organizuar nga Terre des hommes.

Më 20 dhjetor 2021, Avokati i Popullit, me mbështetje të Zyrës së Bashkimit Evropian në Kosovë, “Mbështetja e BE-së për Institucionin e Avokatit të Popullit”, organizoi tryezë diskutimi më të rinjtë e vendit, në të cilën u diskutua në lidhje me draft-broshurën për rregulloren e brendshme të IAP-së për pranimin dhe trajtimin e ankesave të fëmijëve, e cila është paraparë t’u shpërndahej fëmijëve të Kosovës që t’i kuptojnë të drejtat e tyre më mirë e më thjeshtë. Pjesëmarrësit u interesuan për numrin e ankesave të fëmijëve tek Avokati i Popullit, format e adresimit që ruajnë interesin e fëmijëve dhe ato nuk cenohen.

## **Aktivitetet dhe takimet e MKP-së me institucionet kompetente**

Gjatë periudhës për të cilën po raportohet, MKP-ja ka realizuar një numër të konsiderueshëm të aktiviteteve. Disa nga këto aktivitete u përkrahën nga Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë përmes projektit për forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Republikës së Kosovës në luftimin dhe parandalimin e torturës, trajtimeve poshtëruese dhe degraduese.

Më 8 mars 2021, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në takimin e organizuar nga Zyra e Këshillit të Evropës, me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Kosovës dhe me koordinatoren e trajnimeve të Policisë së Kosovës, ku u prezantua projekti i Këshillit të Evropës për fuqizimin e kapaciteteve të institucioneve publike për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit dhe mundësitë e bashkëpunimit.

Më 17 mars 2021, Njësia Korrektuese e EULEX-it, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë, mbajti takim me personelin e MKP-së, lidhur me trajtimin i cili planifikohej të realizohej për MKP-në, lidhur me trajtimin e të burgosurve me sëmundje mendore, nga perspektiva e personelit korrektues, me ç’ rast ata me personelin e MKP-së ndan praktikatat e tyre si ish-drejtorë të burgjeve në Suedi dhe në Holandë.

Më 29 prill 2021, në kuadër të bashkëpunimit të ndërsjellë me Njësia Korrektuese të EULEX-it, u realizua trajnimi për personelin e MKP-së, për trajtimin e të burgosurve me sëmundje mendore në burgje, me ç’ rast ata me personelin e MKP-së ndan praktikatat e tyre si ish-drejtorë të burgjeve në Suedi dhe në Holandë.

Më 12 maj 2021, MKP-ja realizoi takim me Shërbimin Korrektues të Kosovës, lidhur me rastet e regjistruara në IAP dhe sfidat e këtij institucioni në realizimin e mandatit të tij.

Më 14 maj 2021, zëvendësja e Avokatit të Popullit dhe drejtori i MKP-së realizuan takim me ministren e Drejtësisë, në të cilin u diskutuan aspekte të ndryshme, ndër to edhe implementimi i rekomandimeve si dhe lidhur me forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional.

Më 19 maj 2021, MKP-ja realizoi takim me përfaqësuesit e ShKK-së, lidhur me ndikimin e pandemisë COVID-19 në punën e këtij institucioni, si dhe sfidat me të cilën u përball gjatë periudhës së pandemisë në realizimin e detyrave të përditshme.

Më 27 maj 2021, organizuar nga Këshilli i Evropës, u mbajt video-konsultimi online ndërmjet MKP-së dhe ekspertëve të angazhuar nga Këshilli i Evropës, ku u diskutuan aspekte të ndryshme lidhur me vizitën e MKP-së në institucionet e regjionit të Pejës, si: në stacione policore, në SHIB dhe në Qendrën Paraburgimit në Pejë.

Më 18 qershor 2021, përfaqësuese të MKP-së u takuan me zyrtarët kompetentë të Policisë së Kosovës, me ç' rast u diskutua ndikimi i pandemisë COVID-19 në punën e Policisë së Kosovës.

Më 18 qershor 2021, me rastin e shënimit të 20 Qershorit - Ditës Botërore të Refugjatëve, në Vrandidoll (Qendra për Azilkërkuues) u organizua takim nga UNHCR-ja, me ç' rast u prezantuan rinovimet e bëra në këtë qendër. Në këtë solemnitet mori pjesë zëvendësja e Avokatit të Popullit, përgjegjëse për MKP-në, znj. Naile Alaj.

Më 25 qershor 2021, MKP-ja dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë, me rastin e Ditës Ndërkombëtare në Mbështetje të Viktimave të Torturës (26 Qershori), organizoi konferencë me temën: *"Impakti Covid 19 dhe të drejtat e personave të privuar nga liria"*. Në këtë konferencë, përveç institucioneve vendore, ndërkombëtare, shoqërisë civile, morën pjesë edhe përfaqësues të MKP-vë të Evropës Juglindore dhe ekspertë të mëparshëm dhe aktualë të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës (KPT).

Më 13 korrik 2021, drejtoresha e MKP-së mori pjesë në tryezën e diskutimit e organizuar nga Programi i Bashkimit Evropian për Sektorin e Drejtësisë në Kosovë (Projekti EUKOJUST) në bashkëpunim me Shërbimin Korrektues (ShKK) dhe me Shërbimin Sprovës të Kosovës (ShSK), për prezantimin e gjetjeve fillestare dhe vlerësimin e boshllëkut administrativ në funksionimin aktual të Shërbimit Korrektues dhe të atij Sprovues.

Më 7 korrik 2021, përfaqësues të MKP-së realizuan takim me IPK-në, për të diskutuar aspekte të ndryshme të hetimit të rasteve të pretendimeve të qytetarëve për keqtrajtim fizik nga zyrtarët e Policisë së Kosovës. Me këtë rast u paralajmërua se Zyra e OSBE-së për Institucionet Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR) dhe Reforma Penale Ndërkombëtare (PRI) do të fillojnë botimin e tyre të ri: *"Mbrojtja e të Drejtave të Njeriut në Burgje ndërsa Parandalon Radikalizimin që çon në Terrorizëm ose Dhuna: Një udhëzues për vëzhguesit e paraburgimit"*. Publikimi nënvizon rëndësinë e monitorimit të pavarur të paraburgimit dhe shikon në detaje një numër fushash specifike të rrezikut ndaj të drejtave të njeriut në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit që çojnë në terrorizëm në një kontekst burgu.

Më 22 korrik 2021, MKP-ja, në bashkëpunim me Zyrën e KE-së në Prishtinë, organizuan takimin e grupit punues për vlerësimin e zbatimit të disa dispozitave të caktuara të Ligjit mbi Shëndetin Mendor, për vendosjen e pavullnetshme të personave të privuar nga liria në institucionet e mbyllura të shëndetit mendor. Takimi u organizua në kuadër të projektit: Forcimi i Institucioneve të Kosovës në Luftën kundër Torturës, Keqtrajtimit dhe Trajtimeve të Tjera Degraduese, i financuar nga qeveria norvegjeze dhe implementuar nga Këshilli i Evropës, në bashkëpunim të ngushtë me Institucionin e Avokatit të Popullit.

Më 2 gusht 2021, u mbajt konsultim *online* me ekspertët e angazhuar nga Këshilli i Evropës, lidhur me vizitat e MKP-së në vendet e privimit të lirisë në rajonin e Mitrovicës, në kuadër të projektit të Këshillit të Evropës për forcimin e institucioneve në luftën kundër torturës, keqtrajtimit dhe trajtimit tjetër degradues.

Më 6 dhe 7 shtator 2021, MKP-ja dhe Zyra e Këshillit të Evropës në Prishtinë organizuan punëtori dyditore për të finalizuar Strategjinë e MKP-së për periudhën 5-vjeçare, si dhe diskutimi i Ligjit për Shëndetin Mendor.

Më 29 shtator 2021, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, me mbështetje të Këshillit të Evropës, realizoi tryezë diskutimi me temën: *“Trajtimi i pavullnetshëm me ndalim të personave me çrregullime mendore dhe zbatimi i Ligjit për shëndetin mendor”*. Në tryezë morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të shëndetit mendor. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur me sfidat dhe problemet me të cilat ballafaqohen drejtpërdrejt punëtorët shëndetësorë dhe që kërkojnë vëmendje nga ana e gjyqësorit.

Më 30 shtator 2021, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës, në bashkëpunim me Këshillin e Evropës, kanë mbajtur tryezën e dytë me temën: *“Trajtimi i pavullnetshëm me ndalim të personave me çrregullime mendore dhe zbatimi i Ligjit për shëndetin Mendor”*, ku ishin pjesëmarrës përfaqësues nga gjyqësori, prokuroria, policia, përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë, ekspertë të angazhuar nga Këshilli i Evropës si dhe disa përfaqësues nga institucionet e shëndetit mendor. Gjatë diskutimit u prezantuan sfidat që janë hasur nga profesionistët e shëndetit mendor në trajtimin e pavullnetshëm me ndalim të rasteve me çrregullime kronike psikiatrike. Gjithashtu u njoftuan institucionet e drejtësisë me mungesat që kanë institucionet e shëndetit mendor në trajtimin e këtyre rasteve me qëllim që të arrihet një koordinim ndërinstitutional për menaxhimin dhe trajtimin e pavullnetshëm të rasteve me çrregullime mendore.

Më 11 tetor 2021<sup>289</sup>, Mekanizmi Kombëtar për Parandalim të Torturës i Avokatit të Popullit, me mbështetje të Këshillit të Evropës, shënoi Ditën Botërore të Shëndetit Mendor (10 Tetori), duke organizuar konferencë rajonale me temën: *“Standardet e të Drejtave të Njeriut dhe vendosja e pavullnetshme në objektet e mbyllura të shëndetit mendor”*. Qëllimi i konferencës ishte rritja e ndërgjegjësimit të publikut për standardet ndërkombëtare për vendosjen dhe trajtimin e pavullnetshëm në institucione të mbyllura psikiatrike. Konferenca u organizua në vazhden e gjetjeve dhe rekomandimeve të MKP-së dhe gjetjeve të KPT-së pas vizitës së fundit të realizuar në Republikën e Kosovës në vitin 2020.

Më 20 dhe 21 tetor 2021, MKP-ja, me përkrahje të Këshillit të Evropës, realizoi vizitat të vlerësimit të përgjithshëm në institucionet përkatëse në regjionin e Prizrenit.

Më 2, 3, dhe 4 nëntor 2021, MKP-ja, me përkrahje të Këshillit të Evropës, realizoi vizita të përgjithshme në institucione të regjionit të Gjilanit, Ferizajt dhe Lipjanit.

Më 7 dhjetor 2021, MKP-ja, me mbështetje të Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, organizoi tryezë diskutimi me temën: *“Mandati dhe sfidat e punëtorëve social në vendet e privimit të lirisë”*. Qëllimi i tryezës ishte që të shkëmbeheshin përvojat ndërmjet MKP-së, ekspertëve nga universiteti i Prishtinës dhe punëtorëve socialë, të cilët punojnë në qendra korrektuese dhe në të paraburgimit, për të avancuar punën sociale me personat e privuar nga liria.

Më 21 dhjetor 2021, MKP-ja, me mbështetje të Këshillit të Evropës, realizoi tryezë diskutimi me temën: *“Dënimet alternative- Sa aplikohen ato tek ne?”*.

289 Shih komunikatën për media të Institucionit të Avokatit të Popullit: <https://oik-rks.org/2021/10/11/iap-shenoi-diten-boterore-te-shendetit-mendor/>, shihni komunikatën nga Ministria e Drejtësisë: <https://md.rks-gov.net/page.aspx?id=1,15,2582>.



# X. Financimi

## Buxheti i IAP-së

IAP-ja është institucion i pavarur, i cili financohet nga buxheti i Republikës së Kosovës. Sipas Ligjit për Avokatin e Popullit: *“IAP e përgatit propozimin e buxhetit të tij vjetor dhe ia dërgon për miratim Kuvendit të Republikës së Kosovës.”*<sup>290</sup> Po sipas kësaj dispozite ligjore, IAP-së i sigurohet buxhet i nevojshëm shtesë edhe për rastet e shtimit të obligimeve dhe kompetencave me këtë ligj dhe me ligjet e tjera, respektivisht edhe burime shtesë përkatëse dhe adekuate financiare dhe njerëzore.<sup>291</sup>

## Financimi i IAP-së nga Buxheti i Republikës së Kosovës

IAP-ja, bazuar në procedurat ligjore për përgatitjen dhe dorëzimin e kërkesës së rregullt buxhetore, e ka parashtruar kërkesën e vet buxhetore për vitin 2021 në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT).

Kërkesa buxhetore për vitin 2021 nga ana e Avokatit të Popullit është përgatitur mbi bazën e planifikimit të nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së për vitin kalendarik 2021, bazuar në mandatin ligjor.

290 Ligji për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, neni 35, paragrafi 3.

291 Po aty.

Buxheti i IAP-së për vitin 2021, sipas Ligjit të Buxhetit, **është ndarë në shumën prej 1.269.278.99 €**. Ky buxhet është i destinuar për këto kategori buxhetore:

1. Paga dhe mëditje, në shumën prej 982.850.99 €;
2. Mallra dhe shërbime, në shumën prej 258.928.00 €;
3. Shpenzime komunale, në shumën prej 15.000.00 €;
4. Shpenzime kapitale, në shumën prej 12.500.00 €.

Pasqyrimin e buxhetit të IAP-së për vitin 2021, sipas kërkesës buxhetore dhe në raport të buxhetit të ndarë sipas Ligjit të Buxhetit Fillestar për 2021, të shpenzimeve buxhetore dhe në raport të deklarimit të kursimeve buxhetore nga IAP-ja dhe të shkurtimeve të tjera buxhetore me Vendim të Qeverisë, do ta paraqesim në formën tabelore mbi bazën e dhënave të përgjithshme sipas kategorive ekonomike buxhetore. Kurse raportimi financiar i detajuar për vitin buxhetor 2021, për të gjitha kategoritë e nënkategoritë ekonomike buxhetore dhe nënkategoritë e veçanta ekonomike buxhetore, do të hartohet veçmas dhe do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, mbi bazën e raportimit të rregullt vjetor dhe të formularit të unifikuar për raportime financiare nga institucionet e pavarura, ashtu siç kërkohet nga ana e Komisionit për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës.<sup>292</sup>

Më konkretisht në paraqitjen tabelore në vijim do të pasqyrohet buxheti i IAP-së për vitin 2021, duke e filluar me Kërkesën buxhetore, me buxhetin fillestar të Ligjit për Buxhetin e vitit 2021, sipas Deklarimeve të kursimeve buxhetore nga IAP-ja, të shkurtimit të buxhetit me vendim të Qeverisë të Republikës të Kosovës dhe buxhetin final për vitin 2021.

<sup>292</sup> Raporti financiar i detajuar për buxhetin e IAP-së do t'i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës, sipas formularit unik për raportime financiare.

Tabela 1: Buxheti i IAP-së për vitin 2021, sipas të dhënave në vijim:

Kategoria ekonomike	Kërkesa buxhetore e IAP-së, finale, datë 25.09.2020	Buxheti i ndarë me Ligjin e Buxhetit për vitin 2021	Deklarimi i kursimeve nga IAP-ja	Shkurtime me vendim të Qeverisë	Buxheti final 2021
Paga dhe mëditje	1.051.387.00	982.850.99	0.00	( 35.279.60 )	947.571.39
Mallra dhe shërbime	258.928.00	258.928.00	( 30.000.00 )	( 10.988.87 )	217.939.13
Shpenzime komunale	15.000.00	15.000.00	( 8.500.00 )	( 1.592.38 )	4.907.62
Shpenzimet kapitale	51.500.00	12.500.00	( 4.500.00 )	( 3.000.00 )	5.000.00
<b>Gjithsej buxheti</b>	<b>1.373.815.00</b>	<b>1.269.278.99</b>	<b>(43.000.00)</b>	<b>( 50.860.85 )</b>	<b>1.175.418.14</b>

Planifikimi i buxhetit, shpenzimi i buxhetit dhe deklarimi i kursimeve buxhetore për vitin 2021 është realizuar sipas nevojave të planifikuara dhe destinacionit të përcaktuar për plotësimin e nevojave dhe të aktiviteteve të punës së IAP-së, të cilat kanë qenë me interes të sigurimit të ushtrimit të mandatit, të mbarëvajtjes së punës dhe funksionimit të IAP-së. Kurse planifikimi dhe shpenzimet e buxhetit për vitin 2021 kanë shumë të ndikuara nga situata e pandemisë, sepse një pjesë e madhe të aktiviteteve të punës nuk kanë mundur të realizoheshin sipas planit të punës së IAP-së, me ç' rast mosrealizimi i këtyre aktiviteteve të punës ka ndikuar direkt edhe në mosshpenzimin e buxhetit të planifikuara për vitin buxhetor 2021. Nga IAP-ja nuk ka mundur monitorimi dhe kontrolli i brendshëm në shfrytëzimin ekonomik dhe efikas të buxhetit.

Për vitin 2021, sipas procedurave ligjore, IAP-ja ka bërë edhe deklarimin e kursimeve buxhetore në muajin tetor 2021, në shumën totale prej 43.000.00 €. Mirëpo, me vendim të Qeverisë së Republikës të Kosovës, në muajin dhjetor 2021, është bërë harmonizimi dhe shkurtimi i buxhetit të IAP-së në kategoritë e ndryshme buxhetore edhe në masën monetare prej 50.860.85€.

## Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve për vitin 2021

Buxheti i IAP-së për vitin buxhetor 2021 është realizuar në masën monetare 1.134.291.88 €, apo shprehur në përqindje për 96.50 %, në raport me buxhetin final të fundvitit.

Në tabelën vijuese e paraqesim gjendjen e buxhetit final në raport me shpenzimet buxhetore për vitin 2021, sipas të dhënave buxhetore të kategorive ekonomike dhe të shprehura në përqindje.



Tabela 2: Buxheti final dhe realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2021

Nr.	Kategoritë ekonomike	Buxheti Final për 2021	Buxheti i shpenzuar	Mjete të lira	Realizimi në %
1.	Paga dhe mëditje	947.571.39	947.571.39	0.00	100.00
2.	Mallra dhe shërbime	217.939.13	182.212.28	35.726.55	83.61
3.	Shpenzime komunale	4.907.62	4.507.91	399.71	91.86
4.	Shpenzime kapitale	5.000.00	0.00	5.000.00	0.00
<b>Gjithsej</b>		<b>1.175.418.14</b>	<b>1.134.291.88</b>	<b>41.126.26</b>	<b>96.50</b>

# XI. Statistikat

## Përmbledhja statistikore e ankesave dhe e rasteve

Nga 1 janari 2021 deri më 31 dhjetor 2021, në Institucionin e Avokatit të Popullit, zyra qendrore në Prishtinë dhe në zyrat rajonale: Prizren, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë dhe Graçanicë janë parashtruar 1612 ankesa të qytetarëve të Kosovës, me pohimet ankimore për shkelje të të drejtave dhe të lirive të njeriut nga autoritetet publike në Republikën e Kosovës, por edhe me kërkesa për këshillë apo ndihmë juridike.

Nga analiza e ankesave të paraqitura nga qytetarët, sipas kategorive kushtetuese të të drejtave dhe të lirive të njeriut, vërehet se numri më i madh i tyre kanë të bëjnë me: *të drejtën për gjykim të drejtë dhe të paanshëm, të drejtën për mjete juridike, të drejtën e punës dhe ushtrimit të profesionit, mbrojtjen shëndetësore dhe sociale, mbrojtjen e pronës, barazia para ligjit, e drejta e qasjes në dokumente publike etj.*

Në paraqitjet e mëposhtme tabelore, në mënyrë më të detajuar janë paraqitur shënimet për numrin e përgjithshëm të ankesave të pranuar, të shqyrtuara dhe të vendosura për pranimin apo mospranimin e tyre për hetim, rastet e hapura për hetim me vetiniciativë të Avokatit të Popullit, pastaj përkatësia etnike e ankuesve dhe përkatësia gjinore, autoritetet përgjegjëse publike ndaj të cilëve janë paraqitur ankesat, numrin e

rasteve të vendosura si të përfunduara/mbyllura, numri i raporteve dhe i rekomandimeve të publikuara ndaj autoriteteve publike dhe niveli i zbatimit të rekomandimeve nga këto autoritete.

Tabela 1: Ankesat e paraqitura te Avokati i Popullit në vitin 2021

	<b>Numri i përgjithshëm i ankesave të pranuar</b>	<b>1612</b>
	Numri i personave të përfshirë në ankesa	2494
<b>Përkatësia etnike e ankuesve</b>		
	Shqiptarë	1461
	Serbë	54
	Turq	26
	Ashkalinj	18
	Boshnjakë	15
	Egjiptianë	14
	Romë	11
	Goranë	11
	Të tjerë	2
<b>Përkatësia gjinore e ankuesve</b>		
	Meshkuj	1154
	Femra	458
<b>Autoritetet publike përgjegjëse ndaj të cilave janë drejtuar ankesat (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse).</b>		
	Ministritë	484
	Gjykatat	456
	Komunat	241
	Policia	93
	Prokuroritë shtetërore	65

<b>Person privat</b>	<b>58</b>
Kompanitë private	38
Ndërmarrjet publike	27
Autoritetet e huaja	20
Agjencia Kosovare e Privatizimit	19
Të tjera	214

Tabela 2: Ankesat të vendosura si të papranueshme

<b>Numri i ankesave të papranueshme</b>	<b>939</b>
<b>Ankesat e papranueshme, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit</b>	
S'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	248
Në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	232
Mos hfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	229
Jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	160
Mosinteresim, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	56
Raporti është publikuar – Neni 24, pika 3	6
E parashtruar pas afatit ligjor - Neni 21, pika 1.3.2	4
Ankesë anonime - Neni 21, pika 1.3.3	2
Keqpërdorim i së drejtës së ankesës – Neni 21, pika 1.3.4	2

Tabela 3: Ankesat në pritje për shqyrtim

<b>Numri i ankesave në pritje për shqyrtim</b>	<b>7</b>
--	----------

Tabela 4: Ankesat të vendosura si të pranueshme për hetim

<b>Numri i ankesave të vendosura si të pranueshme për hetim</b>	<b>692</b>
<b>Numri i rasteve hetimore me iniciativë të AP (Ex officio)</b>	<b>45</b>
<b>Përkatësia etnike e ankuesve bazuar në ankesat e hetuara</b>	
Shqiptarë	599
Serbë	42
Turq	16
Goran	8
Ashkalinj	7
Romë	7
Egjiptianë	6
Boshnjakë	5
Të tjerë	2

Përkatësia gjinore e ankuesve, bazuar në ankesat e hetuara	
Meshkuj	479
Femra	213
Autoritetet publike përgjegjëse të ankesave të hetuara (një ankesë mund të ketë më shumë se një palë përgjegjëse)	
Gjykatat	246
Ministritë	226
Komunat	114
Policia	43
Prokuroritë shtetërore	27
Ndërmarrjet publike	8
Person privat	8
Kompanitë private	5
Agjencia Kosovare e Privatizimit	4
Autoritetet e huaja	1
Të tjera	92

Tabela 5: Numri i ankesave të hetuara, sipas Kapitullit II të Kushtetutës - Të Drejtat dhe Lirit Themelore (një ankesë mund të përfshijë disa të drejta e liri)

E drejta për gjykim të drejtë dhe të paanshëm	261
E drejta për mjete juridike	215
E drejta e punës dhe e ushtrimit të profesionit	138
Barazia para ligjit	77
Mbrojtja shëndetësore dhe sociale	75
Mbrojtja e pronës	62
E drejta e qasjes në dokumente publike	40
Të drejtat e fëmijës	33
E drejta për arsimin	28
Ndalimi i torturës, trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës	24
Të drejtat e të akuzuarit	18
Liria e lëvizjes	15
Dinjiteti i njeriut	13
E drejta për jetën	13
Të drejtat zgjedhore dhe të pjesëmarrjes	10
Kufizimi i të drejtave dhe i lirive themelore	9
E drejta e martesës dhe të familjes	5
Liria e mediave	5

Përgjegjësia për mjedisin jetësor	4
Liria e shprehjes	4
E drejta e integritetit personal	4
Liria e besimit, ndërgjegjes dhe e fesë	4
Mbrojtja gjyqësore e të drejtave	2
Raste për ndërmjetësim	2
E drejta e privatësisë	2
Liria e artit dhe e shkencës	1
Konfesionet fetare	1
E drejta e lirisë dhe e sigurisë	1
Liria e asociimit	1
Liria e tubimit	1

Tabela 6: Ankesat të vendosura me përfundim të hetimeve (përfshijnë ankesat e vitit 2021 dhe të viteve paraprake)

Numri i përgjithshëm i ankesave të përfunduara/mbyllura	806
<b>Ankesat e përfunduara/mbyllura, sipas neneve të Ligjit për Avokatin e Popullit</b>	
I zgjidhur në pajtim me kërkesën e ankuesit - Neni 21, pika 1.5	340
I papranueshëm, s'ka shkelje, keqadministrim - Neni 22, pika 1.1	173
I papranueshëm, në shfrytëzim të mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.3	132
I mbyllur me raport – Neni 24, pika 3	79
I papranueshëm, mosshfrytëzim i mjeteve juridike - Neni 22, pika 1.4	45
I mbyllur për mosinteresim të ankuesit, dështim i palës - Neni 22, pika 1.2	32
I papranueshëm, jashtë juridiksionit - Neni 21, pika 1.3.1	5

Tabela 7: Raportet me rekomandime, Opinionet dhe Kërkesat për masë të përkohshme.

Raporte për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	24
Raporte për rastet hetimore me iniciativë të AP, Ex officio	10
Raportet e MKP-së	13
Letra me rekomandime për ankesat e hetuara (nga ankesat e qytetarëve)	9
<b>Rekomandime në Raportet dhe letrat me rekomandime</b>	<b>157</b>
Amicus Curiae	2
Kërkesë për masë të përkohshme	2
Opinione	4

Tabela 8: Zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike përgjegjëse

Autoriteti përgjegjës	Rekomandime të zbatuara	Rekomandime të pazbatuara	Në pritje për zbatim
Qeveria e Republikës së Kosovës	0	0	22
Ministria e Drejtësisë	7	0	30
Ministria e Punëve të Brendshme	1	0	6
Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit	1	0	0
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit	2	0	5
Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës	3	0	0
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit	0	0	1
Ministria e Shëndetësisë	6	0	9
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal	1	0	2
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve	0	0	1
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale	0	0	1
Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës	0	0	2
Policia e Kosovës	4	0	8
ShSKUK	5	0	1
Dogana e Kosovës	0	0	2
Inspektorati i Punës	0	0	2
Agjencia Kosovare e Privatizimit	1	0	0
Agjencia për Informim dhe Privatësi	0	0	1
Universiteti i Prishtinës	3	0	0
Fakulteti i Arkitekturës - UP	0	0	1
Komisioni i Pavarur i Mediave	0	0	1
Këshilli Gjyqësor i Kosovës	0	0	3
Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Këshilli Gjyqësor i Kosovës	1	0	1
Këshilli Prokurorial i Kosovës	0	1	2
Gjykata Themelore në Prishtinë	1	0	3
Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave	1	0	0
Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme	0	0	1
Prokuroria Themelore në Prishtinë	1	0	0
Komuna e Prishtinës	1	0	1
Komuna e Fushë Kosovës	1	0	0

RAPORTI VJETOR 2021

Komuna e Vushtrrisë	0	0	1
Komuna e Graçanicës	0	0	1
Komuna e Ferizajt	2	0	0
Komuna e Mitrovicës së Veriut	0	2	0
Komuna e Gjilanit	0	1	0
Komuna e Deçanit	0	0	1
Komuna e Shtërpcës	0	0	1
Gjimnazi “Kuvendi i Lezhës”	1	0	0
<b>Totali</b>	<b>43</b>	<b>4</b>	<b>110</b>



## Paraqitja grafike e statistikave të ankesave të paraqitura te Avokati i Popullit - 1 janar 2021 - 31 dhjetor 2021

Figura 1: Përqindja e ankesave të qytetarëve të shqyrtuara/vendosura nga Avokati Popullit




Figura 2: Përqindja e ankesave sipas përkatësisë etnike të qytetarëve




Figura 3: Përqindja e ankesave sipas gjinisë së qytetarëve




Figura 4: Autoritetet publike përgjegjëse, sipas ankesave të qytetarëve




Figura 5: Përqindja e ankesave të hapura për hetim, sipas përkatësisë etnike të qytetarëve




Figura 6: Autoritetet publike përgjegjëse, sipas ankesave të hapura për hetim




Figura 7: Përqindja e ankesave të hetuara, sipas Kapitullit II të Kushtetutës -Të Drejtat dhe Liritë Themelore




Figura 8: Ankesat e vendosura me përfundim/mbyllje të hetimeve (përfshijnë ankesat e vitit 2021 dhe të viteve paraprahe)




Figura 9: Përqindja e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga autoritetet publike përgjegjëse





Figura 10: Përqindja e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit të publikuara gjatë vitit 2020, më 31 dhjetor 2020 dhe më 31 dhjetor 2021



## Statistikat mbi treguesin 7 të Kontratës së Reformës Sektoriale për Reformën e Administratës Publike<sup>293</sup>

Më 7 dhjetor 2017, mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian u nënshkrua Marrëveshja financiare për Instrumentin për Asistencën e Para-Anëtarësimit - IPA 2016, pjesa e dytë, për Reformën e Administratës Publike. Kontributi maksimal i Bashkimit Evropian në këtë marrëveshje është në vlerën prej 25.000.000.00 EUR.

Objektivi i përgjithshëm i kësaj marrëveshjeje: *“Synon përkrahjen e procesit të reformës së administratës në Kosovë me qëllim të rritjes së llogaridhënies, transparencës dhe efektivitetit të administratës publike, me fokus më të madh në nevojat e qytetarëve dhe bizneseve. Ky program synon të ndihmojë qeverinë e Kosovës në zbatimin e pakos strategjike të reformës së administratës publike e miratuar në vitin 2015 e fokusuar veçanërisht në përmirësimin e llogaridhënies së administratës, harmonizimin e zhvillimit dhe koordinimit të politikave, në prezantimin e menaxhimit modern të burimeve njerëzore dhe modernizimin e shërbimeve publike të orientuar drejt konsumatorit. Programi gjithashtu do të fuqizoj kapacitetet administrative të nevojshme për zhvillimin dhe zbatimin e acquis të BE-së.”<sup>294</sup>*

Vlen të theksohet se me qëllim të rritjes së nivelit të zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, kjo çështje është përfshirë në po këtë marrëveshje, përmes treguesit nr. 7, i cili parashikon që deri në vitin 2020, zbatimi i rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga institucionet e nivelit qendror të arrijë jo më pak se 60%. Ndërsa kujtojmë se në vitin 2016, sa u përket rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror, zbatimi i tyre ka qenë në shkallën 16%. Për shkak të gjendjes së krijuar me pandeminë Covid-19, pas kërkesës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Komisioni Evropian, duke marrë parasysh rrethanat e krijuara, patën dhënë dritën e gjelbër që afati i arritjes së caqeve lidhur me treguesit e përcaktuar në kontratë, të shtyhet prej fundit të vitit 2020 deri në fundin e vitit 2021.

Ripërserisim faktin se kjo kontratë përmes përfshirjes së treguesit 7, ka ndikuar jashtëzakonisht shumë në një trend gjithmonë në rritje të kthimit të përgjigjeve sa u përket rekomandimeve të adresuara për institucionet e qeverisë qendrore si dhe zbatimin të rekomandimeve në përgjithësi. Kjo është arritur falë ndërveprimit të vazhdueshëm të trekëndëshit mes Institucionit të Avokatit të Popullit, Zyrës për Qeverisje të Mirë dhe institucioneve të tjera gjegjëse, të cilave u janë adresuar rekomandimet.

Më poshtë në formë narrative dhe grafike po e paraqesim gjendjen e zbatimit të treguesit nr. 7.3.1 dhe 7.3.2 për vitin 2021:

**Treguesi 7.3.1 kërkon që të paktën 80% e institucioneve të qeverisë qendrore, të cilave Avokati i Popullit u ka adresuar rekomandime në periudhën ndërmjet 1 janarit dhe 30 nëntorit 2021, janë përgjigjur me një letër brenda afatit ligjor prej 30 ditësh.**


Avokati i Popullit, gjatë periudhës 1 janar deri më 17 dhjetor nëntor 2021, u ka adresuar 79 rekomandime institucioneve të nivelit qendror<sup>295</sup>, nga të cilat, për 63 rekomandime ka marrë përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të përcaktuar me nenet 25 dhe 28 të Ligjit nr.

293 Marrëveshja financiare për IPA 2016 - pjesa e dytë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së.

294 Marrëveshja financiare për IPA 2016 - pjesa e dytë, ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BE-së, fq. 18.

295 Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara me treguesin 7 të Marrëveshjes financiare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjendet në gazetën zyrtare në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

5/L-019 për Avokatin e Popullit,<sup>296</sup> kurse për 16 rekomandime të tjera nuk ka marrë përgjigje apo përgjigja ka arritur jashtë afatit ligjor. Me këtë nxirret konkluzioni se shkalla e zbatimit për treguesin 7.3.1 nuk e ka arritur cakun për një përqindje shumë të vogël (për vetëm 0.25 %), sepse Avokati i Popullit, gjatë periudhës së përcaktuar, ka marrë përgjigje brenda afatit ligjor prej 30 ditësh vetëm për 79.75% të rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror. Prandaj, sipas këtyre të dhënave, treguesi 7.3.1 nuk është përmbushur.




**Treguesi 7.3.2 kërkon që të paktën 60% e të gjitha rekomandimeve drejtuar institucioneve të qeverisë qendrore, të lëshuara në vitet 2019, 2020 dhe 2021, në të cilat institucionet e nivelit qendror janë përgjigjur pozitivisht, janë zbatuar.**

Avokati i Popullit, gjatë viteve 2019, 2020 dhe periudhën prej 1 janarit – 17 dhjetor 2021, u ka adresuar gjithsej 296 rekomandime institucioneve të nivelit qendror.<sup>297</sup> Në rekomandimet e adresuara gjatë së njëjtës periudhë dhe për të cilat kemi marrë përgjigje pozitive apo përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, kemi 215 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 118, apo shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit, sipas indikatorit 7.3.2, ka arritur në 54.88 %, me çka konstatohet se nuk ka arritur të përmbushet.<sup>298</sup>

<sup>296</sup> <https://www.oik-rks.org/2018/08/20/ligji-per-avokatin-e-popullit-nr-05l-019/> qasur më 13/02/2019.

<sup>297</sup> Institucionet e nivelit qendror të përcaktuara sipas listës në metodologjinë e treguesit 7 (7.3.1 dhe 7.3.2) të Marrëveshjes financiare mes Kosovës dhe Bashkimit Evropian; Kjo marrëveshje mund të gjendet në gazetën zyrtare në linkun: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15707>

<sup>298</sup> Metoda e kalkulimit është bërë sipas formulës së përcaktuar me treguesin 7.3.2: X= numri i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror gjatë periudhës së përcaktuar, për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve, janë zbatuar/numri total i rekomandimeve të adresuara institucioneve të nivelit qendror, gjatë periudhës së përcaktuar për të cilat institucionet përgjegjëse kanë kthyer përgjigje me synim pozitiv mbi zbatimin e rekomandimeve x 100.







**RAPORTI VJETOR**  
**2021**  
**Nr. 21**